


# Revista e Hulumtimeve të Studentëve





# Revista e Hulumtimeve të Studentëve

Volumi 5

Maj 2023



## Përmbajtja:

### **Departamenti i Biznes dhe Menaxhment**

Gratë sipërmarrëse në Republikën e Kosovës .....	9
<i>Ardiana Çela,</i>	
Menaxhimi i faktorëve që ndikojnë në adaptimin e shërbimeve elektronike nga klientët e bankave komerciale në Kosovë.....	33
<i>Agim Musa</i>	
Roli i menaxhmentit në ngritjen e performances së Administratës Publike në Republikën e Kosovës .....	43
<i>Rina Fetahu</i>	

### **Departamenti i Juridik-ut**

Mituria si pengesë martesore .....	53
<i>Arxhend Qaili, Erina Hoxha</i>	
Kontratat e punës në sektorin privat në Rahovec.....	65
<i>Leonit Fejzaj</i>	
Besimi fetar dhe martesë - rrethanat shoqërore të Kosovës.....	73
<i>Doart Qorrolli</i>	
Martesa në moshë të hershme .....	83
<i>Lendrita Hasani</i>	

### **Departamenti i Shkencave Politike**

Mallkimi i Resurseve .....	91
<i>Nart Hyseni</i>	
Ngjyra të njëjta – flamuj të ndryshëm – Belgjika dhe Gjermania.....	97
<i>Shpresa Tafaj</i>	
Të drejtat e punëtorëve në sektorin privat në Republikën e Kosovës.....	107
<i>Samire Dema</i>	
Dhuna ndaj grave në Kosovë .....	115
<i>Bleona Sylejmani, Gresa Jakupi</i>	
Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian- sfidat dhe përparësitë.....	121
<i>Dardan Brahim</i>	

### Departamenti i Shkencave Kompjuterike

Ndikimi i machine learning ne intelegjencen Artificiale .....	133
<i>Albion Burrniku</i>	
<i>Belinda Rexha</i>	
Përdorimi i metodave agile në zhvillimin e softuerit.....	141
<i>Faton Xhema</i>	
Llogaritja kuantike në sigurinë kibernetike .....	147
<i>Mehreme Gashi, Elita Rexha</i>	
Përdorimi i entropisë së informacionit në gjenerimin e fjalëve në lojën Wordle.....	151
<i>Shkodran Hasani</i>	

### Departamenti i Gjuhës Angleze

The Impact of Social Media on Mental Health.....	159
<i>Eda Lakna</i>	
Fake news as a propaganda tool.....	165
<i>Ndriçim Qarri</i>	
What is the Future of Journalism? .....	169
<i>Erta Reçica</i>	

### Departamenti i Fizioterapisë

Zvogëlimi i dhimbjes pas trajtimit fizioterapeutik.....	173
<i>Ali Svarca, Blinera Ademi, Ardina Rexha, Ergita Merovci</i>	
Tëndimi i kyqit të këmbës tek adoleshentet e moshës 14- 15 vjeqare .....	187
<i>Redon Havolli, Mediana Begolli, Gresa Ukaj</i>	
Efkti i fizioterapisë pas intervenimit kardio kirurgjik .....	197
<i>Vlera Xhemshiti</i>	

### Departamenti i Infermierisë

Shprehite negative të adoleshenteve në Komunën e Obiliqit .....	205
<i>Fiona Toverlani</i>	
Tumoret Intracerebrale tek Femijët .....	223
<i>Fjolla Ymeri</i>	
Qendrimi ndaj personave me aftesi te kufizuara.....	233
<i>Donjeta Halimi, Rolantina Muji, Laurena Hyseni</i>	
Kujdesi infermior ndaj Pacientit pas Ndërhyrjes Kirurgjikale .....	271
<i>Anjeza Morina, Zana Gashi</i>	

## Qëllimi

Një ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet arsimit i lartë në Republikën e Kosovës është mungesa e ndërlidhjes midis hulumtimeve bashkëkohore dhe mësimdhënies. Rrjedhimisht, problemet me financim të aktiviteteve akademike, mungesa e qendrave adekuate për hulumtim, dhe strukturave efektive të qeverisjes kanë kontribuar që Kosova të renditet e fundit në Ballkan sa i përket numrit të hulumtimeve shkencore të prodhuara për një vit. Përkundër këtyre sfidave, Kolegji Ndërkombëtar Universum (Universum International College) pretendon se procesi mësimor mund të bëhet më efektiv sa i përket cilësisë dhe përmbajtjes nëse bashkëpunimi midis studentëve dhe profesorëve thellohet, dhe në këtë mënyrë krijohet një përgjegjësi e përbashkët në kultivimin e një fryme hulumtuëse brenda institucioneve të arsimit të lartë. Një hap para drejt përmirësimit të gjendjes aktuale është themelimi i Revistës së Hulumtimeve të Studentëve që do të botohet një herë në vit nga Kolegji Ndërkombëtar Universum (Universum International College), dhe e cila ka për qëllim:

- ndërtimin e marrëdhënieve më të mira midis studentëve dhe profesorëve,
- adresimin e sfidave akademike,
- përmirësimin e shkathtësive të shkrimit, hulumtimit dhe prezantimit,
- perforcimin e tipareve positive tek studentët dhe profesorët, dhe
- trajtimin e temave të cilat janë në interes të akademisë dhe shoqërisë.

## Pjesëmarrësit

Ky është vëllimi i pestë i Revistës së Hulumtimeve të Studentëve. Komisioni vlerësues ka vendosur që këtë vit akademik aplikimet të jenë të hapura vetëm për studentët e Kolegjit Ndërkombëtar Universum (Universum International College).

Këtë vit akademik janë dorëzuar 26 aplikacione, dhe janë pranuar 26 aplikacione në listën perfundimtare të punimeve të përfshira në Revistën e Hulumtimeve të Studentëve. Nga 26 punimet hulumtuëse, 22 janë përgatitur nga studentet e nivelit baçelor dhe 4 nga studentët e nivelit master. Me konkretisht 8 punime hulumtuëse janë përgatitur nga studentët e Departamentit të Shkencave Juridike dhe 1 student nga Diplomaci, 4 nga studentet e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, 3 nga studentët e Fizioterapisë, 3 nga Studentët e Departamentit të Gjuhës Angleze, 3 studentë nga Departamenti i Biznes dhe Menaxhmentit si dhe 4 studentë nga Departamenti I Infermierisë.

## Komisioni vlerësues

Komisioni vlerësues i revistës përbëhet nga katër anëtarë të komisionit të Universum International College. Ky komision pëveç që kishte për detyrë përzgjedhjen e punimeve hulumtuese, gjithashtu kanë qenë përgjegjës për hartimin e kriterëve dhe sigurimin e cilësisë së punimeve të përzgjedhura. Lista e anëtarëve të Komisionit Vlerësues është paraqitur me poshtë:

PROF. FILIP RUXHO  
Kryetar i Komisionit Vlerësues  
[filip.ruxho@universum-ks.org](mailto:filip.ruxho@universum-ks.org)

PROF. VALON MURATI  
Dep. i shk. Politike & Juridike  
[valon.murati@universum-ks.org](mailto:valon.murati@universum-ks.org)

PROF. HYRMET MYDYTI  
Dep. i shkencave kompjuterike  
[hyrmet.mydyti@universum-ks.org](mailto:hyrmet.mydyti@universum-ks.org)

PROF. BEKIM RAMABAJA  
Dep. i Fizioterapisë  
[bekim.ramabaja@universum-ks.org](mailto:bekim.ramabaja@universum-ks.org)

## Roli i mentorëve

Në mënyrë që të rritet cilësia e punimeve të dorëzuara nga studentët, secilit student i është caktuar një profesor/profesionist i cili ka bërë mentorimin e procesit të hulumtimit dhe përgatitjes sa më profesionale të punimit hulumtues. Mentorë të cilët mund të vijnë nga akademia apo industria kanë luajtur rol të rëndësishëm në këshillimin dhe mbështetjen e studentëve ku shumica nga ata ka qenë hera e parë që përfshihen në hulumtimin e natyrës së tillë. Natyrisht që mentorët janë përkujdesur që temat e përzgjedhura nga studentët të jenë aktuale dhe të gjejnë aplikueshmëri në shoqërinë tonë. Mentorët e përfshirë në volumnin e pestë të Revistës së Hulumtimeve të Studentëve janë paraqitur si me poshtë:

PROF. TEVIDE SHABANI  
Dep. Higjienë -Tenik Dentare dhe Infermieri  
[tevide.shabani@universum-ks.org](mailto:tevide.shabani@universum-ks.org)

PROF. HYRMET MYDYTI  
Dep. Shkenca Kompjuterike  
[hyrmet.mydyti@universum-ks.org](mailto:hyrmet.mydyti@universum-ks.org)

PROF. SEJDI XHEMAJLI  
Dep. Biznes dhe Menaxhment  
[sejdi.xhemajli@universum-ks.org](mailto:sejdi.xhemajli@universum-ks.org)

PROF. BEKIM RAMABAJA  
Dep. i Fizioterapisë  
[bekim.ramabaja@universum-ks.org](mailto:bekim.ramabaja@universum-ks.org)

PROF. AVNI ALIDEMAJ  
Dep. Juridik  
[avni.alidemaj@universum-ks.org](mailto:avni.alidemaj@universum-ks.org)

PROF. ARIANIT KRYPA  
DEP. SHKENCA KOMPJUTERIKE  
[arianit.krypa@universum-ks.org](mailto:arianit.krypa@universum-ks.org)

PROF. ARTAN ALIU  
Dep. Gjuhë Angleze dhe Gjermane  
[artan.aliu@universum-ks.org](mailto:artan.aliu@universum-ks.org)

PROF. VALON MURATI  
Dep. Sh. politike dhe Juridik  
[valon.murati@universum-ks.org](mailto:valon.murati@universum-ks.org)

PROF. DONJETA ZEJNULLAHU PLLANA  
Dep. Biznes dhe Menaxhment  
[donjeta.pllana@universum-ks.org](mailto:donjeta.pllana@universum-ks.org)

PROF. BESMIR HYSENI  
Dep. Higjienë -Tenik Dentare dhe Infermieri  
[besmir.hyseni@universum-ks.org](mailto:besmir.hyseni@universum-ks.org)

PROF. FLAMUR HASIMI  
Dep. Higjienë -Tenik Dentare dhe Infermieri  
[flamur.hasimi@universum-ks.org](mailto:flamur.hasimi@universum-ks.org)

PROF. BESART PREBREZA  
DEP. SHKENCA KOMPJUTERIKE  
[besart.prebreza@universum-ks.org](mailto:besart.prebreza@universum-ks.org)



# Gratë sipërmarrëse në Republikën e Kosovës

---

Ardiana Çela,

---

## Abstrakti

Objekt shqyrtimi i këtij punimi është sipërmarrësia e grave në Republikën e Kosovës, rëndësia e sipërmarrësisë së grave dhe nevojat e tyre sipërmarrëse. Analiza e karakteristikave të sipërmarrjeve të grave është thelbësore jo vetëm për shkaqe empirike, por edhe për qëndrueshmërinë ekonomike në Kosovë. Gratë shpeshherë veprojnë me një kapacitet jo zyrtar dhe të pargjistruar. Mungesa e informacionit cilësor dhe sasior për rolin e tyre në ekonomi vështirëson zgjerimin e potencialit të kësaj vlere të kapitalit njerëzor në shoqërinë tonë. Në Kosovë, fuqizimi ekonomik për gratë është proces i kushtëzuar mbi burimet në dispozicion si dhe nuk ofron shumë mundësi dhe hapësirë grave që të promovojnë dhe të aplikojnë aftësitë e tyre në mënyrë që të përfitojnë ekonomikisht. Edhe sot pas njëzet e dy vjetëve të ndihmës për zhvillim, gratë e Kosovës e në veçanti gratë që banojnë në zonat rurale janë ende të margjinalizuara dhe kanë relativisht qasje të kufizuar në informata dhe burime. Gratë, edhe sot përballen me shumë pengesa në lidhje me rolet tradicionale gjinore që ndikojnë në mundësitë e tyre ekonomike. Mungesa e pronësisë, dhe mungesa e mbështetjes së qeverisë janë faktorë të rëndësishëm që pengojnë zhvillimin e sipërmarrjes së grave. Për të realizuar qëllimin e këtij hulumtimi mbi sipërmarrjen e grave në RKS, janë intervistuar 202 gra sipërmarrëse nga shtatë rajonet e Kosovës: Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjilan. Nga analiza e të dhënave na rezulton që ende nuk ekziston një strategji kombëtare për gratë sipërmarrëse në Kosovë, ndërsa në vendet e rajonit strategjia zhvillimore e këtyre shteteve përfshin edhe gratë sipërmarrëse.

## Fjalët kyçe:

Gratë sipërmarrëse, zhvillim ekonomik, punësim, barazi gjinore

# 1. Hyrja

Fuqizimi ekonomik i grave është një çështje e të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë sociale, që i vë gratë në një pozitë më të fortë dhe u ofron atyre fuqinë për pjesëmarrje të përbashkët në të gjitha nivelet e zhvillimit të shoqërisë si dhe për të marrë vendime që promovojnë mirëqenien e tyre dhe të familjes. Në Kosovë, fuqizimi ekonomik për gratë është proces i kushtëzuar mbi burimet në dispozicion, proces i cili nuk ofron shumë mundësi dhe hapësirë grave që të përdorin aftësitë e tyre në mënyrë që të kenë qasje dhe kontroll mbi përfitimet ekonomike. Gratë, edhe sot përballen me shumë pengesa në lidhje me rolet tradicionale gjinore që ndikojnë në mundësitë e tyre ekonomike. Mungesa e pronësisë, dhe mungesa e mbështetjes së qeverisë janë faktorë të rëndësishëm që pengojnë zhvillimin e sipërmarrjes më të grave. Gjithmonë mendohet se gratë janë prezente dhe të përfshira në të gjitha agjendat e qeverisë si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, mirëpo në realitet ato vetëm përmendën. Kjo ndodhë për arsye se mungon një dialog i strukturuar midis palëve kyçe të interesit, mungojnë mekanizmat për mbështetje institucionale për promovimin e politikave për gratë, mungojnë mekanizmat për zbatimin e strategjive dhe planeve për fuqizimin ekonomik të grave, sidomos mekanizmat lidhur me moszbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore. Këto janë vetëm disa nga faktorët që e tregojnë këtë realitet, sepse nuk ekziston mbështetje e posaçme financiare për gratë, kur dihet se qasja në financa është një faktor kritik për mundësimin e zhvillimit ekonomik. Ligjet dhe nën-ligjet fiskale nuk kanë dispozita të posaçme për nxitjen e grave në vetëpunësim. Papunësia vazhdon të jetë një sfidë e madhe për gratë.

Nëse shikojmë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, edhe sot shihet një hendek i madhë i grave. Kjo më së miri dëshmohet nga të dhënat e Agjencionit Statistikor të Kosovës (ASK), ku papunësia në Kosovë konsiderohet se është 25.8 përqind sipas TM1 2021, (29.7 përqind e të papunëve janë femra ndërsa 24.2 përqind janë meshkuj). Pjesëmarrja e meshkujve në tregun e punës dëshmohet se është dy herë më e lartë se e femrave (42.8 përqind meshkuj ndërsa 15.9 përqind femra), ndërsa sipas raportit të burrave dhe grave në punësim del se 40 përqind janë meshkuj, ndërsa 12 përqind femra që do me thënë se vetëm 12 përqind e grave kanë marrëdhënie pune të përhershme dhe me kohë të plotë. Kjo tregon qartë se në tregun e punës vazhdon të mbizotërojë pabarazia mes burrave dhe grave ku sipas rezultateve të AFP-së, në TM1 2021, fuqia joaktive është mjaft e lartë, 60.5%, me fokus të veçantë te femrat me 77.3 %, krahasuar me meshkujt, 43.5%.

## 2. Shqyrtimi i Literaturës

### 2.1 Pozita e grave dhe vajzave në shoqëri

Programi i Qeverisë 2020-2023, fokusohet specifikisht në fuqizimin e rolit të gruas dhe pozitës së grave dhe vajzave në shoqëri (Kapitulli 2 pika 2.1 Te drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe komunitetet), me qëllim të avancimit dhe fuqizimit të pozitës së tyre, hartimin

dhe zbatimin e politikave adekuate për fuqizim ekonomik të tyre, me qasje ndër sektoriale të përcjella me resurse adekuate për zbatim, qeveria do të vazhdoj me fuqizimin e mekanizmave institucional për barazi gjinore, si dhe mekanizmave institucional për mbrojtjen nga diskriminimi, përmes zbatimit me rigorozitet të Ligjit për Barazi Gjinore dhe rregulloreve përkatëse për forcimin e mekanizmave gjinorë në nivel vendi. Kosovës i mungojnë të dhëna të sakta për dallimet gjinore mbi përfshirjen në ekonominë jo-formale dhe shfrytëzimin e kohës. Analiza gjinore është thelbësore për informimin e ligjeve, politikave dhe programeve të qeverisë që të adresojnë problemet e ekonomisë jo-formale dhe të nxisin rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse duke siguruar një qasje që nuk shkakton dëme. Shumë herë nuk arrijnë të ngrejnë kokën mjaftueshëm për të shikuar mundësitë.

## **2.2 Potenciali i grave dhe të rinjve**

Krijimi i një mjedisi për rritjen të qëndrueshme përmes sektorit privat, ka qenë një ndër fokuset kryesore të përkrahjes nga Donatorët përmes organizatave të shoqërisë civile vitet e fundit, duke parë potencialin e rinisë në vendin tonë edhe pse Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon dhe përballet me nivele të larta të varfërisë dhe papunësi masive mirepo Kosova ka mundësi të mëdha investimi në energji dhe miniera, bujqësi dhe blegori, ndërtim, tekstile dhe turizëm.

## **2.3 Pronësia**

Pronësia e grave mbi pronën zgjeron aftësitë e tyre, zgjeron fuqinë e tyre negociuese dhe rrit aftësinë e tyre për të trajtuar cenueshmërinë. Është e rëndësishme që të vendosen stimuj për të tërhequr llojet e duhur të investimeve nga donatorët, që këta të fundit të përcjellin njohuritë teknike, aftësitë manaxheriale dhe kapitalin për investim në këta sektorë, dhe që paralelisht së bashku me reformat dhe transparencën qeveritare të sigurohet që këto investime të përkthehen në rritje më të lartë ekonomike me pjesëmarrje të grave.

## **2.4 Integrimi i prespektivës gjinore**

Integrimi i prespektivës gjinore mund të zbulojë nevojën për ndryshime në objektiva, strategji dhe masa, për të bërë të mundur që gratë ashtu si edhe burrat të ndikojnë, të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga proceset e zhvillimit. Kjo mund të sjellë ndryshime në organizata - struktura, procedura dhe kultura - për të krijuar mjedise organizative të favorshme për promovimin e barazisë gjinore në ekonomi.

## **2.5 Ekonomia Moderne**

Në ekonominë moderne, ristrukturimi i vazhdueshëm ekonomik, inovacioni dhe globalizimi kanë çuar në transformime të mëdha në tregjet e punës, që kanë ndikuar në krijimin e profesioneve të reja. Megjithëse, kjo shpesh ka shkakuar boshllëqe në mes të aftësive të

kërkuara nga tregu i punës dhe ato të cilat fuqia punëtore i posedon dhe tendencat e sotme tregojnë se gratë do të jenë një forcë shtytëse e rritjes së sipërmarrjes në të ardhmen. Në veçanti në vendet në zhvillim, mundësitë e ofruara nga gratë sipërmarrëse ndihmojnë në rritjen e tregjeve dhe rritjen e perspektivës së punësimit. Por pavarësisht progresit, tema është e rëndësishme për komunitetin e zhvillimit për shkak të sfidave që mbeten dhe faktit që hendeku gjinor mbetet një fenomen global. “Kjo nuk është një çështje e vendit në zhvillim - është një çështje globale,” potencoj Lee. “Ka vetëm rreth 10 vende në botë ku sipërmarrja është e barabartë.” Dhe Kosova nuk bën pjesë në këtë shifër, mirpo shteti duhet të mbështesë në mënyrë efektive sipërmarrjen e femrave dhe të monitorojnë dhe vlerësojnë vazhdimisht përpjekjet e tyre. Potenciali i grave në Kosovë në aspektin prodhues është një art i cili mund të sjellë inovacion duke kontribuar në mirëqenjen dhe pamvarsinë ekonomike dhe rritjen e prodhimit vendorë si dhe krijimin e vendeve të reja të punës, sepse prodhimi vendor mbetet gjithmonë një indikator që fuqizon ekonominë në tërësi.

Ashtu si çdo individ edhe gruaja ka vlera dhe potencial prandaj duhet ti mundësohet të realizojë potencialin e saj, pavarësisht nga gjinia, raca, etnija, ngjyra, religjioni, orinetimi seksual, niveli arsimorë si dhe statusi familjar, etj,

## 2.6 Sfidat me të cilat përballen gratë sipërmarrëse

Gratë duhet të përballen me një gamë të gjerë sfidash në biznes. Në letër, gjërat nuk janë dukur kurrë më mirë për femrat sipërmarrëse. Që nga viti 2017, më shumë se 11 milionë biznese në SHBA ishin në pronësi të grave, duke punësuar afro 9 milionë njerëz dhe duke gjeneruar 1.7 trilion dollarë në shitje, sipas Shoqatës Kombëtare të Pronareve dhe Grave në Biznes. Gratë mund të ndihen sikur duhet të përvetësojnë një qëndrim stereotip “mashkullor” ndaj biznesit: konkurrues, agresiv dhe ndonjëherë i ashpër, por CEO-të e suksesshme femra besojnë se të qëndrosh besnike ndaj vetes dhe të gjesh zërin tënd janë çelësi për t’u ngritur mbi pritshmëritë e paracaktuara. Bëhu vetvetja dhe ki besim në atë që je,” tha Hilary Genga, themeluese dhe CEO e Trunkettes. “Ju arritët atje ku jeni me punë të palodhur dhe këmbëngulje, por më e rëndësishmja, ju jeni atje.

Mos e përshtatni veten me idenë e një njeriu se si duhet të duket një udhëheqës.” Jo të gjithë themeluesit e startup-eve kërkojnë investitorë për të ndihmuar në ngritjen e bizneseve të tyre, por ata që e dinë se sa i vështirë mund të jetë procesi ky proces. Rritja e kapitalit është edhe më e vështirë për bizneset në pronësi të grave. Një raport i Kolegjit Babson (2014), zbuloi se më pak se 3% e kompanive me financim të kapitalit sipërmarrës kishin CEO gra. Ne e dimë se të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë shtylla kurrizore e ekonomise ku produktet vendore të përpunuara përgatiten kryesisht nga gratë fermerë dhe gra që jetojnë dhe punojnë në fshat ku shpesh janë në disavantazh nga pabarazia për shkak të specifikave rurale, shpesh përballen me një trefishtë ndarje: dixhitale, rurale dhe gjinore.

Hulumtimet kanë treguar se ekziston një paragjykim i nënkuptuar ndaj grave si sipërmarrëse, ku njerëzit kanë më pak gjasa të besojnë se gratë kanë aftësi për të patur sukses si sipërmarrëse. Ky perceptim e bënë më të vështirë që këto gra të sigurojnë fonde. Përveç kësaj, ky supozim kulturor se sipërmarrja është një aktivitet mashkullor mund të thyejë gratë nga konsiderimi i ndërmarrësisë në radhë të parë. (Fetsch, Jackson, Wiens, 2015). Fuqizimi

ekonomik i gruas dhe rritja e ekonomisë sipërmarrëse janë dy trende përcaktuese të kohës sonë. Gratë sipërmarrëse kanë më shumë gjasa të punojnë drejt rritjes së kontrolluar dhe fitimprurëse me një interes relativisht të vogël, thjesht që dalja e tyre të jetë fitimprurëse. Ato shpesh preferojnë të ri-investojnë fitimet e biznesit mbi investimet e kapitalit në shkallë të qëndrueshme. (Fink, 2015). Gratë sipërmarrëse kanë më shumë gjasa të punojnë drejt rritjes së kontrolluar dhe fitimprurëse me relativisht pak interes për të pozicionuar veten për një dalje fitimprurëse.

Ata shpesh preferojnë të riinvestojnë fitimet e biznesit mbi investimet e kapitalit për të shkallëzuar në mënyrë të qëndrueshme. Gratë përqafojnë gjithnjë e më shumë sipërmarrjen, ato janë pioniere në kultura të ndryshme biznesi dhe modele të rritjes sipërmarrëse.

## 2.7 Emancipimi i sipërmarrjes dhe inovacionit midis grave sipërmarrëse në vendet në zhvillim

Përmirësimi i rritjes ekonomike është i vështirë nëse përjashtohet gjysma e popullsisë. Mjerisht, pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore të Kosovës është ndër më të ulëtat në Evropë. Megjithatë, USAID-i po ndihmon gratë që të përmirësojnë aftësitë dhe të ardhurat e tyre. Më pak se 10 për qind e bizneseve në Kosovë janë të udhëhequra nga gratë ose në pronësi të grave, dhe vetëm 3 për qind e të gjitha kredive të biznesit shkojnë për gratë.

Numri i femrave ndërmarrëse në Kosovë është gjithashtu ndër më të ulët në rajon, dhe femrat shpesh hasin në më shumë barrierë sesa meshkujt kur përpiqen të themelojnë një biznes. Gratë përballen me vështirësi në marrjen e kredisë kryesisht për shkak se ato nuk zotërojnë llojin e kolateralit të nevojshëm për të siguruar kredi, të tilla si pasuri të paluajtshme, pajisje dhe tokë. Për shkak të normave kulturore, prona shpesh regjistrohet në emër të një të afërmi mashkull dhe në raste shumë të ralla në emër të një gruaje, pavarësisht që tani bëjnë thirrje shumë organizata joqeveritare që pronat e fituara së bashku të regjistrohen në emër të dy bashkëshortëve. Biljana Vicentijevic zotëron dhe operon një pastičeri në Mitrovicën e Veriut, duke përmbushur shumë role: menaxhere, kryekuzhinierë dhe shefe higjiene. Puna e saj e palodhur shpërblehet në vlerësimin e klientëve, ajo siguron që ëmbëlsirat dhe biskotat e saj jo vetëm të duken bukur, por janë edhe produkte cilësore. Çdo grua e re duhet të përpiqet të ketë një biznes, thotë Vicentijevic.

Çështja kryesore është të kesh një ide të mirë se çfarë të bësh. Ka një milion mundësi, zgjidhni atë që është më e mira për mjedisin përreth jush, një produkt unik për të ofruar. Synoni pikërisht atë që dëshironi të bëni dhe qëndroni me të nëse doni të keni sukses. Përdërisa shumë pak produkte eksportohen aktualisht nga Kosova, eksportet po përshpejtohen me shpejtësi. Pothuajse të gjitha mjedrat e prodhuara në Kosovë po eksportohen, duke rritur të ardhurat dhe duke krijuar vende të reja pune, duke përfshirë shumë vende pune për gratë. Këtë vit, një përqindje e lartë e atyre që kryenin punë sezonale duke mbledhur mjedra ishin gra dhe shumë prej tyre punojnë edhe në ferma familjare. Myzafere Bryma filloi kultivimin e mjedrave dy vite më parë dhe tani thotë: “Jam aktive gjatë gjithë kohës, punoj gjithë sezonin. Është më e vështirë, sigurisht, për një grua. Por punët e shtëpisë janë më të lehta kur bëni edhe diçka tjetër anash.

Psikologjikisht, jam më mirë. Jam krenare për veten që po bëj diçka.” Rritja e mundësive për gratë në biznes po ndihmon në rritjen e ekonomisë së Kosovës dhe forcimin e të gjithë vendit.

## 2.8 Vështrim i përgjithshëm mbi gratë sipërmarrëse dhe sipërmarrjen

Përkundër një sektori financiar të konsoliduar mirë në Kosovë, i cili dominohet nga sektori bankar, qasja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në kredi bankare është e kufizuar nga norma të larta interesi, kërkesa të larta për kolateral dhe relative mosgatishmëria e bankave për të financuar projekte të reja nga mikro dhe ndërmarrjet e vogla dhe bizneset fillestare. Sipas Mjedisit të Biznesit të Bankës Botërore/Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Anketa e Ndërmarrjeve, qasja në financa është një nga pengesat kryesore për ndërmarrjet e anketuara në Kosovë. Gratë përballen me sfida shtesë, që rrjedhin nga tradicionalja normat dhe pronat e rralla. Vetëm rreth 15 përqindja e grave sipërmarrëse kanë përdorur bankën tregtare kreditë dhe gratë zotërojnë vetëm 25.2 për qind të ndërmarrjeve në Kosova, sipas Instrumentit të Komisionit Evropian (2020) për Asistencën e Para-Aderimit. Gratë sipërmarrëse kanë vështirësi veçanërisht me financimin. Në vitin 2017, ndërmarrjet në pronësi të grave përfituan 25 herë më pak financimi se ndërmarrjet në pronësi të burrave dhe vetëm 15 përqind e gratë pronare të biznesit kanë përdorur kredi bankare komerciale, sipas Komisionit Evropian. Agjencia për Financa në Kosovë (AFK) është e katërta më e madhe institucioni mikrofinanciar në Kosovë. Ofron akses në financimi i firmave mikro dhe të vogla të drejtuara nga sipërmarrës, sidomos në zonat rurale. AFK-ja i shërben gjithë Kosovës përmes një rrjeti prej 23 degesh.

Në vitin 2020, AFK u bë institucioni i parë mikrofinanciar në vendi për t’u bashkuar programit të BERZH-it Gratë në Biznes, duke përfituar bizneset mikro, të vogla dhe të mesme të udhëhequra nga gratë. Programi i BERZH Gratë në Biznes mbështet gratë sipërmarrëse për të pasur akses në financa dhe njohuri rrisin bizneset e tyre. Gratë në Punë në internet është një projekt që u drejtua nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për trajnimin për informim punë të lidhura me teknologjinë, investimi dhe shtrirja teknike ndihmë për gratë për të punuar në internet duke përdorur tregjet e internetit. Ekonomia Dixhitale e Kosovës është një projekt i Bankës Botërore për të ofruar infrastruktura me brez të gjerë me shpejtësi të lartë dhe aksesin në fuqi punëtore tregjet, burimet e reja të njohurive dhe shërbimet publike për familjet dhe institucionet në zonat rurale. Për më tepër, projekti trajnon dhe lidh rininë me mundësi punësimi online; dhe përmirëson aksesin në burimet e njohurive, duke përfshirë arritjen dhe bashkëpunimin më të mirë mundësi për institucionet e arsimit të lartë. Veçanërisht për bizneset në pronësi të grave ishin detyrimet familjare, me rreth 47 për qind të grave që tregojnë këtë kujdesi për familjen kufizon aftësinë e tyre për t’u përfshirë aktivitete biznesi.

Duke dixhitalizuar bizneset mikro dhe të vogla në Kosovë ose duke synuar veçanërisht përmirësimet në produktivitet dhe nivelet e efikasitetit me ndihmën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Kosova mund të rrisë ndjeshëm vëllimin e produkteve me

vlerë më të lartë për t'u bërë konkurrues tregjet ndërkombëtare. Bizneset mikro dhe të vogla duhet bëhen më të shkathët. Gjithashtu, gjatë krizës pandemike dhe të saj pas kësaj, Kosova do të duhet të fokusohet në zhvillimin afatgjatë të sektorit të biznesit, i cili kërkon qasje në mundësitë e tregut, si dhe teknologjia e re dhe menaxhimi i praktikave më të mira.

## 2.9 Pse ka rëndësi mbështetja e bizneseve në pronësi të grave

Gratë në Kosovë përfaqësojnë vetëm 10 për qind të ndërmarrësve apo pronarëve të bizneseve për bizneset që janë zakonisht mikro ose të vogla. Vetëm 3 për qind e të gjitha kredive të biznesit shkojnë për gratë. Bizneset e zhvilluara nga gratë dhe ato të udhëhequra nga gratë në Kosovë janë zakonisht më të vogla dhe të përqendruara kryesisht në tregun jo-formal dhe më pak të ngjarë të operojnë në sektorë me vlerë të lartë të shtuar me potencial rritjeje. Si rezultat, një numër i madh i këtyre bizneseve nuk kanë aftësi dhe njohuri për të zgjeruar biznesin e tyre në mënyrë të suksesshme dhe të qëndrueshme ose për t'u shndërruar nga një kompani jo punëdhënëse në një punëdhënëse. Kjo është shkaktuar kryesisht nga vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë kosovare në marrjen e kredive, qasjen në informacion, tregjet e mundshme dhe teknologjinë. Shpesh atyre u mungojnë garancitë në formën e hipotekave, historisë së kredisë. Gratë e biznesit identifikojnë sfidat e tyre kryesore në kombinim me çështjet financiare si; janë rregulloret e pamjaftueshme tatimore, praktikat e këqija bankare, përgjithësisht klima e dobët e investimeve në Kosovë dhe diskriminimi nga klientët.

## 2.10 Gratë sipërmarrëse kontribuuese në Ekonominë Globale

Gratë sipërmarrëse po bëjnë të rëndësishme kontributet në ekonominë dhe shoqërinë globale. Bazuar në vendet në anketën GEM 2020, rreth 274 milionë gra në mbarë botën janë të përfshirë edhe në fillimet e biznesit në 139 milionë gra pronare/menaxhere dhe themeluese biznesi dhe 144 milionë gra investitorët informalë global. Norma e pronësisë (e përcaktuar nga GEM si zotëruese) dhe menaxhimin e një biznesi që ka paguar pagat, mëditjet ose çdo pagesë tjetër për pronarë për më shumë se 42 muaj) për grate është 5.6%, që përfaqëson një në tre të themeluar pronarët e bizneseve në mbarë botën. Mbi 5% e femrave në mbarë botën janë investitorë aktivë informalë, që përfaqësojnë mbi 40% të investitorëve informalë në botë. Pjesa më e madhe e ndikimit ekonomik, inovacioni dhe krijimi i vendeve të punës në botë ka origjinën e vet në krijimin e një biznesi të ri. Globalisht, 30.2% gratë sipërmarrëse të anketuara pritet të punësojnë gjashtë ose më shumë punonjës në pesë vitet e ardhshëm krahasuar me 48% të meshkujve sipërmarrës.

Me fjalë të tjera, gratë sipërmarrëse përfaqësojnë rreth një në tre të orientuar drejt rritjes sipërmarrësit aktivë në botë sot. Jo vetëm gratë po i afrohen barazisë me meshkujt në aktivitete fillestare, por ata janë shumë të përfshirë në sipërmarrje me rritje të lartë dhe padyshim që ka një ndikim të rëndësishëm në tregjet e tyre, komunitetet dhe kombëtare ekonomitë. Shumë gra në mbarë botën po bëjnë të rëndësishme ndikimin, pavarësisht barrierave në sistem që ndikojnë mundësitë rritjeje. Është e domosdoshme që më shumë fokusi është vendosur në ndihmën e grave sipërmarrëse dhe pronarët e bizneseve për të ndërtuar rritje të

lartë shoqërore. Sipërmarrja e grave është çelësi për rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse në ekonominë në zhvillim.

Në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, 17 për qind e grave janë sipërmarrëse dhe 35 për qind aspirojnë të bëhen sipërmarrëse. Të marra së bashku, mbi gjysma e grave në vendet në zhvillim e shohin sipërmarrjen si një rrugë drejt një të ardhmeje më të mirë, krahasuar me 25 për qind në vendet me të ardhura të larta. Megjithatë, gratë sipërmarrëse në vendet në zhvillim mbeten prapa burrave në vendet e tyre dhe grave në vendet me të ardhura më të larta në aftësinë e tyre për të transformuar aspiratat e tyre në biznese elastike dhe në rritje. Këto pabarazi nënvizojnë pse zhblokimi i potencialit të rritjes së grave sipërmarrëse është kaq kritik për fuqizimin ekonomik të grave, nxitjen e rritjes ekonomike dhe krijimin e shoqërive më të barabarta në botën në zhvillim.

### 3. Qëllimi i punimit

Studimi ka pasur për qëllim një varg objektivash për të kontribuar në zbatimin e strategjive dhe planeve për fuqizimin ekonomik të grave, me qëllim të përpjekjeve vendore për të promovuar dhe avancuar agjendën e barazisë gjinore. Sidomos zbatimin e:

- Ligjit për Barazi Gjinore
- Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore
- Indikatorët për Gratë Sipërmarrëse - Akti i Biznesit të Vogël (ABV)
- Plani në Veprim për Gratë Sipërmarrëse
- Objektivat e Mijëvjeçarit
- Strategjia Kombëtare për Mbështetjen e NVM (2012-2020)

### 4. Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza

Ky hulumtim bazohet në dy hipoteza:

- I. Sa është e përshtetshme pjesëmarrja e grave në Ekonomi?
- II. Si shikohet gruaja Sipërmarrëse nga prespektiva gjinore?

Prandaj, bazuar në dy hipoteza, konkludimet dhe rekomandimet do t'ju sigurojnë institucioneve qeveritare/jo-qeveritare, partnerëve zhvillimor dhe investitorëve vendor e të huaj një plan të politikës së ardhshme zhvillimore në strategjinë ekonomike drejtë fuqizimit të gruas. Do të pasqyroj informatat të cilat i kam grumbulluar gjatë punës në teren ku edhe kam zbatuar mbi 60 projekte të ndryshme, do të identifikojë problemet kyçe dhe pengesat financiare në procesin e zhvillimit të afarizmit; do të bëjë të dukshme iniciativat e grave dhe sukseset e tyre; do propozoj masat për të stimuluar aktivitetet e afarizmit të udhëhequra nga gratë dhe t'i zhvillojë kapacitetet menaxhuese të grave si dhe të informojë në lidhje me vizionin dhe gatishmërinë afatshkurtër dhe afatgjatë të grave sipërmarrëse.



## 5. Metodatat dhe teknikat e hulumtimit

Bazuar në pyetjen hulumtuese dhe rezultatin e pritur, është zgjedhur të përdoret metoda kualitative si qasje hulumtuese përmes pyetsorit.

### 5.1 Teknika e hulumtimit/ Analizës

Pyetësori është zhvilluar me qëllim të qartësimit të informatave mbi nevojat e grave sipërmarrëse në rajonin e Kosovës, janë identifikuar frytet e ngushta dhe mundësitë në sektorin formal të afarizmit në pronësi, apo që udhëhiqen nga gratë. Pyetësori kishte për synim nxjerrjen e informatave sa më të qarta në lidhje me nevojat e trajnimit të grave sipërmarrëse. Fushat kryesore në të cilat ishte fokusuar pyetësori përfshijnë situatën e grave sipërmarrëse duke përfshirë të dhënat e biznesit të identifikuar përmes kodeve për ruajtjen e anonimitetit të kompanive vendore, rrjetëzimet dhe partneritetet në biznes, informacionet për sipërmarrjen, qasjen në financa, burimet njerëzore dhe trajnimit.


### 5.2 Kriteret e përdorura për intervistim:

1. Kompanitë private
2. Mikro, e vogël ose e mesme (deri në 250 të punësuar)
3. Ekzistuese në treg dhe të cilat zhvillojnë aktivitet më së paku tre vite dhe
4. Në pronësi (e plotë ose të pjesërishtme) dhe të menaxhuara nga një grua

Pjesa më e madhe e pyetësorëve është plotësuar nga vetë gratë sipërmarrëse on-line (përmes internetit), një pjesë tjetër është plotësuar në vendin e ngjarjes (aty ku nuk kishte qasje në internet), ndërsa në zonat rurale gratë sipërmarrëse janë intervistuar drejtpërdrejtë dhe pyetësorët janë plotësuar në mënyrë mekanike ku janë identifikuar.

## 6. Rezultatet e hulumtimit

Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë situatën e grave sipërmarrëse në RKS, përmes përgjigjeve të tyre ku është përdorur si mostër pyetsori dhe gjithsejtë janë intervistuar 202 gra sipërmarrëse nga shtatë rajonet e Kosovës: Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjilan.



Të dhënat nga Fig.1, tregojnë llojin e veprimtarisë afariste të cilën e ushtrojnë gratë. Bazuar në hulumtim nga totali i përgjithshëm kemi një pasqyrë të të dhënave ku numri më i madh i subjekteve afariste ku pronare janë gratë, është i përqëndruar në veprimtari shërbyese me 50 përqind duke përfshirë: ndërtime, hotelerin, informacionin dhe komunikimin, financa, patundshmëri, shërbime teknike dhe shkencore, arsim, shëndetësi dhe art. Ndërsa, 21.3 përqind i përbëjnë bizneset tregtare (respektivisht shitje me shumicë dhe pakicë), 14.9 përqind të bizneseve në agrokulturë udhëheqen nga gratë (përfshirë edhe pylltarin dhe peshkimin), dhe vetëm 13.9 përqind e tyre merren me prodhimtari. Veprimtaritë që nuk kanë zbatim fare nga gratë janë minierat (gurë thyesit), energjetika (lëndët djegëse, furnizues i ajrit të kondicionuar), shërbimet e ujësjellësit (kanalizimet, menaxhimi i mbeturinave, etj), transportimi dhe magazinimin.

**Figura 2. Moshë**





Figura e dytë paraqet moshën e grave të intervistuar të cilat menaxhojnë sipërmarrjen e tyre. Nga 202 gra të intervistuar del se pjesa më e madhe e bizneseve të cilat menaxhohen nga ato janë të moshës 25-44 vjeçare, do të thotë 82.2 përqind, përderisa përqindja më e vogël e grave që udhëheqin bizneset e tyre sipas të dhënave është moshë 45-60 vjeç, me 17.4 përqind dhe moshë deri në 24 vjeç, që udhëheqin sipërmarrjet sipas të dhënave përbëjnë vetëm 0.5 përqind.

**Figura 3. Partnerët në Biznes**




Sa i përketë partneritetit në biznes, të dhënat tregojnë se 54 përqind e grave kanë filluar biznesin vetëm (pa partner), përderisa 46 përqind e sipërmarrjeve udhëheqen nga partnerë të përbashkët që nga fillimi i aktivitetit të tyre.

**Figura 4. Qëllimi/arsyeja e hapjes së veprimtarisë**




Nga të dhënat e dala në fig.4, shohim se një ndër qëllimet kryesore të grave për hapjen e biznesit është pavarësia ekonomike, ku 51 përqind e konfirmojnë, përderisa 23.8 përqind e tyre konfirmojnë se nuk kanë pasur mundësi të zgjedhjes për punësim, ndërsa 8.4 përqind janë motivuar duke parë përparësitë që një biznes ju ofron. Një pjesë e tyre, 5.9 përqind konfirmojnë se kanë filluar biznes për arsye se nuk kanë qenë të kënaqura me pozitën ku kanë punuar më parë, ndërsa 10.9 përqind e grave kanë vazhduar biznesin të trashëguar nga familja.

**Figura 5. Politikat kombëtare/ lokale për zhvillimin ekonomik të NVM**



Sa i përket përshtatshmërisë të politikave në nivel kombëtar dhe lokal për zhvillim ekonomik të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), gratë kanë dhënë vlerësimin e tyre ku: 4.5 përqind mendojnë se janë relevante, 57.9 përqind mendojnë se janë pjesërisht relevante, 22.3 përqind konfirmojnë se nuk janë relevante, dhe 15.3 përqind e grave nuk i njohin politikat.

**Figura 6. Performanca e tanishme e biznesit**




Performancën e tanishme të biznesit të tyre, shumë nga gratë sipërmarrëse apo 75.2 përqind e tyre e vlerësojnë si të mirë, përdërisa vetëm 5.9 përqind e vlerësojnë të shkëlqyer, 8.4 përqind jo aq të mirë, dhe 10.4 përqind e grave deklarojnë se kanë vështirësi dhe mundohen të mbijetojnë. Nga të dhënat shohim se asnjë aktivitet në rënje nuk është deklaruar nga totali i përgjithshëm i grave të intervistuar.

***Numrit të punëtorëve në sipërmarrjet që udhëheqen nga gratë***


Sa i përket numrit të punëtorëve në sipërmarrjet që udhëheqen nga gratë, të dhënat dëshmojnë se 97.5 përqind e sipërmarrjeve janë mikro biznese me 1-9 punëtorë, dhe vetëm 2.5 përqind e tyre kanë konfirmuar se kanë 10-49 të punësuar. Ndërsa sipërmarrje të mesme mbi 50 punëtorë dhe të mëdha të menaxhuara nga gratë mbi 100-250 punëtorë nuk konfirmohet asnjë.

***Figura 7. Fushat problematike që ndikojnë në sipërmarrje/Ndryshimet teknologjike***




Fushat problematike që ndikojnë në sipërmarrje kur kemi të bëjmë me ndryshime teknologjike (teknologji e re më e avancuar) sipas të dhënave vlerësohet se: 7.9 përqind e grave sipërmarrëse konsiderojnë problem të parëndësishëm, 23.3 përqind e konsiderojnë si fushë më pak të rëndësishme e cila ndikon në biznesin e tyre, ndërsa 38.6 përqind e konsiderojnë si një fushë problematike dhe të rëndësishme, dhe 30.2 përqind e grave sipërmarrëse e konsiderojnë fushë shumë.

***Figura 8. Rritja e koston të prodhimit***




Rritja e koston së prodhimit ndikon poashtu dhe paraqitet një fushë mjaftë problematike për shumicën e sipërmarrjeve të grave, ku vetëm 8.9 përqind e grave e vlerësojnë si të parëndësishme, 17.3 përqind si më pak të rëndësishme, përdërisa 36.1 përqind e vlerësojnë koston e prodhimit të rëndësishme, dhe 37.6 përqind këtë fushë e shohin shumë të rëndësishme dhe problematike që ndikon në sipërmarrje.

**Figura 9. Marketingu i dobët ose jo-ekzistues**



Marketingu i dobët ose jo-ekzistues, edhe kjo është një ndër fushat e rëndësishme për çdo veprimtari, ku si çdo fushë tjetër edhe marketingu kërkon përkushtim dhe investim të veçantë sepse ndikon në zhvillimin, promovimin dhe profitin e sipërmarrjeve. Sipas të dhënave shohim se vetëm 5.4 përqind e grave e vlerësojnë si të parëndësishme, 33.2 përqind si më pak të rëndësishme, ndërsa 29.2 përqind e vlerësojnë të rëndësishme, dhe 32.2 përqind e vlerësojnë si fushë problematike shumë të rëndësishme.


**Figura 10. Llojet e instrumenteve financiare prezente për gratë sipërmarrëse**



Llojet e instrumenteve financiare si dhe programet tjera specifike prezente për mbështetje dhe zhvillim të biznesit në Kosovë, sipas grave sipërmarrëse vlerësohen në bazë të këtyre të dhënave: 5.9 përqind vlerësojnë huat ndërkombëtare dhe të BE-së, ndërsa grantet të cilat ofrohen nga partnerët zhvillimor ndërkombëtar dhe BE-ja vlerësohen me 32.1 përqind. Huat kombëtare vlerësohen se janë prezente me 26.7 përqind, kurse grantet nga institucionet kombëtare me 25.2 përqind. Më shumë se BE-ja janë vlerësuar huat nga ana e OJQ-ve, ku sipas të dhënave vlerësohen të jenë prezente me 9.6 përqind, ndërsa grantet nga OJQ-të vlerësohen me 6.0 përqind. Më së shumti janë vlerësuar huat nga investimet private me një përqindje shumë të lartë rreth 47.4 përqind, kurse grantet nga investimet private vlerësohen rreth 4.3 përqind.

Nga figura shohim se 10.4 përqind, e grave sipërmarrëse pajtohen me instrumentet e financimit, kurse me mungesën e granteve pajtohen rreth 32.5 përqind.


**Figura 11. Llojet e instrumenteve financiare që përdoren nga gratë sipërmarrëse**



Kur gratë sipërmarrëse janë pyetur se cilat instrumente financiare i përdorin me shumë për investim në biznesin e tyre, të dhënat tregojnë se sa i përket përdorimit të huave ndërkombëtare dhe të BE-së vetëm 1.4 përqind e tyre konfirmojnë se i përdorin, ndërsa grantet 3.8 përqind. Huat kombëtare konfirmohet se i përdorin rreth 7.2 përqind, kurse grantet kombëtare 6.6 përqind. 1.4 përqind e grave sipërmarrëse konfirmojnë se përdorin edhe huat nga OJQ-të, kurse grantet nga OJQ-të përdoren rreth 0.5 përqind. Nga figura shohim se huat dhe grantet që përdoren më së shumti nga gratë vijnë nga investimet private rreth 84.2 përqind, kurse grantet nga investimet private kanë një përqindje më të vogël krahasuar me huat rreth 11.5 përqind.


Duke marrë parasysh mos praktikimin e huave, 5.9 përqind e grave pajtohen, kurse me mungesën e përdorimit të granteve pajtohen rreth 77.6 përqind e tyre.

**Figura 12. A ka informata të mjaftueshme në dispozicion mbi qasjen në financa**




Sa i përket se a ka informata të mjaftueshme në dispozicion mbi qasjen në financa, 11.9 përqind e grave vlerësojnë se ka informata të mjaftueshme në dispozicion, 15.8 përqind vlerësojnë se nuk kanë informacione, dhe 72.3 përqind vlerësojnë se kanë informacione të pjesërishme mbi qasjen në financa.

**Figura 13. Burimet informative për qasje në financa që përdoren nga gratë sipërmarrëse**




Burimet informative të cilat gratë sipërmarrëse më së shumti i përdorin dhe informohen janë mediet (të shkruara dhe elektronike) me rreth 38.4 përqind. Ndërsa më së paku gratë informohen nga Shoqata të Biznesit dhe Odat Ekonomike rreth 5.6 përqind e tyre. Gjithashtu, gratë sipërmarrëse të intervistuar konfirmojnë se Shoqatat e Grave në Biznes janë burim i mirë informativ ku 22.4 përqind e tyre informohen rregullisht sa i përket qasjes në financa. Nga fletushkat dhe abonimet vetëm 9 përqind e grave i përdorin, ndërsa materialet për shpërndarje nga institucionet e ndryshme financiare janë poashtu një burim shumë i mirë ku 24.6 përqind e grave i përdorë ato.

**Figura 14. Alternativat e instrumentave financiar për biznes**




Gratë sipërmarrëse përdorin alternativa të ndryshme të instrumentave financiare për të investuar dhe zhvilluar biznesin e tyre. Të dhënat tregojnë se 1.2 përqind e sipërmarrëseve përdorin faktorimin, 15.8 përqind lizingun apo qiran. Një instrument që gjenë mjaft zbatim është garancia bankare me 39.9 përqind, ndërsa blerja e urdhërpagesave financiare përdoret me 32 përqind, investim në kapital 6.7 përqind. Bizneset "Angles" kanë një përqindje të përdorimit rreth 3.6 përqind, kurse më së paku zbatohen siguracionet e eksportit me 0.8 përqind.

**Figura 15. Burimet Njerëzore/ Organizmet e trajnimve brenda sipërmarrjes**



Sipërmarrjet e grave gjithashtu mundohen të investojnë në përmirësimin e shkathtësive të punëtorëve të tyre varësisht nga fusha e veprimtarisë. Të dhënat e dala nga figura tregojnë se 12.2 përqind të trajnimeve organizohen në sipërmarrje të cilat i ofrojnë vetë punëtorët e kualifikuar, 21.2 përqind i ndjekin trajnimet jashtë sipërmarrjes të cilat organizohen nga institucionet, organizatat e ndryshme duke përfshirë – trajnime, seminare, konferenca, konsultime, ndërsa 66.7 përqind organizohen sipas nevojave të definuara nga vetë sipërmarrja.


**Figura 16. Përgjegjësit për burimet njerëzore dhe aktivitetet e trajnimit**



Secila sipërmarrje përbëhet nga struktura organizative menaxhuese e saj. Kur gratë janë pyetur se kush është përgjegjës për burimet njerëzore dhe aktivitetet trajnuese në sipërmarrje, të dhënat tregojnë se 41.3 përqind e tyre konfirmojnë se përgjegjës është drejtori, 10 përqind konfirmojnë se është pronari, ndërsa vetëm 5 përqind të rasteve kanë konfirmuar se përgjegjës për burime njerëzore dhe trajnime është Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dhe 48.3 përqind të rasteve nuk disponojnë me person përgjegjës për këtë.




**Figura 17. Arsyet e organizimit të trajnimeve**




Ekzistojnë një mori arsyesh që i shtyen sipërmarrësit të organizojnë trajnime ngritjen e shkathhtësive të punëtorëve, dhe secila nga ato përmban rëndësi të veçantë për sipërmarrjen. Sa i përket arsyes arsyes të organizimit të trajnimeve për vazhdim të biznesit, gratë e vlerësojnë sipas këtyre të dhënave: 1 përqind e sipërmarrësve e shohin jo të rëndësishme, 6.4 përqind e tyre e vlerësojnë arsye më pak të rëndësishme. Ndërsa, mbi gjysma e grave të intervistuar 53.5 përqind e vlerësojnë trajnimin si arsye të rëndësishme, dhe 39.1 përqind si shumë të rëndësishme.

**Figura 18. Për tu përditësuar me teknologji dhe trende të reja**




Arsye tjetër për trajnime të stafit është edhe njohja, informimi dhe përdorimi i teknologjisë së re. Sipas të dhënave, vetëm 1 përqind e grave sipërmarrëse e vlerësojnë arsye jo të rëndësishme, 7.9 përqind e tyre vlerësojnë se është arsye më pak e rëndësishme, përderisa 38.6 përqind e sipërmarrësve e vlerësojnë të rëndësishme, dhe 52.5 përqind vlerësojnë se është arsye shumë e rëndësishme.

**Figura 19. Për të rritur biznesin**




Organizimin e trajnimeve gratë sipërmarrëse e konsiderojn si arsye e cila ndikon shumë edhe në rritjen e biznesit, sipas të dhënave asnjëra nga sipërmarrëset nuk e konsideron si jo të rëndësishme, vetëm 3.5 përqind e tyre e konsiderojnë arsye më pak të rëndësishme. Ndërsa pjesa më e madhe e grave 38.6 përqind e konsiderojnë se për të rritur biznesin e tyre organizimi i trajnimeve është arsye e domosdoshme dhe e rëndësishme, dhe 57.9 përqind konsiderojnë se është arsye shumë e rëndësishme.

**Figura 20. Për të rritur kualitetin e shërbimeve dhe produkteve**




Për të rritur kualitetin e shërbimeve dhe produkteve asnjëra nga gratë sipërmarrëse nuk është deklaruar se trajnimet e këtij lloji nuk janë të rëndësishme apo arsye më pak e rëndësishme. Pjesa më e madhe e grave të intervistuar 23.8 përqind, kanë konsideruar se rritja e kualitetit të shërbimeve dhe produkteve është arsye e rëndësishme, përderisa 76.2 përqind e tyre konsiderojnë se është arsye shumë e rëndësishme dhe e nevojshme.

**Figura 21. Për të përmirësuar imazhin e kompanisë**



Sa i përket rëndësisë së organizimit të trajnimeve për të përmirësuar imazhin e kompanisë, edhe kjo vlerësohet nga gratë me 56.4 përqind si shumë e rëndësishme, dhe 37.6 përqind e rëndësishme, përderisa vetëm 5.9 përqind e grave e kanë konsideruar si më pak të rëndësishme.

**Figura 22. Ndarja e buxhetit vjetor për investime në trajnime**




Sa i përket ndarjes së buxhetit vjetor për të investuar në trajnime, pjesa më e madhe e grave sipërmarrëse 97.5 përqind, kanë konfirmuar se nuk ndajnë buxhet vjetor, ndërsa vetëm 2.5 përqind e tyre kanë konfirmuar se e ndajnë çdo vit.

**Figura 23. Investimet në tre vitet e fundit për zhvillimin e burimeve njerëzore**



Sipas të dhënave trendi i investimeve për zhvillimin e burimeve njerëzore për tre vitet e fundit është rritur me 22.8 përqind, pjesa më e madhe e grave sipërmarrëse 57.9 përqind kanë konfirmuar se ka mbetur e njëjtë pasi që ato nuk ndajnë buxhet vjetor për këtë fushë të rëndësishme, dhe 19.3 përqind kanë konfirmuar se është zvogëluar.


**Figura 24. Burimet kryesore të financimit për zhvillimin e burimeve njerëzore**



Burimet kryesore për financimin e zhvillimit të burimeve njerëzore si: trajnimet, edukimi, dhe përmirësimin e aftësive të punëtorëve i sigurojnë nga vetë kompania ku 15.8 përqind e tyre e kanë konfirmuar këtë, ndërsa 63.4 përqind konfirmojnë se në sipërmarrje kujdesen


kryesisht punëtorët. Kurse sa i përket fondeve publike vetëm 5 përqind e tyre e sigurojnë financimin nga këto fonde, dhe 15.8 përqind i sigurojnë financimet nga organizatat ndërkom-bëtare ose projektet e ndryshme të cilat ofrohen nga partnerë të ndryshëm zhvillimor.

**Figura 25. Marketingu dhe shitjet**



Marketingu luan rolin kryesorë të çdo sipërmarrje në shitjen e produkteve të cilat i ofron në treg. Në figurë janë të paraqitura vlerësimet nga ana e menaxherëve dhe punëtorëve për rëndësinë e marketingut dhe shitjeve si temë e trajnimit. Pronarët dhe menaxherët e vlerësojnë si shumë të rëndësishme, rreth 55 përqind e tyre, poashtu edhe punëtorët e tjerë 43.6 përqind konsiderojnë se trajnimet e marketingut janë fushë shumë e rëndësishme. I rëndësishëm mendojnë se është 25.7 përqind e pronarëve dhe menaxherëve, dhe 36.6 përqind e punëtorëve tjerë. Pak e rëndësishme mendojnë 14.9 përqind e pronarëve dhe menaxherëve, kurse 13.4 përqind e punëtorëve tjerë. Ndërsa vetëm 6.4 përqind e punëtorëve mendojnë se është jo e rëndësishme, dhe 4.5 përqind e pronarëve dhe menaxherëve e konsiderojnë si jo të rëndësishme.

**Figura 26. Zhvillim i produktit/shërbimit**



Pronarët, menaxherët dhe punëtorët sa i përket trajnimit mbi rëndësinë e zhvillimit të produktit apo shërbimit e vlerësojnë një temë e cila është shumë e rëndësishme për secilën sipërmarrje. 65.3 përqind e pronarëve dhe menaxherëve e vlerësojnë si shumë të rëndësishme, ndërsa punëtorët tjerë 43.6 përqind e tyre poashtu e vlerësojnë se është shumë e rëndësishme. E rëndësishme mendojnë se është 28.2 përqind e pronarëve dhe menaxherëve dhe 41.6 përqind e punëtorëve tjerë. Pak e rëndësishme mendojnë 5.4 përqind e pronarëve dhe menaxherëve, kurse 14.4 përqind e punëtorëve tjerë. Vetëm 0.5 përqind e punëtorëve mendojnë se është jo e rëndësishme, përderisa 1 përqind e pronarëve dhe menaxherëve e konsiderojnë si jo të rëndësishme.

## 7. Konkluzionet

Kosova ende nuk disponon një vizion afatgjatë të politikave të qëndrueshme për të mbyllur hendekun në mes të pjesëmarrjes së grave dhe burrave në veprimtarinë sipërmarrëse. Institucionet qeveritare dhe jo qeveritare të vendit mundohen të punojnë vazhdimisht për të ndryshuar sistemin e vlerave, sjelljes dhe ambientit nga të cilat varet zhvillimi i veprimtarisë sipërmarrëse të gruas.

Mirëpo, në takimet e shpeshta me gratë gjithmonë identifikohen pengesa të shumta për sipërmarrësinë e gruas duke filluar që nga stereotipet që ekzistojnë në shoqëri deri te mungesa e fondeve dhe mungesa e përkrahjes institucionale. Kjo situatë mund të ndryshojë me krijimin e një ambienti më të favorshëm përmes hartimit të politikave të duhura në mënyrë që të merret parasysh potenciali i sipërmarrësisë së grave. Sipërmarrjet e grave ende përballen me probleme të shumta në shumë fusha gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre biznesore si: barrierat që lidhen me sundimin e ligjit (psh. konkurrenca jo e shëndoshe, korrupsioni, sistem i dobët gjyqësor etj.), barrierat fiskale (TVSH), financiare (nomrat e larta kreditore dhe mungesa e alokimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për gratë sipërmarrëse), mungesa e trajnimeve (përfshierja e grave në skemat voucher nga insitucionet qeveritare), dhe rrjetëzimet.

Si përfundim, studimi paraqet disa njohuri për situatën ekonomike të sipërmarrjeve të grave, si dhe strukturën e ndryshme ekonomike. Kosova, ende nuk disponon një strategji të mirëfilltë gjithëkombëtare për zhvillim ekonomik dhe strategji kombëtare për gratë sipërmarrëse, ndryshe nga vendet e rajonit që i kane zhvilluar dhe i praktikojnë ato. Bashkimi Evropian kërkon që situata aktuale e grave sipërmarrëse në vendet para-aderimit në BE, duhet të jetë më e zhvilluar për të kontribuar për një Europë më konkurruese. Prandaj BE-ja, kërkon krijimin e një mjedisi nxitës për sipërmarrjet e grave në rajon në kuadër të theksit të veçantë që i jepet sipërmarrjeve të grave në Aktin e Biznesit të Vogël (ABV) për Evropën, një angazhim të plotë të qeverive për zhvillimin e sektorit privat nxitjen e punësimit të grave aktive.

Treguesit të cilët konsiderohen të rëndësishëm për një zhvillim strategjik për sipërmarrësinë e grave përqendrohen në katër fusha: politikat, trajnimet, qasje në burime financiare dhe rrjetëzime. Prandaj, ashtu sikur vendet e rajonit edhe qeveria e Kosovës, përkatësisht ministrите përkatëse, institucionet që e përkrahin sektorin privat dhe grupet e interesit të qytetarëve duhet të pershtasin politikat e tyre në mënyrë që të merret parasysh potenciali i grave duke krijuar një mjedis të favorshëm për sipërmarrëset gra.

## 8. Rekomandimet

Sistemet e Qeverisjes Kombëtare duhet të promovojnë strategji gjithë përfshirëse të zhvillimit ekonomikë e cila ofron përfitime shoqërore në terma afatgjatë, duke përfshirë mirëqenien e grave sipërmarrëse, zvogëlimin e pabarazisë dhe papunësisë për një zhvillim të qëndrueshëm kombëtar.

Qeveria dhe palët kyçe të interesuara duhet të krijojnë kuadër mbështetës të politikave për sipërmarrjet e grave me një program pune në vazhdimësi dhe mbështetje financiare për secilën prej fushave të politikave (fiskale, ekonomike, të punësimit, sociale, si dhe arsimore e trajnuese) që përfshin një forum konsultimi për sipërmarrjet e grave, si dhe masa që lidhen me informacionin dhe krijimin e rrjeteve. Promovimin, shkëmbimin dhe përdorimin e njohurive, teknologjike, praktikave të mira dhe strategjive të përshtatshme sektoriale, duke përfshirë edhe mundësitë e ofruara nga informacionet dhe teknologjia e komunikimit (TIK), interneti – si bazë e teknologjisë. Rritjen e qasjes së grave sipërmarrëse në shërbimet financiare, duke përfshirë huat, sigurimin dhe shërbimet e brendshme të pagesave, poashtu dhe aftësitë e të bërit biznes, aftësitë ekonomike, financiare, si dhe duke ofruar mbështetje për kalimin e shërbimeve financiare nga ato jozyrtare ( jo formale ) tek ato zyrtare ( formale).

Inkurajimi për pavarësinë ekonomike të grave si një kusht për zhvillim të mëtejshëm të grave sipërmarrëse nëpërmjet mbështetjes financiare dhe kredive për gratë, zhvillimin e sistemit të fondeve garantuese nga buxheti i konsoliduar i Kosovës përmes krijimit të linjave të veçanta kreditore dhe qasjes të grave në të gjitha llojet e burimeve. Krijimi dhe zbatimi i një kornize kombëtare për trajnime që përfshinë të gjitha palët e interesuara (arsim, ekonomi, punësim, odat ekonomike, punëdhënësit, OJQ-të) për të ndërtuar një qasje sistemike të ndjeshme nga ana gjinore në trajnimin për sipërmarrjet në fushat e: a) vetë-punësimit, b) krijimit të bizneseve dhe c) rritjes dhe zhvillimit të bizneseve të regjistruara të grave. Sigurimi se njësitë gjinore fuqizohen në nivel qendror dhe lokal, dhe janë të mbështetura nga buxhetet e dhura dhe të fuqizuara për të siguruar që të gjitha politikat dhe programet janë me ndjeshmëri gjinore dhe përgjegjëse rreth shqetësimeve të grave në biznes. Marrja e masave për të rritur fuqizimin ekonomik të grupeve të ndryshme të grave, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve dhe sensibilizimin e tyre nëpërmjet investimeve, shkëmbimit të informacioneve dhe mësimëve të nxjerra në nivele të ndryshme qoftë qeveritare, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Sigurimin që të dhënat apo informacionet për gratë sipërmarrëse të jenë në dispozicion, të përhapura dhe të arritshme në mënyrë transparente nga institucionet qeveritare dhe partnerët e tjerë zhvillimor. Eliminimi i praktikave diskriminuese në lidhje me gratë sipërmarrëse që kanë të bëjnë me arsimimin, trajnimin dhe ngritjen e aftësive për punësimi, duke nxitur shërbyesit e trajnimeve dhe konsulencës të sektorit publik dhe organizatave jo-qeveritare. Zhvillimi i kapaciteteve për gratë sipërmarrëse përmes organizimit të trajnimeve për të marrë pjesë në konceptimin, mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave dhe informacioneve, për të nxitur politika dhe masa më të mira për avokim dhe monitorim.

Ofrim i trajnimeve me metoda të ndryshme pjesëmarrëse, zhvillimi i shërbimeve arsimore, trajnuese dhe këshilluese për gratë sipërmarrëse në nivele dhe disiplina të ndryshme duke përdorur aftësitë e këshilltarëve të qeverisë në nivel qendror dhe lokal, dhe të shoqërisë civile.

## Referencat:

1. Agjensia e Statistikave të Kosovës – online [Anketa e Fugisë Punëtore \(AFP\), TM1 2021 | \[rks-gov.net\]](#)
2. Women Economic Forum., [2017] – online [https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2019/02/Agjenda-Nacionale-per-Fugizimin-Ekonomik-te-Grave\\_final.pdf](https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2019/02/Agjenda-Nacionale-per-Fugizimin-Ekonomik-te-Grave_final.pdf)
3. Saxena, A. [2016] The Rise of Women Entrepreneurship – online <https://www.entrepreneur.com/article/271784>
4. Cornish, L. [2017] Are Women Entrepreneurship the key to Global Economic Development – online <https://www.devex.com/news/are-women-entrepreneurs-the-key-to-global-economic-development-91010>
5. Coughlin, J.H with Tomas, A.R [2002] The Rice of Women Entrepreneurs
6. VanderBrug, J. [2013] The Global Rise of Female Entrepreneurs – online <https://hbr.org/2013/09/global-rise-of-female-entrepreneurs>
7. Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare., [2019] Studim kërkimor mbi investimet nga diaspora, ndikimi në ekonominë e Kosovës, fq. 4 – online [https://oegjk.org/wp-content/uploads/Kosova-IHD-Raporti-Final\\_Shqip.pdf](https://oegjk.org/wp-content/uploads/Kosova-IHD-Raporti-Final_Shqip.pdf)
8. Kosovo Gender Studies Center., Women Property Rights Pilot Index – online [http://www.kgscenter.net/site/assets/files/1741/eng\\_index.pdf](http://www.kgscenter.net/site/assets/files/1741/eng_index.pdf)
9. ODHR., [2017] Making Laws Work for Women and Men: A Practical Guide to Gender-Sensitive Legislation – online <https://www.osce.org/files/f/documents/d/f/420200.pdf>
10. EBRD., [2015] – online <https://www.ebrd.com/news/2015/ebrd-supports-women-entrepreneurs-in-kosovo.html>
11. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 -2023, Qershor [2020], fq.13
12. Womens Network, Analiza Gjinore, [2018] – online <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2022/03/Analiza-Gjinore-mbi-Ekonomine-Joformale-ne-Kosove-1.pdf>
13. Hill. N., [1994] Mendo dhe bëhu i pasur, fq. 99
14. USAID, [2014] Strategjia për bashkëpunim dhe zhvillimin e vendit 2014 – 2018 online [https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS\\_Kosovo\\_2014\\_ALB.pdf](https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS_Kosovo_2014_ALB.pdf)
15. NGO, Gratë në Biznes – online [https://gratenebiznes.com/per\\_ne](https://gratenebiznes.com/per_ne)
16. National Association of Women Business Owners – online <http://nawbo.org/resources/women-business-owner-statistics>
17. Fernandez. P and Sanfilippo. M., [2020] online – <https://www.businessnewsdaily.com/5268-women-entrepreneur-challenges.html>
18. Women Entrepreneurship Platform WEP, Report [2022] online – [http://www.womenentrepreneurshipplatform.org/uploads/1/0/9/4/109400817/final\\_wep\\_report\\_to\\_copa-cogeca\\_march\\_2022.pdf](http://www.womenentrepreneurshipplatform.org/uploads/1/0/9/4/109400817/final_wep_report_to_copa-cogeca_march_2022.pdf)
19. Fetsch, E, Jackson, Ch, and Wiens, J. [2015] Women entrepreneur are key to accelerating growth., online <https://www.kauffman.org/resources/entrepreneurship-policy-digest/women-entrepreneurs-are-key-to-accelerating-growth/>
20. Fink, S. [2015] Women entrepreneurs show appetite for growth – online <https://centreforentrepreneurs.org/releases/women-entrepreneurs-show-appetite-for-growth/>
21. USAID Kosovo [https://www.usaid.gov/sites/default/files/success/files/Ndermarresia\\_merr\\_hov\\_ne\\_Kosove\\_permes\\_inkubatorit\\_te\\_ndermarresise.pdf](https://www.usaid.gov/sites/default/files/success/files/Ndermarresia_merr_hov_ne_Kosove_permes_inkubatorit_te_ndermarresise.pdf)
22. Kosova Job – online <https://kosovajob.com/article?id=17>

23. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë <https://www.amchamksv.org/sq/ndermarresia-e-rendesishme-ne-uljen-e-papunesise/>
24. Women Business Association SHE-ERA, [2016] Mbështetja e Grave Sipërmarrëse në Buqësi 2012 – 2015
25. Cutura, J [2021] Investing in Energy Efficiency Sparks Change for Kosovo’s Women Entrepreneurs – online <https://www.mcc.gov/blog/entry/blog-032921-kosovo-women-entrepreneurs>
26. OSCE. Stories, [2017] Empowering Kosovo’s Women Entrepreneurs <https://www.osce.org/stories/empowering-kosovo-women-entrepreneurs>
27. Carranza., E with Dhakal., Ch and Love., I [report 2018]., Female Entrepreneurs: How and Why are they different: Online <https://documents1.worldbank.org/curated/en/400121542883319809/pdf/Female-Entrepreneurs-How-and-Why-are-They-Different.pdf>
28. Report Anna et al., [1999]. NON-ECONOMIC OUTCOMES
29. Istrefi Jahja with Ivana Saba, [2021], How is Women Entrepreneurs Kosovo Changing the Perception of Female Founders in the Country <https://swissep.org/our-impact/success-stories/how-is-women-entrepreneurs-kosovo-changing-the-perception-of-female-founders-in-the-country>
30. USAID., [2015] Success Story /Women Gain Traction in Kosovo’s Business Sector – online <https://www.usaid.gov/sites/default/files/success/files/Women%20Gain%20Traction%20in%20Kosovo%27s%20Business%20Sector.pdf>
31. UN Women., Report / Fact Sheet [2021] Kosovo Women Entrepreneurs -online [https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2021/8/Expo%20Report/Kosovo\\_Factsheet-min.pdf](https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2021/8/Expo%20Report/Kosovo_Factsheet-min.pdf)
32. GiZ., Raport [2021] - Përkrahja e grave sipërmarrëse në Kosovë – online [http://www.k-w4w.org/site/assets/files/1898/perkrahja\\_e\\_grave\\_ndermarrese\\_ne\\_kosove\\_1.pdf](http://www.k-w4w.org/site/assets/files/1898/perkrahja_e_grave_ndermarrese_ne_kosove_1.pdf)



# Menaxhimi i faktorëve që ndikojnë në adaptimin e shërbimeve elektronike nga klientët e bankave komerciale në Kosovë

---

Agim Musa

---

## Abstrakti

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të analizohet menaxhimi i faktorëve që ndikojnë në adaptimin e shërbimeve elektronike nga klientët e bankave komerciale në Kosovë.

Duke parë që sektori bankar ka shënuar progres të rëndësishëm, në vitet e fundit është arritur një avansimin i shërbimeve për klientët duke ju përshtatur nevojave të reja të tregut të cilat kërkojnë që shërbimet bankare të jenë në dispozicion në çdo kohë dhe në çdo vend.

Nga rrezultatet doli se digjitalizimi ka ndryshuar në mënyrë thelbësore ekonomitë e shumë vendeve të botës, dhe në veçanti disa sektorë të ekonomisë. Edhe sistemi bankar në Kosovë nuk bën përjashtim nga kjo tendencë pasi që bankat komerciale kanë punuar shumë në këtë drejtim.

Përmes këtij punimi, kemi trajtuar menaxhimin e faktorëve që ndikojnë në adaptimin e shërbimeve elektronike nga klientët e bankave komerciale në Kosovë duke marrë si shembull banken Raiffeisen Bank dhe shërbimet elektronike ajo ofron.

Në fund të punimit janë trajtuar rrezultat e pyetësorit të realizuar me 104 pjesëmarrës dhe janë dhënë konkluzionet dhe rekomandime e dala nga hulumtimi.

## Fjalët kyçe:

shërbimet elektronike, bankat komerciale, sistemi banker, klientët.

# 1. Hyrje

Ky punim ka për qëllim që të analizohen menaxhimi i faktorëve që ndikojnë në adaptimin e shërbimeve elektronike nga klientët e bankave komerciale në Kosovë, sa këto risi po përmirsojnë dhe lehtësojnë punën e bankave dhe klientëve të saj. Sipas bankave del që shërbimet e elektornike kanë lehtësuar punët për klientët dhe ne po e realizojmë këtë hulumtim që të shohim se sa klientët janë të kënaqur me shërbimet elektronike të bankave komerciale, si ato po priten nga klientët. Përmes një pytësori në rrjetet sociale do ta masim këtë çështje tek klientët e bankave komerciale në Kosovë dhe kemi parë sa bankat komerciale po arrijnë t'i menaxhojnë shërbimet elektronike që ata i ofrojnë për klientet e tyre.

## 1.1. Objektivat e Studimit

Ky studim do të analizoj menaxhimin e faktorëve që ndikojnë në adaptimin e shërbimeve elektronike nga klientët e bankave komerciale në Kosovë.

Objektivat e këtij hulumtimi janë:

- Të trajtohet ndikimi i risive bankare në lehtësimin e punës së klientëve,
- Të hulumtohet se sa po praktikohen shërbimet elektronike bankare nga klientët dhe si po menaxhohen ato.
- Të shikojmë nëse risitë elektronike bankare janë duke u përshtatur nga bankat për klientët.

## 1.2. Pyetjet e hulumtimit

Pas rishikimit të literaturës ne kemi këto pyetjet kryesore të hulumtimit:

1. Si po menaxhohen risitë e inovacioneve në sistemin bankar të Kosovës?
2. Si po i presin klientët risitë e inovacioneve në sistemin bankar të Kosovës?
3. A janë të kënaqur klientët me risitë e inovacioneve në sistemin bankar të Kosovës?
4. A ka krijuar zhvillimi i inovacioneve lehtësira vetëm për bankat apo edhe për klientët?
5. A kanë krijuar risitë e inovacioneve në sistemin bankar të Kosovës, shërbime të shpejta, të sigurta dhe të besueshme në çdo kohë dhe në çdo vend?
6. A po arrijnë të përshtaten klientët me shërbimet e risive të inovacioneve në sistemin bankar të Kosovës?

## 1.3. Hipotezat e studimit

Hipoteza e ngitur nga rishikimi i literaturës për këtë punim është:

### Hipoteza 1:

*H<sub>0</sub> - Lehtësia nga përdorimit i shërbimeve elektronike bankare ka ndikim në menaxhim më të mirë të këtyre shërbimeve nga ana e klientëve.*

### Hipoteza 2:

*H<sub>1</sub>: Përdorimi i shërbimeve elektronike bankare ndikon në lehtësimin e shërbimeve për klientët;*

### Hipoteza 3:

*H<sub>1</sub>: Zgjedhja e bankës komerciale nga klientët varet nga shumë nxitës/faktorë.*

## 2. Korniza teorike

### 2.1. Kuptimi i shërbimeve elektronike

Bankimi elektronik, një term i përdorur për sistemin më të ri bankar, përfaqëson një shpërndarje automatike të produktëve, shërbimeve bankare të reja dhe tradicionale, në mënyre të drejtpërdrejt për klientët, përmes kanaleve elektronike të komunikimit interaktiv. Është një shërbim që ofron klientëve mundësinë për të fituar qasje në llogaritë e tyre, të kryejnë transaksione si dhe të marrin informacion mbi produktet dhe shërbimet financiare përmes rrejtit publik apo privat përfshirë internetin.

Bankimi elektronik apo shërbimi elektronik mund të përfshijë ATM - të, transfertat bankare, bankat telefonike, transferet e fondeve elektronike dhe karta debiti. Për shumë njerëz, bankingu elektronik do të thotë akses 24 orësh në të holla nëpërmjet një makine automatike (ATM) ose depozitë direkte të pagesave në llogaritë e kontrollit ose të kursimit. Por, bankingu elektronik përfshinë shumë lloje transaksionesh, të drejta, përgjegjësi dhe nganjëherë kosto.

Shërbimet bankare elektronike, në të gjithë botën shihen sot si mënyra më e shpejtë, më e lehtë dhe më e sigurt për të marrë informacion mbi produktet dhe transaksionet e thjeshta bankare, si dhe për të pasur qasje në para dhe në pagesa gjatë 24 orëve në ditë, 7 ditë në javë.

Si rrjedhojë, sot bankat kanë rimodeluar dhe vazhdojnë të jenë në proces të vazhdueshëm të rimodelimit të degëve të veta. Është në rritje numri i bankave komerciale në botë që po kalojnë në konceptin e shërbimit të klientëve përmes kanaleve të shumfishta të shitjes.

### 2.2. Rëndësia e shërbimeve elektronike

Shërbimet elektronike janë të rëndësishme si nga ana e klientëve ashtu edhe nga ana e bankave. Për bankat zvoglojnë kostot operacionale dhe mundësojnë që në të njëjtën kohë të shërbejnë shumë klientë, ndërsa për klientë ofrojnë qasje 24 orë.

Sistemi elektronik është pjesë e rëndësishme e aktiviteteve bankare, në bazë të cilave bankat përpiqën të mbajnë klientë ekzistues ose të tërheqin klientë të rinj përmes një cilësie më të mirë të shërbimit dhe uljes së çmimëve të këtyre shërbimeve. Kohën e fundit bankimi elektronik është bërë rrugë për zhvillimin e sistemit bankar.

Po ofron mundësi për të krijuar procese të shërbimeve që kërkojnë më pak resurse të mbrendshme dhe ulje të shpenzimeve, gjithashtu po siguron mundësi për të arritur më shumë klient. Nga këndvështrimi i klientëve, bankat elektronike u mundësojnë klientëve qasje më të lehtë në shërbimet financiare dhe kursim kohe në menaxhimin e financave të tyre. Bankat filluan të shikojnë në e-banking si një mjet për të zëvendësuar disa nga funksionet e tyre tradicionale të bankës, për dy arsye:

Së pari, krijimi i degeve ishte i kushtueshëm dhe mbajtja e tyre krijonte shpenzime të mëdha.

Së dyti, produktet / shërbimet e bankut si ATM dhe transferimi elektronik i fondeve ishin një burim shtesë për bankat që i shfrytëzonin ato.

Duke qenë në një industri të egër konkurruese, aftësia e bankave për të dalluar vetën në bazë të çmimit është e kufizuar. Teknologjia ka prezantuar mënyra të reja për të ofruar

shërbime bankare për klientë, siç janë Atm-ët dhe bankat në internet. Prandaj, është e domosdoshme që bankat të përshtasin strategjitë e tyre në përgjigje të ndryshimit të nevojave të klientëve dhe zhvillimeve në teknologji.

### **2.3. Menaxhimi i shërbimeve elektronike në sektorin bankar në Kosovë**

Sektorin bankar në Kosovë ka shënuar progres të rëndësishëm në pesë vitet e fundit. Ky progres është evident në shumë aspekte përfshirë rritjen e kreditimit, rritjen e depozitave, uljen e normave të interesit për kredi, uljen e kredive jo-përformuese dhe ruajtjen e parametereve të duhur të kapitalit dhe likuiditetit. Gjithashtu, në këto vite është arritur progres i mirë në avansimin e shërbimeve për klientët duke ju përshtatur nevojave të reja të tregut të cilat kërkojnë që shërbimet bankare të jenë në dispozicion në çdo kohë dhe në çdo vend.

Progresi përmes inovacionit nuk është vetëm funksion i përditësimit dhe avansimit teknologjik, në fakt është shumë më kompleks. Për të qenë i dobishëm, progresi duhet të bëhet përmes përshtatjes së shërbimeve me nevojat e bizneseve apo qytetarëve në mënyrë sa më të individualizuar që është e mundur. Sigurisht, që individualizimi i shërbimeve i ka limitet e veta por në ekonominë moderne, ku klienti ka kërkesa shumë specifike dhe konkurrenca për shërbime është e lartë, nevojitet që edhe ofruesit e shërbimeve të individualizojnë për aq sa është e mundur dhe ka arsyeshmëri ekonomike.

Sektorin bankar është duke investuar shumë si në teknologji ashtu edhe në resurset njerëzore për të qenë sa më efektiv në implementim e këtyre mundësive të reja dhe për të qenë sa më afër nevojave të klientëve. Kjo ka bërë që institucionet bankare në vend të jenë shumë stabile duke shënuar rritje të rëndësishme edhe në pranimin e depozitave por edhe në zgjerimin e kreditimit për të përmbushur nevojat e bizneseve dhe qytetarëve për financim.

### **2.4. Digjitalizimi bankar në Evropë dhe Kosovë**

Niveli i digjitalizimit të shërbimeve bankare në Kosovë vlerësohet të jetë i ngjashëm me atë të Bashkimit Evropian. Sot, sistemi bankar në vend është zhvilluar aq shumë teknologjikisht, ku pothuasje të gjitha shërbimet bankare realizohen përmes platformave elektronike. Me gjithë zhvillimet teknologjike, sektori bankar i Kosovës evidenton numrin më të lartë të punëtorëve, në kuadër të industrive tjera financiare në vend me 3,363 të punësuar.

Pranonin depozita të klientëve, jepnin kredi, bënin transfere financiare, depozitonin para të gatshme. Vetëm këto shërbime i kryenin për klientët bankat komerciale në Kosovë menjëherë pas përfundimit të luftës në vend. Por, rreth 19 vite më pas sektori bankar i Kosovës ka bërë revolucion në këtë drejtim, si rezultat i investimeve të bëra nga bankat në teknologjinë informative, duke zhvilluar kanalet elektronike të ofrimit të shërbimeve për klientët. Sot, sistemi bankar i Kosovës është zhvilluar aq shumë teknologjikisht, ku pothuasje të gjitha shërbimet bankare realizohen përmes platformave elektronike.

Zhvillimet më të hovshme në sektorin bankar të Kosovës kanë ndodhur në 5 vitet e fundit, përkatësisht nga viti 2013 e këndeje, ku klientëve u ofrohen një qasje shumë e lehtë në shërbimet e ofruara.

Me gjithë zhvillimet teknologjike, sektori bankar i Kosovës evidenton numrin më të lartë të punëtorëve, në kuadër të industrive tjera financiare në vend, me 3,363 të punësuar, ku vetëm nga fundi i vitit 2017 e deri më tani numri i punëtorëve në këtë sektor është rritur për 44.

### 3. Metodologjia dhe të dhënat të punimit

Hulumtimi është hulumtim sasiorë, me qasje shkak-pasojë. Në hulumtim kemi të bëjmë me mostër të rëndomtë. Të dhënat primare janë marrë nga qytetarët të cilët janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme në rrjetin social facebook, ku e kam shpërdarur pyetësorin në shumë grupe të ndryshme. Gjithësej janë plotësuar 104 pyetësorë.

#### 3.1. Organizimi i studimit


Fillimisht është realizuar pyetësori prej 14 pyetjeve dhe ka qenë i strukturuar me pyetje të mbyllura. Pyetësori është shpërndarë në grupe të shumta ku arritën te plotësohen 104 prej tyre nga qytetar nga mosha 18 deri 45 vjet. Shpërndarja e pyetësorit është bërë në qytete të ndryshme, tek klientët që më pas ndahen në regjione. Të dhënat e dala nga pyetësori janë grumbulluar, analizuar dhe paraqitur në formë të tabelave. Analiza e të dhënave është bërë nëpërmjet programit statistikor SPSS duke përdorur korrelacionin dhe kemi bërë zbërthimin e të dhënave të kësaj teme.

#### 3.2. Burimi i të dhënave

Hapi tjetër në procesin e përmbledhjes së punimit është mbledhja e të dhënave. Në këtë hulumtim si popullacion kemi të gjithë qytetarët e Kosovës që janë klientë të bankave komerciale në Kosovë dhe janë përdorues të shërbimeve elektronike bankare. Mostra është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme me anë të rrjetit social Facebook. Kemi mbledhur të dhëna nga gjithsej 104 pyetësorë, ku përmes tyre do të mundohemi të japim disa përfundime për rastet të cilat do të analizohen.


#### 3.3. Mosha e pjesëmarrësve

Në pyetësorin e realizuar pjesëmarrësit ishin 81 pjesëmarrës nga mosha 18 deri 25, 21 pjesëmarrës nga mosha 24 deri 45 vjet dhe nga 2 pjesëmarrës nga mosha 45-65 vjet.



### 3.4. Gjinia e pjesëmarrësve

Në këtë pjesë është paraqitur gjinia e pjesëmarrësve në pyetësor. Pyetësorin e plotësuan 76 femra dhe 28 meshkuj apo 73.1% ishin nga gjinia femërore kurse 26.9% nga gjinia mashkullore.



## 4. Rrezultatet e hulumtimit – Menaxhimi i shërbimeve elektronike në sistemin bankar të Kosovës

### 4.1. Analiza dhe diskutimi i rezultateve

Në këtë punim ne kemi testuar dhe analizuar hipotezat me programin SPSS përmes analizës së korrelacionit apo ndryshe madhësi statistikore që na ndihmonë të kuptojmë relacionin mes dy variablave.

Në vazhdim do të analizojmë hipotezat e ngritura të këtij punimi dhe pastaj do t'i interpretojmë rezultatet finale.

### 4.2. Testimi dhe interpretimi i hipotezave të ngritura

Në këtë pjesë janë testuar rezultatet e pyetjes se a i përdorni shërbimet elektronike të bankave komerciale dhe të pyetjes sa ju kanë lehtësuar punë shërbimet elektronike dhe përmes korrelacionit është testuar hipoteza e parë.

**Tabela 1**

*Analiza e korrelacionit që tregon lidhjen mes përdorimit të shërbimeve elektronike dhe sa ju kanë lehtësuar punën shërbimet elektronike bankare.*

		A përdorni shërbimet elektronike?	Sa ju kan lehtësuar punë shërbimet elektronike?
A përdorni shërbimet elektronike?	Pearson Correlation	1	-.346**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	104	104
Sa ju kan lehtësuar punë shërbimet elektronike?	Pearson Correlation	-.346**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	104	104

Sipas rezultateve të nxjerra nga SPSS përmes analizës së korrelacionit del se ka një korrelacion të fortë signifikant negativ mes përdorimit të shërbimeve elektronike dhe lehtësirave që ofrojnë ato ( $r = -.346$ ,  $p = 0.01$ ). Nga kjo del se përdorimi i këtyre shërbimeve ndikon në lehtësimin e punëve të klientëve. Kjo e vërteton edhe hipotezen H1.

**Tabela 2**

*Analiza e korrelacionit që tregon lidhjen se sa ju kanë lehtësuar punën shërbimet elektronike bankare dhe sa i lehtë është përdorimi i shërbimeve të bankomatit (Atm-së).*

		Sa iu kanë lehtësuar punët shërbimet elektronike?	Sa lehtë janë të përdorshëm shërbimet e bankomatit (ATM-së)?
Sa iu kanë lehtësuar punët shërbimet elektronike të bankës?	Pearson Correlation	1	.064
	Sig. (2-tailed)		.517
	N	104	104
Sa lehtë janë të përdorshëm shërbimet e bankomatit (ATM-s)?	Pearson Correlation	.064	1
	Sig. (2-tailed)	.517	
	N	104	104

Sipas rezultateve të nxjerra nga SPSS përmes analizës së korelacionit të Pearson del se ka një korrelacion të fortë signifikant pozitiv mes lehtësirave që ofrojnë shërbimet elektronike bankare dhe sa janë lehtë të përdorshme shërbimet e bankomatit (ATM-së) ( $r=.517$ ,  $p=0.01$ ). Nga rezultatet e fituara vërtetohet edhe hipoteza jonë  $H_0$ , sipas të cilës sa më i lehtë është përdorimi i këtyre shërbimeve aq edhe më e thjeshtë dhe më e menaxhueshme është për klientin.

**Tabela 3**

*Analiza e korrelacionit mes nxitësve për të zgjedhur llojin e shërbimeve bankare dhe në cilën bankë komerciale në Kosovë është klient.*

		Cka iu nxitu që ta zgjedhni këtë lloj shërbimi të bankës?	Në cilën nga bankat komerciale të Kosovës jeni klient?
Cka iu nxitu që ta zgjedhni këtë lloj shërbimi të bankës?	Pearson Correlation	1	.252**
	Sig. (2-tailed)		.010
	N	104	104
Në cilën nga bankat komerciale të Kosovës jeni klient?	Pearson Correlation	.252**	1
	Sig. (2-tailed)	.010	
	N	104	104

Sipas rezultateve të nxjerra nga SPSS përmes analizës së korrelacionit të Pearson del se ka një korrelacion të dobët signifikant pozitiv mes nxitësve për të zgjedhur llojin e shërbimeve bankare dhe në cilën bankë komerciale në Kosovë është klient ( $r=.252$ ,  $p=0.01$ ). Ky rezultat i dalur vërtetohet edhe hipotezën e fundit sipas të cilës nxitësit/faktorët janë ndër arsye kryesore të përzgjedhjes së bankës komerciale nga ana e klientit.

## 5. Konkludime dhe Rekomandime

Nga rezultatet e arritura në punim del se:

- Edhe pse bankat komerciale në Kosovë po rrisin investimet në inovacione, këto investime nuk po ndikojnë që kënaqshmëria e klientëve ndaj risive në shërbimet bankare të rritet.
- Lehtësirat e përdorimit nga bankat ka ndikim statistikor në adaptimin e shërbimeve elektronike të bankave komerciale në Kosovë.
- Bankat komerciale në Kosovë kanë bërë investime në inovacione në vitet e fundit, por këto investime nuk po ndikojnë që klientet t'i zgjedhin ato banka që po janë më të shpejta në sjelljen e risive në tregun bankar.
- Kursimi i kohës dhe qasja 24 orësh janë dy arsytet për të cilat më së shumti qytetarët e përdorin E-banking në Kosovë.

### 5.1. Rekomandimet kryesore

- Bankat duhet të zgjedhin mënyrë më të favorshme për promovimin e shërbimeve elektronike duke krijuar lehtësi për përdorim dhe kosto më të ulta për klientet.
- Bankat duhet ta zgjerojnë rrjetin e qasjes ndaj shërbimeve të tyre elektronike edhe jashtë vendit po ashtu bankat duhet të jenë më të afërta me klientët, t'i mbajnë të informuar në lidhje me risitë e shërbimeve bankare, pasi që shumë klientë nuk i njohin shërbimet që banka e tyre ofron e kanë mungesë të informative për E-banking.
- Rekomandoj për shërbimin ATM, hapsirë të veçantë për të kryer shërbim që u mundësohet vetëm klientëve që kanë nevojë për shërbimet e bankomatit. Klientët për çdo kyqje në E-banking apo M-banking, të njoftohen me sms apo email lajmerues për të rritur nivelin e sigurisë. Në rastet kur kryhen transfere apo pagesa të njëpasnjëshme të kontaktohen nga banka për verifikim.
- Bankat në Kosovë duhet të punoj më shumë në promovimin e shërbimeve elektronike për të moshuarit pasi problem për përdorimin e ktyre shërbimeve është tek moshat mbi 65 vjet+.
- Rekomandoj që klientët të kenë mundësinë e aplikimit online të paktën për shërbim E-banking, siç mund të përmendim ndërrim të passwordit E-banking.
- Rekomandoj shtim të llogarive shtesë në listen e E-banking pasi që klientët nuk e kanë mundësinë e kryerjes së transfereve apo pagesave nëpërmjet ATM-së në banka tjera, mungesë e perkrahjës teknike etj. Klientët edhe pse kanë E-banking, nuk mund të aplikojnë për ndonjë shërbim shtesë online. Ende është obligative prezenca në bankë.
- Rekomandohet që të ketë një përfundim të përfunduar pasi që shpesh klientet presin një kohë të gjatë në degë për një shërbim shumë të thjesht qoftë për E-banking



apo M-banking, për arsye të mungesës së përsosur të këshillues për shërbime elektronike. Prandaj mund të themi që prezenca e përsosur të këshillues në bankë mund të ndikojë në rritjen e përdorimit të shërbimeve elektronike.

## Referencat:

1. Abenet, Y. (2010). Key factors that determine adoption of internet banking in Ethiopia. Addis Ababa University post graduate studies. Marrë më 25.05.2021, nga linku: <http://etd.aau.edu.et/bitstream/123456789/2274/3/ABENET%20YOYOHANNES.pdf>
2. Ainin, S., Lim, C.H., Wee, A. (2005). Prospects and Challenges of E-Banking in Malaysia. The Electronic Journal on Information Systems in Developing Countries, 22, pp 1-11
3. Akinci, S., Aksoy, Ş., & Atilgan, E. (2004). Adoption of Internet banking among sophisticated consumer segments in an advanced developing country. International Journal of Bank Marketing, 22(3), 212-232.
4. Almazari, A., Siam, A. (2008). E-Banking: An Empirical Study on the Jordanian Commercial Banks. Journal of King Abdulaziz University-Economics and Administration, 22
5. Banka Qendrore e Shqipërisë. (2009). Bankat në epokën e Internetit. Marrë më 20.06.2021, nga linku: [https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime\\_educative/Bankat\\_ne\\_epoken\\_e\\_internetit.html](https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_educative/Bankat_ne_epoken_e_internetit.html)
6. BQK, (2019), nga linku <https://www.bqk-kos.org/>,
7. Comptroller's Handbook. (1999). Internet Banking. Marrë më 20.06.2021, nga linku: <https://occ.gov/static/news-issuances/news-releases/1999/nr-occ-1999-94-internet-banking.pdf>
8. Federal Trade Commission. (August 2012). Marrë më 20.06.2021, nga linku: <https://www.consumer.ftc.gov/articles/pdf-0109-electronic-banking.pdf>
9. J Belás, J., Korauš, M., & Gabčová, L. (2015). Electronic Banking, Its Use and Safety. Are There Differences in the Access of Bank Customers by Gender, Education and Age? International Journal of Entrepreneurial Knowledge, 3(2), 16-28. doi:10.1515/ijek-2015-0013
10. Laukkanen, T. Pasanen, M. (2008). Mobile Banking Innovators and Early Adopters: How They Differ from Other Online Users? Journal of Financial Services Marketing, 13, 86-94. DOI: <http://dx.doi.org/10.1057/palgrave.fsm.4760077>
11. Marshall, J. J., Heslop, L. A. (1988). Technology Acceptance in Canadian retail banking: a study of consumer motivations and the use of ATMs. International Journal of Bank Marketing, Vol. 6, No.4.pp 31-41
12. Mobarek, A. (2007) E-banking practices and customer satisfaction- a case study in Botswana. University of Botswana
13. Nelson, R. R., & Winter, S. G. (1977). In search of useful theory of innovation. Research Policy, 6(1), 36-76. doi:10.1016/0048-7333(77)90029-4
14. Raiffeisen Bank Kosova - [www.raiffeisen-kosovo.com](http://www.raiffeisen-kosovo.com),
15. Raj, D, R. (2020). E-banking global perspective-issues & events. Government P.G. College, Ambala. DOI: [10.13140/RG.2.2.34141.03046](https://doi.org/10.13140/RG.2.2.34141.03046)
16. Rogers, E. (1983). Difuzion of Innovations. A Division of Macmillan Publishing Co., Inc. 866 Third Avenue, New York, N. Y. 10022, nr 82-70998
17. Sathye, M. (1999). Adoption of Internet banking by Australian consumers: an empirical investigation. International Journal of Bank Marketing, Vol. 17 No. 7, pp. 324-

334. <https://doi.org/10.1108/02652329910305689>
18. Shergill, G.S., Li, B. [2005]. Internet banking – An empirical investigation of customers' behaviour for online banking in New Zealand. *Journal of E-business*, Vol. 5, No. 1: 1-16
  19. Sohail, M.S., Shanmugharn, B.E. [2003]. E-banking and customer preferences in Malaysia: an empirical investigation. *Information Sciences*, Vol. 150, pp. 207-211
  20. STARS. [2016]. Shërbimet digjitale bankare në Kosovë. Marrë më 10.06.2021, nga linku: <https://www.bankassoc-kos.com/Al/te-tjera/160/sherbimet-digjitale-bankare-ne-kosove-dhjetor-2016/>
  21. Suh, B., Han, I. [2002]. Effect of trust on customer acceptance of Internet banking. *Electronic Commerce Research and Applications*, Vol.1, pp.247-263.
  22. Vyas, Sh. et al. [2012]. Impact of E-Banking on Traditional Banking Services. *International Journal of Computer Science & Communication Networks*, Vol 2(3), 310-313
  23. Biboli. E. [ 18.06.2015]. Inovacionet teknologjike e pavarsojne dhe e fuqizojne klientin e bankave. Marrë më 10.06.2021, nga linku: (<https://telegafi.com/sherbimet-moderne-bankare-dhe-inovacionet-teknologjike-e-pavaresojne-dhe-e-fuqizojne-klientin-e-bankave/>)
  24. Bela, J., Koraus, M., Gbcova, L. [2015]. Electronic Banking, Its use and safety. Are There Differences In the Access Of Bank Customers by Gender, Education and Age. *International Journal of Entrepreneurial Knowledge Issue 2/Volume 3* p 16-28
  25. Krasniqi, A., Beqiri, E., A.Sh.L.[ 2017]. E drejta Bankare Bankat dhe Ebanking. f.268
  26. Association German Banks. [2007]. Online banking security web (<file://onlinebankingsicherheit.pdf>)
  27. Krastafilaku, E. [2014]. Modele të reja në shërbimet bankare, të bazuara në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në Shqipëri. *Universiteti I Tiranës punim per doktorature*. Fq 17-20.

# Roli i menaxhmentit ne ngritjen e performances se Administrates Publike ne Republikën e Kosoves

---

Rina Fetahu

---

## Abstrakti

Konceptet e menaxhimit publik paraqesin analizë dhe studim mbi administraten publike, proceset dhe reformat që janë ndërmarrë, si dhe rolin e menaxhimit strategjik në zhvillimin e saj.

Roli i administratorëve publik në bërjen e politikave publike dhe rëndësia që ata kanë, në ngritjen e performancës së administrative publike paraqet çështje jetike. Sipas studiuësve egziston një marrëdhënie e fortë dhe ndikim pozitiv midis administratorëve publikë në politikë bërjen publike. Roli i menaxherëve është i jashtëzakonshëm, thelbësor në ngritjen e performancës së një fushe të cilën ata e udhëheqin. Një menaxher i mirë arrin që përmes punës profesionale ta ngris performancën e njerëzve duke ndikuar poashtu në ngritjen e performancës se një sektori publik. Ngritja e një sektori publik nënkupton zhvillimin e shtetit. Do të thotë zingjiri progresiv fillon nga individi që menaxhon një sektor publik, i cili nëpërmjet punës së mirë ndikon në progresin e një shteti. Globalisht administrata publike mund të konsiderohet si një shtrirje e qeverisjes.

## Fjalët kyçe:

administrator, menaxher, performancë, menaxhim publik

# 1. Konceptet bashkëkohor mbi menaxhimin publik

## 1.1 Definimi i termit menaxher

Menaxherët e sektorit publik perfeksionojnë aftësitë e tyre në marrëdhëniet me njerëzit dhe kanë nevojë për vizione dhe pasion për t’i realizuar projektet e tyre të cilët kanë imagjinatë dhe guxim për të ri-dizajnuar organizatat e tyre; dhe komunikojnë me vizionet e tyre, si dhe frymëzojnë punojnësit. Për të përfunduar këtë proces, menaxherët kanë nevojë për kritika konstruktive dhe modele për t’u imituar. Kështu një nga detyrimet e menaxhmentit të lartë është të mësojë dhe të udhëzojë dhe shohim që për mbijetesën e një organizate duhet marrë përsipër përgjegjësia e edukimit të liderëve të tij. Materialet e menaxherit janë aftësitë njerëzore. Thelbi i punës së tij është të arrijë qëllime madhështore përmes përpjekjeve njerëzore. Autori dhe politikani francez Jean-Jacques Servan-Schreiber përmbledh idenë: “Menaxhimi është arti i artit, sepse ai është organizues i talentit”.(Schreiber,1979). Menaxhmenti paraqet procesin përmes të cilit grupi i zgjedhur i njerëzve i drejton të gjithë të punësuarit, sipas detyrës së përbashkët për një qëllim të përbashkët.


## 2. Rëndësia e menaxhmentit në administrata publike

### 2.1 Roli i menaxherit në sektorin publik

Menaxherët janë përgjegjës për proceset e kryerjes së aktiviteteve në mënyrë efikase me dhe përmes njerëzve të tjerë dhe arritjen e qëllimeve të organizatës përmes ekzekutimit të katër funksioneve bazë të menaxhimit: planifikimi, organizimi, udhëheqje dhe kontrolli. Të dy grupet e proceseve përdorin burime njerëzore, financiare dhe materiale. Sigurisht, disa menaxherë janë më të mirë se të tjerët në arritjen e kësaj! Ka pasur një sërë studimesh mbi atë që menaxherët bëjnë në të vërtetë, më të famshmit nga ato të kryera nga profesori Henry Mintzberg në fillim të viteve 1970 (Mintzberg, 1973).

Roli i liderit përcakton marrëdhëniet ndërmjet menaxherit dhe punonjësve. (Mintzberg, 1973).

**Skica 2- Roli i menaxherit**



Marrëdhëniet e drejtpërdrejta me njerëzit në rolet ndërpersonale e vendosin menaxherin në një pozicion unik për të marrë informacion. Kështu, tre rolet informuese kanë të bëjnë kryesisht me aspektet informative të punës menaxheriale. Në rolin e monitoruesit, menaxheri merr dhe mbledh informacion. Në rolin e shpërndarësit, menaxheri transmeton informacion të veçantë në organizatë. Menaxheri i nivelit të lartë merr dhe transmeton më shumë informacion nga njerëz jashtë organizatës sesa mbikëqyrësi. Në rolin e zëdhënësit, menaxheri shpërndan informacionin e organizatës në mjedisin e saj. Kështu, menaxheri i nivelit të lartë shihet si një ekspert i industrisë, ndërsa mbikëqyrësi shihet si një njësi ose ekspert departamenti. Qasja unike në informacion e vendos menaxherin në qendër të vendimmarrjes organizative. Ka katër role vendimtare që luajnë menaxherët. Në rolin e sipërmarrësit, menaxheri inicion ndryshimin. Në rolin e trajtuesit të shqetësimeve, menaxheri merret me kërcënimet ndaj organizatës. Në rolin e alokuesit të burimeve, menaxheri zgjedh se ku do t'i shpenzojë organizatat përpjekjet e saj. Në rolin e negociatorit, menaxheri negocion në emër të organizatës.

Menaxheri i nivelit të lartë merr vendimet për organizatën në tërësi, ndërsa mbikëqyrësi merr vendime për njësinë e tij të veçantë të punës. Mbikëqyrësi i kryen këto role menaxheriale por me theks të ndryshëm nga menaxherët më të lartë. Menaxhimi mbikëqyrës është më i fokusuar dhe afatshkurtër në perspektivë. Kështu, roli i figurës bëhet më pak i rëndësishëm dhe roli i trajtuesit të shqetësimeve dhe i negociatorit rritet në rëndësi për mbikëqyrësin. Meqenëse lidërshipi përshkon të gjitha aktivitetet, roli i liderit është ndër më të rëndësishmit nga të gjitha rolet në të gjitha nivelet e menaxhimit (Mintzberg, 1973).

### **3. Menaxhimi publik dhe matja e performances në administratën publike në Republikën e Kosovës**

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët e Kosovës mbetet ende sfidë për të gjitha qeveritë lokale. Duke qenë dëshmitarë të kësaj kohe, shohim se ofrimi i shërbimeve esenciale lë shumë për të dëshiruar. Kjo vërehet dukshëm në komunat të cilat kanë territor më të madh dhe numër të madh të banorëve. Arsyet për këtë gjendje janë nga më të ndryshmet. Nga njëra anë administrata komunale është e mbingarkuar me personel dhe pjesë shumë e madhe e buxhetit të tyre shpenzohet për paga dhe medijtje të personelit, e nga ana tjetër edhe pse ka mbingarkesë të administratës, numër i madh i personelit nuk janë të pajisur me kompetenca për të performuar kënaqshëm në pozitën që mbajnë. Mungesa e buxhetit dhe mungesa e kapaciteteve njerëzore, janë vetëm disa nga arsyet pse qytetarët sot ballfaqohen me sfidat e panumërta gjatë rutinës ditore. Edhe pse performanca e komunave ka më shumë se një dekadë që matet nga niveli qendror, parametrat e matjes kanë qenë të fokusuar në matjen e sasisë së ofrimit të shërbimeve dhe asnjëherë nuk ka evoluar në nivel më të lartë, matjen e cilësisë së shërbimeve.

Kjo ngase, në shumë nga vendbanimet nuk ofrohen ende shërbimet esenciale, si uji i pijshëm, përfshirja në kanalizim, shërbimet shëndetësore, grumbullimi i mbeturimeve, etj

(MAPL, 2019). Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes Divizionit për Performancë të Komunave, në baza vjetore matë performancën e ofrimit të shërbimeve nga komunat përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës së Komunave, sistemi i cili ka filluar të zbatohet nga viti 2009. Në vijim është paraqitur ndërtimi dhe funksionimi i këtij sistemi.

### 3.1 Metodat e vlerësimit të performancës në sektorin publik në Republikën e Kosovës

Performanca karakterizohet nga shumë dimensione, prandaj edhe metodat që ndërtohen për vlerësimin e saj duhet të marrin në konsideratë aspekte të ndryshme të punës. Metodatat e performancës janë të shumta, por përgjithësisht ato ndahen në dy grupe të mëdha (Kutlllovci, 2004):

1. Metoda të orientuara nga sjellja,
2. Metoda të orientuara nga rezultatet.

Ndër metodatat e orientuara nga sjellja, dy janë kryesoret:

- Metoda grafike e shkallëzimit,
- Metoda e referimit.

**Metoda grafike e shkallëzimit** është një nga metodatat më të thjeshta dhe më ekonomike të vlerësimit të performancës. Sipas kësaj metode, renditen në një tabelë të gjithë faktorët që mendohet se përcaktojnë performancën e punonjësve dhe vlerësimi i tyre bëhet sipas një shkallëzimi të caktuar.

**Metoda e referimit** është një metodë relativisht e re që përfaqëson një teknikë vlerësimi nëpërmjet përcaktimit qysh më parë të disa pika, të cilat i përdorim si pika referimi për të gjykuar nëse performanca është e mirë apo e keqe. Për t'i përcaktuar këto pika reference, duhet të bëhet një analizë e detajuar e punës dhe e ngjarjeve të ndodhura në praktikë. Si e tillë, kjo metodë kërkon harxhim relativisht të madh kohe e mjetesh monetare, prandaj ajo është e rekomandueshme të përdoret kryesisht në ato raste kur shumë persona kryejnë të njëjtën punë apo punë të ngjashme midis tyre.

**Metoda e orientuar nga rezultati** Metoda më kryesore është menaxhimi me anë të objektivave. Kjo metodë është në përdorim të gjërë, pasi objektivat e përcaktuara në bashkëpunim midis eprorit dhe vartësit shërbejnë si standarde kundrejt të cilëve bëhet vlerësimi i performancës së tyre. Një nga avantazhet kryesore të kësaj metode është se punonjësit e dinë pak a shumë si do të vlerësohet performanca e tyre. Menaxhimi nëpërmjet objektivave (MNO) është një filozofi e propozuar në fillim nga Peter Drucker. MNO kërkon të gjykojë performancën e punonjësve në bazë të suksesit të tyre në arritjen e objektivave që ata kanë vendosur, nëpërmjet konsultimit me eprorët e tyre. Përpyekjet e përmirësimit të performancës sipas MNO fokusohen në qëllimet që duhen arritur nga punonjësit dhe jo në aktivitetet që ata kryejnë. Në mënyrë që të kenë sukses, programet e MNO duhet të arrijnë disa kërkesa:

- së pari, objektivat e vendosura në çdo nivel të organizatës duhet të jenë sasiore dhe të matshme,
- së dyti, rezultatet e pritshme duhet të jenë nën kontrollin e punonjësve dhe qëllimet duhet të jenë në përputhje për çdo nivel,

- së treti, menaxherët dhe punonjësit duhet të vendosin kohët specifike kur do të rishikohen dhe vlerësohen qëllimet,
- së fundit, çdo qëllim i punonjësit duhet të shoqërohet nga një përshkrim se si do të arrihet ky qëllim.

Ekzistojnë edhe shumë metoda të tjera për të vlerësuar performancën. Këto në përgjithësi janë të klasifikuar si metoda krahasues dhe standarde absolute. Një sektor publik duhet të zgjedh një metodë të bazuar në dy kritere:

- a) faktorët që organizata dëshiron t'i masë dhe
- b) metoda që më së shumti mund t'i përshtatet natyrës së organizatës.

Metoda krahasuese – Ashtu siç tregon edhe emri i tyre, metodat komparative krahasojnë një punëtor me punëtorin tjetër, me qëllim të përcaktimit të rangimit të performancës (Kutllovci, 2004). Standardet absolute- përmes përdorimit të standardeve, çdo rast individual vlerësohet në bazë të standardeve të shkruara, me ç'rast maten disa faktorë të performancës. Një ndër këto metoda është edhe metoda e sistemit referent. Ranguesi identifikon dhe cakton një peshë për çdo detyrë që duhet të vlerësohet. Punonjësi pastaj notohet në çdo detyrë për të caktuar performancën e përgjithshme.

**Menaxhimi sipas objektivave** (Management by Objectives – MBO) është një program i vlerësimit, i bazuar në rezultate, në të cilin qëllimet në mënyrë reciproke përcaktohen nga mbikëqyrësit dhe vartësit dhe punonjësit kategorizohen në shkallë varësisht nga përmbushja e qëllimeve. MBO nënvizon vlerën dhe rëndësinë e involvimit të punonjësit dhe inkurajon diskutimet e punonjësve për përparësitë dhe dobësitë.

Çështjet për dizajnimin e një sistemi efektiv të vlerësimit të performancës përfshijnë:

- 1.) Qëllime të qarta dhe të matshme për çdo punë
2. Vlerësime të rregullta dhe “feed-back”,
3. Lidhje të procesit me zhvillimin e punonjësit dhe
4. Edukim të vlerësimit rreth qëllimeve dhe praktikës së tij. Megjithatë, është e rëndësishme të vlerësohet në mënyrë objektive procesi i vlerësimit të performancës, si në teori ashtu edhe praktikë. Ky vlerësim përfshin një rishikim të qëllimit, të karakteristikave dhe të detyrave të rëndësishme për procesin e vlerësimit dhe një përmbledhje të problemeve të këtij sistemi.


## 4. Analizë empirike e fituar nga të dhënat në terren

Në punim është shqyrtuar se si bëhet menaxhimi i performancës në sektorin publik dhe sa ndikon menaxhimi dhe vlerësimi i performancës së punonjësve të sektorit publik. Ky hulumtim është kryer gjatë periudhës kohore Qershor-Tetor 2022. Menaxhimi i burimeve njerëzore është një proces i cili është i fokusuar tek marrëdhëniet njerëzore, ku në mënyrë që kontributi i tyre në punë të jetë sa më i madh, me anë të menaxhimit bëhet sigurimi i mirëqenies së tyre. Vlerësimi i performancës lidhet ngushtë me suksesin e një institucioni sepse sa më e madhe të jetë performanca e punonjësve aq më shumë edhe institucioni në tërësi do të korr sukses, por për të arritur një performancë në nivel, duhet të ketë qëllime të caktuara të cilat të cilat

më pas do ta tregonin rezultatin. Menaxhimi i burimeve njerëzore ka kaluar nëpër një proces të gjatë të zhvillimit derisa ka arritur në statusin që ka marr sot, si një nga funksionet më të rëndësishme të menaxhimit në një organizatë, sektor apo njësi. Ky hulumtim ka gjithsej 100 të anketuar.

**Grafiku 1 Sa e kuptoni termin performance?  
SA E KUPTONI TERMINI PERFORMANCË?**

■ Shumë mirë ■ Mesatarisht ■ Nuk e kuptoj ■




Pyetja e parë ndonëse mund të apostrofohet si një pyetje banale, megjithatë ka pasë një prapvijë të arsyeshme. Pyetje e thjeshtë, por e cila do të shpërfaqte problematika të thella në sistemin tonë institucional, sikurse të ishte vetëm edhe një përgjigje e mosnjohjes së termit performancë. Megjithatë nga 100 anketues të gjithë kanë pasë njohuri mbi këtë term.

**Grafika 2 Ndikimi i vlerësimit të mirë**

**A KA NDIKUAR VLERËSIMI I MIRË NË ZBATIMIN DHE KRYERJEN E DETYRAVE TUAJA TË PUNËS?**

■ Po ■ Mesatarisht ■ Fare pak ■ Jo




Vlerësimin e mirë e pranojnë të gjithë, por shpeshherë hasim probleme atëherë kur vlerësimi ka konotacion negativ. Jo çdokush arrin ta kapërdijë vlerësimin si negativ. Megjithatë mbetem e kënaqur që 79% e anketuesve janë ndjerë të vlerësuar shumë mirë nga menaxherët apo administratorët.



**Grafika 3 Realizimi në afat i proedurave të vlerësimit**

**A REALIZOHET NË AFAT PROCEDURA E VLERËSIMIT TË  
REZULTATEVE TË PUNËS APO NDODH QË EDHE TË NEGLIZHOHET?**

■ Po, realizohet. ■ Realizohet, pak para afatit ■ Nuk realizohet në afat ■




Në këtë pyetje nuk kam hasë në ndonjë anomali, ashtu siç edhe është pritur 92% kanë dhënë përgjigje pozitive në lidhje me realizimin e vlerësimeve të duhura.

**Grafika 4 Ndikimi i metodave vlerësuese në ngritjen e performancës**

**SA KANË NDIKUAR METODAT VLERËSUESE NË NGRITJEN  
PERFORMANCËS/VLERËSIMIT TUAJ?**

■ Shumë ■ Mesatarisht ■ Aspak ■




Duket qartë se vlerësimi nga menaxherët ka qenë i duhur dhe metodat vlerësuese kanë qenë të kënaqshme. Të paktën nga të anketuarit tanë shihet qartë se asnjëri nuk ka dhënë përgjigje negative, duke na bërë të kuptojmë se menaxherët apo administratorët janë duke i marr me seriozitet dhe profesionalizëm problemet e vlerësimit.

**Grafika 5** *Komunikimi individual i rezultateve të vlerësimit*

**KUJT I JEPNI MË SHUMË RËNDËSI GJATË PUNËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

■ Faktorëve cilësor   ■ Faktorëve sasior   ■ Të dyjave njëkohësisht   ■




Komunikimi individual apo grupor i vlerësimit, tregon një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit. Ai aspekt është transparenca ndaj punëtorit. Transparenca ndaj punëtorit e bën të ndihet i vlerësuar punëtori gjë që ndikon në ngritjen e cilësisë. Nuk ka rëndësi aq shumë komunikimi a ndodh në grup apo individualisht, sipas mendimit tim, vetëm të qënurit transparent krijon tek punëtorët një besim të plotë nga menaxheri dhe krijimin e një frymë të mirë në ambientet e punës, gjë që natyrisht ndikon në ngritje të cilësisë dhe shërbimeve.

**Grafika 6** *Kujt i jepni më shumë rëndësi gjatë punës në administratën publike*

**KUJT I JEPNI MË SHUMË RËNDËSI GJATË PUNËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

■ Faktorëve cilësor   ■ Faktorëve sasior   ■ Të dyjave njëkohësisht   ■



Siç e kemi përmendur gjatë punimit, administrata publike vlerëson shumë performancën mbi faktorët cilësor dhe sasior. Shikuar nga kënvështrimi i përgjigjeve shihet se përgjigja është ndarë në tre grupe të mëdha. Grupi i parë që mendoj se është më i drejti, i ka dhënë rëndësi edhe faktorëve cilësor edhe faktorëve sasior duke i komponuar të dyja gjatë punës, kurse grupi i dytë dhe i tretë iu kanë dhënë rëndësi njëra apo tjetra. Edhe pse gjatë punës punojnë me të dy faktorët, megjithatë ata mendojnë se njëra apo tjetra kanë një rëndësi pak më të madhe dhe duhet dhënë kujdës më të shtuar.

## 5. Konkluzione dhe rekomandime

Në bazë të analizës në studimin të vlerësimit të performancës, kemi arritur në përfundim se një proces mirë i organizuar i vlerësimit të performancës, duke ditur se: çfarë dëshiron të masësh, duke krijuar standardet që në fillim se në bazë të cilave standarde dëshiron të masësh, mbi metodat që do të përdorësh, se si vlerësohet nga vlerësuesi, një vlerësim sa më objektiv do ketë një ndikim shumë të madh si për institucionin ashtu edhe për të punësuarit. Të mirat për institucionin janë ato se ia jep një pasqyrë reale për punën që bëhet në dhe proceset të cilat duhet të ndryshojnë në bazë të rezultateve të vlerësimit të performancës dhe për punëtorët është një mundësi e mirë, sepse ata kuptojnë saktësisht se si janë duke punuar dhe në një mënyrë apo tjetër del në shesh çdo problematikë, e cila mund të zgjidhet përfundimisht duke vënë në progress institucionin. Aplikimi i vlerësimit të performancës së administratës publike është proces kyq në zhvillimin e vendit, shihet se metodat që përdoren ndonëse paksa të kufizuara janë tejet efikase në realizimin apo përmbushjen e pritshmërive dhe ngritjes së performancës së administratës publike

Disa rekomandime, për menaxherët e administratave publike:

1. Kalimi nga transparenca teorike në atë reale apo praktike, e cila e bën më të lehtë për t'u kuptuar punën e administratës publike
2. Angazhimi i punonjësve publik për administratë publike të hapur.
3. Hartimi i një plani kombëtar për integritetin e sektorit publik dhe luftën kundër korrupsionit
4. Promovimi i përdorimit të të dhënave të hapura si një mjet për krijimin e vlerave
5. Ndërtimi i një strukture administrative sa më fleksibël duke decentralizuar kompetencat në lidhje me përmirësimin e shërbimeve të përbashkëta

## Referencat:

- MUMFORD, Lewis – The City In History: Its Origins, Its Transformations and Its Prospects – New York, Harcourt, Brace and World [1961]
- HAMMOND, Nicholas – A History Of Macedonia. Vol. I: Historical geography and prehistory. Oxford: The Clarendon Press, [1972]
- SCHREIBER, Jean-Claude Servan-, Le Huron de la famille, Calmann-Lévy, [1979].
- DeMARS Leslie Heavy Vetting: Boards of directors now want to talk to would-be CFOs and vice versa. CFO Magazine, California, [2006]
- GHOSHAL, S. and BARTLETT, C. The Individualized Corporation: A Fundamentally New Approach to Management. Collins Business, New York [1999]
- ROSENTHAL, Caitlin Accounting for Slavery: Masters and Management. Harvard University Press, Massachusetts [2018].
- CHONG, Derrick Arts Management. London: Routledge. [2010].
- HAYNES, Marion - Managing Performance New York, Crisp Learning: [1990]
- KETTL, Donald and FESSLER, James. The Politics of the Administrative Process. Washington D.C.: Press [2009]

- MINTZBERG, Henry The Nature of Managariel Work. Harper&Row, New York [2013]
- MINTZBERG, Henry Manager - L'essentiel: Ce que font vraiment les managers... et ce qu'ils pourraient faire mieux Paris, Vuibert [2014]
- GOMEZ-Mejia, LUIS R.; BALKING B. David; CARDY, Robert Management: People, Performance, Change, 3rd edition. New York:McGraw-Hill, [2008].
- KETTL, Donald The Transformation of Governance: Public Administration for Twenty-First Century America, Johns Hopkins University Press, Maryland 2002
- CIPFA, [International Federation of Accountants (IFAC)/Chartered Institute of Public Finance and Accountancy (CIPFA) International Frame Work: Good Governance in the Public Sector Public Sector (New York: IFAC and London: [2014]
- MAWHINNEY, Thomas C. REDMON, William, MERLE, Carl Handbook of Organizational Performance,. Routledge. [2001]
- DeNISI, A. & PRITCHARD, R.]. Performance appraisal, performance management, and improving individual performance: A motivational framework. Management and Organization Review, [2006]
- ARVEY, R. D., & MURPHY, K. R. [1998]. Performance evaluation in work settings. Annual Review of Psychology,
- CARDY, R. L. Performance management: Concepts, skills, and exercises. New York: M. E. Sharpe, [2003]
- CEDERBLUM, D.The performance appraisal interview: A review, implications, and suggestions. Academy of Management Review, [1982]
- FISHER, S. G. [1997]. The manager's pocket guide to performance management. Amherst, MA: HRD Press.
- Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Komunave – Matje për t'u përmirësuar, MAPL, [2017];
- RISHER, H. Refocusing performance management for high performance. Compensation and Benefits Review. Pensylvania [2003]
- MEYER, M. KIRSTEN, M. Introduction to Human Resource Management. Claremont, CA: New Africa Books [2005]
- Raporti i performancës së komunave për vitin 2017, s.l.: MAPL. [2018].
- Raporti i performancës së komunave për vitin 2018, s.l.: MAPL. [2019]
- KUTLLOVCI, E. Menaxhimi i Resurseve Humane. Prishtinë. [2004]
- LLACI, Sh. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. Tiranë. Botimi i II [2005]
- "Parimet Evropiane të Administratës Publike", Dokumentet e SIGMA-s, Nr. 27, Publikimet e OECD, <http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/5kml60zwd7h.pdf?expires=1398415030&id=id&accname=guest&checksum=FD455B0079C9FE4E957DE2E41D-6A25CA>

# Mituria si pengesë martesore

---

Arxhend Qaili,  
Erina Hoxha

---

## ABSTRAKT

Mosha si një nga kriteret për lidhjen e një martese të ligjshme vazhdon të jetë një nga sfidat e shoqërive në tranzicion. Përplasja rreth çështjes së miturisë si pengesë martesore është jo vetëm në rrafshin praktik por edhe në atë teorik. Kryesisht, në shtetet në zhvillim por edhe në ato me të drejtë zakonore të fuqishme vërehen kundërshti ndërmjet rregullimit juridik dhe atij zakonor të kësaj çështjeje.

Punimi mëton të shpalos këtë divergjencë ndërmjet normave zakonore dhe atyre juridike në rregullimin e moshës së lejuar për lidhje të martesës së ligjshme në kontekstin e Kosovës, duke analizuar Ligjin për Familjen në Kosovë si dhe dispozitat kanunore dhe shariatike. Punimi nuk është i mbështetur vetëm në shqyrtime teorike dhe analiza juridiko-dogmatike por edhe në të dhëna cilësore përmes intervistave nga njohës të kësaj çështjeje. Qasja e përdorur është interdisciplinare dhe e ndërthurur duke e trajtuar fenomenin e miturisë si pengesë martesore nga prizmi i së drejtës, sociologjisë dhe ai të drejtave të njeriut.

Pra, duke përdorur metodat krahasuese, analitike, juridiko-dogmatike dhe cilësore, punimi shtjellon martesat miturore dhe ndikimin e zakoneve dhe faktorëve tjerë në favorizimin e kësaj dukurie e cila është e rregulluar qartë me dispozita të së drejtës pozitive.

## Fjalët kyçe:

martesat, mituria, ligji për familjen, kanuni, sheriati.

## 1. Hyrje

Mituria si pengesë martesore është një temë shumë e rëndësishme në të drejtën familjare e cila ka qenë në qendër të debatit dhe diskutimit nëpër shekuj. Në këtë punim me anë të metodës krahasuese, analitike, juridiko-dogmatike dhe asaj cilësore do të bëjmë një analizë në mes të burimeve të së drejtës zakonore si: Kanuni dhe sheriat, me ligjin për familjen në Republikën e Kosovës (LIGJI NR. 2004/32), në lidhje me miturinë si pengesë martesore.

Në këtë analize krahasuese do të shqyrtojmë se si kanuni dhe sheriat si burime të së drejtës zakonore kanë trajtuar çështjen e miturisë si pengesë martesore dhe si ka ndikuar tek të miturit kjo praktikë e dëmshme. Do të hulumtojmë se a kanë qenë efektive dispozitat e këtyre rregullave tradicionale për lidhjen e marrëdhënieve martesore, çfarë efekte negative kanë pasur tek fëmijët dhe a praktikohen ato në ditët e sotme duke ditur se kemi kundërligjshmëri me dispozitat e ligjit për familjen (LIGJI NR. 2004/32), dhe njëkohësisht ky fenomen shkakton shkelje të të drejtave të njeriut.

Nga studimet e mëparshme, të kryera nga autorë të ndryshëm, me theks të veçantë gjatë periudhës së viteve të 80-ta, është vërtetuar se ndikimi i normave fetare në martesat e hershme të vajzave ka qenë relativisht i lartë. Në ndërkohë, me zhvillimet shoqërore të mileniumit të ri, ndikimi i normave fetare në rregullimin e martesave si dhe raporteve ndërmjet bashkëshortëve në bashkësi martesore është zbehur shumë duke i dhënë përparësi rregullimit juridik të martesës nëpërmjet normave juridike që rrjedhin nga Ligji për Familjen në Kosovë.

Megjithatë, mituria si pengesë martesore vazhdon të shpërfaqet edhe sot, me theks të veçantë në zonat e thella rurale dhe kryesisht brenda komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase. Në komunitetet e lartpërmendura normat fetare vazhdojnë të dominojnë procesin e lidhjes së martesave duke shkelur dispozitat e Ligjit për Familjen në Kosovë e të cilat në mënyrë taksative e përcaktojnë moshën e lejuar për lidhjen e martesës. Paraqitja e këtij fenomeni të martesave të hershme është po ashtu rrjedhojë e gjendjes së vështirë socio-ekonomike të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas si dhe nivelit të ulët të njohurive lidhur me të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet prindërve dhe fëmijëve në kuadër të bashkësisë martesore apo edhe asaj jashtëmartesore.

Problemi i shpërfaqur, lidhur me miturinë si pengesë martesore, është trajtuar në mënyrë joadekuate nga institucionet përkatëse duke lejuar që fenomeni i përmendur të mos ndërpritet. Shoqëria civile dhe sidomos organizatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të grave janë mjaftë aktive në parandalimin e këtij fenomeni gjë që ka ndikuar në ngritjen e përgjithshme të vetëdijes së shoqërisë për ta luftuar këtë dukuri.

## 2. Martesa si institucion juridik dhe shoqëror

Martesa është një lidhje midis dy personave që synon të krijohet në baze të dashurisë, respektit dhe besnikërisë. Martesa shpall publikisht një marrëveshje të përjetshme midis dy njerëzve për të ndarë përgjegjësitë dhe për të ndërtuar një familje së bashku. Martesa në kuptimin juridik është një kontratë ligjore midis dy personave që synon të krijojë një lidhje të

vazhdueshme dhe të ndërjegjshme në mes tyre. Martesa është e rregulluar nga ligjet e një shteti, qe ka për qëllim të mbrojë të drejtat dhe detyrimet e qiftit si dhe të rregullojë aspektet e ndryshme të jetës së tyre familjare. Përveç të drejtave dhe detyrave midis bashkëshortëve, martesa ka një rol të rëndësishëm në ligjin e trashëgimisë, ligjin e fëmijëve dhe në ligjin e divorcit. Pra, martesa është institucion juridik duke qenë se mënyra e lidhjes së saj, raportet bashkëshortore, të drejtat dhe detyrimet në bashkësi martesore, por edhe vet zgjidhja e martesës janë të rregulluara me norma juridike të karakterit urdhërues. Martesa është edhe institucion shoqëror ngase nga kjo varet edhe zhvillimi demografik i shoqërisë, respektivisht reprodukimi shoqëror.

Martesa kryesisht ka tri qëllime kryesore: Qëllimin natyror (i cili është thujtë qëllimi kryesor i martesës është lindja e dhe mirëritja e fëmijëve, që nënkupton raportet intime në mes bashkëshortëve); qëllimin moral (bashkëshortet kanë për detyrë të ndihmojnë njëri tjetrin në nevojë, ta mirëkuptojnë, ta mbrojnë, të kujdesen dhe ti japin përkrahje morale dhe materiale në raste të nevojës); qëllimi shoqëror (martesa nuk është çështje private, veçse institucion shoqëror, ajo është bazë e familjes, qe ka detyrë të kryej funksione të shumta shoqërore, para së gjithash vetëdijesimin dhe ngritjen e shëndoshë të brezave të rinj. Pikërisht për shkak të karakterit shoqëror që kanë martesa dhe familja, ato janë vendosur nën përkujdesje dhe mbrojtje shtetërore dhe shoqërore.

Martesa si institucion në vete posedon edhe pengesa ligjore të evitueshme dhe të pa evitueshme. Më poshtë do të potencohen disa nga pengesat ligjore në lidhje me kurorëzimin apo lidhjen e kontratës së martesës. Martesa në mes të gjinisë së njëjtë, e cila është shumë e evidente në ditët e sotme por jo në të gjitha shtetet e botës, është ligjore në disa kontekste por lidhur me këtë çështje vazhdohet të debatohet fuqishëm për dhe kundër në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Sipas disa studimeve të ndryshme, shumica e shteteve të botës që e kanë pranuar këto lloje të martesave janë pikërisht në shtetet e Evropës perëndimore.

Pengesë është edhe lidhja e afërt e gjakut e cila është e ndaluar apo e kufizuar nga ligji me raste të caktuara. Megjithatë, ka disa vende të cilat e këtë pengesë e konsiderojnë relative dhe në rrethana të caktuara edhe lejohet. Në kontekstin Kosovës dhe në përgjithësi në vendet ballkanike gjinia e gjakut paraqitet si pengesë absolute martesore.

Pengesë është edhe poligamia (martesa e shumëfishtë) e cila është e ndaluar në shumicën e shteteve të botës. Organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e ka kërkuar ndalimin e poligamisë në mbarë botën, duke argumentuar se kjo praktikë shkel dhe diskriminon gratë.

Si pengesë e pa evitueshme është edhe gjendja psiko-fizike e individit, nëse një person nuk është në gjendje psiko-fizike të mirë dhe e ka të pamundur të marrë vendime, në ato raste martesa nuk mund të realizohet.

Si pengesë martesore globale e cila është më e përhapur se pengesat tjera, përfshirë edhe Republikën e Kosovës, është edhe mituria në të cilën edhe fokusohet ky hulumtim. Moshë minimale e lejuar me ligj për të lidhur martesë ndryshon në vende të ndryshme të botës dhe atë nga 16 deri në 21 vjeç, në pjesën më të madhe të vendeve. Megjithatë, duhet të theksohet se mosha minimale e lejuar për të martuar është vetëm një kriter për të vlerësuar ligjshmërinë e një martese, pasi ka shumë faktorë të tjerë që duhet të merren në konsideratë, si për shembull, qëndrimi i lirë dhe i ndershëm i dy partnerëve për të marrë vendime dhe që

të dy të jenë në moshë të mjaftueshme për të kuptuar dhe pranuar përgjegjësitë dhe sfidat e një martesë.

Praktika e martesës së fëmijëve ka vazhduar të bjerë në mbarë botën. Gjatë dekadës së kaluar, përqindja e grave të reja që ishin të martuara si fëmijë u ul me 15 %, nga 1 në 4 (25%) në afërsisht 1 në 5 (21%). Megjithatë, rreth 650 milionë vajza dhe gra që jetojnë sot janë martuar para ditëlindjes së tyre të 18-të. Ndërsa ulja globale e martesave të fëmijëve duhet të festohet, asnjë rajon nuk është në rrugën e duhur për të përmbushur Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm për eliminimin e kësaj praktike të dëmshme deri në vitin 2030.

Është e rëndësishme të theksohet se në disa vende ka ende praktika të martesave të shumëfishta, dhe në disa prej tyre, moshë minimale për martesën mund të jetë më e ulët se sa te martesat mongame. Megjithatë, kjo praktikë është e diskutueshme dhe shumë vende kanë nisur procesin e ndalimit të saj për shkak të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe diskriminimit të grave.

### **3. Mituria si pengesë martesore sipas ligjit për familjen në Republikën e Kosovës**

Sipas ligjit për familjen në Republikën e Kosovës (LIGJI NR. 2004/32), mituria është një nga pengesat martesore e cila është e rregulluar detajisht me dispozitat ligjore. Për më tepër, dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje kanë mbetën të karakterit urdhërues përkundër faktit që Ligji për Familjen është amandamentuar disa herë që nga miratimi i tij në vitin 2006. Në vijim do të analizojmë disa prej dispozitave kryesore të këtij ligjit në lidhje me miturinë si pengesë martesore.

Neni 15 i Ligjit për Familjen përcakton se martesë nuk mund të bëhet nëse njëra nga palët është nën moshën minimale të martesës ose nëse nuk kanë aftësi të marrin vendime të vetëdijshëm për tu martuar. Pra, në Republikën e Kosovës, martesë nuk mund të lidhet ligjërisht nëse personat janë të mitur. Nëse ndodh që një person i mitur ka lidhur martesë në Kosovë, ajo mund të anulohet nëpërmjet një procesi gjyqësor, i cili mund të nisë nga vetë personi i mitur, prindërit ose gjykatat kompetente.

Përveç kësaj, ligji në Kosovë ka dispozita të tjera që mbrojnë të drejtat e personave të mitur në lidhje me martesën, duke ndaluar martesën e detyruar ose martesën e kushtëzuar. Kjo do të thotë se personat e mitur kanë të drejtë të bëjnë vendimet e tyre për martesën në moshën e duhur dhe në bazë të vullnetit dhe dashurisë së tyre.

Por ekzistojnë edhe mënyra të veçanta të cilat e përjashtojnë miturinë si pengesë martesore në Republikën e Kosovës. Në raste të veçanta, mund të ketë nevojë për lejen e gjykatës për martesë nëse një person dëshiron të lidhë martesë përkundër faktit se nuk ka arritur moshën minimale të përcaktuar ligjërisht. Për të marrë lejen për martesë në këto raste, personi i mitur duhet të paraqitet në Gjykatën e Themelore të zonës ku ai ose ajo jeton dhe të kërkojë lejen e gjykatës për të martuar.

Në këtë rast, ai ose ajo duhet të kërkojë një autorizim nga gjykata, duke paraqitur një kërkesë shkruar në formë të rregullt dhe duke vendosur arsyet se pse dëshiron të martohet



në moshën e tij ose të saj të mitur. Gjykata, do të shqyrtojë kërkesën dhe do të vendosë nëse duhet të japë autorizimin për martesë. Nëse gjykata e vlerëson se kërkesa për autorizim për martesë është në interesin e personit të mitur, atëherë do të japë autorizimin për martesë me kusht që organi i kujdestarisë dhe raporti mjekësor është në favor të një martese të tillë dhe vlerëson apo konstaton gjendjen e mirë psiko-fizike të palës. Në përgjithësi, leja për martesë nga gjykata jepet vetëm në raste të veçanta dhe kjo varet nga vlerësimi i gjykatës, duke e konsideruar situatën dhe rrethanat konkrete.

Në këtë mënyrë, Ligji për Familjen në Kosovë ka krijuar një mjedis ligjor të favorshëm për lirinë e martesës dhe në raste të veçanta ka bere të mundur edhe tejkalimin e miturisë si pengesë martesore, brenda kushteve të përcaktuara sipas ligjit por asnjëherë në moshë më të hershme se 16 vjeç.

## 4. Dispozitat e Kanunit lidhur me martesën

Kanuni i Lekë Dukagjinit është me rëndësi të jashtëzakonshme për kulturën dhe traditën shqiptare. Libri është një kod i zakoneve dhe traditave që kanë qenë të praktikuara në veri të Shqipërisë dhe në trojet e tjera shqiptare, përfshirë edhe Kosovën. Libri është ndarë në dymbëdhjetë (12) vëllime, të cilat trajtojnë zakonet dhe traditat e shqiptarëve. Vëllimi i tretë është një nga vëllimet më të rëndësishme të librit, pasi trajton një seri prej 21 kapitujsh që janë të dedikuara në përshkrimin e rregullave të zakonshme për martesën, lidhjen e martesës dhe divorcit.

Në vëllimin e tretë të kanunit të Lekë Dukagjinit mund të shohim se kemi shumë pengesa martesore por qëllimi ynë në këtë hulumtim është që të fokusohemi tek mosha minimale e lejuar tek meshkujt dhe tek femrat në lidhjen e një martese. Në këtë kanun nuk ka një pjesë të veçantë që flet drejtpërdrejt për moshën e martesës apo miturinë, por ka disa rregulla që lidhen me këtë temë. Në përgjithësi, kanuni përcakton moshën minimale të martesës për vajzat dhe djemtë, si dhe rregullat për të bërë kërkesën për martesë dhe ceremoninë e martesës.

Sipas rregullave kanunore, moshat minimale të martesës janë shumë më të ultë në krahasim me ligjin e sotëm dhe kishte dallime gjinore apo seksiste, vajzat mund të martohen në moshën 12-14 vjeçe me kushtin që martesa të kryhet pas dy-tre vitesh kur ato arrijnë moshën 14-16 vjeçe, ndërsa djemtë mund të martoheshin në moshën 18-20 vjeçe.

Në kanunin e Lekë Dukagjinit kemi hasur në shumë dispozita diskriminuese sidomos tek gjinia femërore siç u theksua më lartë. Pra, femra nuk kishte të drejtë zgjedhje për fatin e saj të jetës dhe për më tepër ajo ishte e nënshtruar. Një dispozitë kanunore e cila e dëshmon këtë përmendet në nyjën e trembëdhjetë e cila flet për detyrat e gruas në martesë dhe thotë se: *“Gruaja anë detyrë me i rroguja pa zhibla, dhe me i ndejë nën sundim, me i ndejë gati me të veshjen e të mbathjen”*. Do të thotë se roli i femrës sipas kanunit është vetëm një mjet pune dhe shtimit të natalitetit.

## 5. Rregullat e sheriatit lidhur me lidhjen e martesës

Në botën Islame nuk ka një moshë të caktuar në lidhje me miturinë si pengesë martesore. Nuk ka asnjë Dispozitë në Sheriat që të përcaktojë një moshë të caktuar martesore për burrin ose gruan. Përgjithësisht, ekziston pajtimi se martesë e një vajze të mitur (nën 18 vjeç) është e lejuar nëse babai i saj e jep lejen për martesë me dikë edhe nëse vajza nuk është në pajtueshmëri me atë akt. Moshë e lejuar në Sheriat është e caktuar me pubertetin, pjekurinë e përgjithshme dhe aftësinë e tij/saj për të dalluar se çfarë është e mirë apo e keqe, të tilla që miratimi ose mosmiratimi i tij personal në vendimet e rëndësishme të jetës të bëhet i vlefshëm.

Për një grua madhore, nuk parashikohet që babai i saj ta martojë, përkundrazi çdo kujdestar mund ta martojë atë. Por parashikohet që ajo të japë lejen dhe pëlqimin e saj në lidhje me atë martesë. Femra e arrin moshën madhore kur ndodh një nga katër gjërat: mbushja e moshës pesëmbëdhjetëvjeçare, rritja e qimeve pubike, emetimi i maniy-t (lëngu i lëshuar në momentin e kulmit) me dëshirë qoftë zgjuar apo në gjumë, ose cikli menstrual.

Në rast se femra nuk e ka arritur moshën madhore Kurani dhe Suneti tregojnë se martesë e një të mituri (një femre që ende nuk e ka arritur pubertetin) është e vlefshme dhe nuk parashikohet ndonjë moshë e caktuar për këtë. Nëse një burrë e jep për martesë vajzën e tij të virgjër me dikë që është në pajtueshmëri, atëherë martesë është e vlefshme.

## 6. Analizë krahasuese në mes të së drejtës zakonore dhe Ligjit për Familjen në Kosovë

Siç është theksuar edhe më lartë, në Republikën e Kosovës, sipas Ligjit për Familjen (LIGJI NR. 2004/32), moshë minimale për lidhjen e një martesë është 18 vjeç, dhe askush nuk mund të martohet para kësaj moshe, pa marrë lejen e gjykatës. Kjo është një rregull që duhet të ndiqet nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Në të drejtën zakonore, moshë minimale për lidhjen e një martesë nuk është e caktuar në mënyrë të përgjithshme, por nëse flasim për moshat rreth 12-14 vjeçare tek vajzat, me kusht që martesë të përfundojë kur ajo të mbushë 14-16 vjeç, konsiderohet si një moshë e paimagjinueshme për të dhënë miratimin e saj për një marrëdhënie seksuale ose martesore.

Një martesë nën moshën 16 vjeç konsiderohet si një krim seksual. Kjo tregon qartë konfliktin ndërmjet dispozitave zakonore dhe dispozitave të së drejtës pozitive, me ç' rast ligji i Kosovës ndalon martesën nën moshën 18 vjeç, krahasuar me dispozitat zakonore. Është më se e qartë se rregullat e diktuar nga Ligji për Familjen në Kosovë duhet respektuar ngase janë më të drejta dhe mbrojnë zhvillimin psiko-fizik të të miturve.

Jo rrallë, familjet të cilat kanë një gjendje të rëndë ekonomike dhe me mentalitet patriarkal vazhdojnë të zbatojnë rregullat kanunore lidhur me martesën duke bërë shkelje të dispozitave të ligjit të aplikueshëm.

Kjo vazhdon të mbetet sfida për autoritetet e Kosovës dhe për shoqërinë në tërësi, për të siguruar që çfarëdo rregulla të sjelljes e që shkaktojnë shkelje të rënda të të drejtave të

njeriut duhen eliminuar nga shoqëria jonë. Ndërkohë që ligjet, dhe aktet nënligjore janë të nevojshme për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e të miturve, është gjithashtu e rëndësishme që shoqëria të vetëdijesohet dhe të ndryshojë mentalitetin dhe perceptimin e tyre për këtë çështje, duke kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive themelore të të miturve në shoqërinë moderne.

## **6.1 Arsyet të cilat sjellin fenomenin e martesave në mituri dhe problemet që mund ti shkaktojnë këto tek individit dhe shoqëria**

Arsyet për martesat e fëmijëve janë të ndryshme dhe mund të ndikohen nga disa faktorë si: faktorët social-ekonomike dhe kulturore, si dhe rrethana të ndryshme si konfliktet, dhuna në familje, varfëria, mungesa e arsimit, mungesa e sigurisë etj.

Disa arsye konkrete mund të jenë:

1. Mungesa e arsimit (në vende ku niveli i arsimit është i ulët, vajzat dhe djemtë kanë më pak mundësi për të marrë arsim dhe për të kuptuar rëndësinë e një marrëdhënieje të shëndetshme dhe të barabartë me partnerin);
2. Varfëria dhe mungesa e mundësive për punësim (në vende me varfëri dhe mungesë të mundësive për punësim, martesat mund të konsiderohen si një zgjidhje për problemet ekonomike);
3. Diskriminimi i gjinor (tek disa kultura, mashkulli është shikuar si personi i cili kontrollon martesën dhe vajzat nuk kanë të drejtë të bëjnë zgjedhje për jetën e tyre, në këto raste, vajzat mund të jenë të detyruara të martohen në moshë të re dhe kundër dëshirës së tyre).

Martesat e të miturve kanë pasoja të rënda dhe mund të kenë ndikim në shëndetin fizik dhe emocional të fëmijëve dhe në zhvillimin e shoqërisë dhe të ekonomisë. Disa prej pasojave mund të jenë:

1. Mungesa e arsimit (në raste të martesave në mituri, të miturit mund të ndërpresin arsimimin dhe kjo mund të ketë pasoja të rënda në zhvillimin e tyre të qëndrueshëm dhe në karrierën e tyre në të ardhmen);
2. Rritje e ndarjes dhe divorcit (në martesat e fëmijëve ka një rrezik më të madh për ndarje dhe divorc, sepse këto martesat zakonisht nuk janë të bazuara në dashuri dhe respekt, dhe nuk i japin partnerëve mundësinë të rriten dhe të zhvillohen së bashku);
3. Probleme shëndetësore (martesat në moshë të re mund të ketë pasoja të rënda për shëndetin fizik të fëmijëve, duke përfshirë rrezikun e shtatzënisë në moshë të re dhe komplikimet gjatë lindjes);
4. Nxitje e diskriminimit dhe dhunës në familje (martesat në moshë të re mund të çojnë në diskriminimin e partnerit sepse shumica e të miturve të cilët lidhin martesë ndërpresin shkollimin dhe nuk kanë mentalitet të zhvilluar për ta trajtuar partnerin në mënyrë të barabartë).

## 6.2 Martesat në mituri në Republikën e Kosovës

Në Republikën e Kosovës, sipas disa statistikave të analizuara, ky fenomen i martesave të hershme është më së shumti i përhapur tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë. Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH), në raportin për të drejtat e njeriut në botë ka ngritur si shqetësim edhe martesat e hershme në Kosovë për vitin 2021. Në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), thuhet se 1 në 25 gra dhe 1 në 50 meshkuj të moshës 20-24 vjeç ishin martuar para moshës 18 vjeç në Kosovë.

Sipas këtij raporti i cili ishte publikuar në vitin 2019-2020, përqindja është shumë më e lartë te femrat dhe meshkujt e kësaj moshe nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjyljeta Devolli nga Organizata për të drejtat e grave dhe vajzave rome, ashkali dhe egjiptiane konsideron se si zgjidhje e kësaj problematike është informimi dhe vetëdijesimi i familjeve të këtyre komuniteteve lidhur me martesat e hershme.

“Ato vajza e lënë shkollimin, mbesin ekonomikisht të varura gjatë gjithë jetës, iu nënshtrihen martesave jologjore, lindin fëmijë në kohën kur ato janë vetë fëmijë dhe nuk kanë njohuri në edukimin e fëmijëve, pastaj shumë shpesh janë edhe viktimat të dhunës në familje dhe formave tjera të abuzimit”, [tha ajo për Radio Evropa e Lirë](#).

Ngjashëm si Devolli mendon edhe Muhamet Arifi, drejtues i organizatës “Balkan Sunflowers”, i cili merret me edukimin dhe çështjet e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Arifi theksoi se një prej arsyeve kryesore është papunësia. Martohen, krijojnë familje dhe përfitojnë nga ndihmat social dhe mbijetojnë disi, deklaroi ai.”

Edhe Koalicioni i Organizatave joqeveritare për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, KOMF, ka thënë se edukimi është një prej faktorëve kryesorë pse ndodhin martesat e hershme. **Error! Bookmark not defined.** “Martesa para moshës 18-vjeç, për fat të keq, është një realitet i errët i shumë vajzave dhe kjo është shkelje e të drejtave të fëmijëve”, tha Bukureza Surdulli, hulumtuese në organizatën KOMF. Shkaktar tjetër konsiderohet të jetë edhe shëndetësia. Kjo për shkak të mungesës së shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësore, që do të ndihmonte që këto komunitete të edukoheshin edhe për shëndetin. “Kur të bëhen këto vizita në shtëpi, normalisht një punëtor social apo një infermier do të mund t’i ndërgjegjësonte lidhur me mbrojtjen nga shtatzënia e hershme, duke qenë se një nga shkaktarët e martesave të hershme janë edhe shtatzënitë e hershme”, deklaroi Surdulli.

Ky problem synohet të rregullohet me draft-Kodin e ri Civil, të cilin e ka përgatitur Ministria e Drejtësisë në Kosovë. Sipas këtij Kodi Civil, i cili pritet të miratohet, “askush nuk mund të lidhë martesë pa e mbushur moshën 18 vjet, duke ndaluar mundësinë e lidhjes së martesave të hershme nën moshën 18-vjeçare”.

Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), ndërkohë vlerëson se që nga marsi i vitit 2018, në të gjithë botën, diku rreth 21 për qind e grave të reja janë martuar para moshës 18-vjeçare. Po ashtu, sipas UNICEF-it, 650 milionë gra dhe vajza që janë gjallë sot, janë martuar para moshës 18-vjeçare. Çdo vit, 12 milionë vajza në të gjithë botën, martohen para moshës 18-vjeçare dhe pritet që 150 milionë vajza të martohen para se t’i mbushin 18 vjet, deri në vitin 2030.

### 6.3 Kodi penal dhe martesë

Bigamia, martesë e detyruar, bashkësia jashtëmartesore me personin nën 16 vjeç, dhuna në familje, mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme, braktisja dhe mos raportimi i abuzimit të fëmijëve janë disa nga veprat që Kodi Penal i Kosovës i ka paraqitur si vepra penale ndaj martesës dhe familjes.

Një person i cili lidhë martesë derisa është i martuar, mund të dënohet deri në një vit burgim. Por, kur personi që detyron tjetrin të lidhë martesë mund të ndëshkohet deri në 8 vite burgim. Ngjashëm me këto rrethana personi madhor që bashkëjeton në bashkësi jashtëmartesore me të mitur nën 16 vjeç mund të dënohet deri 20 vite burgim. Të dhënat e mbledhura nga [Millennium Foundation Kosova – MFK](#) në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës tregojnë se numri vendimeve me burgim për veprat penale kundër martesës dhe familjes ka shkuar duke u rritur nga viti në vit. Gjatë periudhës kohore 2016-2019, të dhënat statistikore tregojnë se departamentet e përgjithshme shqiptuan 63 vendime me burgim. Për më tepër, sipas Sipas [MFK-së](#), vitin 2016 gjykatat e filluan me 36 lëndë të martesës dhe familjes, nga të cilat arritën të zgjidhin 32 raste. Prej këtyre, 2 vendime u shqiptuan me burgim, 1 me kusht ndërkaq për asnjë lëndë nuk u shqiptua aktgjykim refuzues apo lirues.

Vitin 2016, gjykatat e përfunduan me 32 lëndë të zgjidhura e asnjë lëndë të pazgjidhur. Vitin pasues, nga 58 raste në total të martesës dhe familjes, gjykatat zgjidhën 46. Prej këtyre lëndëve, 10 dënime me burgim u shqiptuan. Vitin 2017, gjykatat e përfunduan me 46 lëndë të zgjidhura ndërkaq statistikatat tregojnë se edhe në këtë vit për asnjë lëndë nuk u shqiptua aktgjykim refuzues apo lirues. Të dhënat e [MFK-së](#) më tej sqarojnë se gjatë 2018-ës, prej 78 lëndëve të veprave të martesës dhe familjes u shqiptuan 22 vendime me burgim. Fillim viti 2019, nisi me gjithsej 90 lëndë në punë prej të cilave gjykatat morën 29 vendime me burgim, ndërkaq, shqiptuan një dënim me gjobë dhe me kusht. Nëse e krahasojmë numrin e lëndëve gjatë katër viteve, kuptojmë se për çdo vit gjykatat pranorin rreth 50 raste, kurse vit pas viti shënonin ngritje të shqiptimit të vendimeve me burgim.

### 6.4 Statistikat e martesave të hershme në vitin 2019

Gjatë vitit 2019, tri të mitura ranë pre e premtimit të rrejshëm për martesë, ndërsa 39 çifte nën moshën 18 vjeçare u martuan gjatë vitit. **Y. D., më 14 qershor të këtij viti ishte nisur për në shkollë, por dy orë më vonë babai i Y. D. kishte marrë një thirrje telefonike nga babai i B. R., ku njoftohej se ajo ka filluar të bashkëjetoj me B. R (17-vjeçar). Prindërit e Y. D. nuk ishin pajtuar që vajza e tyre të kalojë në një fazë të tillë ‘martesore’ si 15-vjeçare. Pas rreth gjashtë muajsh Y. D ishte gjetur. Raste të ngjashme të martesave me të mitur gjatë vitit 2019 kanë shënuar rritje të dukshme krahasuar me vitet paraprake.**

Policia e Kosovës ka bërë të ditur për Gazetën Sinjali se gjatë vitit 2019 janë evidentuar 39 raste të martesave me fëmijë, veprim i cili është në kundërshtim me ligjet e Kosovës. Ndërkaq, gjatë vitit 2019, kanë ndodhur tri raste të marrëdhënies seksuale me personat që kanë dhënë premtim të rrejshëm se do të martohen në të ardhmen. Në vitin 2018 janë evidentuar 15 raste kur persona të caktuar janë martuar me fëmijë të mitur, ndërsa gjatë po

këtij viti kanë ndodhur tri martesë të detyrueshme dhe një rast ku kanë kryer marrëdhënie me premtimin se do të martohen në të ardhmen e afërt. Ndërsa në vitin 2017 Policia e Kosovës ka evidentuar 28 raste të martesave të të miturve, tri martesë të detyruara dhe një rast të marrëdhënie seksuale me pretendim të rrejshëm për martesë. Sipas disa hulumtimeve të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, ngacmimi seksual është dukuri e përhapur në Kosovë dhe manifestohet në mënyra të ndryshme. Sipas hulumtimit, prej ngacmimeve seksuale më së shumti preken gratë dhe vajzat e reja.

## 7. Opinioni i qytetarëve në lidhje me miturinë si pengesë martesore

Për nevoja të këtij punimi janë intervistuar disa qytetarë lidhur me çështjen e miturisë si pengesë martesore. Intervista ishte e pastrukturuar dhe është zhvilluar me njohës të mirë të kësaj çështjeje në Komunën e Hanit të Elezit.

Opinioni im në lidhje me martesat në mituri është shumë negative. Ky fenomen është shkelje e të drejtave të njeriut, më saktësisht, martesat nën moshën 18 vjeçare konsiderohen si një shkelje e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve. Ata mund të ndjehen të detyruar për tu martuar dhe mund të mos kenë mundësinë të zgjedhin vetë personin me të cilin do të martohen. Përveç kësaj, martesë nën moshën 18 vjeçare mund të rezultojë me ndërprerjen e arsimit dhe mund të ketë ndikim të dëmshëm në mundësitë e të rinjve në punësim në të ardhmen. Unë si qytetar i Republikës së Kosovës dhe si jurist i diplomuar i apeloj gjykatave që të lëshojnë sa më pak leje për martesë nën moshën 18 vjeçare sepse kjo ka një ndikim shumë negativ tek të rinjtë.

Ndërsa sipas një sociologut të intervistuar, martesat nën moshën 18 vjeçare kanë ndikime negative në nivel sociologjik, në mënyra të ndryshme si:

- Izolimi social: Martesat e parakohshme mund të çojnë në izolim shoqëror dhe humbje të mundësive për zhvillim personal dhe profesional. Kjo ndikon në mënyrë negative në rritjen e ndërgjegjësimit të adoleshentëve për jetën shoqërore dhe në forcimin e lidhjeve të tyre me komunitetin dhe shoqërinë në tërësi.
- Ndikim negativ në arsim: Adoleshentët që martohen nën moshën 18 vjeçare kanë tendencë të ndërpresin shkollën shkakun që nuk mund ta përballojnë presionin psikologjik dhe nuk kanë kohë të mjaftueshme për të ndjekur orët mësimore (Disa raste edhe në shkollën tonë). Kjo rrit mundësinë e tyre për të qenë të papunë dhe të varen nga të tjerët për jetesën e tyre.
- Rritje e rasteve të dhunës në familje: Adoleshentët që martohen nën moshën 18 vjeçare kanë tendencë të krijojnë më shumë raste të dhunës në familje dhe probleme të tjera të lidhura me përdorimin e drogës dhe alkoolit si pasojë presionit të madh psikologjik.

Në përgjithësi sipas opinionit tim, martesat nën moshën 18 vjeçare kanë ndikime negative në nivel sociologjik dhe shoqëror dhe ndikojnë në mënyrë të dëmshme në rritjen dhe zhvillimin e adoleshentëve duke i privuar ata nga mundësitë për tu zhvilluar si individë dhe anëtarë të komunitetit.

Ndërsa nga ana tjetër, mjekja (psikologe) nga Hani i Elezit është shumë e brengosur për

këtë fenomen, i cili edhe pse në raste më të rralla se në të kaluarën, të pranishëm në shoqërinë tonë. Martesat në mituri kanë ndikime negative të mëdha në shëndetin psikologjik dhe fizik të adoleshentëve si:

- Stresi dhe ankthi: Adoleshentët që martohen nën moshën 18 vjeçare mund të jenë të stresuar dhe në ankth nga përgjegjësitë dhe sfidat e lidhura me martesën. Ata mund të ndjehen të pashpresë dhe të ndjehen të vetmuar, duke i bërë ata më të prirur për probleme shëndetësore si depresioni, ankthi dhe ndjenjat e izolimit.
- Rritja e mundësisë për abort: Të miturit të cilët bien pre e martesave në moshë të re kanë më shumë mundësi të ndodhin në situata të pakëndshme si shtatzënia e padëshiruar dhe ndoshta ngritja e mundësisë së abortit. Aborti mund të ketë ndikim të dëmshëm të gjatë në shëndetin psikologjik dhe fizik të adoleshentit dhe mund të shkaktojë një ndjenjë të madhe të trishtimit dhe stresit.
- Ndikimi negativ në zhvillimin emocional: Adoleshentët që martohen nën moshën 18 vjeçare mund të kenë ndikim të dëmshëm në zhvillimin emocional. Ata mund të mos kenë mundësinë për të zhvilluar personalitetin e tyre dhe të formojnë marrëdhënie të shëndetshme me veten dhe me të tjerët.

Pra, martesat nën moshën 18 vjeçare kanë ndikime negative të mëdha në shëndetin psikologjik dhe fizik, duke i bërë ata më të prirur për probleme si në marrëdhëniet e tyre martesore ashtu edhe në shoqëri. Ishte mendim i përgjithshëm i qytetarëve se kjo dukuri e neveritshme duhet të minimizohet dhe të çrrënjohet nga shoqëria jonë.

## 8. Përfundim

Në këtë punim është shqyrtuar mituria si pengesë martesore si dhe pasojat eventuale të martesave të hershme në shoqërinë tonë. Duke u bazuar në shqyrtimin e dokumenteve dhe hulumtimeve të ndryshme, është bërë e qartë se martesat miturore kanë pasoja të rënda për individin si dhe për shoqërinë në përgjithësi. Të miturit që krijojnë marrëdhënie martesore do të përballen me humbjen e arsimit dhe kufizime të tjera në zhvillimin e tyre emocional dhe social. Gjithashtu, martesat nën moshën 18 vjeçare kanë ndikim negativ edhe në nivelin makrosocial, duke kontribuar në rritjen e nivelit të varfërisë, arsimimit të ulët, etj.

Andaj, ky fenomen është i rrezikshëm jo vetëm për individin por edhe shoqërinë në tërësi dhe si i tillë do të duhej ndaluar tërësisht. Rrjedhimisht, kërkohet një angazhim i fuqishëm i institucionet publike, shoqërisë civile dhe individët për ta luftuar këtë dukuri negative. Në këtë mënyrë, do të sigurohej që të miturit do të kenë mundësi të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë, të kenë mundësi për të ndjekur ëndrrat dhe synimet e tyre dhe të kontribuojnë në krijimin e një shoqëri të drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Kjo është një çështje e rëndësishme brenda shoqërisë sonë dhe të gjithë ne do të duhej të veprojmë menjëherë në nivel individual, kolektive dhe institucionale për ta çrrënjësuar këtë dukuri dhe për të garantuar një të ardhme më të mirë për të rinjtë tanë. Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme të ndërregjysojmë të miturit që të kuptojnë vlerën e arsimit dhe të zhvillimit të aftësive të tyre në këtë kohë të tranzicionit. Është po aq e rëndësishme edhe krijimi i mekanizmave efikas dhe efektiv të parandalimit të kësaj dukurie duke analizuar në vazhdimësi mjedisin e

mundshëm të paraqitjes së fenomenit dhe të ndërmerren masa të përshtatshme parandaluese. Rrjedhimisht, do të sigurohej që të miturit të vazhdojnë të jenë të lirë dhe të vendosin për vetën dhe për të ardhmen e tyre të pa ndikuar nga elemente arkaike të së drejtës zakonore apo të çfarëdo presioni nga rrethi familjar dhe shoqëror ku ata jetojnë.

Gjithashtu, nevojitet një angazhim i fuqishëm dhe i vendosur nga institucionet publike, për të ndaluar praktikën që favorizojnë martesat në moshë miturore. Kjo mund të arrihet nëpërmjet promovimit të edukimit seksual, ngritjes së ndjeshmërisë rreth këtyre çështjeve, duke dhënë informacione dhe mbështetje të nevojshme për të miturit dhe duke krijuar një mjedis më të favorshëm për ta.

## Referencat:

1. Alidemaj, A. [2022-2023]. E drejta familjare. Ligjerata të autorizuara
2. Farnsworth, N. [2012]. Martesa e fëmijëve. UNFPA Kosovë. Prishtinë.  
[https://kosovo.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/KOSOVO-Albanian-final\\_0.pdf](https://kosovo.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/KOSOVO-Albanian-final_0.pdf)
3. Gashi, H., Aliu, A., dhe Vokshi, A. [2012]. Komentar Ligji Nr. 2004/32 për familjen i Kosovës. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Prishtinë.
4. Girls, not brides [S.A]. Where it happens. <https://www.girlsnotbrides.org/about-child-marriage/where-child-marriage-happens/>
5. Gjenovci, Sh [1933]. Kanuni I Lekë Dukagjinit. Shkodër.
6. Hudda, A. [S.A]. The Religion Of Al-Islam And Marriage Marriage <https://www.al-islam.org/religion-al-islam-and-marriage-age-marriage>
7. Islam question & answer. [2000, Shkurt]. Marrë më 25 mars 2023, nga <https://islamqa.info/en/answers/7193/the-girls-father-disagrees-with-a-marriage-what-is-the-solution>
8. Kosovë lidhjet martesore që mund t'ju dërgojnë në burg. [2022]. Telegrafi. <https://telegrafi.com/kosove-lidhjet-martesor-qe-mund-tju-dergojne-ne-burg/>
9. Marmullaku, A. [2022]. Martesat e hershme problem i pazgjidhur në Kosovë. Albanian post, <https://albanianpost.com/martesat-e-hershme-problem-i-pazgjidhur-ne-kosove/>
10. Masci, D. Desilver, D [2019]. A global snapshot of same-sex marriage. Pew Research Center. [A global snapshot of same-sex marriage | Pew Research Center](https://www.pewresearch.org/global/2019/08/28/a-global-snapshot-of-same-sex-marriage/)
11. Plakolli, A. [2020]. Shkaqet e Martesave të Hershme tek Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës. The Ideas Partnership. <http://theideaspartnership.org/wp/wp-content/uploads/2020/02/Albanian.pdf>
12. Podvorica, Hamdi. [2019]. E drejta familjare: Botimi i V-stë me ndryshime dhe plotësime. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik. Prishtinë.
13. Sattari, M. M. [2021-2022]. Polygamy as a cross-cultural dispute in EU. University of Padova
14. Taulant Qenaj. [2022]. Varfëria dhe braktisja e shkollës që po çojnë në martesë të hershme. Radio Evropa e Lirë. <https://www.evropaelire.org/a/martesat-e-hershme-ne-kosove/31805200.html>
15. Tri të mitura ranë pre e premtimit të rrejshëm për martesë, 39 çifte nën moshën 18 vjeçare u martuan gjatë këtij viti. [2019]. Sinjali <https://sinjali.com/tri-te-mitura-rane-pre-e-premtimit-te-rrejshem-per-martese-39-cifte-nen-moshen-18-vjecare-u-martuan-gjate-ketij-viti/>
16. United nations children's fund. [2018]. Child marriage: latest trends and future prospects [S.A]. Child Marriage in Islamic Law. Marrë më 27 Mars, 2023 nga <https://data.unicef.org/resources/child-marriage-latest-trends-and-future-prospects/>



# Kontratat e punës në sektorin privat në Rahovec

---

Leonit Fejzaj

---

## ABSTRAKT

Fenomeni i të punësuarve pa kontrata të punës është mjaftë i shprehur në shoqëritë në tranzicion, siç është rasti me Kosovën. Një pjesë e madhe e punëdhënësve i shmangen lidhjes së kontratave të punës me punonjësit e tyre me ç'rast shkaktohen dëme të mëdha ndaj shoqërisë në përgjithësi dhe shkelje elementare të të drejtave të punëtorëve në veçanti.

Qëllimi kryesor i këtij punimi kërkimor është të shpjegojë marrëdhëniet ndërmjet sektorit privat dhe shtetit të mirëqenies. Sektori privat, ashtu edhe shteti i mirëqenies sociale, janë koncepte mjaftë të gjera. Për ta ngushtuar temën, fokusi i është dhënë kontratave të punës, duke qenë se shumica e të punësuarve në sektorin privat të Kosovës nuk kanë kontrata ose kanë kontrata fiktive. Rrjedhimisht, ata nuk paguajnë tatime apo çfarëdo kontributi tjetër social e që mund të jetë në favorin e tyre momental por jo edhe për të ardhmen e tyre dhe të mirëqenies së përgjithshme shoqërore.

Punimi fokusohet te punonjësit në sektorin privat në komunën e Rahovecit dhe për nevojat e këtij punimi janë përdorura metodat të ndërthurura hulumtuese duke filluar me metodën juridike-dogmatike, analizën e përmbajtjes dhe metodën cilësore.

## Fjalët kyçe:

Kontrata e punës, mirëqenia sociale, tatimet në page, e drejta e punës.

## 1. HYRJJE

Një vend ku qeveria kujdeset për qytetarët e tyre, duke u siguruar atyre mirëqenie ekonomike dhe sociale, është një vend që kategorizohet si shtet i mirëqenies. Ky term, shtet i mirëqenies, u dëgjua për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Një shtet i mirëqenies u ofron qytetarëve të tij mundësi të barabarta kur bëhet fjalë për arsimim dhe mundësi punësimi, u jep atyre sigurim shëndetësor dhe u ofron qytetarëve të tij të paktën gjërat thelbësore që u nevojiten për të mbijetuar.

Në çdo shoqëri si edhe në Kosovë, ka individë që janë në pozita më të larta shtetërore apo edhe pronarë të kompanive private dhe në fakt kanë më shumë pushtet se pjesa tjetër e qytetarëve dhe supozohet se do të duhej të punonin dhe kontribuonin për të mirën e përgjithshme. Por fatkeqësisht jo të gjithë e bëjnë këtë. Jo rrallë, individët me pozita të larta në shoqëri dhe shtet i keqpërdorin ato duke mos përdorur burimet në mënyrën e duhur me qëllim të përfitimeve personale. Ai lloj keqpërdorimi i pushtetit dhe burimeve të një vendi quhet korrupsion.

Këto dy çështje janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën. Korrupsioni është një nga faktorët më të mëdhenj që e bën një vend të mos mund të ketë një shtet të mirëqenies dhe kjo bëhet duke mos qenë i drejtë me të gjithë qytetarët, duke mos u siguruar atyre gjërat thelbësore, duke mos pasur një sistem të mirë arsimor dhe shëndetësor si dhe duke i privuar nga e drejta në punë. Korrupsioni gjithashtu i bën njerëzit të humbasin besimin e tyre te liderët e atij vendi. Kosova është një nga vendet ku korrupsioni është ende shumë prezent. Siç u përmend më lart, kjo vjen si pasojë e udhëheqjes jo adekuate dhe mungesës së sundimit të ligjit.

Ky punim do të fokusohet tek punonjësit që punojnë në sektorin privat pa kontrata duke hulumtuar ndikimin e këtij fakti në gjendjen sociale të këtyre punonjësve në komunën e Rahovecit.

Për nevojat e këtij punimi janë përdorura metodat të ndërthurura hulumtuese duke filluar me metodën juridike-dogmatike, analizën e përmbajtjes dhe metodën cilësore dhe sasore.

## 2. Baza ligjore për kontratat e punës në sektorin privat

Marrëdhëniet e punës në sektorin privat në Republikën e Kosovës janë të rregulluara me Ligjin e punës. Ky ligj parasheh mbrojtje për punëtorët në sektorin privat dhe publik, si dhe për punëtorët e huaj dhe punëtorët pa shtetësi që punojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu ka një mbrojtje të veçantë për gratë shtatzëna ose gjidhënëse, punëtorët me aftësi të kufizuara dhe ata/ato nën moshën 18 vjeç. Ligji është miratuar më 16 dhjetor 2010 dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet punëmarrësve dhe punëdhënësve.

Ligji synon të siguroj përmbushjen e këtyre parimeve kryesore:

- Liria e asociimit dhe njohjen e të drejtës për negociata (kontrata) kolektive;
- Eliminimin e çdo lloj pune të detyruar ose të dhunshme;
- Eliminimin e punës së fëmijëve;
- Eliminimin e diskriminimit në punë.

Sipas Ligjit të Punës, çdo punëtor duhet të ketë kontratë pune e cila duhet të jenë me shkrim dhe e nënshkruhen nga punëmarrësi dhe punëdhënësi. Çdo kontratë pune duhet të përmbajë detaje për punëdhënësin dhe punëmarrësin, orarin e punës, vendin e punës, përshkrimin e punës, datën e fillimit, pagën dhe detajet e pushimit vjetor. Ligji përcakton kushtet minimale të punësimit, për shembull, ditët minimale të pushimit vjetor janë 4 javë, paga minimale e vendosur nga qeveria, periudhat minimale të pushimit që janë 30 minuta, etj.

Çdo punëtor që mendon se në një farë mënyre i janë shkelur të drejtat dhe pretendon se është viktimë e diskriminimit, ka të drejtë të padisë dhe të ndërmarrë masa ligjore në gjykatë.

Pra, është e qartë se kuadri ligjor është i përcaktuar dhe këto çështje janë të rregulluara me ligj, por nga sa shihet në jetën e përditshme, nga intervistat dhe përgjigjet nga anketa e bërë për këtë hulumtim tregojnë se kjo kornizë nuk është duke u zbatuar plotësisht dhe punonjësit nuk mbrohen plotësisht nga diskriminimi në punë ose nga cenimi i të drejtave të tyre. Për më tepër, nëse punonjësit nuk kanë një kontratë të vlefshme, ata nuk mund as të raportojnë diskriminimin apo të ndërmarrin ndonjë veprim ligjor ndaj tij, sepse nuk ka fakte apo dokumente që personi është i punësuar në një kompani.

Ka shumë raste kur Ligji i Punës nuk respektohet realisht. Me mosrespektim të Ligjit të Punës nënkuptohet:

- Mosrespektimi i orarit të punës, pra detyrimi i punonjësve të punojnë më gjatë se sa është paraparë;
- Mosrespektimi i pushimit vjetor, pushimit gjatë orarit të punës, pushimit shëndetësor e kështu me radhë;
- Mos njoftimi me kohë i punëmarrësit se kontrata e tij nuk do të vazhdohet më;
- Mos respektimi i pushimit të lehonisë;
- Mosrespektimi i pagës minimale, etj.

Me probleme si këto të lartshënuara më së shumti ballafaqohen të punësuarit në sektorin privat. Më poshtë është një analizë e orarit të punës në javë, dhe krahasimi ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2018 ka publikuar “Anketën e Fuqisë Punëtore”. Ky sondazh tregon se më pak se 11% e punëtorëve me kohë të plotë si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, punonin më pak se 40 orë në javë, kështu që pjesa tjetër prej tyre 89% punonin 40 orë ose më shumë. Nga ata që punonin më shumë se 40 orë në javë, 68% punonin 40-48 orë, 8,4% punonin 49-59 orë dhe 12,8% punonin 60 orë ose më shumë.

Ka arsye të ndryshme pse ligji nuk zbatohet si duhet dhe përse shkelen të drejtat e punëtorëve. Një nga këto është edhe mungesa e ekuilibrit ndërmjet ekonomisë dhe sistemit arsimor. Kosova vazhdon të ketë një nga normat më të larta të papunësisë në Evropë, pasi oferta e fuqisë punëtore tejkalon kërkesën për fuqi punëtore. Në një treg të tillë jashtëzakonisht konkurrues, punëtorët ndihen të nënshtruar nga shpejtësia e zëvendësimit të tyre në një kohë kaq të shkurtër, veçanërisht në sektorin privat, punëtorët që kërkojnë orar më të shkurtër pune ose të drejta të tjera përballen me kërcënime për t’u zëvendësuar pasi ka shumë të pa punësuar dhe të tjerë janë në pritje të një pune.

Ligji i Punës ndër të tjera përcakton orarin e punës në javë që është 40 orë. Kosova ka edhe Inspektoratin e Punës, roli i të cilit është të monitorojë zbatimin e ligjit të punës. Në vitin 2018 kishte 42 inspektorë dhe mbi 85 mijë biznese. Ky është një numër i vogël inspektorësh

të cilët nuk mund t'i mbulojë të gjitha bizneset dhe të analizojnë kushtet e tyre të punës. Një rast tjetër ku nuk respektohet ligji i punës është ai i kontratave të punëtorëve. Fatkeqësisht ka një numër të madh të të punësuarve që punojnë pa kontrata në sektorin privat. Ka edhe raste kur punonjësit kanë kontrata, por ato janë të përkohshme. Kështu që punëdhënësit e kanë shumë të lehtë t'i pushojnë nga puna sa herë të duan. Mos pajisja e punonjësve me kontrata pune dhe mosdeklarimi janë shkelje të ligjit dhe dënohen sipas dispozitave të ligjit të punës.

Shpeshherë punëtorët pa kontratë janë të rrezikuar edhe në vendin e tyre të punës. Numri i të punësuarve joformalë për fat të keq nuk dihet ngase të tilla raste nuk raportohen pranë autoriteteve mirëpo sipas të dhënave joformale, rreth 60 % e punëtorëve punojnë pa kontrata valide të punës. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga personat që janë të punësuar, 54% e tyre punojnë me kontrata të përhershme dhe 46% fatkeqësisht punojnë me kontratë të përkohshme. Nga ana tjetër, sipas revistës “Evropa e Lirë” (2019), nga punonjësit me kontratë, 25% e tyre kanë kontratë të përhershme dhe 74.5% e tyre me kontratë të përkohshme. Sipas Jusuf Azemit, kryetar i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës, janë më shumë se 50 % e të punësuar që punojnë pa kontrata. Pra, mund të shihet se numrat ndryshojnë nga njëri-tjetri.

Puna pa kontrata dëmton në mënyra të ndryshme punonjësit dhe shtetin dhe ata që përfitojnë nga kjo janë bizneset. Këta punonjës për fat të keq nuk janë të regjistruar si punëtorë dhe nuk paguajnë tatimet dhe as kontributet pensionale. Punëtorët e tillë kanë pasur dhe kanë shumë probleme dhe kjo është vërejtur edhe gjatë kohës me pandeminë Covid 19. Qeveria e Kosovës deklaroi se çdo qytetar që punonte, por si pasojë e kësaj pandemie duhej të pushonte së punuari, do të përfitonte një pagë nga pakoja emergjente e shtetit. Po çka me ata që kanë punuar pa kontratë e që janë më shumë se gjysma e punëtorëve faktik?

Fatkeqësisht njerëzit që punonin në sektorin privat nuk mund të përfitonin këtë pako sepse nuk ishin të regjistruar si punonjës. Por, Sindikatat e Pavarura të Sektorit Privat kërkuan nga qeveria që nga kjo pako të përfitonin edhe punonjësit pa kontratë dhe e vetmja mënyrë që ata t'i merrnin ato para ishte nëse do të lidhnin kontratë me punëdhënësit e tyre për të paktën një vit.

Në vitin 2015, Agjenda 2030 u miratua nga të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm krijon një model të unifikuar për paqen dhe prosperitetin. Në thelb të tij janë 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, këto synime janë një thirrje për veprim, si një partneritet global midis të gjitha vendeve. Qëllimi është përmirësimi i shëndetësisë dhe arsimit, reduktimi i pabarazive, fundi i varfërisë etj. Synimi numër 8 – Punë e denjë dhe rritje ekonomike dhe objektivi numër 16 – Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta janë të lidhura kryesisht me temën e këtij punimi. Objektivi numër 8 synon të arrijë punësim të plotë dhe produktiv, rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme dhe punë të denjë për të gjithë. Deri në vitin 2030 ai synon të arrijë pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë nga gjithashtu ofrimi i punës së denjë për të gjithë burrat dhe gratë, mbrojtja e të drejtave të punës dhe sigurimi i mjedisit të sigurt dhe të sigurt të punës. Për më tepër, qëllimi numër 16 promovon shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse; ai synon të ofrojë akses në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtojë institucione të përgjegjshme në të gjitha nivelet në mënyrë që të rrisë kënaqësinë e popullatës me përvojën e tyre me shërbimet publike dhe të reduktojë korrupsionin në të gjitha format (Objektivat e Zhvillimit

të Qëndrueshëm, 2015-2030).

Institucionet e Kosovës kanë përgatitur një plan për zhvillim të qëndrueshëm që merret me këtë çështje duke fuqizuar politikën socio-ekonomike me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe uljes së punësimit joformal në Kosovë. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016 – 2021 synon ta arrijë këtë duke marrë disa masa si përmirësimi i të drejtave të punëtorëve, garantimi i standardit minimal të sigurisë dhe shëndetit, monitorimi më i mirë i zbatimit të kuadrit ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare. Një masë tjetër është krijimi i platformave dhe organeve të përbashkëta për inspektim në terren; kjo do të forcojë bashkërendimin e veprimeve institucionale në uljen e punësimit informal. Rënia e papunësisë joformale dhe përmirësimi i kushteve në punë do të ndikojë pozitivisht edhe në gjendjen sociale të Republikës së Kosovës.

### **3. Struktura e të punësuarve në Komunën e Rahovecit**

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin Dukagjinit, gjegjësisht në subrajonin e Podrimës. Është njëra nga komunat e mesme me pozitë gjeografike që i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 35 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka 56,208 banorë të organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 2000 biznese operojnë brenda komunës së Rahovecit. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre merren me veprimtari tregtare, 13% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 10% në prodhimtari, pjesa tjetër në transport.

Sipas raporteve të bëra në institucione Shëndetësore të Rahovecit janë:

- Drejtor Shëndetësie- 1,
- Mjek- 28,
- Teknik- 21,
- Të tjerë- 18,

Ndërsa sipas të dhënave të të punësuarve në veprimtari arsimore janë:

- DKA- 5
- Drejtor/esh – 22
- Z.v drejtor/esh – 2
- Sekretar/esh -2
- Profesor/esh -95
- Arsimitar/e – 337
- Edukator/e – 0
- Punëtorë ndihmës/e – 91

Nuk dihet saktësisht numri i të punësuarve në sektorin privat në Komunën e Rahovecit, megjithatë nga hulumtimi i bërë dhe deklaratat e të intervistuarve për nevojat e hulumtimit, del në pah se qytetarët e punësuar në sektorin privat përbëjnë shumicën e të punësuarve nga numri i përgjithshëm i të punësuarve.

## 4. Zbatimi i dispozitave të Ligjit të Punës

Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës janë të përcaktuara me dispozita ligjore. Mirëpo këto ligje të hartuara dhe të miratuara nuk po zbatohen nga punëdhënësit e sektorit privat. Më konkretisht, ligji i punë (LIGJI NR. 03/L-212) definon të drejta dhe detyrimet e dy palëve, punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke përcaktuar si më poshtë:

- Kontrata e Punës – është akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit;
- Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarin ta lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme;
- Përshkrimin e detyrave të punës;
- Vendin e punës dhe njoftimin që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme, orët dhe orarin e punës, datën e fillimit të punës, kohëzgjatjen e Kontratës së Punës;
- Lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër, kohëzgjatjen e pushimeve;
- Përfundimin e marrëdhënies së punës;

Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuar kryen punë ose shërbime në të mirë të punëdhënësit. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Por shtrohet pyetja: Sa respektohet kontrata e punës në sektorin privat në Komunën e Rahovecit? Për këtë arsye janë vizituar dhe intervistuar disa punonjës të sektorit privat në Komunën e Rahovecit.

Nga hulumtimi i kryer del se një numër i madh i punëtorëve në kompani të vogla prodhuese punojnë me vite të tëra pa kontratë pune dhe me orar të stërzgatur. Përkundër insistimit të punonjësve që të hartohen kontratat, punëdhënësit kanë refuzuar një gjë të tillë duke pamundësuar pagesën e kontributeve pensionale dhe tatimeve në paga të punonjësve. Gjithashtu, punonjësit e sektorit privat në vazhdimësi kanë kërkuar të punojnë nga tetë orë në ditë dhe të shfrytëzojnë pushimin javor sipas dispozitave të ligjit të punës. Mirëpo, kjo kërkesë është neglizhuar në vazhdimësi nga punëdhënësit.

Nga ana tjetër Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat potencon se 50 % e punëtorëve në sektorin privat nuk zhvillojnë veprimtari punuese mbi bazën e një kontrate të shkruar dhe të nënshkruar ndërmjet punëdhënësi dhe punëmarrësit. Ndër të tjera, 80 % e të punësuarve në sektorin privat janë të detyruar të punojnë jashtë orarit të punës.

Sektori privat është punëdhënësi më i madh në Kosovë me ç'rast vlerësohet se në këtë sektor punojnë mbi 220 mijë punëtorë. Paga mesatare në sektorin privat është nën 350 euro.

Gjatë hulumtimit të bërë është vërejtur edhe një dukuri tjetër e që ndërlidhet me ekzistimin e kontratave të nënshkruara por që nuk zbatohen si të tilla. Pra, këto kontrata fiktive të punës shfrytëzohen vetëm për nevoja të punëdhënësit sa për të raportuar në rast të inspektimeve dhe jo për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ligji i punës. Në këto raste nuk respektohet orari i punës, pushimi ditor dhe javor si dhe pagesa e paraparë sipas këtyre kontratave.

Këto raste nuk raportohen nga punonjësit nga frika e humbjes së vendit të punës dhe pamundësisë për të gjetur ndonjë vend tjetër të punës.

## 5. Përfundim

Në Kosovë, ligji i cili mbron të drejtat e punëtorëve është në fuqi që nga viti 2011, por si i tillë nuk ka gjetur zbatim në përmasa të kënaqshme, në veçanti për punëtorët që punësohen në sektorin privat. Ndërsa zbatueshmëria e ligjit të punës në sektorin publik është në nivelin e duhur duke qenë se punëtorët e këtij sektori nuk kanë shpërfaqur ankesa të ndërlidhura me të drejtat e tyre. Në sektorin privat, sipas të dhënave, janë të evidentuar mbi 222 mijë punëtorë e që është numër shumë më i lartë se i atij në sektorin publik (rreth 80 mijë).

Edhe nga hulumtimet e bëra nga disa organizata joqeveritare në Kosovë, po ashtu është evidentuar shkelje flagrante e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat. Nga Qendra për Politika dhe Avokim në Kosovë, e cila ka bërë një hulumtim të zbatimit të Ligjit të punës dhe Ligjit për siguri dhe shëndet në punë, thonë se ligji i punës fare pak respektohet nga punëdhënësit në sektorin privat.

Të dhënat nga terreni tregojnë se 38.46 për qind e të intervistuarve nga sektori i shërbimeve, tregtisë dhe hotelerisë, punojnë pa kontratë pune, ndërsa në sektorin e ndërtimit 59.76 për qind janë deklaruar të mos kenë kontratë pune. Ndërsa, 81 për qind e të punësuarve në sektorin e ndërtimit janë deklaruar se brenda një jave punojnë nga 50-60 orë pune, dhe vetëm 9.82 për qind janë kompensuar me para për orët shtesë të punës.

Sa i përket pushimit vjetor, 73.17 për qind e punëtorëve të ndërtimit janë deklaruar së nuk u paguhet pushimi vjetor. Sipas këtij hulumtimi të Qendrës për Politika dhe Avokim, thuhet se në gjykatat e Kosovës, aktualisht janë të pazgjidhura 1640 konteste civile të punës dhe vetëm në Gjykatën Themelore të Prishtinës presin për t'u zgjidhur 139 raste.

Edhe të dhënat e mbledhura nga Komuna e Rahovecit, me theks të veçantë nga punonjësit e sektorit privat i konfirmojnë të gjeturat e shpalosura të organizatave të shoqërisë civile. Me fjalë të tjera, të jesh i angazhuar si punonjës në sektorin privat do të thotë të punosh për një kafshatë goje pa kurrfarë të drejtash që rrjedhin nga ligji i punës. Ndërsa, punësimi në sektorin publik është tepër i vështirë dhe pa respektim të parimit të meritokracisë. Kjo është një ndër arsytet që të rinjtë e Kosovës janë duke u larguar masivisht drejt shteteve të Evropës Perëndimore për një të ardhme më të mirë ku fundja të drejtat e tyre janë të garantuara me ligjet e punës së shteteve pritëse. Ky fenomen i informalitetit është duke e dëmtuar fuqishëm Republikën e Kosovës dhe për pasojë ka migrimin e të rinjve dhe po ashtu edhe evazionin fiskal i cili vazhdon ta mbajë arkën e shtetit të varfër. Është detyrim i çdo qytetari të Kosovës dhe në veçanti të institucioneve të shtetit që të ndërmarrin masat e duhura që të krijohen kushte më të mira të punës në sektorin privat të Kosovës, ngase pikërisht nga këtu mbushet arka e shtetit nga e cila bëhet rishpërndarja te sektori publik dhe te qytetari në formë të shërbimeve të ofruara nga shteti.

## Referencat:

1. Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë punëtore, Prishtinë 2018. Qasur më 23.03.2023. <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-fuqise-punetore-afp-tm1-2018>
2. Instituti GAP, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit: arritjet, negecjet dhe pritjet. Prill 2021. [https://www.institutigap.org/documents/67812\\_Strategjia%20komb%C3%ABtare%20p%C3%ABr%20zhvillim.pdf](https://www.institutigap.org/documents/67812_Strategjia%20komb%C3%ABtare%20p%C3%ABr%20zhvillim.pdf)
3. Intervistë me zyrtarë komunal të drejtorisë së shëndetësisë në Rahovec. Mars 2023.
4. Intervistë me zyrtarë komunal të drejtorisë së arsimit në Rahovec. Mars 2023.
5. Intervistë me zyrtarë komunal të zyrës për regjistrimin e bizneseve në Komunën e Rahovecit. Mars 2023.
6. Intervistë me Meriton Spahija – punëtor në sektorin privat në Rahovec. Intervista është zhvilluar më 14.03.2023, në Rahovec.
7. Intervistë me Muhamet Shala – Punonjës në sektorin privat në Rahovec. Intervista është realizuar më 14.03.2023, në Rahovec.
8. Komuna e Rahovecit, Portali komunal. Qasur më 22.03.20223: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/qyteti/numri-i-banoreve/>
9. Kuvendi i Kosovës, Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm. Qasur më 22.03.2023: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/zhvillimi-i-qendrueshem/objektivat-per-zhvillim-te-qendrueshem/>
10. Ligji i Punës, Nr. 03/L-212, Kuvendi i Republikës së Kosovës, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 90 / 01 DHJETOR 2010. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735> Qasur më 23.03.2022.
11. Radio Evropa e Lirë, Intervistë e Jusuf Azemit – Kryetar i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Shkurt-2021. Qasur më 20.03.2023: <https://www.evropaelire.org/a/kontrata-pune-sektori-privat-/31106369.html>
12. Revista Ekonomia, Mbi 60 për qind e punëtorëve punojnë pa kontrata pune, qasur më 24.03.2023. <https://www.ekonomia.info/sq/ekonomi/mbi-60-per-qind-e-punetoreve-punojne-pa-kontrata>
13. Revista Demokracia, Punëtorët të mos pranojnë punësim pa kontratë të punës, 07.02.2021. Qasur më 24.03.2023. <https://demokracia.com/azemi-punetoret-te-mos-pranojne-punesim-pa-kontrate-te-punes/>



# Besimi fetar dhe martesë - rrethanat shoqërore të Kosovës

---

Doart Qorrolli

---

## ABSTRAKT

Në institutin e martesës kanë ndikuar faktorë të ndryshëm gjatë gjithë historisë njerëzore. Ndër faktorët dominues që i rregullonin çështjet martesore dhe ato familjare ishin normat zakonore të cilat pjesërisht rrjedhin nga mësimet fetare. Ndikimi i besimit fetar në lidhjen dhe vazhdimësinë e martesave vazhdon të jetë i pranishëm në shoqëritë moderne duke rënë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me normat ligjore që e rregullojnë materien e së drejtës martesore, familjare dhe trashëgimore.

Edhe në kontekstin e Kosovës, besimi fetar ka pasur ndikim dhe vazhdon të ketë në lidhjen dhe mbarëvajtjen e martesave. Punimi synon të analizoj përmasat dhe thellësinë e ndikimit të besimit fetar në martesat e sotme në Kosovë duke analizuar dispozitat kanunore, shariatike dhe ato të së drejtës pozitive. Rrjedhimisht, del në pah se në kontekstin kosovar, ndikimi i rregullave që rrjedhin nga besimet fetare vazhdon të jetë i fuqishëm në zonat rurale dhe më pak të zhvilluara. Ndërsa, në zonat urbane dhe ato të zhvilluara, instituti i martesës është në harmoni të plotë me rregullimin juridik duke e mbështetur plotësisht parimin e laicitetit dhe barazisë ndërmjet bashkëshortëve.

Për shtjellimin e temës bosht të këtij punimi, janë përdorur metoda analitike, juridiko-dogmatike, krahasuese, cilësore si dhe ajo historike.

## Fjalët kyçe:

Besimi fetar, vetëdijesimi, martesë, e drejta pozitive, zakonet.

# 1. Hyrje

Ky punim nga lënda e sociologjisë të së drejtës prek dukuritë shoqërore që gjenden në kryqëzimin e fesë dhe martesës në Kosovë. Në këtë hulumtim, janë kërkuar një sërë të dhënash dhe shfaqjesh letrare për të arritur te përfundimi se vlerat e ngërthyer në fetë e qarkulluara dhe pranuar nga popullata mbizotëruese e tokës së Kosovës mbështesin martesën dhe veçanërisht përjetësinë e lidhjes martesore.

Me shqyrtimin e mësimave fetare abrahamike mbi martesën, do të nxjerrët zanafilla fetare e vlerave që trajtojnë llojin më të përsosur të martesës. Dashuria, besnikëria, adhurimi dhe mbështetja e ndërsjellë janë cilësi të rrënjëzuara në marrëdhënien rregullore të martesës monogame, të cilat mishërojnë synimin më të lartë të lidhjes njerëzore. Fetë abrahame, si shtylla të shumë shoqërive, përveç cilësive të parapërmendur gjithashtu lartësojnë mirësitë jetike të pastërtisë seksuale dhe shenjtërisë bashkëshortore. Këto veti padyshim se gjallërojnë çiftet të bashkëpunojnë në ndërtimin e një lidhjeje të ngurtësuar dhe të qëndrueshme përjetësore, e cila gjerësisht mundëson sigurinë dhe begatshmërinë e njësisë familjare dhe, rrjedhimisht, të shoqërisë më të gjerë.

Në qoftë se të gjithë do të ndiqnin përsosmërinë e monogamisë së përjetshme, njerëzimi nuk do të vuante nga pasojat që vijnë nga mosndjekja e saj. Atëherë, ndër pjesët thelbësore të këtij punimi është pikërisht përkrahja e saj nga fetë më ndikuese që kanë qarkulluar në Kosovë.

Më tutje, në kapitullin me radhë, do të potencohen ndikimet e këtyre feve në Kanunin e Lekë Dukagjinit, që është vepër tejet e rëndësishme për kulturën shqiptare.

Është e vërtetë se shqiptarët kanë shumicë numerike në Shqipëri dhe Kosovë, por anëtarët e shqiptarëve zbehen në krahasim me botën. Vazhdueshmëria dhe jetëgjatësia e ngjasimit etnik shqiptar janë të varura nga kuptimi zanafillor i martesës, që përmban parimet e monogamisë heteroseksuale dhe që siguron mjedisin më të mbarë për lindjen dhe ruajtjen e një gjendjeje të qëndrueshme dhe shëndetdhënëse shoqërore.

Më tutje, do të trajtohet martesë si institucion i ligjshëm dhe shoqëror në Kosovë, që është shumë e rëndësishme për të kuptuar fillimisht historikun e ligjeve mbi martesën dhe familjen, e pastaj funksionet e këtyre ligjeve në Kosovë.

Së fundmi, mosmarrëveshja zakonore që valëvitet nga parashtrimi i miratimit të martesave homoseksuale në Kosovë kërcënon shembjen e vlerave që prej kohësh janë çmuar nga shumica e popullsisë Kosovare. Për këtë arsye, i takon hulumtuesve të ngulisin gurthemelet e koklavitura shoqërore të kësaj çështjeje dhe të kërkojnë një zgjidhje që drejtpeshon kërkesat bashkëvepruese të trashëgimisë dhe bashkëkohshmërisë.

Në këtë hulumtim, janë përdorur metoda analitike, juridiko-dogmatike, krahasuese, cilësore si dhe ajo historike.

## 2. Kuptimi i martesës në fetë mbizotëruese abrahamike

Fetë abrahamike të tërat e gjurmojnë prejardhjen e tyre nga themeluesi i tyre Abrahami. Ato janë tre besimet kryesore monoteiste: Judaizmi, Krishterimi dhe Islami. Çfarë i bashkon këto fe është besimi në një Perëndi, i cili pohohet si krijuesi i gjithësisë dhe burimi i gjithë qenies.

Feja më e vjetër prej të lartpërmendurave është Judaizmi, i cili thekson rëndësinë e ndjekjes së urdhërimeve të Zotit siç parashtrohen në Tora, që është përmbledhja e pesë librave fillimtarë të Biblës Hebraike. Krishterimi u lind nga Judaizmi, dhe veçanërisht përqendrohet rreth jetës dhe mësimave të Jezu Krishtit, i përfytyruar si Biri i Zotit dhe shpëtimtari i njerëzimit. Krishterët besojnë se nëpërmjet besimit në Jezu Krisht dhe vetëflijimit të Tij në kryq, ata mund të arrijnë shpëtim dhe jetë të përjetshme. Krishterimi gjithashtu përfshin shumë mësimet Hebraike dhe ka të zhvilluar një zakon të pasuruar me meshë dhe udhëzime. Islami u shfaq në shekullin e shtatë pas Krishtit i thelbësuar në mësimet e Muhamedit, të cilin myslimanët e shohin si të fundit në një varg të gjatë profetësh të dërguar nga Zoti. Myslimanët besojnë vetëm në një Zot dhe se nënshtrimi ndaj vullnetit të Tij është çelësi i arritjes së shpëtimit dhe jetës së përjetshme. Kur'ani është libri qendror i Islamit.

Brenda sixhadesë së ndërlikuar të besimeve abrahamike, një temë që i bashkon këto tradita është ungjëllizimi i monogamisë së përjetshme, që është mendësi nderuese për besëlidhjen martesore të shenjtëruar midis një burri dhe një gruaje. Pasi që Tora përbëhet nga pesë librat e parë të Biblës Hebraike dhe është shkrimi qendror i Judaizmit dhe Bibla e Krishterë gjithashtu përfshin të njëjtat pesë libra së bashku me shkrime shtesë që përbëjnë Shkrimin e Shenjtë (Biblën), duket e përshtatshme që të përdoret Bibla për përkufizimin e martesës në kornizën judeo-kristiane.

Në librin e Zanafillës, që është libri i parë i Biblës Hebraike dhe Besëlidhjes së Vjetër, shkruhet se i Plotfuqishmi e skaliti burrin sipas shëmbëlltyrës dhe ngjashmërisë së tij, dhe se Ai përftoi gruan prej njëres brinjë të burrit, që ajo të jetë shoqëruese dhe ndihmëse e tij. Shkrimi i Shenjtë i Gjenezës përcjell se kur një burrë dhe një grua nderojnë premtimet, ata shndërrohen në një trup të vetëm. Ky nyjzim i shkëlqyer dhe i mrekullueshëm pasqyron bashkëtingëllimin dhe dashurinë e Hyjnore—një mëdyshje e papërshkrueshme që tejkalon të kuptuarit njerëzor. Bashkimi i martesës trajtëson një njësi të re familjare me zotërimin e një imazhi dhe qëllimi të posaçëm. Shpirtrat e bashkuar nuk janë më dy ente të ndara, por një skuadër joshëse që manovron për të arritur synimet dhe prirjet e saja. Në teologjinë e krishterë trinitare, kjo mund të shqyrtohet si një burrë dhe një grua duke u bërë një në thelb dhe dy në persona, në të njëjtën mënyrë që Zoti është një në thelb dhe tre në persona (Biri, Ati dhe Fryma e Shenjtë), që hedh në pah ngjasimin me Zotin.

Në Ungjillin e Mateut, kapitulli 5, vargjet 31-32, shkruhet në mësimin mbi ndarjen martesore: “ Qe thënë se: Kush e ndan gruan e vet, le t’ia japë letrën e ndarjes.’ E unë po ju them: kushdo e ndan gruan e vet – përveç në rastin e fëlligështisë – e bën atë të thyejë kurorën; e nëse ndokush martohet me gruan e ndarë, shkelë kurorën.”

Jezusi në këto vargje shpjegon çështjen e ndarjes martesore. Ai fillon duke thënë bindjen e

përgjithshme se një burrë që ndan gruan e tij duhet t'ia japë asaj një letër ndarjeje. Megjithatë, Jezusi vazhdon të thotë se kushdo që ndan gruan e tij, përveç në rastin e fëlligështisë, e bën atë të kryejë fëlligështi, dhe kushdo që martohet me një grua të ndarë kryen fëlligështi. Fëlligështia nënkupton tradhti bashkëshortore, dhe ajo thyen kurorën e besnikërisë.

Një burrë që ndahet nga gruaja kur gruaja e tij nuk e ka tradhtuar atë vazhdon ende të jetë në marrëveshje martesore; dhe nëse një burrë tjetër martohet me këtë grua atëherë gruaja, po ashtu dhe ky burrë, janë duke kryer fëlligështi. Më tutje, në Ungjillin e Mateut në kapitullin 19, në vargjet 3-8, Jezusi mbështet fjalët e tij duke iu përgjigjur një sprovimi prej disa farisenjve që e pyetën atë: “A është e lejueshme ta lëshojë burri gruan për ndonjë arsye?” Jezu Krishti u përgjigj: “A nuk keni lexuar se Krijuesi, kur i krijoi në fillim i krijoi mashkull e femër e tha: ‘Për këtë arsye njeriu do ta lërë babanë e nënën e vet e do të jetojë me gruan e vet e të dy do të jenë vetëm një trup?’ Kështu ata nuk janë më dy, por një trup i vetëm. Prandaj, çka Hyji bashkoi, njeriu të mos e ndajë!” Ata prapseprap vijuan: “E përse atëherë Moisiu urdhëroi: ‘të jepet letërndarja e të lëshohet?’” Ai (Jezusi) u përgjigj: “Moisiu ju lejoi t’i ndani gratë tuaja për shkak të karakterit tuaj të pagdhundur. Por në fillim nuk ka qenë ashtu. Kurse unë po ju them: Kush e lëshon gruan e vet – përveç në rast të fëlligështisë – e martohet me një tjetër grua, bën kurorthyerje; po edhe ai që martohet me gruan e ndarë, bën kurorthyerje.”

Tek Romakëve kapitulli 7 vargjet 1-3, ngurtësohet përjetshmëria e lidhjes martesore, siç u ungjillizua nga Krishti, duke u thënë se Ligji e detyron njeriun derisa ai është gjallë, për këtë arsye gruaja e martuar është e lidhur me burrë deri sa ai është gjallë. Pra, derisa ta ketë burrin gjallë, po shkoi me ndonjë tjetër, do të quhet kurorëthyesë, në çoftë se martohet me një burrë tjetër. Shkrimi i Shenjt në 1 Korintianëve, kapitulli 6 vargjet 9-10, përcjell se as tradhtarët, as fëlligështarët, as idhujtarët, as kurorthyesit, as homoseksualët e çdo lloji, as vjedhësit, as pijanecat, as shpërralluesit, as cubat nuk do të kenë pjesë në mbretërinë e Hyjit. Këto vargje pasqyrojnë se personat që kryejnë tradhti bashkëshortore nuk do të shkojnë në mbretërinë e Perëndisë (në parajsë).

Në këto kapituj e vargje gjithashtu flitet për shturje seksuale (Shkrimi Shenjt): 1 Korintianëve 6:18-20 – “Ikni prej fëlligështisë! Çdo mëkat që bën njeriu është jashtë trupit, kurse ai njeri që bën fëlligështi, mëkaton kundër trupit të vet. Apo nuk e dini se trupi juaj është Tempulli i Shpirtit Shenjt që banon në ju që e keni prej hyjit dhe se nuk i përkitni më vetvetes? Sepse jeni blerë me çmim të lartë.

Prandaj, jepni lavdi Hyjit në trupin tuaj.” Galatasve 5:19 – “Tashti, veprat e mishit janë të njohura. Ato anë: fëlligështia, papastërtia, shfrenimi...” Efesianëve 5:3 – “Fëlligështia ose çdo lloj papastërtie ose lakmimi as të mos zihet në gojë ndër ju, siç u ka hije të shenjtërve; Hebrejve 13:4 – “Martesa le të jetë plot nder ndër të gjithë dhe shtrati martesor i panjollë, sepse Hyji do t’i gjykojë fëlligështarët dhe kurorthyesit.”

Sipas Islamit, martesa është hapi fillestar për ndërtimin e një familjeje. Kjo familje nuk mund të jetë e fuqishme nëse themelet nuk i ka të rrënjëzuara në një lidhje të fuqishme. Për këtë arsye, e drejta e Sheriatit i ka dhënë një rëndësi të veçantë martesës duke e quajtur atë “lidhje e fortë”.

Zoti i Madhëruar e krijoi njeriun në dy gjini (mashkullore dhe femërore) dhe porositi martesën në mes dy gjinive që të gjejnë prehje, dashuri dhe mëshirë ndërmjet tyre. Në Kur’an

thotë: “Dhe nga faktet (e madhërisë) së Tij është për të mirën tuaj. Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), kështu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka arsytim për njerëzit që mendojnë.” (Kur’an Er-Rum, 21). Çështjen e martesës e ka lënë në lirinë e zgjedhjes së dy bashkëshortëve pa ndonjë kushtëzim, sepse ajo është një lidhje me dëshirë dhe nuk mund të lidhet pa dëshirën e dy bashkëshortëve. e cila vjen me kuptimin e një bashkimi apo kontrate ndërmjet dy bashkëshortëve.

Kjo është një lidhje e fortë me vetë jetën, me shoqërinë dhe me qenien e begatshme të njerëzve të përmbushur me dinjitet. Martesa urdhërohet në burimin kryesor të së drejtës së Sheriatit, siç është shkruar në Kur’an: “Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakëve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri e me katra. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robërshat).

Ky përkufizim është më afër që të mos gaboni.” Disa njerëz martoheshin me jetimet që i kishin nën kujdesin e tyre për t’iu ikur shpenzimeve dhe për të mos nxjerrë mallin e tyre prej shtëpisë së vet. Kur’ani urdhëroi ose të ndjekin drejtësinë ndaj jetimeve, ose të martohen me gra të tjera, madje deri me katra, por në raste të tilla të matin veten se sa do të jenë të drejtë, përndryshe të martohen vetëm me një grua.

Juristët e të drejtës së Sheriatit e kanë shpjeguar Kur’anin dhe kanë thënë se martesa është një detyrim fetar, si një ruajtëse e ndershmërisë dhe zotim shoqëror. Kur’ani dhe këshilla e profetike e paraqesin martesën në trajta të ndryshme, si arsytim për qenien e Zotit. Martesa konsiderohet si qetësi familjare dhe mënyrë legjitime për lënien e pasardhësve. Ajo është themeli i familjes.

Pa martesë nuk ka familje dhe pa familje nuk ka bashkësi njerëzore. Ky është veprim i përbashkët i njerëzve të zakonshëm, udhëheqësve shpirtëror e madje edhe e profetëve. E gjithë kjo është kështu për arsye se martesa në të drejtën e Sheriatit fillimisht dhe në radhë të parë merret si një veprim i drejtë i përkushtimit të përgjegjshëm. Vetëm me martesë sigurohet zhvillimi i zakonshëm i bashkësisë njerëzore me qëllim që lloji njerëzor të vazhdoj rrugëtimin e tij.

Në Islam Zoti i Lartësuar thotë: “Ne dërguam edhe para teje (Muhamed) profet dhe atyre u mundësuam të kenë gra e fëmijë...”. Sipas Islamit, i dërguari i Zotit, Muhamedi, gjithashtu në shumë porosi të tij ka nxitur në nyjëzimin e personave të gjinisë së kundërt për lidhje martesore. Madje ai tërheq vëmendjen se ikja nga martesa është një lloj i ikjes së trashëgimisë së tij dhe drejtimit të tij. Muhamedi ka thënë: “Martesa është pjesë e veprimit tim jetësorë dhe, kushdo që i largohet veprimit tim jetësorë nuk është nga ne (Mysliman)!”

### **3. Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe ndikimi fetar në kulturën e shqiptarëve në Kosovë**

Kanuni është e drejtë e pashkruar zakonore e cila te Shqiptarët në Kosovë është ruajtur deri në bashkëkohësi. Botëkuptimi që mbizotëron është se kjo vepër është e Lekë Dukagjinit, ligjvënësit të së drejtës zakonore. Me rënien nën pushtetin turk, bëhen përpjekje të pashallarëve

të atëhershëm dhe e velive turk që në jetën shoqërore të zbatohet e drejta e Sheriatit, gjë që populli i sprovuar e ka kundërshtuar ashtu si ka ditur dhe ka pasur mundësi. Në këtë drejtim, pushteti turk nuk ka mundur asnjëherë t'i qërojë hesapet tërësisht me rregullat dhe shpirtin e Kanunit tek shqiptarët. Edhe me kalimin e një pjesë të shqiptarëve në fenë Islame, shpirti i Kanunit qëndroi i palëkundur, përkundër përpjekjes për ta sforcuar të drejtën e Sheriatit nga ana e perandorisë Osmane.

Mbledhësi i rregullave të Kanunit ishte prifti katolik Shtjefën Gjeçovi, i cili shërbeu në kishat e Dukagjinit të sotëm dhe në Shqipërinë Veriore. Veprën e tij të përpiluar e quajti "Kanuni i Lekë Dukagjinit", pjesëzat e së cilës filluan të botohen në vitin 1913 në revistën "Hylli i Dritës", ndërsa pas vdekjes së tij, më 1933, u botuan si vepër e plotë. Në veprën e tij, prifti Gjeçovi në 110 faqe shkuan për Kishën dhe të drejtat e saj sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, ndër të cilat përfshihet martesë dhe familja. Kanuni i kushton rëndësi jetike martesës, për arsye se sipas tij, të martohesh do të thotë të bëhesh shtëpi. Kjo shprehet përmes vargut "me ia shtue shtëpisë edhe një rob ma tepër..." gjegjësisht për punë dhe lindje të fëmijëve.

Kanuni i Lekë Dukagjinit njih katër lloje të martesës, por martesë e vetme e ligjshme është martesë me kurorëzim, për arsye se ajo është në përputhshmëri me frymën fetare dhe zakone shqiptare. Gruaja që mbahet nën kurorë, por që nuk është kurorëzuar, është kundër fesë dhe Kanunit. Një grua ose vajzë e rrëmbyer është e paligjshme sipas fesë dhe Kanunit; martesë për provë gjithashtu kundërshton fenë dhe Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Zoti i shtëpisë është i plotfuqishëm në vendosjen e martesës për anëtarët e familjes së tij. Vetëm nëse një person është i papjekur dhe nuk ka prindër, mund të vendosë vet për martesën e tij. Por, nëse një person ka prindër, ai ose ajo nuk ka të drejtë të vendosë vet për martesë, për caktimin e mesitit, të përzihet në punët e fejesës dhe në përgatitjen e nuses me veshmbathje, dhe as për caktimin e datës së dasmës. Vajzat nuk kanë të drejtë të vendosin për martesën e tyre, madje edhe nëse nuk kanë prindër, kjo përgjegjësi i takon vëllezërve apo kushërinjve.

Fatkeqësisht, Kanuni vështirëson drejtësinë gjinore, për arsye se ai i sheh gratë si mjete dhe jo si të barabarta me burrat. Nëse një vajzë dëshiron të ndërrojë familjen e saj, prindërit e saj mund t'ia japin me dhunë djalit të një familjeje tjetër dhe ta kërcënojnë atë me vdekje nëse ajo nuk dëshiron të martohet me djaloshin apo burrin e zgjedhur. Pavarësisht se këto kushte janë absurde dhe të pakuptueshme në shekullin XXI, ato ende janë në qenësi në disa zona të Shqipërisë dhe janë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e njeriut. Në Kanun nuk ka martesë pa dasmë. Gruaja mund të vritet për prishje të kurorës dhe tradhti, kurse për vjedhje dhe gabime, burri mund ta lëshojë. Kanuni nuk i pranon si martesë të rregullta martesat siç janë: bigamia, biandria, leviratin, sororatin, martesat për pronë, rrëmbimin dhe kokubinatin. Ka shumë presione mbi burrin dhe gruan nëse jetojnë në martesë dhe në çoftëse ata nuk kanë vënë kurorë.

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, martesë është një bashkëjetesë ndërmjet dy personave, por gjithashtu një marrëveshje midis dy familjeve. Nëse një person dëshiron të martohet, ai duhet të kërkojë lejen e prindërve, dhe nëse prindërit pranojnë, atëherë dhe vetëm atëherë mund të fillojë zhvillimi i fejesës. Gjatë kësaj kohe, burri dhe grua krijojnë një lidhje të veçantë të miqësisë dhe besnikërisë, njëkohësisht duke ndjekur të drejtat dhe detyrimet që

vijnë nga martesë sipas Kanunit. Burri dhe gruaja kanë një përgjegjësi të madhe për të krijuar dhe mbajtur pajtimin në familje, duke i nderuar detyrimet dhe të drejtat që dalin nga martesë. Nëse njëri nga partnerët nuk i ndjek detyrimet dhe të drejtat e tij, ai mund të ndëshkohet nga shoqëria dhe familja; dhe nëse një çift nuk mund të zgjidhë problemet e tyre në një marrëveshje, ata mund të kërkojnë ndihmën e miqve dhe shoqërisë, të cilët do të vendosin nëse çifti duhet të ndahet. Në këtë rast, pasuria duhet të ndahet në një mënyrë të ndershme dhe të drejtë. Femrat janë një pjesë e rëndësishme e procesit të fejesës dhe martesës në Kanun. Një grua duhet të respektojë burrin e saj dhe të kujdeset për të, duke i shërbyer atij dhe duke iu bindur detyrave të saja si bashkëshorte. Përveç kësaj, ajo duhet të respektojë dhe t'i bindet ligjeve dhe rregullave të Kanunit të Lekë Dukagjinit në lidhje me martesën dhe familjen.

E drejta e Sheriatit pranon dy lloje të martesës: me femrat e lira dhe me robëresha. Në popujt Islamik është hequr robëria, prandaj nuk ka martesë me robëresha, por vetëm me femra të lira. Sheriati shtjellon edhe pengesat për t'u martuar një çift. Ekzistojnë dy pengesa për martesë: të pandryshueshme dhe të përkohshme. Në pengesat afatgjata përfshihen vetëm lidhjet farefisnore. Por, pengesave të pandryshueshme u takojnë gjithashtu këto: farefisnia, numri i grave, të qenët i martuar, dallimi në fe, jodinjiteti, shkurorëzimet e tepërta dhe iddet.

Në linjën e brinjëve (të ëmës) martesë ndalohet me motrën, tezen, vajzën e vëllait ose të motrës së gruas së tij. Numri i grave është ndalesë sipas së drejtës së Sheriatit, sepse e drejta islamike sheh dy lloje të poligamisë në të njëjtën kohë:

- a) kur burri jeton njëkohësisht me më shumë gra; dhe atë të barasvlershme,
- b) kur burri pas shuarjes së martesës së parë lidh shumë kurora tjera.

E drejta islamike e lejon poligaminë në të njëjtën kohë dhe të përsëritshme, ndërsa e drejta kishtarë nuk e lejon atë të njëkohshme. Për nga dallim me të drejtën islame dhe kishtarë, e drejta zakonore nuk e lejon poligaminë. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit ata që kanë hyrë në poligami nuk kanë asnjë të drejtë të martohen sipas zakonit ose të drejtës kishtarë katolike. Kanuni i Lekë Dukagjinit si e drejtë është nën ndikimin e kishës katolike. Kur'ani e lejon poligaminë, sepse burri është i lejuar të jetojë njëkohësisht me më së shumti katër gra. Gruaja nuk ka të drejtë t'ia ndalojë burrit që përveç saj të mos martohet me grua tjetër.

## 4. Martesë si institucion juridik dhe shoqëror në Kosovë

Në periudhën e pushtimit Otoman, Kosova ishte në një skelet ligjor gjithëpërfshirës me vendet e tjera të Ballkanit. Në mesin e shekullit të njëzetë gjatë udhëheqjes jugosllave, u zbatua një sistem ligjor me përkatësi qendrore. Më pastaj, pas luftës së Kosovës, u krijua një sistemi ligjor i ri që bazohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në ligjvënien e saj të brendshme, si dhe në nivele ndërkombëtare të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Në Ligjin e Familjes, martesë është parashtruar si një bashkëjetesë e burrit dhe gruas. Ajo ka një përmasë shoqërore dhe personale, por është gjithashtu e rregulluar nga ligji. Martesë ka për qëllim krijimin dhe mbrojtjen e familjes, e cila peshohet si një celulë themelore e shoqërisë. Në këtë kuptim, martesë është një ndërmarrje e rëndësishme që ndikon në jetën shoqërore dhe në marrëdhëniet personale. Ligji i martesave në Kosovë u miratua në vitin

2004 dhe është i shtyllëzuar në nivele ndërkombëtare. Ai rregullon marrëdhëniet burrë-grua dhe përcakton veprimet e martesave dhe ndarjeve martesore. Martesa mund të bëhet vetëm midis dy personave të moshës së rritur, që janë të lirë dhe të aftë për të kuptuar natyrën e marrëveshjes. Ligji i martesave parashikon që martesa mund të shfuqizohet në disa raste të caktuara, për shembull nëse ajo është bërë nën ndikimin e detyrimit ose nëse një prej partnerëve ka qenë i/e përafërt me një person tjetër gjatë martesës. Nëse martesa merr fund me një shkurorëzim, Ligji i martesave e rregullon kujdesin e fëmijëve dhe përcakton se si do të ndahen pronat dhe pasuritë e bashkëjetesës së mëparshme.

E drejta familjare është një fushë e drejtësisë që përfshin rregullimin e marrëdhënieve në familje si: martesën, ndarjen martesore, marrëdhëniet prind-fëmijë, birësimin, trashëgiminë dhe çështjet e tjera të lidhura me familjen. Në Kosovë, e drejta familjare rregullohet nga Kodi Civil i Republikës së Kosovës, Kodi Familjar i Republikës së Kosovës, si dhe nga akte të tjera nënligjore. Synimi kryesor i këtyre ligjeve është të mbrojnë të drejtat dhe dëshirat e anëtarëve të familjes dhe të sigurojnë marrëdhënie familjare të ndershme dhe të drejta për të gjithë. Për të arritur këtë qëllim, Kosova ka ndryshuar disa prej ligjeve të saja për të rritur barazinë gjinore në martesë dhe për të mbrojtur fëmijët në rastet e shkurorëzimeve dhe të marrëdhënieve prind-fëmijë.

Më 1 shtator 2006, në Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, u botua Ligji Nr. 2004/32 i titulluar “Ligji për Familjen i Kosovës”. Ky ligj thekson detyrat dhe përgjegjësitë e shtetit dhe njerëzve në mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të familjes në Kosovë. Qeveria e Kosovës me këtë ligj synon rregullimin e raporteve familjare dhe përkrahjen e të drejtave të anëtarëve të sajë, duke krijuar një mjedis të mbarë për zhvillimin dhe mirëqenien e familjeve. Ligji për Familjen i Kosovës, në pjesën e tij të parë, përmban dispozita të përgjithshme që kanë të bëjnë me përcaktimin e konceptit të familjes, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të familjes dhe marrëdhëniet familjare. “Familja” në këtë ligj përcaktohet si një grup njerëzish që janë të lidhur nga lidhja e gjakut, lidhja martesore ose birësimi. Ligji përcakton të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të familjes dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të personave të varfër që janë pjesë e familjes. Ligji gjithashtu rregullon marrëdhëniet ndërfamiljare, duke përfshirë çështjet e martesës, divorcit, trashëgimisë dhe gjykimin e çështjeve familjare. Mënyrat e nevojshme të veprimit për shkrimin në listë të martesave dhe shkurorëzimeve përcaktohen në ligj, si dhe kushtet e nevojshme për birësimin e fëmijëve. Qëllimi i këtij ligji është të mbrojnë të drejtat dhe nevojat e anëtarëve të familjes, të përmirësojë marrëdhëniet ndërfamiljare dhe të rregullojë disa prej çështjeve më të rëndësishme familjare në Kosovë.

Ligji Nr. 2004/32 është një ndër ligjet më të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, pasi që ndihmon në mbrojtjen e të drejtave dhe nevojave të familjeve në rrethana të llojllojshme. Sipas tyre, ky ligj është një shembull i mirë i një politike shoqërore përparimtare në Kosovë, por është shumë e rëndësishme që zbatimi i tij të jetë i dobishëm dhe i drejtë. Për të ngritur efikasitetin e zbatimit të këtij ligji, duhet të ketë më shumë ndërgjegjësim dhe trajnim për personelin juridik dhe për qytetarët në përgjithësi si dhe të ndërtohet një sistem i dobishëm i vëzhgimit dhe vlerësimit të zbatimit të këtij ligji, duke i përfshirë në këtë proces dhe organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e familjeve në Kosovë.



## 5. Përfundim

Në kohën e sotme në Kosovë, ndikimi i të drejtës pozitive apo të aplikueshme në lidhjen e martesave është më i rëndësishëm se ndikimi i fesë, për arsye se gjithnjë e më shumë njerëz (veçanërisht në qytetet e mëdha) janë duke zgjedhur të martohen sipas ligjit dhe jo sipas rregullave dhe zakoneve fetare. Për t'u martuar, duhet të plotësohen kushtet dhe rrjedhimet e caktuara nga ligji, si: të jenë në moshë të rritur, të jenë të lirë, të kenë zotësinë juridike, etj. Ligji gjithashtu rregullon edhe çështjet e tjera të martesës, si: përcaktimi i pasurisë së çiftit, detyrat dhe të drejtat e tyre dhe procesin e ndarjes së pasurisë në rastin e shkurorëzimit apo ndërprerjes martesore.

Edhe pse feja vazhdon të ketë ndikim të rëndësishëm në shoqërinë kosovare, shumica e njerëzve nuk e ndjekin atë në çështjen e martesës. Disa besime fetare kanë rregulla të veçanta për martesën, siç është rasti me islamin, por nuk janë të detyrueshme për njerëzit që nuk janë besimtarë të këtyre feve.

Martesa është rregulluar nga ligji dhe shumica e të drejtave dhe detyrime bashkëshortore janë të rregulluara me norma juridike urdhëruese ndërsa një pjesë e çështjeve rregullohen me mirëkuptim ndërmjet bashkëshortëve. Nëse një çift vendos të martohet sipas rregullave fetare, ata janë të lirë ta bëjnë këtë, por një martesë e tillë nuk prodhon asnjë efekt juridik duke qenë se në Kosovë efekt juridik prodhojnë vetëm martesat civile të lidhura sipas dispozitave të Ligjit për Familjen dhe në institucionet përkatëse administrative. Pra, institucioni i martesës në Kosovë ka përqafuar plotësisht parimin e laicitetit dhe barazisë.

## Referencat:

1. Arbresh. [2019]. Çfarë thotë Kanuni i Lekë Dukagjinit për femrat, fejesën dhe martesën? Marrur nga <https://www.arbresh.info/kulture/cfare-thote-kanuni-i-leke-dukagjinit-per-femrat-fejesen-dhe-martesen/>
2. Bytyqi, A. & Murati, M. [2020]. Ndikimi i Ligjit të Familjes në Barazinë Gjinore në Kosovë.
3. Revista e të Drejtave të Njeriut dhe Punës Sociale, 5.
4. Encyclopædia Britannica. [2023, Shkurt 26]. Abraham. Marrë nga <https://www.britannica.com/biography/Abraham>
5. Filipaj, S. [2011]. Shkrimi Shenjt: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re. Tiranë, Albania: Zanafilla. [Zanafilla 1:27, Zanafilla 2:22, Mateu 5:31 & 5:32, Mateu 19:3, Romakëve 7:1-3 & 1 Korintianëve 6:9-6:10]
6. Gashi, H. [2019]. Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë [fq. 201-204]. Akademia e Drejtësisë.
7. Gashi, H., Aliu, A., & Vokshi, A. [2012]. Komentar - Ligji Nr. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS.
8. Ibën Maxhe. [n.d.]. Sunnen. Kitabu nikah, hadhithi nr.1864.
9. Intervistë me Sevdai Haxhiu-Imami Xhamisë së boshnjakëve. Intervista është realizuar në Ferizaj më 24.03.2023.
10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. [2008]. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
11. Kur'an. Kaptina En-Nisaë, Kaptina Err-Rrad.
12. Kurdiq, Sh. [2003]. Martesa dhe marrëdhëniet intime në Islam. Zenicë, Bosnia and

- Herzegovina: Medzlis Islamske Zajednice Zenica.
13. Kutub, M. [2001]. Dilemat rreth Islamit. Prishtinë, Kosovo: Koha.
  14. Shehu, B. [2012]. Fjalor sociologjik. Tirana, Albania: IDK - Instituti i Librit dhe të Kulturës "Libra për të gjithë". [f. 134, 141, 260]
  15. Shtufi, K. [2022]. Martesa e Shqiptarëve në Kosovë: Brak Albanaca na Kosovu. [Punimi origjinal i publikuar më 1986]. Prishtinë, Kosovo: Printing Press - Prishtinë.
  16. Zanima, L. [2021, March 29]. Së pari i takon miqësia: Martesa, fejesa, paja, miqësia, gruaja, burri - të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kanuni i Lekë Dukagjinit. Marrur nga <https://www.zanimalsise.com/martesa-fejesa-paja-miqesia-gruaja-burri-te-drejtat-dhe-detyrimet-qe-rrjedhin-nga-kanuni-i-leke-dukagjinit/>

# Martesa në moshë të hershme

Lendrita Hasani

## ABSTRAKT

Fenomeni i martesave të hershme vazhdon të jetë sfidë për shtetet në zhvillim edhe pse përmasat e këtij fenomeni janë më të vogla se në të kaluarën. Kjo dukuri është e pranishme edhe në shoqërinë kosovare dhe si e tillë shkaktohet nga faktorë të ndryshëm. Punimi shtjellon raportit mes të drejtës zakonore dhe të drejtës pozitive të ditëve të sotme, lidhur me martesat e të miturve, ndikimin e familjes dhe rrethit shoqëror në këto martesat dhe pasojat e tyre në familje e shoqëri, me theks të veçantë për Komunën e Shtimes.

Fillimisht është trajtuar koncepti i martesës nga prizmi i së drejtës zakonore, duke e krahasuar atë me përkufizimin ligjor. Më pastaj është shtjelluar martesat në periudha të ndryshme historike duke potencuar edhe ndikimet që kanë pasur në konceptin tradicional të lidhjes së martesës. Punimi nënvizon edhe bazën ligjore të martesës, si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ajo. Në hartimin e këtij punimi është përdorur qasje e ndërthurur, duke filluar nga shqyrtimi i literaturës juridike por edhe nga studimi empirik nga i cili janë marrë të dhëna cilësore. Rrjedhimisht, në këtë punim janë shfrytëzuar metoda kronologjike, statistikore, metoda juridiko-dogmatike dhe e analizës së përmbytjes.

## Fjalët kyçe:

Martesat e hershme, komuniteti pakicë, vetëdijesimi, pengesat ligjore

## 1. Hyrje

Martesa përfaqëson një angazhim të përjetshëm midis dy partnerëve. Ndërsa kjo zakonisht përfshin interes të ndërsjellë romantik, martesa është gjithashtu një kontratë ligjore që u jep të drejta dhe përgjegjësi të veçanta palëve të përfshira.

Në vendin ku jetoj unë, me themelimin e shtetit më 2008, është vendosur që Kosova të jetë shtet i pavarur dhe demokratik, shtet i cili u jep liri dhe u siguron të drejta të gjithë qytetarëve pa dallim moshe, gjinie, race apo feje. Duke u nisur nga këto parime themelore kushtetuese është zhvilluar edhe ky punim që për temë bosht ka familjen dhe martesën.

Përkundër garantimit të të drejtave dhe lirive themelore për çdo qytetarë të Kosovës si nëpërmjet dispozitave kushtetuese ashtu edhe atyre ligjore, martesat e hershme janë dukuri që vazhdojnë të jenë të pranishme në shoqërinë kosovare. Rrjedhimisht, ky fenomen negativ është duke injoruar dispozitat kushtetuese dhe dispozitat e Ligjit për Familjen në Kosovë. Megjithatë, krahasuar me të kaluarën, ky fenomen ka shënuar rënie të dukshme por edhe më tej mbetet i pranishëm te komunitetet e marginalizuara në shoqërinë tonë.

Në këtë punim do të jenë në fokus martesat në qytetin ku jetoj unë e në veçanti martesat në moshë të hershme. Janë sqaruar rrethanat, shkaqet dhe pasojat se pse shoqëria kosovare e në veçanti ajo në qytetin e Shtimes ka marrë dhe merr këto vendime në një moshë të papjekur dhe jo mjedis adekuat për të formuar një çift bashkëshortor apo edhe familje.

Fillimisht është trajtuar koncepti i martesës nga prizmi tradicional (e drejta zakonore) duke e krahasuar me përkufizimin ligjor. Më pastaj është shtjelluar martesat në periudha të ndryshme historike duke potencuar edhe ndikimet që kanë pasur në konceptin tradicional lidhur me martesën. Gjithashtu, punimi nënvizon edhe bazën ligjore të martesës dhe familjes, si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga përcaktimi ligjor.

Martesat në moshë të hershme, kushtet ekonomike, kushtet familjare, aspekti i edukimit, komunitetet pakicë e të tjera do jenë disa nga termet më të përdorura në këtë punim dhe ku do të njihemi nga afër me secilën prej tyre.

Në hartimin e këtij punimi është përdorur qasje e ndërthurur, duke filluar nga shqyrtimi i literaturës por edhe nga studimi empirik nga i cili janë marrë të dhëna cilësore. Për më tepër në këtë punim janë shfrytëzuar metodat e ndërthurura hulumtuese siç janë metoda kronologjike, metoda statistikore, metoda juridiko-dogmatike dhe e analizës së përmbajtjes.

## 2. Zhvillimi historik i institutit të martesës

Nëse kthehemi në histori dhe shikojmë prapa në kohë, zakonisht ky raporti martesor ka qenë një urë lidhëse mes dy apo më shumë njerëzve (zakonisht mes një burri dhe gruaje) të cilët për arsye ekonomike, angazhime familjare, obligime kulturore a fetare bashkoheshin në një lidhje të quajtur martesë. Martesa shihej si akt që kishte të bëjë krijimin dhe mbajtjen e një apo më shumë raporteve mes anëtarëve dhe familjeve mes vete me qëllim sigurimin e jetesës, lidhjen e aleancave, zgjerimin e punës, sigurimin e pasurisë ose pozitës/statusit në shoqëri, vazhdimin e linjës së gjakut etj.

Nga kjo nxjerrim se faktorët më të rëndësishëm ishin faktorët social, ekonomik dhe politik. Vajzat që mbushnin moshën e pubertetit dhe piqeshin sa për të lënë trashëgimtarë martoheshin nga prindërit apo kujdestarët e tyre dhe tani “epiteti” nga vajzë kalonte në grua: nuk ekzistonte zgjedhja se me kë do të martoheshin dhe në shumicën e rasteve, gratë as nuk e njihnin burrin para se të martoheshin.

Në ceremoninë e fejesës së Greqisë së lashtë, një baba dorëzonte vajzën e tij që në moshë 13-14 vjeçare me këto fjalë: “Unë e lë peng vajzën time për të prodhuar pasardhës të ligjshëm”. Ndërkohë te hebrenjtë e lashtë, burrat ishin të lirë të merrnin disa gra duke përfshirë edhe vajza të mitura. Nëse gratë nuk arrinin të lindnin pasardhës, burrat e tyre mund t’i kthenin dhe të martoheshin me dikë tjetër mirëpo gratë jo.

Në mesjetë, vajzat ishin zakonisht në adolehencë kur martoheshin, dhe djemtë ishin në të njëzetat e hershme. Marrëveshja e martesës bazohej në vlerën monetare. Familja e vajzës që do të martohej i jepte një prikë, ose dhurim djalit me të cilin do të martohej. Prika do t’i paraqitej dhëndrit në momentin e martesës.

Në shekullin XIX dhe XX nga martesë tradicionale përfshihej që burri t’i sigurote gruas mbështetje dhe mbrojtje ekonomike në këmbim të shoqërimit dhe shërbimeve të nënës. Presionet e forta sociale i nxitën burrat dhe gratë të martoheshin që në moshë të re dhe i bënë shërbimet e lakmuara që personat e martuar që i ofronin njëri-tjetrit të vështira për t’u marrë diku tjetër.

### 3. Aspekti fetar i martesës

Në aspektin fetar kemi dy nga qëndrimet kryesore mes fesë së krishtere dhe asaj myslimane. Martesa në Kishën Katolike, e njohur edhe si martesë e shenjtë, është “besëlidhja me të cilën një burrë dhe një grua vendosin midis tyre një partneritet të gjithë jetës dhe që urdhërohet nga natyra e saj për të mirën e bashkëshortëve dhe riprodhimit dhe edukimin e pasardhësve”, dhe e cila “është ngritur nga Krishti Zot në dinjitetin e një sakramenti midis të pagëzuarve.”

Në Islam, nikahu është një kontratë ndërmjet dy njerëzve. Si dhëndri ashtu edhe nusja duhet të pranojnë martesën me vullnetin e tyre të lirë. Një kontratë formale verbale ose në letër konsiderohet pjesë përbërëse e një martesë islame të vlefshme fetare dhe përshkruan të drejtat dhe përgjegjësitë e dhëndrit dhe nuses.

#### 3.1 Martesa tek shqiptarët sipas Kanunit

Libri i tretë i Kanunit të Lekë Dukagjinit, neni 11, përcakton martesën si në vijim:

*“M’u martue më kanun do’me thanë m’u ba shpi, me i a shtue shpis  
nji rob ma teper, sa për krah të punve, sa per të shtuem të fmive.”*

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, libër nga Shtjefën Gjeçovi i botuar më 1933, bëhet përmbledhja zakonore e të gjitha rregullave, adeteve dhe akteve tjera zakonore ndër shekuj

tek shqiptarët. Në librin e tretë kemi përcaktimin e martesës ku nga kemi edhe citimin lart. Termi martesë do të thotë krijimi i familjes e cila ka rëndësinë e saj morale dhe biologjike. Gruaja paraqitet si robëreshë e cila nuk ka të drejtë të marrë vendime personale për jetën e saj, as të zgjedh se me kë të martohet por vetëm të lindë e kujdeset për fëmijët. Rregullat dhe normat në Kanun janë të natyrës patriarkale.

Këtë më së miri e gjejmë tek libri i Gjergj Rrapit ku ndër të tjera tregon edhe për përcaktimin e moshës në martesë. E drejta zakonore përcakton moshën e fëmijës mashkull, i cili rritet dhe pjekët aq sa mund të mbajë pushkën. Kështu ai kishte të drejtë të mbajë pushkë, të kishte grua dhe të krijonte familje. Porositë e kësaj të drejte zakonore te shqiptarët nuk përkujdeseshin mbi zotësinë psikike, shëndetësore e shpirtërore, si në mbajtjen e armës ashtu edhe në hyrjen në martesë. E tillë është edhe situata tek fëmija femër; nuk ka ekzistuar kujdes as për aftësinë fizike e shpirtërore të fëmijës-femër, sepse rregullat patriarkale e kanë hedhur në pozitë inferiore femrën në krahasim me mashkullin.

## 4. Çka është martesë dhe baza ligjore e saj

Martesa është bashkëjetesa ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza të unitetit në familje.

Sipas ligjit Nr.2004/32 Ligji mbi familjen i Republikës së Kosovës e përkufizon martesën si bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave me seks të ndryshme, me anë të së cilës të dy personat janë të lirshëm të vendosin të bashkëjetojnë me qëllimin e krijimit të një familjeje. Të dy, mashkulli dhe femra kanë të drejtën të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim apo ndalim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit dhe gjithashtu janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj, nëse ajo përfundon.

Pra, nga ky përkufizim kemi definimin e martesës në ligjin për familje të Kosovës duke theksuar se martesë është një ‘marrëveshje’ mes dy palëve, mes dy seksëve të ndryshme biologjike të cilët lidhen me qëllim formimin e një familjeje. Të dy personat (mashkulli dhe femra) janë të barabartë para ligjit dhe normave tjera ligjore e kushtetuese ku s’ka dallime apo ndarje në bazë të veçorive të njërës apo tjetrit si në kombësi, racë apo fe. E gjithë kjo duke marrë për bazë vullnetin e lirë të dyja palëve. Aq e rëndësishme sa martesë është edhe vazhdimësia dhe përfundimi i saj nëse diçka nuk shkon mirë. Të gjitha këto janë të rregulluara me procedura të detajizuara në bazë të dispozitave ligjore të cilat adresojnë aspektet e ndryshme të martesës.

Ndërsa, Ligji për Familjen në Kosovë është shumë i qartë lidhur me moshën e lejuar për lidhjen e martesës duke e ndërlidhur atë me moshën madhore dhe arritjen e aftësisë së plotë për të vepruar. Lidhur me këtë ka përjashtime por të cilat përsëri janë të rregulluara me dispozita ligjore të cilat vlejnë në rrethana të përcaktuara nga vet ligji.

## 4.1 Çka është martesë e hershme

Martesa e hershme është kurorëzim i dy personave ku njëri apo të dyja palët janë nën moshën madhore 18 vjeçare. Ky fenomen në shoqërinë kosovare nuk është edhe aq i vogël mirëpo ajo që brengos më shumë janë shkaktarët e saj.

Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë.

Për shkak të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet vetëm nëse konstaton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore. Kështu para se të marrë vendimin, gjykata do të kërkojë mendimin e Organit të Kujdestarisë, do ta dëgjojë të miturin dhe prindërit përkatësisht kujdestarin e tij. Gjukata gjithashtu do të dëgjojë mendimin e institucionit përkatës shëndetësor dhe do të hetojë rrethanat tjera të rëndësishme lidhur me kërkesën për lidhjen e martesës para se të nxjerrë vendim lidhur me çështjen.

## 4.2 Martesat e hershme në Shtime

Nga zyra e ofiçarisë dhe zyra e komuniteteve në komunën e Shtimes ka statistika që nga 03.01.2022 deri më 31.12.2022 në të cilën periudhë kohore kanë ndodhur gjithsej 328 martesë të rregullta dhe 29 të jashtme. Nga këto martesë, tri prej tyre janë të regjistruara si martesë të hershme: 1 në Shtime (komunitet shqiptar) dhe 2 raste në fshatin Gjyrkoc (komunitet pakicë). Shkaku i martesës së parë (martesë e një vajze nën moshën 18 vjeçe me një mashkull me moshë mbi 18 vjeç të dy të komunitetit ashkali) në rrethana më përsheptuese për rregullimin e lejeqendrimit në një shtet të jashtëm në të cilin jeton dhe punon njëri nga bashkëshortët.

Rastet e tilla janë të shumta në Kosovë dhe kjo arsye sa po vjen e po fuqizohet më shumë shkaku i largimit të të rinjve nga vendi dhe krijimi i mundësive në shtete të huaja. Ky është një problem real për shoqërinë tonë ngase i nxitë të rinjtë të martohen në moshë të re vetëm për tu larguar nga Kosova. Pra, shihet një lloj ndikimi i drejtpërdrejt i ngecjes në zhvillim ekonomik në nxitjen e martesave të hershme (16-17 vjeçare) me qëllim të largimit nga Kosova.

Ndërkohë shkaku i dy martesave tjera, një e komunitet shqiptar dhe një ashkali janë shtatëzani të hershme që domosdo duhet të jenë shtatëzani të paplanifikuara. Moskujdesi i të miturve, mungesa e kontraktivëve apo edhe mosdija e tyre ka rezultuar në shtatëzani të hershme. Formimi i një familjeje në moshë 16-18 vjeçare është një sfidë e madhe e një të riu në Kosovë.

Ai/ajo do të kufizohet nga gjithçka që e rrethon: fillimisht nga familja, nga paragjykimet e rrethit, do të pengohet në ndjekjen e edukimit të mëtejshëm pasi që në këtë rast duhet të fokusohet në atë që të gjejë punë dhe të ketë të ardhura të mjaftueshme për familjen, duke u ballafaquar me sfida tejet të mëdha për të siguruar mirëqenien e familjes.

Mungesa e arsimimit sidomos tek komunitetet pakicë rom, ashkali, egjiptian është e evidente. Në përjashtim të disa rasteve të rralla që ndjekin shkollimin fillor, shumë të tjerë

as që marrin mundin të vazhdojnë shkollimin e mesëm apo atë të lartë. Duke qenë se 90% e tyre ndërprejnë arsimimin në faza të hershme kjo rezulton si një nga shkaqet e papunësisë në nivele të larta dhe rrjedhimisht edhe të gjendjes së vështirë socio-ekonomike.

## 5. Shkaqe të tjera të martesave të hershme në Kosovë

Sipas një raporti të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës lidhur me kurorëzimet në Kosovë për vitin 2020/2021, janë lidhur gjithsej 24 martesat e moshave 16-19 vjeç. Numri i këtyre martesave dallon nga qyteti në qytet pasi aty ku ka numër të komuniteteve pakicë më shumë, rastet e martesave të hershme janë të shumta.

Fillimisht martesat e hershme, në nivel të përgjithshëm të Kosovës, i hasim më shumë tek vajzat se sa tek djemtë. Arsyeja është se vajzat arrijnë moshën e pjekurisë më herët dhe nga mendësia e prapambetur patriarkale nuk lejohen të shkollohen më tej apo edhe të punojnë. Kjo zakonisht ndodh tek familjet e komuniteteve pakicë të cilat janë në varfëri ekstreme dhe me ndihma sociale. Kështu vajza konsiderohet si barrë financiare e familjes dhe zgjidhje e vetme e saj shihet martesa. Me martesën e saj jo vetëm që largohet nga shtëpia mirëpo në anën tjetër familja e vajzës kërkon dhe merr një vlerë të caktuar parash si shpërblim apo rezultat i kësaj “shitjeje”. Martesat ka raste kur ndodhin edhe për të shlyer borxhe ose për të menaxhuar mosmarrëveshje mes familjeve. Sipas një raporti të Ambasadës Amerikane në Kosovë, tregohet më qartë:

*“Ndonëse nuk ka të dhëna zyrtare për raste të martesës së hershme dhe të detyruar të fëmijëve, ajo ishte praktikë e rëndomtë në komunitetin rom, ashkali, egjiptian, boshnjak dhe goran. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-it, ndërsa përqindja e përgjithshme e grave të moshës 20 deri 24 vjeçare që martoheshin para moshës 18 vjeçare ishte e ulët, përqindja për gratë në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian ishte tepër e lartë, në një në tri. Sipas një raporti të qeverisë që përqendrohej në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, rreth 12 për qind e fëmijëve, kryesisht vajza, martoheshin para moshës 15-vjeçare. Nivelet e larta të varfërisë në këto komunitete i kontribuuan kësaj përqindjeje.”*

Arsye e tjetër janë shtatëzanitë e hershme ku nga një raport i qeverisë mbi strategjinë e avancimit të komuniteteve në Kosovë theksohet se shkalla e lindjes së adoleshenteve është 7 herë më e lartë në mesin e vajzave të moshës 15-19 vjeç që jetojnë në familje më të varfër. 1 në 50 gra të moshës 20-24 vjeç ka pasur lindje para moshës 18 vjeç në Kosovë, megjithatë, gjasat që gratë e kësaj moshe të kenë një lindje para moshës 18 vjeç rritet në 1 në 10 nëse jetojnë në familje me varfëri ekstreme.



## 5.1 Pasojat e martesave të hershme

Martesa në mituri ndikon në aftësinë e një vajze për të vazhduar më tutje edukimin e saj ku 90% e vajzave detyrohen ose veçse e kanë braktisur shkollimin për t'u fokusuar në përgjegjësitë shtëpiake ose për të rritur fëmijë.

Martesat e fëmijëve kanë pasoja shkatërruese në shëndetin dhe zhvillimin e vajzave mirëpo edhe në atë të djemve. Si vetë fëmijë, ata nuk janë të përgatitur fizikisht dhe emocionalisht për t'u bërë prindër. Nënadoleshente dhe foshnjat e tyre janë të dyja në një rrezik më të lartë për të vdekur gjatë lindjes sesa gratë që kanë fëmijë më vonë. Krahasuar me gratë e moshës 20-35 vjeç, gratë shtatzëna nën 20 vjeç janë në rrezik më të madh për vdekje dhe sëmundje, duke përfshirë gjakderdhje gjatë shtatzënisë, toksemi, hemorragji, lindje të zgjatur dhe të vështirë, anemi të rëndë dhe paaftësi.

Adoleshentja shtatzënë përfaqëson në fakt tre pacientë: nënën, foshnjën dhe vetë adoleshentin. Ata gjithashtu kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në familje ose shfrytëzim, madje edhe nga anëtarët e tjerë të asaj familjeje e jo vetëm nga burri.

## 5. Përfundim

Në ligjin për familje të Republikës së Kosovës, që është amendamentuar në vitin 2011, konstatohet që mosha adekuate për martesë është atëherë kur të dy individët janë të moshës madhore dhe kanë përgjegjësi e janë të aftë edhe për familje e fëmijë. Në po të njëjtin ligj thuhet se martesë nën moshën 18 vjeçare mund të ndodhë vetëm atëherë kur individët janë paraqitur tek zyra përkatëse e ofiçarisë dhe rasti ka kaluar edhe në gjykatë me ç'rast janë bërë dhe kanë përfunduar të gjitha obligimet e nevojshme si nga pajtimi i kujdestarëve të të dy të miturve, raporti i mjekut për pjekurinë fizike dhe psikike si dhe dëshira apo pajtimi i individëve në këtë martesë.

Të dhënat për martesë dhe lindje të foshnjave në mosha të hershme nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për vitin 2021/2022 si dhe disa statistika të marra personalisht nga komuna tregojnë një numër të madh shqetësues të këtyre rasteve. Është edhe më shqetësuese fakti që ka një numër konsiderueshëm të madh të martesave të të miturve e sidomos në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas por që as gjysma e këtyre martesave nuk janë të evidentuara nga organet përkatëse.

Shkaqet kryesore të këtyre martesave janë mospjekuria e moshës që rezulton në shtatëzanitë e hershme, mungesa e arsimimit, nevoja për largim nga shteti dhe kycja në shtete të huaja, nevojat e ndryshme familjare, gjendja e vështirë socio-ekonomike por edhe aspekte kulturore të grupeve të caktuar në shoqërinë tonë.

Si në shumicën e rasteve dhe fenomeneve të shoqërisë kosovare edhe këtu pasojat më të mëdha të këtij fenomeni rëndojnë mbi femrat pasi që vendimmarrja e tyre brenda komuniteteve të caktuara është tejet e kufizuar. Ndalimi i edukimit, shtatëzanitë e hershme dhe të padëshiruara, problemet në familje, dhuna në familje dhe ndarja nga shoqëria dhe aktivitete tjera janë disa nga pasojat me të cilat ballafaqohen të miturit që kanë lidhur martesë të ligjshme apo edhe jetojnë në bashkësi jashtëmartesore.

Rekomandohet një qasje e integruar e shoqërisë dhe e institucioneve shtetërore në paran-

dalimin e dukurisë së martesave të hershme. Institucionet shtetërore përkatëse duhet të jenë më të vëmendshëm në identifikimin e rasteve dhe analizimin e shkaqeve të paraqitjes së kësaj dukurie. Ndërsa, shoqëria civile duhet të angazhohet fuqishëm në vetëdijesimin e shoqërisë për efektet negative të kësaj dukurie duke u përqendruar te ato grupe shoqërore që janë më të rrezikuara nga kjo dukuri.

## Referencat:

1. [“Catechism of the Catholic Church – IntraText”](#). Marrë nga origjinali me 24 Qershor 2016. Qasur 7 Mars 2023.
2. Gjeçov, S. (2010). Kanuni i Lekë Dukagjinit. Botime Françeskane.[III]. <https://jusufzimeri.com/fejesa-dhe-martesa-te-shqiptaret-dhe-kanuni-i-lek-dukagjinit/>
3. Intervistë me zyrtarin e zyrës së ofiçarisë I.H dhe zyrtarit nga zyra e komuniteteve I.D në komunën e Shtimes. Intervista është bërë Mars 2023.
4. Kosova Raporti I vitit 2021 për të drejtat e njeriut në Kosovë ... [n.d.]. Qasur me 9 Mars 2023, <https://al.usembassy.gov/sq/our-relationship-sq/official-reports-sq/>
5. Kurorëzimet Jashtë Kosovës Sipas Grup-Moshës së burrit dhe Gruas nga Viti, grupmosha e Burrit dhe grupmosha E Gruas. PX Web. [n.d.]. Qasur më 9 Mars, 2023. <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-lindjeve-2020>
6. Ligji mbi Familjen, Nr. 06/L-077, Kuvendi i Republikës së Kosovës, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 2004/32. 17 JANAR 2019. <https://gzk.rksgov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735> Qasur më 07.03.2023.
7. Martesa. [n.d.]. Qasur 7 Mars, 2023, <https://www.njohligjin.al/familja/martesa/>
8. Marriage. Medieval Times Dinner & Tournament. [n.d.]. Qasur 9 Mars 2023, <https://www.medievaltimes.com/education/medieval-era/marriage>
9. Reid, K. (29 Dhjetor, 2022). Child marriage: Facts, and how to help end it. World Vision. Qasur 9 Mars, 2023, <https://www.worldvision.org/child-protection-news-stories/child-marriage-facts>
10. Rrapi, Gj. (2022), Martesa e shqiptarëve në Kosovë, Alphabet J&H. Faqe 153-172
11. Staff, T. W. (8 Janar, 2015). The origins of Marriage. The Week. Qasur më 9 Mars, 2023. <https://theweek.com/articles/528746/origins-marriage>
12. Strategjia Për Avancimin e të drejtave të komunitetet ROM, Ashkali dhe Egjiptian Prezantohet në pesë rajonet e Kosovës. Anti Discrimination. [7 Dhjetor 2022]. Qasur 9 Mars 2023, <https://raportodiskriminimin.org/news/134>

# Mallkimi i Resurseve

---

Nart Hyseni

---

## Abstrakt

Ky punim diskuton për fenomenin e mallkimit të burimeve natyrore, ku vendet me burime të pasura, si nafta dhe gazit, kanë tendencë të kenë një rritje më të ulët ekonomike, të kenë institucione demokratike më të dobëta si dhe nivele më të larta të korrupsionit dhe konflikteve në krahasim me vendet që nuk kanë apo kanë më pak burime të tilla. Faktorët që ndikojnë në mallkimin e burimeve janë varësia nga industritë nxjerrëse, moszhvillimi i sektorëve tjerë ekonomikë, përqendrimi i pasurisë dhe pushtetit në duart e disa individëve ose elitave, e cila e rrit pabarazinë dhe lulëzon korrupsionin.

Punimi diskuton edhe efektet e mallkimit të burimeve në vende të ndryshme, duke përmendur shembuj të efekteve në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim. Nigeria merret si një shembull i mallkimit të burimeve dhe keqpërdorimit të mundësive të mëdha të zhvillimit.

Në fund të tekstit përmendet se mallkimi i burimeve nuk është një fenomen i pandryshueshëm dhe se vendet mund të ndërmarrin hapa për të zbutur ndikimet e tij nëpërmjet përdorimit të diversifikimit ekonomik dhe një qeverisjeje më të mirë.

## Fjalë kyçe:

mallkimi i burimeve, burime natyrore, Nigeria, moszhvillimi ekonomik, korrupsioni vendet në zhvillim.

## 1. Hyrje

Mallkimi i burimeve, i njohur gjithashtu si paradoksi i bollëkut, i referohet fenomenit ku vendet të cilat janë të pasura me burime natyrore, siç është nafta, gazi apo edhe mineralet e ndryshme, kanë tendencë që të kenë një rritje më të ulët ekonomike, të kenë institucione demokratike më të dobëta si dhe nivele më të larta të korrupsionit e konflikteve në krahasim me vendet që nuk kanë apo kanë më pak burime të tilla.

Mallkimi i burimeve është një çështje mjaft komplekse në të cilën ndikojnë faktorë të ndryshëm. Faktori me ndikimin më të madh është varësia e ekonomisë nga industritë nxjerrëse, e cila pastaj shpesh ka për pasojë neglizhencën e zhvillimit të sektorëve të tjerë ekonomikë dhe mungesën e llojllojshmërisë ekonomike. Kjo varësi nga industritë nxjerrëse, përveç se ndikon në moszhvillimin e sektorëve tjerë ekonomik, e bën gjithashtu një shtet të prekshëm dhe ekonominë e tij shumë të ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve globale të mallrave, duke shkaktuar paqëndrueshmëri ekonomike të atij shteti. Përveç kësaj, përqendrimi në industritë nxjerrëse shpesh çon në një përqendrim të pasurisë dhe pushtetit në duart e disa individëve ose elitave, duke e rritur pabarazinë dhe duke e mundësuar lulëzimin e korrupsionit. Këto elita shfrytëzojnë burimet natyrore për përfitime personale duke mos investuar në zhvillimin e vendit, me një qeverisje pa transparencë e llogaridhënie duke minuar kështu sundimin e ligjit dhe institucionet demokratike.

Në shumë vende të botës, vende këto ku gjenden shumica e burimeve natyrore, mallkimi i burimeve ka pasur efekte shkatërruese, e sidomos në vendet në zhvillim, siç janë Nigeria, Venezuela dhe Republika Demokratike e Kongos.

## 2. Burimet natyrore afrikane bekim apo mallkim?

Në vitin 2015, Ross botoi një artikull në Rishikimin Vjetor të Shkencave Politike, që kërkonte të përmbledhonte gjendjen e njohurive mbi mallkimin e burimeve dhe efektet e tij. Artikulli arriti në përfundimin se efektet e mallkimit të burimeve ndryshojnë në varësi të llojit të burimit, kontekstit në të cilin gjendet vendi dhe nivelit të qeverisjes në një rajon të caktuar. Për shembull, vendet që mbështeten shumë në eksportet e naftës priren të përjetojnë një rritje më të ngadaltë ekonomike dhe një shkallë më të lartë të paqëndrueshmërisë politike në krahasim me vendet, që kanë një larmi më të madhe të produkteve që i eksportojnë. Për më tepër, artikulli zbuloi se mallkimi i burimeve është më i rëndë në vendet me struktura më të dobëta institucionale dhe qeverisëse, pasi këto vende janë më pak në gjendje të kapin përfitimet e burimeve të tyre, duke çuar në nivele më të larta korrupsioni dhe pabarazi më të madhe ekonomike. Së fundi, artikulli arriti në përfundimin se mallkimi i burimeve nuk është një fenomen i pandryshueshëm dhe se vendet mund të ndërmarrin hapa për të zbutur ndikimet e tij nëpërmjet përdorimit të diversifikimit ekonomik dhe një qeverisjeje më të mirë (Ross, 2015).

Pse burimet natyrore në disa vende afrikane nuk po i nxjerrin njerëzit nga varfëria? Afrika është e bekuar me shumë burime natyrore, për shembull Republika Demokratike e Kongos,

pritet të jetë lideri global në furnizimin me litium që përdoret në bateritë e telefonave celularë dhe makinave elektrike. Vendet e tjera kanë burime të bollshme minerale, ndaj pse ky kontinent nuk po përparon? Duke filluar nga ari në Afrikën Perëndimore deri te diamantet në Afrikën e Jugut, njerëzimi ka shfrytëzuar mineralet e çmuara të Afrikës për shekuj me radhë. Në ditët e sotme, përderisa lëndët e para po përfundojnë diku tjetër, shfrytëzimi i minierave afrikane po lulëzon. Afrika është shtëpia e disa prej prodhuesve më të mëdhenj të mineraleve në botë, Afrika e Jugut shquhet për platinin, Republika Demokratike e Kongos për kobaltin dhe koltan dhe Botsvana është numër dy në mbarë botën për diamantet. Por, me burime kaq të bollshme minerale, pse vendet afrikane nuk janë më të pasura, më të zhvilluara dhe pa popullsi të varfër? Janë disa arsye për këtë. Për shembull shumica e operacioneve minerare janë të huaja. Përveç Afrikës së Jugut, e cila ka industrinë e saj minerare, korrupsioni në shtetet tjera më të dobëta nënkupton që popullsia e vendit rrallë përfiton nga pasuritë e veta. Gjithashtu, të drejtat e njeriut nuk përfillen dhe nuk respektohen. Për më tepër, praktikatat miope të minierave e kanë lënë tokën të dëmtuar dhe ujin të helmuar. Përveç kësaj, mineralet rrallë rafinohen e përpunohen në vend, ato eksportohen të papërpunuara me një çmim më të ulët, kurse fitimet e mëdha bëhen diku tjetër. I ashtuquajturi mallkim i resurseve ka bërë që të ketë shumë konflikte duke e lënë popullsinë vendore që tani të luftojnë për mbetje (“Is Africa really a victim of the infamous resource curse”, 2022).

### 3 Burimet natyrore - Nigeria

Le të flasim për Nigerinë dhe naftën e saj. Nigeria është prodhuesi kryesor i naftës në Afrikë dhe nafta është burimi më i madh i të ardhurave të qeverisë. Por ekonomia ka qenë në vështirësi dhe nivelet e varfërisë janë në rritje. “Varfëria e atyre që jetojnë rreth burimit të pasurisë së Nigerisë është e paparë” (“Nigerian Oil and the Disappearing Money”, 2020). Ajo ka rezervat e dyta më të mëdha të provuara në kontinentin afrikan dhe është prodhuesi i 12-të më i madh në mbarë botën. E megjithatë shumë nigerianë e kanë një jetë shumë të vështirë. Sipas World Poverty Clock (2023), mbi 71 milionë njerëz jetojnë jo vetëm në varfëri, por në varfëri ekstreme. Kjo është 32% e popullsisë. Pavarësisht pasurisë së madhe të naftës së Nigerisë, gjysma e popullsisë së saj jeton me më pak se 2 dollarë në ditë. Tani, normalisht se një vend i pasur me burime natyrore, siç është Nigeria, mund të mbështetet në një pjesë të asaj pasurie të naftës. Puna është se qeveria nigeriane po e bën këtë, mirëpo kjo është pjesë e problemit sepse qeveria e Nigerisë varet nga nafta për 75% të të ardhurave të saj. Pra, kur çmimet globale të naftës u ulën shumë në vitin 2014, Nigeria hyri në recesion, nga i cili ende po përpiqet të dalë. Por edhe kur çmimet e naftës janë të mira, ekspertët nigerianë thonë se një pjesë e madhe e këtyre të ardhurave nuk i shkon popullsisë, por elitave të pasuruara duke u bazuar në fuqinë politike dhe korrupsion (Samuel, 2013).

Me shpalljen e pavarësisë më 1 tetor 1960, Nigeria ishte shteti më i ri i botës me resurse të mjaftueshme që në një kohë të shkurtër dhe me investimet e duhura do ta bënin shtetin më të pasur në Afrikë dhe një ndër më të pasurit në botë. Por rrethanat e Luftës së Ftohtë, që në pjesën e dytë të shekullit 20-të zhvillohej në mes SHBA-së dhe ish-BRSS-së, kanë ndikuar në vendosjen e juntave ushtarake të mbështetura nga SHBA ose ish-BRSS, të cilat e

pamundësonin zhvillimin ekonomik. Interesi e këtyre dy fuqive të mëdha ishte që ta mbanin nën kontroll qeverinë e Nigerisë dhe të merrnin burimet e saj natyrore me çmim të lirë dhe pastaj ta shisnin të njëjtin resurs me çmimin e tregut. Gjithashtu, zbulimi i naftës katër vjet para pavarësisë, ka bërë që interesimi i perëndimit të jetë edhe më i madh për të mbajtur nën influencën e vet Republikën e Nigerisë. Një ndër prodhuesit më të mëdhenj të naftës në Nigeri është kompania Shell e cila edhe sot ka ndikim të madh në politikat nigeriane dhe dikton qeverinë për politikat ambientaliste që janë në favor të kësaj kompanie. Vetëm një përqindje e vogël e fitimeve nga shitja e naftës i shkon shtetit të Nigerisë, por edhe ajo përqindje shkon përsëri në prodhim të naftës, në vend se të shkojë për arsim, shëndetësi, në zhvillimin e industrive të tjera apo të shkojë në një fond sovran që do të shërbente për zhvillim dhe për popullsinë, ashtu siç e ka Norvegjia dhe në vitet e fundit edhe Guyana.

Duke qenë që nafta përbën eksportin më të madh të Nigerisë, kjo ka shkaktuar rënie të prodhimit në industritë e tjera duke shkaktuar kështu varësi nga eksporti i naftës dhe varësinë e ekonomisë vetëm në naftë. Një gjë e tillë ka ndodhur në Venezuelë ku e tërë ekonomia është e varur prej çmimeve të naftës dhe gati çdo gjë prodhohet për eksport. Në anën tjetër kemi Norvegjinë e cila e ka shtetëzuar prodhimin e naftës dhe fitimin prej shitjes së naftës e vendos në Fondin Sovran, i cili fond është ndër më të mëdhenjtë në botë. Me këtë fond Norvegjia ka investuar në industri të tjera dhe nuk lejon përdorimin e këtij fondi për investime në prodhimin e naftës. Fondi sovran i Norvegjisë i ka përafërsisht rreth 1.3 trilion dollarë (Meredith, 2023) dhe nëse do të ndahej për kokë banori në Norvegji, atëherë secili prej tyre do t'i merrte nga rreth 250 mijë dollarë. Qeveria Norvegjeze, gjithashtu, ka vendosur një limit prej 2 milion barela në ditë që të mos lejojë që nafta të bëhet eksporti më i madh i Norvegjisë dhe të mos varet vetëm prej naftës. Një Nigeri e fortë është vështirë të bëhet, por nuk është e pamundur. Me një qeveri si duhet, që investon në drejtësi, arsim, shëndetësi dhe industri të tjera, t'u kërkojë kompanive të naftës përqindje më të lartë në fitimin e shitjes së naftës, mund të arrijë sukses të madh. Mirëpo, nëse Nigeria vazhdon në këtë rrugë atëherë kam frikë se do të përfundojë si Venezuela.

## 4. Përfundim

Në përgjithësi, mallkimi i burimeve është një çështje e mjaft komplekse e që kërkon një përgjigje po aq komplekse e gjithëpërfshirëse duke filluar nga koordinimi i politikë-bërësve, shoqërisë civile dhe sektorit privat. Kjo përgjigje duhet të përfshijë përmirësimin e qeverisjes, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe investimin në drejtësi, arsim dhe në zhvillimin e kapitalit njerëzor. Vetëm duke trajtuar rrënjën e problemit, shtetet mund t'i kthejnë burimet e tyre natyrore në një bekim dhe jo në një mallkim duke promovuar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përparimin e shoqërisë në përgjithësi.

Pra, resurset natyrore të një vendi nuk do të duhej të ishin një mallkim, por mënyra se si i përdorim ato për përfituesit tanë ekonomik është ajo që ka rëndësi si dhe se sa i fortë është legjislacioni që koordinon nxjerrjen, përpunimin dhe shitjen e resurseve.

## Referencat:

1. Al Jazeera. [2020]. Nigerian Oil and the Disappearing Money. AlJazeeraEnglish. <https://www.youtube.com/watch?v=SngLPSCWads&t=131s>
2. DW the 77 percent. [2022]. Is Africa really a victim of the infamous resource curse?. Deutsche Welle. [https://www.youtube.com/watch?v=9ZoyzSe\\_gcg&t=1264s](https://www.youtube.com/watch?v=9ZoyzSe_gcg&t=1264s)
3. Meredith, S. [2023]. Norway's gigantic sovereign wealth fund loses a record \$164 billion, citing 'very unusual' year. Europe Economy. CNBC. <https://www.cnn.com/2023/01/31/norways-sovereign-wealth-fund-loses-164-billion-in-2022.html#:~:text=The%20%241.3%20trillion%20fund%20was,bedrock%20of%20the%20fund's%20wealth.>
4. Ross, M. [2015]. What have we learned about the resource curse? Annual Review of Political Science. Vol. 18:239-259. <https://doi.org/10.1146/annurev-polisci-052213-040359>
5. Samuel, J. [2013]. In Nigeria, oil divides the rich and poor. The World Economics. <https://theworld.org/stories/2013-02-18/nigeria-oil-divides-rich-and-poor>
6. World Poverty Clock. [2023]. Nigeria. World Data Lab. <https://worldpoverty.io/map>





# Ngjyra të njëjta – flamuj të ndryshëm – Belgjika dhe Gjermania

---

Shpresa Tafaj

---

## Abstrakti

Politikat krahasuese, si nënfushë e shkencave politike, përcaktohet nga aplikimi i metodave krahasuese, të cilat shërbejnë për të përvijuar rastet dhe situatat dhe për të theksuar të përbashkëtat dhe dallimet mes sistemeve të ndryshme politike, duke përfshirë metodat historike, narrative dhe sasiore, si dhe duke analizuar kushtet dhe rrethanat, të cilat ndikojnë në gjendjen politike, ekonomike, sociale e kulturore të shteteve.

Rrjedha e studimeve të politikave krahasuese fokusohet në kërkimin e përgjigjeve analitike të një game të gjerë çështjesh, si p.sh., përse disa vende janë demokratike ndërsa të tjerat jo, çfarë rëndësie kanë kushtetutat, përse disa vende janë në konflikt të vazhdueshëm, përse ndryshojnë institucionet ekonomike dhe politikëbërja në vende të ndryshme, etj.

Ky punim paraqet një analizë krahasuese politike me një përshkrim të shkurtër të sistemeve politike të dy shteteve fqinje të Bashkësisë Evropiane, Belgjikës dhe Gjermanisë, duke tërhequr në vazhdimësi paralele mes tyre, për të vënë në dukje ngjashmëritë dhe dallimet në sistemet politike, sistemet zgjedhore, politikat ekonomike, sociale, etj.

## Fjalët kyçe:

Belgjika, Gjermania, sistemi politik, politika ekonomike, federalizmi

## 1. Hyrje

Të përbashkëtat dhe dallimet mes Belgjikës dhe Gjermanisë kanë qenë dhe janë vazhdimisht në fokusin e interesimit tim, jo vetëm profesional. Duke qenë se jeta ime private, politike, sociale e profesionale zhvillohet në një trekëndësh mes këtyre dy shteteve dhe Kosovës, zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore në të tri vendet kanë efekt të rëndësishëm në të jetuarit tim dhe të familjes sime, garantimin e lirive dhe të drejtave, respektimin e vlerave individuale e shoqërore, sigurimin e ekzistencës dhe cilësisë jetësore, etj. Prandaj me përkushtim të veçantë kam bërë këtë punim hulumtues, në të cilin jam përpjekur të përmbledh shkurtimisht në disa faqe, karakteristikat e veçoritë dhe të përmend dallimet dhe ngjashmëritë më të rëndësishme mes Belgjikës, vendit, i cili më strehoi në kohë të luftës dhe më ndihmoi të rinis jetën private e profesionale thua nga fillimi, dhe Gjermanisë, vendit në të cilin vazhdova integrimin, jetoj dhe veproj, e të cilit i paguaj taksa. Sistemet politike të të dy vendeve kanë përcjellur në vazhdimësi integrimin tim politik e social në këto vende, prandaj, përveç hulumtimeve shkencore, në këtë punim mund të shfaqen edhe informata të bazuara në përvojën time personale.

Punimin do ta filloj me një pasqyrë të shkurtër të raporteve politike e sociale mes dy shteteve, për të vazhduar me historikun e shtetformimit, sistemet politike të të dy vendeve dhe zhvillimin e tyre ekonomik, gjithnjë duke paraqitur në mënyrë paralele ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. Me tri ngjyra të njëjta, por të paraqitura në formë dhe renditje të ndryshme në simbolin kryesor të shtetit – flamurin, fillojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes Belgjikës dhe Gjermanisë. Ngjyrat zi, verdh, kuq; si dhe zi, kuq, e artë (një dallim i së verdhës më shumë në shprehje sesa në dukje) paraqesin një ngjashmëri aq të madhe, saqë, në një konferencë ndërkombëtare, vetë kancelari i dikurshëm gjerman, Gerhard Schröder kishte gabuar derën dhe kishte hyrë pa trokitur në zyrën e përfaqësuesit të Belgjikës, duke menduar se po hynte në zyrën e tij.



*Fig. 1: Flamuri Belg dhe ai Gjerman*

## 1. Pasqyra e përgjithshme

	<b>Belgjika</b>	<b>Gjermania</b>
Emërtimi zyrtar:	Mbretëria e Belgjikës	Republika Federale e Gjermanisë
Forma e qeverisjes:	Demokraci parlamentare federale (nën monarkinë kushtetuese)	Republikë parlamentare federale
Sipërfaqja	30.530 km <sup>2</sup>	357.580 km <sup>2</sup>
Banorë:	11.593.000	83.196.000
Banorë/km <sup>2</sup> :	379,7	232,7
Kryeqyteti:	Brukseli	Berlini
gjuhë zyrtare:	holandisht, frëngjisht, gjermanisht	gjermanisht
Festa kombëtare:	21 korriku (1830)	03 tetori (1990)
Rajoni:	Evropa Perëndimore	Evropa Perëndimore
Vend anëtar i BE-së	që nga 1 janari 1958	që nga 1 janari 1958
Anëtar i zonës Shengen	që nga 26 marsi 1995	që nga 26 marsi 1995
Anëtar i NATO-s	që nga 4 prilli 1949	që nga 6 maji 1955

***Tabela 1. Pasqyra e përgjithshme e dy shteteve Belgjikë dhe Gjermani***

Në pasqyrën e mësipërme janë paraqitur informatat themelore të shtetit belg dhe atij gjerman, në të cilën, që në shikim të parë, vërehen ngjashmëritë se të dy shtetet i takojnë një rajoni, pra Evropës Perëndimore, se janë vende anëtare të Bashkimit Evropian që nga themelimi i saj më 1958 dhe anëtare të zonës Shengen, po ashtu që nga themelimi në vitin 1995.

Dallimet vërehen në sipërfaqe, Gjermania është rreth 12 herë më e madhe sesa Belgjika dhe kushtimisht edhe numri i banorëve është më i madh në Gjermani, megjithëse dendësia me 379,7 banorë/km<sup>2</sup> është më e lartë në Belgjikë. Gjermania ka vetëm një gjuhë zyrtare, gjermanishten, ndërsa Belgjika, për shkak të përbërjes etnike, e ku dominojnë flamanët dhe valonët, ka gjuhët përkatëse të këtyre dy etnive, holandishten dhe frëngjishten si gjuhë zyrtare, si dhe, për shkak të rreth 80,000 banorëve të komunitetit gjermanishtfolës të Belgjikës në “Ostbelgien”, gjermanishtja është gjuhë e tretë zyrtare e Mbretërisë Belge (Brüll, 2019).

Megjithëse Belgjika është shtet relativisht i ri, është shpallur shtet 160 vjet më herët se Gjermania. Kjo për shkak të rrethanave historike e politike nëpër të cilat ka kaluar populli gjerman. Në realitet, Gjermania si vend dhe si komb daton shumë më herët, por si një entitet shtetëror unik na paraqitet diku në fund të shekullit 19. Nga shekulli i 10-të deri në vitin 1806, Gjermania ishte pjesë e Perandorisë së Shenjtë Romake të Kombeve Gjermane. Emri “kombi gjerman” u përdor për herë të parë në fund të shekullit të 15-të. Në vitin 1871 u formua shteti i bashkuar gjerman, përkatësisht u krijua Perandoria Gjermane, apo Rajhu Gjerman. Për shkak të rolit të Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore e sidomos në Luftën e Dytë Botërore, Gjermania u nda në dy shtete. Kështu pas Luftës së Dytë Botërore, më 23 maj 1949 u shpall Republika Federale e Gjermanisë (e njohur si Gjermania Perëndimore)

dhe më 7 tetor 1949 Republika Demokratike e Gjermanisë (e njohur si Gjermania Lindore). Data që aktualisht figuron si datë e pavarësisë është data kur Gjermania Perëndimore dhe ajo Lindorja u bashkuan në një shtet për të formuar Republikën Federale Gjermane që është sot (European Union, Germany, p.d.).

Sot Gjermania është një lider evropian dhe global, me një politikë të qëndrueshme demokratike, një ekonomi të fortë (një ekonomi shumë e avancuar që ka arritur të ruajë fuqinë në eksportin e mallrave të prodhuara), dhe i është kthyer ndikimit ndërkombëtar (Dickovick & Eastwood, 2016, f.443).

Vlen të përmendet edhe një dallim, i cili gjithashtu ka të bëjë me rrethanat historike të Gjermanisë dhe të kaluarën e saj naziste në Luftën e Dytë Botërore – Belgjika është ndër shtetet themeluese të Paktit Veriatlantik NATO, në kryeqytetin e së cilës edhe gjendet selia e tij, ndërsa Gjermania është pranuar si anëtare 6 vjet më vonë.

Dhe për fund, por sigurisht jo e fundit për nga rëndësia, madje e kundërta, është forma e qeverisjes që kanë dy shtetet në fjalë. Të dyja kanë të përbashkët federalizmin në sistemin e tyre politik, por me ndryshime të mëdha për faktin se Gjermania është republikë parlamentare, ndërsa Belgjika monarki kushtetuese.

## 2. Sistemet politike

Tipari dallues i sistemeve politike të Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Federale të Gjermanisë është federalizmi. Krahas Austrisë, janë të vetmet shtete federale në Bashkimin Evropian. Shtetet moderne federale bazohen në parimin e ndarjes së pushteteve, që nënkupton ndërthurjen e niveleve në formën e një kufizimi reciprok të pushtetit të qeverisë federale dhe shteteve anëtare (Weinmann, 2005).

Belgjika përshkruhet më së miri nga fakti se identitetet nënkombëtare janë njohur, se u është dhënë autonomi relativisht e gjerë dhe se fundi i këtij zgjerimi të kompetencave nuk duket se është arritur ende. Në Gjermani, nga ana tjetër, përpjekjet drejt diversitetit drejtohen më shumë nga riorganizimi i shpërndarjes së pushtetit shtetëror, që është bërë i nevojshëm si rezultat i ndryshimeve të jashtme (Weinmann, 2005).



**Fig. 2: Ndarja e Belgjikës në rajone dhe e Gjermanisë në lande**

Belgjika është një monarki kushtetuese me një sistem parlamentar të qeverisjes. Në krye të shtetit është mbreti. Në nivel federal, pushteti legjislativ ushtrohet bashkërisht nga Mbreti, Dhoma e Deputetëve (150 anëtarë) dhe Senati (71 anëtarë). Pushteti ekzekutiv është në duart e mbretit dhe ministrave. Mbreti mund të shpërndajë parlamentin federal. Parlamenti mund të detyrojë qeverinë federale të japë dorëheqje, nëse Dhoma e Deputetëve miraton një mocion mosbesimi dhe i propozon mbretit një kryeministër të ri (“Belgien: Politisches System”p.d.).

Në reformën kushtetuese të vitit 1993 u prezantua një ndarje e gjerë e shtetit belg në tri pjesë, për të zgjidhur përfundimisht konfliktet e gjata kulturore midis valonëve frëngjishtfolës në jug dhe flamanëve holandishtfolës në veri. Brukselin, si tokë flamane me banorë shumicë valonë e kanë lënë si rajon të përbashkët, në të cilin, të dy gjuhët janë zyrtare. Që atëherë, vendi është një shtet federal i përbërë nga tri rajone: Brukseli, Flandra dhe Valonia. Analog me këtë, ekziston një ndarje e trefishtë në “komunitete gjuhësore” (komunitete holandisht - , frëngjisht - dhe gjermanisht - folës). Konfederata, rajonet dhe komunitetet kanë parlamente të veçanta me kompetenca të ndryshme (“Belgien: Politisches System”p.d.).


Qeveria federale është kryesisht përgjegjëse për politikën gjyqësore, sociale, të jashtme dhe të mbrojtjes. Planifikimi rajonal, arsimit, marrëdhëniet me publikun, bujqësia, politika e strehimit, uji, energjia, ekonomia, punësimi, transporti dhe mbrojtja e mjedisit janë përgjegjësi e qeverive rajonale. Ato janë gjithashtu përgjegjëse për marrëdhëniet e jashtme, përfshirë edhe politikën e Këshillit të Ministrave të BE-së. Duke qenë se Belgjika mund të flasë vetëm me një zë përballë BE-së, institucionet përkatëse belge duhet të bien dakord për një qëndrim të përbashkët. Nëse kjo nuk është e mundur, Belgjika duhet të abstenojë nga votimi. Komunitetet janë përgjegjëse për arsimin, çështjet personale sociale, gjuhën dhe kulturën (“Belgien: Politisches System”p.d.).

Republika Federale e Gjermanisë është po ashtu shtet federal por i organizuar si një demokraci parlamentare. Kushtetuta parasheh që i gjithë pushteti shtetëror të burojë nga populli. Populli e transferon këtë pushtet në parlamentet (Bundestag dhe Landtag) për kohëzgjatjen e një periudhe elektorale. Pushteti shtetëror është i ndarë ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Sipas protokollit, Presidenti Federal është përfaqësuesi më i lartë në Gjermani, derisa kryetari i Bundestagut ka vendin e dytë. Presidenti Federal zëvendësohet nga Presidenti i Bundesratit - një zyrë që mbahet nga një kryeministër i 16 shteteve federale (lande) në baza vjetore. Zyra me fuqinë më të madhe politike dhe ekzekutive është ajo e Kancelarit Federal. Një nga përfaqësuesit e lartë është edhe Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Federale.

Federalizmi në Gjermani është më shumë se një sistem shtetëror. Ai pasqyron strukturën e decentralizuar kulturore dhe ekonomike të vendit dhe është i rrënjësor thellë në traditë. Përtej funksionit të tyre politik, landet janë gjithashtu reflektim i identiteteve të dallueshme rajonale. Pozicioni i fortë i landeve u përcaktua në Kushtetutën e vitit 1949. Me ribashkimin në vitin 1990, u themeluan pesë shtete të reja: Brandenburg, Mecklenburg-Pomerania Perëndimore, Saksonia, Saksonia-Anhalt dhe Turingia. Një karakteristikë e veçantë janë tri qytete-shtetet. Territori i tyre është i kufizuar në qytetet kryesore të Berlinit, Bremen/Bremerhavenit dhe Hamburgut. Shteti më i vogël është Bremeni me 420 kilometra katrorë dhe 683.000 banorë. Baden-Wyrtemberg është një nga rajonet më të forta ekonomike në Ev-

ropë. Pas Luftës së Dytë Botërore, Sarlandi ishte një shtet pjesërisht sovran nën protektoratin e Francës dhe u përfshi në Republikën Federale të Gjermanisë më 1 janar 1957 si landi i dhjetë (Fazit Communication GmbH, 2022)

Ekziston edhe një çështje lidhur me kulturën politike dhe përshtatjen e Gjermanisë me botën e pasluftës. Ai është roli i Gjermanisë si shtytësi kryesor në bashkimin evropian. Pjesa më e madhe e inovacionit politik të periudhës pas vitit 1945 në Evropë ka ardhur me krijimin e institucioneve të reja superkombëtare në nivel evropian (Dickovick & Eastwood, 2016, f. **Sistemi zgjedhor**




**Fig. 3: Sistemi politik në Belgjikë (a) dhe Gjermani (b)**

Sistemi zgjedhor në të dy vendet siguron përfaqësim proporcional. Ky parim bazohet në idenë që të gjitha grupet shoqërore të përfaqësohen në parlament sipas përqindjes së tyre të votave dhe për rrjedhojë të pasqyrojnë shoqërinë. Kjo do të thotë se zgjedhjet janë demokratike, ku secila votë ka rëndësi. Si rezultat, partitë janë të detyruara të formojnë koalicione qeverisëse, sepse nuk arrijnë të marrin më shumë se 50% të votave.

Veçanti e sistemit zgjedhor gjerman është kombinimi i zgjedhjeve të zonave zgjedhore dhe zgjedhjeve në listë. Votuesit kanë dy vota, një për një kandidat të drejtpërdrejtë në njësinë zgjedhore dhe një për listën shtetërore të një partie. Vota e dytë është vendimtare për përfaqësimin e partisë në mandatet e Bundestagut. Aktualisht (që nga viti 2021) në Gjermani qeveris koalicioni SPD, FDP dhe të Gjelbërit (die Grünen).

Pas zgjedhjeve të fundit në Belgjikë (në vitin 2019) u krijua një precedent: partitë nuk kanë arritur të formojnë qeverinë për rrafsh 493 ditë. Pas 493 ditësh, shtatë parti kanë rënë dakord për një koalicion të ri qeverisëse, të ashtuquajturin koalicioni social-liberal Vivaldi - bazuar në kompozimin “Katër stinët”.



**Fig. 4: Parlamentet federale gjermane dhe belge me numrin e ulëseve, legjislacionet aktuale**

Një veçori në sistemin zgjedhor belge është se pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje është obligative. Për mospjesëmarrje, qytetarët mund të saksionohen me gjobë prej 100 deri 250 € herën e parë, e nëse mospjesëmarrja përsëritet, dënimi mund të arrijë në 500 deri 1000 €. Mospjesëmarrja në zgjedhje mund të arsyetohet me dokument të mjekut ose të ngjashme.

### 3. Politika ekonomike

Belgjika dhe Gjermania janë vende me ekonomi të zhvilluar dhe me kosto solide të jetesës: Gjermania 100%, ndërsa Belgjika 105,07%. Shkalla e papunësisë në Belgjikë është gati dyfish më e lartë se në Gjermani, ndërsa norma e inflacionit për 1,3% më e ulët.

Sektorët kryesorë ekonomikë në Belgjikë në vitin 2020 ishin administrata publike, mbrojtja, arsimi, shëndetësia dhe puna sociale (22%), tregtia me shumicë dhe pakicë, transporti, akomodimi dhe hoteleria (17.7%) dhe industria (16.4%).

65% e eksporteve të Belgjikës shkojnë në vendet e BE-së (Gjermani 17%, Francë 14% dhe Holandë 12%); ndër vendet jo anëtare të BE-së, MB (8% e eksporteve) dhe SHBA (7%) janë partnerët kryesorë tregtarë. 62% e importeve vijnë nga shtetet anëtare të BE-së (Holanda 17%, Gjermania 14% dhe Franca 10%). Nga jashtë BE-së, 7% e importeve vijnë nga SHBA dhe 5% nga Kina (Bashkimi Europian, profili i vendit (Europa.eu))


Ndërsa në Gjermani, sektorët më të rëndësishëm ekonomikë në vitin 2020 ishin industria (23.4%), administrata publike, mbrojtja, arsimi, shëndetësia dhe shërbimet sociale (19.4%) dhe tregtia me shumicë dhe pakicë, transporti, akomodimi dhe hoteleria (15.8%).

53% e eksporteve të Gjermanisë shkojnë në vendet e BE-së (Francë 8% dhe Holandë 7%); ndër vendet jashtë BE-së, SHBA (9% e eksporteve) dhe Kina (8%) janë partnerët më të rëndësishëm tregtarë. 64% e importeve të Gjermanisë vijnë nga vendet anëtare të BE-së (Holanda 14%, Franca, Polonia dhe Belgjika nga 6% secila), 8% vijnë nga Kina dhe 5% nga SHBA (po aty).

	<b>Belgjika</b>	<b>Gjermania</b>
Njësia monetare	Euro	Euro
Shkalla e papunësisë:	6,4 %	3,5 %
Norma e inflacionit:	2,44 %	3,14 %
Kosto e jetesës: (Gjermania = 100%)	105,07 %	100,00 %
Taksat tregtare + detyrimet:	55,40 %	48,80 %
të ardhura mesatare:	42.707 €	43.155 €
Indeksi i korrupsionit:	27 (mirë)	20 (mirë)

**Tabela. 2 – Cilësia jetësore në të dy vendet**

Të ardhurat mesatare kanë një dallim për 1000 € në vit në favor të gjermanëve, derisa belgët janë të detyruar të paguajnë 7,4% më shumë taksa tregtare dhe detyrime sesa fqinjët e tyre gjermanë. Në llogaritjen e standardit të jetesës, në të cilin çmimi i mallrave dhe shërbimeve të caktuara në secilin vend matet në raport me të ardhurat në atë vend, bazuar në Standardin e Fuqisë Blerëse, Belgjika dhe Gjermania paraqiten në pozitë më të volitshme sesa anëtarët tjerë të BE-së. Vlen të theksohet se Gjermania është ekonomia e pestë më e madhe në botë (në bazë të fuqisë blerëse), duke u renditur pas Shteteve të Bashkuara, Kinës, Japonisë dhe Indisë (Dickovick & Eastwood, 2016, f.448).



**Fig. 5: Produkti i Brendshëm Bruto për kokë banori sipas Standardeve të Fuqisë Blerëse**

	Belgjikë: gjithsej	për 1000 banorë	Gjermani: gjithsej	për 1000 banorë
Prodhimi i Brendshëm Bruto:	507.211 Mio €	43,75 Mio €	3.570.742 Mio €	42,92 Mio €
Produkti kombëtar bruto:	494.856 Mio €	42,69 Mio €	3.587.435 Mio €	43,12 Mio €
Mallrat e eksportuara:	435.973 Mio €	37,61 Mio €	1.694.208 Mio €	20,36 Mio €
Mallrat e importuara:	430.387 Mio €	37,12 Mio €	1.500.942 Mio €	18,04 Mio €
borxhi bruto:	548.703 Mio €	47,33 Mio €	2.314.330 Mio €	27,82 Mio €
Deficiti buxhetor:	27.966 Mio €	2,41 Mio €	145.246 Mio €	1,75 Mio €

**Tabela 3. Pasqyra e politikës ekonomike në të dy vendet**



## 4. Përfundim

Belgjika dhe Gjermania ndajnë interesa thelbësore të përbashkëta dhe punojnë ngushtë dhe mirë së bashku. Si shtetet themeluese të BE-së, të dyja kanë dekada angazhimi për ndërtimin dhe thellimin e BE-së, si dhe qëndrime të përbashkëta në lidhje me kursin e saj të ardhshëm dhe tejkalimin e sfidave aktuale. Belgjika gjithashtu ka interesa të përbashkëta për sigurinë me BE-në. Ekziston një koordinim i ngushtë midis Belgjikës dhe Gjermanisë për çështjet e politikës së jashtme dhe ekonomike, duke përfshirë Këshillin e Bashkimit Evropian.

Gjermania është partneri më i rëndësishëm për ekonominë e eksporteve belge. Nga ana tjetër, Belgjika është partneri i nëntë më i madh tregtar i Gjermanisë. Vëllimi tregtar gjermano-belg ishte 101.9 miliardë Euro në vitin 2021, bilanci tregtar është paksa negativ për palën gjermane (Zyra Federale e Statistikave Destatis, 2021). Antverpi është një port i rëndësishëm importi dhe eksporti për Gjermaninë, veçanërisht për Nordrhein-Westfalen. Prioritetet e investimeve gjermane në Belgjikë janë industria kimike në Antverp, ndërtimi i automjeteve në Bruksel, aviacioni dhe gjithnjë e më shumë industria farmaceutike dhe bioteknike. Ekonomia gjermane përfaqësohet nga një numër i madh i degëve të kompanive në Belgjikë.

Si dy shtete demokratike me ekonomi të zhvilluar, shtete të mirëqenies, anëtare në organizatat më të rëndësishme politike, ekonomike e ushtarake në Evropë dhe në botë, shtete ligjore e mbrojtëse të të drejtave njerëzore, Belgjika dhe Gjermania bëjnë pjesë në vendet mikëpritëse për punëtorë nga vendet e pazhvilluara dhe për refugjatë nga vatrat e krizës. Me sistemet e tyre sociale u mundësojnë qytetarëve të tyre jetë cilësore, qasje të barabartë në shërbimet administrative, arsimore, shëndetësore, etj. dhe u garantojnë lirinë e shprehjes, të besimit/mosbesimit, mbrojtje nga diskriminimi në baza gjinore, racore, moshore, të orientimit seksual, etj.

Megjithëse të dy vendet kanë sistem federal, dallimi qëndron në faktin se Belgjika ka federalizëm etnik ndërsa Gjermania atë rajonal dhe se të dy shtetet po shkojnë drejt skajeve të kundërta të së njëjtës: Belgjika drejt federalizmit centrifugal ndërsa Gjermania drejt një shteti unitar të decentralizuar.

## Referencat:

1. Bashkimi Evropian [2023]. Profili i vendeve anëtare, Belgjika . [https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/country-profiles/belgium\\_de](https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/country-profiles/belgium_de)
2. Bashkimi Evropian [2023]. Profili i vendeve anëtare, Gjermania. [https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/country-profiles/belgium\\_de](https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/country-profiles/belgium_de)
3. Bundesregierung [2023] [Qeveria gjermane]. <https://www.bundesregierung.de/breg-de>
4. Bundeswahlleiter [2021]. Bundestagswahlen [Zgjedhjet vendore]. <https://www.bundeswahlleiter.de/bundestagswahlen/2021/informationen-waehler/wahlsystem.html#ee103913-a2a7-4b06-b279-cc3f5051a0d4>
5. Dickovick, J.T. & Eastwood, J. [2016]. Comparative politics - integrating theories, methods, and cases [Oxford University Press] [Politika krahasuese - integrimi i teorive, metodave dhe rasteve]
6. Fazit Communication [2023]. Tatsachen über Deutschland [Fakte për Gjermaninë] [https://interactive.deutschland.de/epapertued/epaper-2023\\_Tatsachen\\_DE/tatsachen-2023-deu.html#68](https://interactive.deutschland.de/epapertued/epaper-2023_Tatsachen_DE/tatsachen-2023-deu.html#68)
7. Länderdaten. Ländervergleich Belgien – Deutschland [Krahasimi i shteteve Belgjikë – Gjermani] <https://www.laenderdaten.info/laendervergleich.php?country1=BEL&country2=DEU>
8. Ostry, H., Morwinsky, O., & Schramm, L. [2017]. Der belgische Föderalismus – ein Modell mit Zukunft? [Konrad-Adenauer-Stiftung e.V. EUROPABÜRO BRÜSSEL [Federalizmi belg – një model me të ardhme?] [www.kas.de/bruessel](http://www.kas.de/bruessel)
9. Weinmann, A. [2005]. Das institutionelle Zusammenwirken zwischen der regionalen Ebene und dem Rat der EU - Deutschland und Belgien im Vergleich [München, GRIN Verlag.] [Ndërveprimi institucional ndërmjet nivelit rajonal dhe Këshillit të BE-së - Gjermania dhe Belgjika në krahasim] <https://www.grin.com/document/53124>
10. <https://www.goruma.de/laender/europa/belgien/politisches-system>
11. Von Dr. Christoph Brüll, Universität Luxemburg.[2019]. Belgien und Deutschland - eine kleine Beziehungsgeschichte - BelgienNet - Das Informationsportal über Belgien [Belgjika dhe Gjermania - një histori e shkurtër marrëdhëniesh - BelgiumNet - Portali informativ për Belgjikën] <https://belgien.net/belgienunddeutschland-2/>

# Të drejtat e punëtorëve në sektorin privat në Republikën e Kosovës

---

Samire Dema

---

## Abstrakt

Në këtë punim do të trajtohet e drejta e punës dhe disa kategorive të caktuara, dhe atë si: rregullimi i të drejtave të punëtorëve sipas kornizës ligjore të Kosovës dhe asaj ndërkombëtare. Në lidhje me këtë Kosova ka dispozita të mjaftueshme ligjore duke u nisur nga kushtetuta, ligji aktet tjera nënligjore e të gjitha të harmonizuara me aktet ndërkombëtare e sidomos të BE-së.

Mes tjerash trajtohet edhe e drejta në punë për gratë dhe personat me aftësi të kufizuar. Përkitazi me këto dy kategori të të punësuarëve sa i përket punësimin të gruas edhe këtu kemi rregullativë ligjore në kuadër të ligjit të punës i cili rregullon marrëdhënien e punës tek gratë duke u bazuar edhe në akte tjera ndërkombëtare si krijimin e kushteve të punës, të drejtat dhe detyrimet, si dhe çështje tjera te veçanta për të cilat gratë i gëzojnë si përparësi për shkak të natyrës së tyre. Megjithatë, përkundër mekanizmave ligjore natyrisht se këto akte juridike mbi të drejtat nuk respektohen mjaftueshëm e sidomos nga sektori privat.

Sa i përket personave me aftësi të kufizuar ndonëse edhe kjo kategori gëzon mbrojtje ligjore por të pamjaftueshme dhe si e tillë gjenë fare pak zbatim. Kjo pasi për aftësitë e tyre që i kanë dhe bazuar në trajtimin që u bëhet të punësuarve rëndom, logjikisht vie edhe në konkludimin se punëdhënësit nuk ofrojnë vend pune e as kushte pune ngase nga ta nuk mund të kërkohet përmbushje e detyrave të punës siç kërkohet tek të punësuarit e zakonshëm. Nga kjo vijmë në përfundim se pavarësisht ndalimit të diskriminimit, fatkeqësisht këto kategori ende diskriminohen.

## Fjalët kyçe:

E drejta e punës, gratë, personat me aftësi të kufizuar, sektori privat, ligji i punës

## 1. Hyrje

Në këtë ese do të flitet për problemet e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat sepse përqindja më e madhe e qytetarëve të Kosovës janë të punësuar pikërisht në këtë sektor.

Këtu janë, cekur disa nga kategoritë më të prekura dhe më të brishta të shoqërisë sonë. Çështja e të drejtave në sektorin privat është një sfidë edhe për shtetin sepse mosrespektimi i të drejtave të punëtorëve mund të jetë një ndër arsyet përse të rinjtë po e lëshojnë vendin në masë të madhe. Andaj pyetja kryesore hulumtuese e këtij punimi të cilit do të përpiqemi t'i përgjigjemi është se a respektohen në Kosovë të drejtat e punëtorëve në sektorin privat? E drejta e punës është e drejtë themelore e çdo njeriu e në Kosovë është e rregulluar edhe me Kushtetutën e sajë. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës është e garantuar e drejta e punës dhe profesionit, njëkohësisht është e ndaluar detyrimi në punë. Po ashtu të drejtat e punëtorëve rregullohen edhe me ligjin e punës, kontratën kolektive, me aktin e brendshëm të punëdhënësit dhe me vet kontratën e punës që lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit. Në këtë punim përveç metodës deskriptive dhe analizës që u kemi bërë ligjeve vendore dhe ndërkombëtare por edhe raporteve të ndryshme kemi përdorur edhe metodën e hulumtimit cilësor sepse për t'iu përgjigjur pyetjes themelore të këtij punimi kemi realizuar edhe një sërë intervistash.

## 2. Rregullimi i të drejtave të punëtorëve sipas kornizës ligjore të Kosovës dhe asaj ndërkombëtare

Në Kosovë, Ligji i Punës (2010), i cili mbështetet edhe në- nenet 49 dhe 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2018/2020), por edhe në legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të ekonomisë së hapur dhe të tregut të punës, e ka për qëllim krijimin e një baze ligjore funksionale, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për marrëdhënien e punës. Në planin ndërkombëtar Organizata Ndërkombëtare e Punës, si agjenci e OKB-së përmes aktiviteteve dhe konventave të shumta ka promovuar punën e denjë si dhe lirinë, barazinë, sigurinë dhe dinjitetin njerëzor për burra dhe gra, gjithashtu është organi ndërkombëtar përgjegjës për miratimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të punës, e cila kërkon që të sugjerojë që standardet e punës janë respektuar qoftë në planin ligjor, qoftë në atë praktik.

Përpos kornizës ligjore sa i përket sa i përket sektorit privat, kur flasim për sigurinë dhe për kushtet të cilat i ofrohen punëtorit nga punëdhënësi fatkeqësisht gjendja në terren është jo e kënaqshme. E marrim shembull sektorin e ndërtimitarisë ku çdo vit kemi më së paku 4 apo 5 persona të cilët vdesin në vendin e punës edhe pse me ligj është e rregulluar që punëdhënësi e ka për obligim ligjor që punëtorit t'i ofroj kushtet adekuate të punës dhe siguri në vendin e punës, mirëpo në praktikë shohim vështirësi në zbatimin e këtyre normave ligjore. Numri i vdekjeve këto viteve fundit është në vitin 2018 janë 23 punëtor, më 2020 janë 11 punëtor të vdekur, në vitin 2021 janë 14, në vitin 2022 janë 15 dhe në këta muajt e pare 2 janë të konfirmuar nga inspektorati por Sindikata e Sektorit Privat thekson se janë

6(“Alarmante vdekjet në vendin e punës”, 2018, “Vdekjet e vazhdueshme të punëtorëve në vendin e punës dhe neglizhenca institucionale” 2022, “Rriten rastet e vdekjeve dhe lëndimeve në vendin e punës”, 2023). Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Drejtoria për Hulumtime Parlamentare, Arkiv dhe Bibliotekë në Kuvendin e Kosovës në vitin 2018 kanë organizuar tryezën vjetore “Sfidat e punëtorëve dhe roli i inspektoratit të punës”. Sipas këtij instituti del që nga sektorët që kanë pasur më së shumti punëtorë të vdekur ka qenë ndërtimtaria, ku sfiduese mbetet mungesa e inspektorëve, andaj rekomandimi i tyre është rritja e numërit të tyre (“Alarmante vdekjet në vendin e punës”, 2018).

Mandej ka edhe probleme të tjera me të cilat ballafaqohet punëtori si p.sh. kur punëdhënësi nuk i ofron fare kontratë për arsye që t’i ik obligimeve financiare sepse nga momenti kur punëdhënësi dhe punëtori e rregullojnë kontratën e punës aty automatikisht sipas ligjit duhet t’i ofrohen kushtet dhe kriteret e punës dhe varësisht prej pozitës ose vendit të punës rrjedhin edhe obligimet dhe detyrimet ndaj institucionit të administratës tatimore dhe kontributeve pensionale. Sipas Rradio Evropa e Lirë (2021) gjysma e sektorit privat në Kosovë nuk kanë kontratë të punës. Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative i mbulon dispozitat ligjore që lidhen me gjobat dhe ndëshkimet për shkeljet, parregullsitë dhe kundërvajtjet në fushën e tatimeve duke siguruar njëtrajtshmëri, saktësi dhe shpejtësi në shqyrtimin e rasteve në drejtim të përmbushjes vullnetare dhe ky funksion është i ndarë nga kontrollet dhe vizitat.

Në praktikë punëtorët ankohen në institucionin përkatës për të drejtat e punëtorit por fatkeqësisht kur nuk kanë një kontratë që dëshmon ekzistencën e një marrëdhënie pune është shumë e vështirë të përfitohet ligjërisht nga ajo çka e ka obligim punëdhënësi. Këto janë problemet me të cilat ballafaqohen punëtorët në sektorin privat, sepse një pjesë e bizneseve i ikin këtyre obligimeve dhe detyrimeve ligjore për shumë arsye, njëra nga këto që është shumë shqetësuese është mos ofrimi i kontratës së punës dhe marrja e pagës në kesh dhe jo nëpërmjet transaksioneve bankare, duke e shndërruar punëmarrësin në një punëtor ilegal. Këtu përpos që dëmtohet punëtori dëmtohet edhe vet shteti ngase punëdhënësi, e në këtë rast bizneset e papërgjegjshme përfitojnë nga pjesa e detyrimit ligjor të cilin e kanë për obligim që ta realizojnë përmes pagesës së tatimit në të ardhura, pagesës në trustin pensional etj. Sigurisht ky është një përfitim afatshkurtër për biznesin, sepse në planin afatmesëm dhe afatgjatë e dëmton edhe atë. Në njërën anë nëse ATK-ja apo Inspektorati i Punës i identifikon këto shkelje mund të pasojnë dënime të rënda për biznesin që mund t’ia rëndojnë funksionimin e deri tek procedimet penale, e në anën tjetër kjo logjikë e pamundëson zhvillimin e këtyre bizneseve në kompani serioze, të qëndrueshme dhe të strukturuar.

Po ashtu një çështje tjetër shumë problematike është se ka raste kur pa asnjë paralajmërim dhe pa asnjë rregull ligjor largohen punëtorët nga puna, pa pasur ndonjë frikë nga pasojat ligjore. Sigurisht kjo më së lehti ndodh në rastet kur punëtorët nuk kanë kontrata të ligjshme pune. Një problem tjetër është që sipas ligjit moshë e një personi që të fillojë të punojë është moshë 18 vjeçare/re, edhe pse ligji e lejon punësimin në punë të lehta prej moshës 15-18 vjeç, por assesi nën moshën 15 vjeçare (neni 7, Ligji i Punës, 2010). Sidoqoftë përkundër këtij rregullimi ligjor kjo në sektorin e ndërtimtarisë nuk përfilllet fare.

### 3. E drejta në punë për gratë dhe personat me aftësi të kufizuar – variant propozim

Sa i përket të drejtave të grave kjo rregullohet edhe me Paktin Ndërkombëtar për Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966/1977). Sipas këtij pakti shteti duhet të krijojë kushte që të ketë paga të drejta dhe shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë, pa kurrfarë dallimi; në veçanti, grave duhet t'u garantohen kushte të punës të cilat nuk janë më të këqija se ato që i gëzojnë burrat dhe të marrin shpërblim të njëjtë si burrat për një punë të njëjtë, po ashtu (neni 7). Po ashtu sipas këtij pakti “një mbrojtje dhe ndihmë sa më e gjerë duhet t'i jepen familjes, e cila është element i natyrshëm dhe themelor i shoqërisë, sidomos për formimin e saj dhe për aq kohë sa ajo ka përgjegjësinë për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve në ngarkim. Martesa duhet të bëhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve të ardhshëm. Gjithashtu mbrojtje e veçantë duhet t'u jepet nënave gjatë një periudhe të arsyeshme kohore para dhe pas lindjes së fëmijëve.

Nënave të punësuar, gjatë kësaj periudhe, duhet t'u jepen pushime të paguara ose pushime të shoqëruara me shpërblime të përshtatshme nga ana e sigurimeve sociale, gjithashtu (neni 10) i Paktit e shpjegon se: 1. Një mbrojtje dhe ndihmë sa më e gjerë duhet t'i jepen familjes, e cila është element i natyrshëm dhe themelor i shoqërisë, sidomos për formimin e saj dhe për aq kohë sa ajo ka përgjegjësinë për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve në ngarkim. Martesa duhet të bëhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve të ardhshëm. 2. Mbrojtje e veçantë duhet t'u jepet nënave gjatë një periudhe të arsyeshme kohore para dhe pas lindjes së fëmijëve. Nënave të punësuar, gjatë kësaj periudhe, duhet t'u jepen pushime të paguara ose pushime të shoqëruara me shpërblime të përshtatshme nga ana e sigurimeve sociale. 3. Masa të posaçme të mbrojtjes dhe ndihmës duhet të merren në të mirë të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve, pa kurrfarë diskriminimi për shkaqe birësie ose për shkaqe të tjera. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të mbrohen kundër shfrytëzimit ekonomik e shoqëror. Punësimi i tyre në punët e dëmshme për moralin ose shëndetin e tyre, të rrezikshme për jetën ose të dëmshme për zhvillimin e tyre normal duhet dënuar me ligj. Shtetet duhet gjithashtu të caktojnë afate moshe nën të cilat do të ndalohet dhe do të dënohet me ligj shfrytëzimi me pagesë i fuqisë punëtore të moshës fëmijërore.

Zbatimi i kornizës ligjore dhe asaj ndërkombëtare sa i përket të drejtave të punëtorëve lë shumë për të dëshiruar. Për më tepër vërehen shkelje të këtyre të drejtave sidomos të grave edhe në sektorin publik përderisa në sektorin privat gratë përpos që nuk i gëzojnë këto të drejta në punë ato janë edhe të keqtrajtuara nga punëdhënësi për të përfituar në forma apo mënyra e ndryshme. Kjo është identifikuar gjatë intervistave me disa të punësuar në disa nga supermarketet e Kosovës, konfidencialiteti I të cilave do të ruhet. Të intervistuarat pohojn se nuk i kanë kushtet e mira, punojnë me një orar zgjatur dhe nuk paguhet për këtë të fundit, ndonse ligji i punës e përcakton se çdo punë jashtë orarit ose duhet të paguhet ose duhet të zëvendësohet me ditë të lira (Intervistat private me L.D, A.J, V.L, dhe S.R, mars 2023). Sipas nenit 23 të Ligjit të Punë (2010)”, raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë. Puna

më e gjatë se orari i plotë i punës, në pajtim me paragrafin e parë të këtij neni, mund të zgjasë vetëm për aq kohë sa është e domosdoshme. Puna që e tejkalon kufirin e përcaktuar sipas paragrafit të këtij neni mund të bëhet edhe në rastet emergjente për parandalimin e aksidenteve ose forcave madhore të paparashikuara. Përveç punës shtesë të detyrueshme nga paragrafi 1 i këtij neni, i punësuari mund të bëjë punë shtesë vullnetare në marrëveshje me punëdhënësin, me kompensim page sipas (nenit 56) të këtij ligji. Ndalohet puna jashtë orarit për të punësuarit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç. I punësuari i cili punon me orar të shkurtuar të punës nuk mund të punojë më gjatë se orari i plotë i punës. Punëdhënësi është i obliguar të mbajë të dhëna të sakta për punët jashtë orarit dhe t'i prezantojë ato sipas kërkesës së Inspektoratit të Punës. Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë punuese të të punësuarit. Punëdhënësi është i obliguar të shpallë orarin e punës në vend të dukshëm” (neni 23). Përkundër këtij rregullimi ligjor shumë gra, dhe në mungesë të një kontrate janë të detyruara të punojnë vetë e vetëm për ta mbajtur familjen sepse nuk kanë të ardhura tjera (Intervistë private me L.D, A.J, V.L, dhe R.S mars 2023). Edhe planifikim familjar është një çështje që mund të jetë një problem shtesë në punë për gratë e reja sepse në një farë mënyre kjo mund të jetë pengesë qoftë për të gjetur punë, qoftë për ta mbajtur atë, për arsye se pushimi i lehonisë shpeshherë nuk respektohet fare dhe punëtores femër nuk i mbetet gjë tjetër ose të marr pushim pa pagesë ose në shumicën e rasteve siç ka ndodhur edhe janë detyruar ta lënë punën fare (Intervistat private me L.D, A.J, V.L, dhe S.R mars 2023). Edhe pse edhe kjo e fundit është e rregulluar me Ligjin e Punës (2010) i cili thotë se përcakton se femrave shtatzënë dhe gjë dhënese u ndalohet të bëjnë punë e cila është e përcaktuar si e dëmshme për shëndetin e nënës apo fëmijës, po ashtu femrës shtatzënë dhe gjë dhënese i ndalohet të bëjë punë të rënda fizike apo të bëjë punë në të cilat i ekspozohet faktorëve biologjik, kimik e fizik të dëmshëm për shëndetin e nënës, fëmijës dhe në përgjithësi aftësive riprodhuese femrës(neni 46).

Një çështje tjetër në sektorin privat ka të bëjë edhe me personat me aftësi të kufizuar dhe të drejtat e tyre, kategori kjo që po ashtu mbrohet sipas ligjit të punës. Në këtë sektor përveç telasheve me punësimin e personave me aftësi të kufizuar, edhe ata që punojnë jo rrallëherë mund të ballafaqohen me problem. Në të vërtetë problemi kryesor i personave me aftësi të kufizuar është shkalla e ultë e punësimit të tyre (HANDIKOS, 2018). Zakonisht këta persona punësohen tek ndonjë familjar apo mik i tyre, përndryshe nëse një person i drejtohet ndonjë institucioni të sektorit privat për të kërkuar punë, ka skepticizëm të madh për punësimin e tyre. Këtu merr edhe më shumë rol nevoja që institucionet e shtetit të ndërhyjnë në fushën e arsimit, përfshirë edhe atë profesional në mënyrë që sa më shumë persona me aftësi të kufizuar të kenë mundësi punësimi duke u bazuar në përgatitjen e tyre arsimore dhe profesionale. Problemi qëndron se ndonëse sipas Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (2009) thuhet se në kushte të veçanta, personat me aftësi të kufizuara, mund të punësohen në Punëtoritë Mbrojtëse, Qendrat Punuese dhe në punë të tjera, në bazë të aftësive të punës dhe sipas kushteve të përgjithshme mund të punësohen në tregun e hapur të punës ose ta mbajnë punën e vet. Madje sipas këtij ligji çdo i 50-ti punëtor qoftë në sektorin public, qoftë në atë privat e po ashtu edhe në atë të shoqërisë civile duhet të jetë person me aftësi të kufizuar. Për më tepër punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet e këtij ligjit bazik, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara

të paguajë në një xhirollogari të veçantë në vijën buxhetore të Buxhetit të Kosovës, pagesat mujore në lartësi të shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës, për çdo person me aftësi të kufizuar që duhet të kishte punësuar (neni 12).

Sipas një hulumtimi që është bërë nga Handikos Prishtina lidhur me punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në institucionet publike dhe kompanit private, i cili ka përfshirë 35 ndërmarrje publik dhe kompani private të bazuara në Prishtinë, që kanë më shumë se 50 punëtorë, si dhe disa të tjera, që kanë më pakë, por mund të kenë të punësuar persona me aftësi të kufizuara. Pyetësi ka përmbajtur temat të cilat përfshijnë hapjen e konkurseve për punësim, inkurajimin e personave me aftësi të kufizuara për të aplikuar, nëse kompania ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara dhe sa, si dhe kualifikimet e tyre, gjithashtu nëse i anketuari kishte njohuri mbi kornizën ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe a e zbaton kompania kriterin 50/1 për punësim të këtyre personave dhe a aplikohet neni 2 i ligjit të punës për ditë shtesë pushimi për personat me aftësi të kufizuara.

Pas përfundimit të punës në terren, Handikos kishte angazhuar një konsulent, për të bërë analizën e të gjeturave të hulumtimit, si dhe për të përpiluar raportin e të gjeturave. Raporti përmban rezultatet e 31 intervistave, ngase katër nga 35 ndërmarrjet dhe kompanitë e përzgjedhura kanë refuzuar të japin informata mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në raport, po ashtu, do të ketë mospërputhshmëri në mes të numrit të kompanive që kanë pranuar të përgjigjen dhe numrit të përgjigjeve. Kjo është rezultat i faktit që disa nga kompanitë nuk kanë pasur informata lidhur me të gjitha pyetjet. Nga ndërmarrjet e synuara, 20 ishin publike, 11 kompani private, ndërsa katër kanë refuzuar të marrin pjesë në hulumtim. Nga këto, një është ndërmarrje publike – RTK dhe tri janë kompani private – RTV 21, KTV dhe IPKO. Nga 35 ndërmarrjet e përfshira në hulumtim, shtatë kanë më pak se 50 punëtorë. Nga 31 kompanitë e përfshira në hulumtim, dhe që kanë pranuar të përgjigjen në pyetje, prin Telekom i Kosovës me 95 persona me aftësi të kufizuara të punësuar.

Pas gjithë asaj që ishte parë në terren Handikos nxjerrë këto rekomandime që kishte bërë ky hulumtim, zyrtarët në nivel qendror dhe në atë lokal të jenë fokusi primar i avokimit për zbatim të kornizës ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. - Ndërmarrjet në përgjithësi, si punëdhënësit primarë potencialë për personat me aftësi të kufizuara të jenë fokusi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për punësim. - Të ngritet vetëdija e përfaqësuesve të ndërmarrjeve publike dhe kompanive private lidhur me ligjin dhe kërkesat e tij për punësim të personave me aftësi të kufizuara. - Të ngritet vetëdija e ndërmarrjeve dhe kompanive që kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara mbi të drejtën e tyre për ditë shtesë të pushimit. (HANDIKOS, 2018).

Sa i përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuara kjo e drejt rregullohet edhe me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007) përmes së cilës shtetet palë zotohen se do marrin të gjitha masat e nevojshme përfshirë ato legislative që të:

- (a) Ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, përfshirë kushtet e pajtimit në punë, punësimin, vazhdimësisë së punësimin, ecjes në karrierë dhe ofrimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës;
- (b) Mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, njësoj si gjithë të tjerët, duke



- përfshirë garantimin e mundësive të barabarta dhe pagesës të barabartë për punën me vlerë, siguri dhe kushte pune të shëndetshme të barabarta, duke përfshirë dhe mbrojtjen nga ngacmimet dhe zgjidhjen e ankesave;
- (c) Garantojnë që personat me aftësi të kufizuar të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e punës dhe të drejtat sindikaliste njësoj si gjithë të tjerët;
  - (d) Mundësojnë që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në programet e përgjithshme udhëzuese teknike dhe profesionale, në shërbimet e punësimit dhe për të garantuar trajnim të vazhdueshëm dhe profesional;
  - (e) Promovojnë mundësitë për punësim dhe karrierë për personat me aftësi të kufizuar në tregun e punës, si edhe ofrimin e asistencës për gjetjen, fitimin, mbajtjen dhe kthimin në punë;
  - (f) Promovojnë mundësitë për vetëpunësim, aktivitete të lirë privat, zhvillimin e kooperativave dhe hapjen e një biznesi personal;
  - (g) Punësojnë personat me aftësi të kufizuar në sektorin publik;
  - (h) Inkurajojnë personat me aftësi të kufizuar në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të duhura, të cilat mund të përfshijnë programe pozitive veprimi, stimuj dhe masa të tjera;
  - (i) Garantojnë që personave me aftësi të kufizuar u sigurohet një akomodim i arsyeshëm në ambientin e punës;
  - (j) Inkurajohen personat me aftësi të kufizuar të fitojnë përvojë pune në tregun e hapur të punës;
  - (k) Promovojnë programe për rehabilitim profesional, për mbajtjen e vendit të punës dhe ofrimin e programeve për kthimin në punë për personat me aftësi të kufizuar (neni 27).

Po ashtu sipas këtij neni shtetet palë po ashtu do të garantojnë që personat me aftësi të kufizuar të mos mbahen në skllavëri apo të përdoren si shërbëtorë dhe të jenë të mbrojtur ashtu si gjithë të tjerët nga puna e detyruar.

## 4. Përfundimi

Siç del nga ky punim mund të thuhet se sektori privat kontrollohet pak dhe se kategoritë e popullsisë të trajtuara në këtë punim si gratë dhe personat me aftësi të kufizuar janë më të predispozura për t'iu shkelurat në të drejtat e punëtorit. Në përgjithësi del se ka shkelje të të drejtave të punëtorëve në sektorin privat dhe rrjedhimisht duhet ndërhyrje më serioze e institucioneve të shtetit në vendosjen e ligjshmërisë në këtë fushë dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Shteti për të garantuar të drejtat e punëtorëve, të angazhojë më shumë inspektorë dhe t'i dërgojë në këta sektorë në mënyrë që kontrolli i bizneseve sa i përket respektimit të të drejtave të punëtorëve të jetë më i madh dhe më efikas. Po ashtu rritja e efikasitetit të gjykatave është jashtëzakonisht e rëndësishme për fuqizimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat. Një rol të rëndësishëm në vetëdijesimin e shoqërisë duhet ta luajnë edhe organizatat e mbrojtjes së interesave të bizneseve, sindikatat, organizatat e shoqërisë civile dhe vetë mediat. Mbit ë gjitha përveç demaskimit të shkeljeve, këta aktorë të shoqërisë do të

duhej të promovonin edhe rastet positive të kompanive serioze të cilat promovojnë të drejtat e punëtorëve dhe të cilat respektojnë ligjshmërinë në këtë drejtim. Kjo përpjekje shoqërore do t'u jepte mundësi punëtorëve të sektorit privat të punojnë pa frikë, ta duan shtetin e tyre, të kenë vullnet për punën që e bëjnë, të ndjehen se po u respektohet dinjiteti njerëzor dhe të kenë kushte të barabarta si gjithë të tjerët.

## Referencat:

1. Ahmeti, N. [2021, February 17]. Gjysma e sektorit privat në Kosovë pa kontrata . Retrieved from Radio Evropa e Lire: <https://www.evropaelire.org/a/kontrata-pune-sektori-privat-/31106369.html>
2. LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNES. [2010, December 1]. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>
3. LIGJI NR. 05/L-078 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KU-FIZUARA. [2016, August 30]. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12811>
4. Organizata Ndërkombëtare e Punës. [2018]. Retrieved from Osservatoriointerventitratta: <https://www.osservatoriointerventitratta.it/organizata-nderkombetare-e-punes/>
5. PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SHOQËRORE DHE KULTURORE. [1996, December 16]. Retrieved from kmd.al: <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735715-Pakti-Drejtat-Ekonomike-Sociale-Kulturore.pdf>
6. Shala, V. [n.d.]. Ligji I Punes. Retrieved from SCRIBD: <https://www.scribd.com/doc/78526137/Ligji-i-Punes>
7. Shehu, E. [2018, December 19]. Alarmante vdekjet në vendin e punës, dominojnë në ndërtimtari . Retrieved from Ekonomia Online: <https://ekonomiaonline.com/alarmante-vdekjet-ne-vendin-e-punes-dominojne-ne-ndertimtari/>
8. Zgjona - Zyra për Gjopa dhe Ndëshkime Administrative. [n.d.]. Retrieved from Administrata Tatimore e Kosovës: <https://www.atk-ks.org/zgjona-zyra-per-gjopa-dhe-ndeshkime-administrative/>
9. Vdekjet e vazhdueshme të punëtorëve në vendin e punës dhe neglizhenca institucionale. [2022]. Nacionale. <https://nacionale.com/politike/vdekjet-e-vazhdueshme-e-punetoreve-ne-vendin-e-punes-dhe-neglizhenca-institucionale-7497>
10. Rriten rastet e vdekjeve dhe lëndimeve në vendin e punës. [2023]. Gazeta 10. <https://gazeta10.com/rriten-rastet-e-vdekjeve-dhe-lendimeve-ne-vendin-e-punes/>.
11. GJETJET NGA HULUMTIMI I PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KU-FIZUARA. [2018, August]. Retrieved
12. from prishtinaonline: [https://prishtinaonline.com/uploads/raporti\\_i\\_anketes\\_handikos\\_prishtina.pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/raporti_i_anketes_handikos_prishtina.pdf)

# Dhuna ndaj grave në Kosovë

**Bleona Sylejmani,  
Gresa Jakupi**

## Abstrakt

Ky punim është realizuar me qëllim të vetëdijesimit për dhunën e raportuar si dhe defektet e drejtësisë nga ana ligjore në Kosovë. Dhuna ndaj grave në Kosovë po merr dimensione të reja dhe efektet e saj po ndikojnë në shoqërinë tonë, andaj analizimi i temave të tilla do të ndihmonte në ndërgjegjësimin se si përjetohej dhuna në familje.

Punimi është realizuar duke u mbështetur në të dhënat e publikuara nga raportet vjetore dhe mujore të Policisë së Kosovës dhe shoqatave kompetente. Për arritjen e rezultateve përfundimtare, është bërë kërkim dhe nga raportet e publikuara ndër vite nga organizatat jo-qeveritare që merren me monitorimin e dhunës ndaj grave, përmes së cilave janë siguruar edhe statistikat e përdorura në tekst. Si rezultat i statistikave të mbledhura, u arrit në përfundim se në shkallë vendi është rritur denoncimi i dhunës në familje krahasuar me vitet e kaluara. Gjithashtu duke analizuar nivelet ligjore në vend, arritëm në përfundim se Kosova vazhdon të ketë ende probleme në sistemin e saj ligjor sa i përket dhunës në familje.

Nëpërmjet këtij punimi është synuar të arrihet krijimi i një paralele ndërmjet rritjes së nivelit të raportimit të dhunës dhe reagimit institucional dhe sistemit të drejtësisë.

## Fjalët kyçe:

Dhuna ndaj grave, dhuna në familje, raportimi i dhunës, legjislati.

## 4. Hyrje

Dhuna ndaj grave si pjesë e dhunës në familje është mjaft e zakonshme në Kosovë, dhe në të shumtën e rasteve arrin në pikën fatale, ku viktimat janë gratë apo vajzat. Kjo dhunë ende mbetet si shkelja më e zakonshme e të drejtave të njeriut. Dhuna, përfshirë dhunën fizike, psikologjike apo seksuale ndikon në jetën e shumë grave dhe vajzave dhe pengon lirinë dhe sigurinë personale dhe përparimin në gjithëpërfshirje e barabartë në shoqëri. Gratë në të gjitha vendet e botës, pavarësisht statusit, klasës, moshës apo fesë, përjetojnë dhunë në të gjitha sferat e jetës. Në Kosovë, dhuna ndaj grave është një problem serioz social, duke penguar kështu dinamikën e përparimit shoqëror, por duke ndikuar edhe në çështjet e sigurisë së përgjithshme të vendit. Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të grave dhe njeriut në përgjithësi, një shkelje që buron nga marrëdhëniet e pabarabarta midis dy gjinive.

## 2. Statistika rreth dhunës në familje në Kosovë

Në Kosovë, pabarazia më së shumti vërehet në pjesëmarrjen publike, politike dhe ekonomike të grave, duke ndikuar kështu në standardin dhe cilësinë e jetesës. Pabarazitë gjinore janë të rrënjosura në normat patriarkale. Një studim i OSBE /UNFPA i vitit 2018, i quajtur *Këndvështrimi i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë* tregoi se qëndrimet tradicionale ende mbizotërojnë. Gati shtatë nga dhjetë burra, përkatësisht 69.5% e tyre u pajtuan që burri “duhet të ketë fjalën e fundit në lidhje me vendimet në shtëpinë e tij”. Një përqindje e ngjashme (72.8%) besojnë se roli më i rëndësishëm i një gruaje është të kujdeset për shtëpinë dhe familjen e saj, dhe 72.5% e burrave besojnë se një grua duhet të kujdeset për fëmijët e saj (OSBE/UNFPA, 2018).

Edhe në Kosovë, dhuna ndaj grave është një nga problemet më serioze me të cilat përballen shoqëria. Mbi 68% e grave në Kosovë kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje (OSBE/UNFPA, 2018). Raportet e ndryshme kanë treguar dhunën në familje si një fenomen në rritje. Sipas të dhënave të paraqitura nga OSBE në vitin 2019, 57% e grave të anketuara kishin përjetuar dhunë fizike, psikologjike ose seksuale që nga moshën 15 vjeçare. Studime të tjera të organizuara nga shoqata të shoqërisë civile evidentojnë se në Kosovë viteve të fundit vazhdon të ketë një rritje në kontekstin e dhunës në familje, për vetë faktin se në raportet vjetore të Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2019 janë shënuar 1,914 raste, gjatë vitit 2020 2,069 raste, gjatë vitit 2021 2,456 raste, ndërsa nga periudha janar-shtator e këtij viti janë raportuar 2,067 raste të dhunës në familje. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave ka trajtuar për vitin 2019 gjithsej 1,353 raste të dhunës në familje, për vitin 2020 ka trajtuar 1,524 raste të dhunës në familje, për vitin 2021 ka trajtuar 51,673 dhe për gjashtëmuajin e parë të vitit 2022 ka trajtuar 40,350. Dallimet në moshë, arsimim dhe vendndodhja dalin në pah sidomos gjatë analizës së këtyre këndvështrimeve shoqërore në ndryshim e sipër. Dallime të tilla të theksuara ka dhe ndërmjet grave nga zonat urbane dhe ato rurale. Për shembull, nga anketat e vitit 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, sa i përket pohimit se gruaje duhet “t’i bindet burrit”, dy të tretat e grave të cilat jetojnë në zonat rurale bien dakord

me këtë deklaratë (64%), krahasuar me 49% syresh nga zonat urbane.

Gjatë luftës në vitet 1998-1999, forcat serbe kanë keqtrajtuar gra në mënyrë psikologjike, fizike dhe seksuale. Dhunimi seksual gjatë kohës së luftës rezultoi me shtatzëni të padëshirura, aborte dhe plagë fizike afatgjata. Kohët e fundit raportet mbi dhunën familjare dhe seksuale janë rritur dhe jo domosdoshmërisht mund të nënkuptohet se raportimi i dhunës është në rritje. Rreth 80% e viktimave të dhunës në familje janë lënduar nga dhunuesi i tyre edhe më parë. Dhunimi në Kosovë ka sjellë sëmundje seksualisht të transmetueshme, SIDA-n, abortet spontane, gjakderdhjet si dhe lëndime tjera në sistemin riprodhues të grave. Shumica e grave janë në dijeni për kontraktivët, por vetëm disa nga ato që jetojnë në familje të dhunshme mund t'i përdorin. Gati 40% e tyre kanë pasur së paku një abort dhe nëntë prej tyre kanë kryer dy e më shumë aborte. Gjysma e tyre kanë qenë rregullisht të penguar nga partneri apo anëtarët e familjes të vizitohen te gjinekologu apo te mjeku. Nga 47 gra që kanë provuar dhunën, 87% e tyre kanë përjetuar dhunë gjatë shtatzënisë. Një e treta e tyre janë penguar të vizitohen te mjeku gjatë shtatzënisë. Lufta në Kosovë dhe ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999, ka pasur ndikim tek përjetimi i dhunës nga gratë. Sipas hulumtimit kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave, gati tre të katërtat e grave cilësohen si të prekura drejtpërsëdrejti nga lufta (73%), e një e treta e tyre (32%) janë deklaruar se incidenti më i rëndë i dhunës së ushtruar nga një jo partner lidhej me luftën (Farnsworth, 2008). Kjo gjendje pasqyron një boshllëk në institucionet e Kosovës dhe kërkon një përgjigje sistematike në fushën e parandalimit të dhunës ndaj grave, e gjithashtu edhe ndëshkimit dhe kryerësve të këtyre formave të dhunës.

### **3. Legjislacioni në Kosovë për dhunën ndaj grave**

Legjislacioni në Kosovë është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nëpërmjet kushtetutës së saj, e cila parashikon zbatim të drejtpërdrejtë të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përgjatë viteve, institucionet në Kosovë kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të krijuar një kuadër ligjor dhe të politikave, që parashikon trajtimin e dhunës ndaj grave me qëllim përmirësimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat.

Legjislacioni në Kosovë mbulon barazinë gjimore, dhunën në familje, ngacmimin seksual, si dhe sulmet seksuale dhe fizike. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2010) synon të parandalojë dhunën në familje dhe të mbrojtë të mbijetuarit e saj. Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj aktual ka vënë në dukje luftën kundër dhunës (në kuadër të Planit Qeverisës 2021-2025). Me strategjinë e planifikuar, në kuadër të programit qeverisës, do të synohet të promovohet një shoqëri e barabartë dhe zero tolerancë ndaj dhunës në familje. Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, synon që të rrisë përpjekjen për të garantuar të jetuarit me dinjitet dhe pa dhunë. Kjo e drejtë themelore synohet të arrihet përmes aktiviteteve të parashikuara me këtë strategji në fushën e parandalimit, mbrojtjes, ri integritit dhe fuqizimit të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ndëshkimit dhe rehabilitimit të kryerësve të këtyre formave të dhunës, si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional. Këtu zë vend edhe Konventa e Stambollit (2011), e cila u bë pjesë e Kushtetutës së Kosovës në shtator të

vitit 2020. Format e ndryshme të dhunës ndaj grave, parashikuar në Konventën e Stambollit, është dhuna mbi baza gjinore, e cila është dhunë që drejtohet kundër një gruaje, vetëm për shkak se është grua apo që prek gratë në shumicën dërrmuese. Përpos këtij dokumenti, plani strategjik bazohet edhe në një tërësi ligjesh të rëndësishme si Kodi Penal i Kosovës (2019), Kodi i Procedurës Penale (2022) etj. Sipas Kodit Penal, nëse një veprë penale kryhet me qëllim të dhunës apo keqtrajtimit fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik të personit tjetër, përmban një formë të veprës penale dhe rezulton me burgim (neni 248). Ndërsa, Ligji mbi Barazinë Gjinore (2015) njeh dhunën e bazuar në gjini si një formë diskriminimi që “pengon seriozisht aftësinë e grave dhe burrave për të gëzuar të drejtat dhe liritë mbi bazën e barazisë” (neni 4.2). Gjithashtu sipas nenit 3 të Ligjit për Barazi Gjinore përkufizohet dhe ndalohet dhuna në baza gjinore, ku nënkupton “aktet e dhunës që rezultojnë apo kanë të ngjarë të rezultojnë në dëmtim apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike, sociale apo ekonomike mbi baza gjinore, duke përfshirë kërcënime për akte të tilla, shtrëngim apo heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur kjo ndodh në jetën publike apo private”. Në bazë të legjislacionit penal, aborti i detyruar (neni 184.2), ndjekja (neni 186.2), dhunimi (neni 230) dhe martesë e detyruar (neni 246) përbëjnë vepra penale specifike. Dënime më të larta parashikohen për ndjekjen që kryhet ndaj një ish partneri apo partneri aktual ose ish anëtarë apo anëtarë aktual të familjes (neni 186.2). Ngacmimi seksual parashikohet dhe ndalohet në bazë të ligjeve të Kosovës për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për barazinë. Sanksionet ligjore parashikohen në formën e gjobave civile, ndërsa shkeljet që përbëjnë vepra penale trajtohen në përputhje me Kodin Penal. Përpos ligjeve, në Kosovë ka gjithashtu Koordinator kundër Dhunës në Familje (Zëvendësministri i Drejtësisë), Njësi Kundër Dhunës në Familje në kuadër të Policisë së Kosovës, Zyrë për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit dhe qendra për punë sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave është proaktive duke i ndihmuar vazhdimisht viktimat për parashtrimin e kërkesave për urdhër mbrojtje, ofron shërbime për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqëson interesat e tyre në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë, me vëmendje të posaçme kushtuar trajtimit të rasteve kundër trafikimit me qenie njerëzore, rasteve të dhunës në familje, keqtrajtimit, vrasjeve, grabitjeve dhe rasteve të reja siç janë ato të dhunimeve seksuale gjatë luftës etj, si dhe përfaqëson këto viktime në polici, prokurori dhe në gjykata.

## 4. Përfundimet

Megjithatë pengesat kulturore mbesin ende. Sipas raporteve të realizuara nga ekspertë të ndryshëm, disa zyrtarë vazhdojnë ende me idenë se disa lloje të caktuara të dhunës kundër grave janë të pranueshme nga aspekti kulturor dhe fajësojnë gratë për krimet e kryera kundër tyre. Gjithashtu vlen të përmendet se legjislacioni zbatohet pak dhe në mënyrë të parregullt, duke thënë se ai kryesisht trajton dhe merret me “dhunë në familje” e jo me “dhunën ndaj grave”. Për shkak të boshllëqeve në legjislacionin penal, zbatimit të dobët të ligjeve penale dhe rregulloreve, mungesës së kapacitetit në sistemin e drejtësisë, sistemi kosovar i drejtësisë po vazhdon të dështojë në trajtimin e grave si viktime të dhunës në familje. Nga ky dështim,

përpos rritjes së raportimit të dhunës, vendi megjithatë po hasë në një nivel të lartë të rasteve të dhunës që nuk raportohen, në mungesë të besimit në sistemin e drejtësisë nga ana e popullit, nivele të larta të mosndëshkimit të autorëve dhe një nivel i lartë i mungesës së mbrojtjes së viktimave të dhunës. Dhuna ndaj grave është një njollë për shoqërinë tonë. Për sa kohë që gratë i nënshtrohen dhunës dhe shohin mangësi në raportimin e dhunës nëpër institucione, imazhi i Kosovës në nivel ndërkombëtar do ketë zbehje. Zbatimi i ligjeve në Kosovës ndaj dhunës me bazë gjinore si shkelje e të drejtave të njeriut, përfshirë sigurimin e qasjes në drejtësi, është i rëndësishëm për rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian (BE), pasi këto përbëjnë të drejta themelore. Komisioni Evropian ka vërejtur mangësi në performancën e institucioneve në adresimin e dhunës me bazë gjinore. Në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2018, theksohen disa çështje, përfshirë: mungesën e koordinimit midis policisë, prokurorëve, institucioneve gjyqësore dhe aktorëve të tjerë kryesorë që merren me dhunën me bazë gjinore, nevojën për financim të qëndrueshëm për qendrat e viktimave të dhunës dhe nevojën për riintegrim më efektiv të viktimave. Andaj, është e domosdoshme që të gjitha nivelet institucionale të vendit t'i trajtojnë problemet e dhunës dhe të krijojnë një mjedis ku dhuna ndaj grave është e papranueshme. Për këtë arsye, duhet të zbatohen ligje më serioze në lidhje me dënimet e autorëve. Incidentet e vazhdueshme të dhunës në familje, sulmet seksuale dhe çdo formë tjetër e dhunës ndaj gruas do të dëmtojë shoqërinë dhe do të pengojë përparimin shoqëror. Prandaj, është e domosdoshme që vendi ynë të marrë masat e duhura për të parandaluar çdo lloj forme të dhunës dhe të punojë më shumë në zbatimin e ligjeve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

## Referencat:

1. OSBE. [2019]. Anketë për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë. Në osce.org : <https://www.osce.org/files/f/documents/e/4/439790.pdf>.
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës. [2019]. Në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.
3. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës. [2022]. Në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.
4. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. [2010]. Në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691>.
5. Ligji për Barazi Gjinore. [2015]. Në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>.
6. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025. [2021]. Në <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>.
7. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026. [2022]. Në <https://kryeministri.rks-gov.net>.
8. Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave tek Prokurori i Shtetit. [2020]. Në <https://prokuroria-rks.org/psh/zmnv/68/misoni>.
9. OSBE/UNFPA. [2018]. Këndvështrim i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë. Gjetur në osce.org : <https://www.osce.org/files/f/documents/b/1/382510.pdf>.
10. Komisioni Evropian. [2018]. Raport për Kosovën. Në <https://kk.rks-gov.net/suhareke/wp->

- content/uploads/sites/30/2019/03/Raporti-per-Kosoves-2018-2.pdf
11. Policia e Kosovës [2020]. Raporti vjetor 2019. Në <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-vjetor-2019-anglisht.pdf>
  12. Konventa e Stambollit - Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. [2011]. Gjetur në Council of Europe Treaty Series — No. 210 : <https://rm.coe.int/168046246b>.
  13. Farnsworth, N. [2008]. Hulumtim kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave. Në [Copy of UNFPA Report Alb22:UNFPA.qxd \[womensnetwork.org\]](#).



# Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian- sfidat dhe përparësitë

---

Dardan Brahim

---

## Abstrakt

Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian është një ndër çështjet më të rëndësishme dhe më madhore për vendin tonë dhe për gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Integrimi në Bashkimin Evropian është një temë e njohur nga të gjithë qytetarët e shtetit të Kosovës, pikërisht për shkak të rëndësisë së madhe që ka. Meqë integrimi në Bashkimin Evropian është pika kyçe për vendin tonë, qëllimi i këtij studimi është që të hulumtojë në detaje perceptimet e studentëve të Kolegjit Universum në lidhje me integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Po ashtu ky studim synon të identifikojë dallimet në mes të studentëve të moshave të ndryshme në lidhje me integrimin në Bashkimin Evropian. Përveç kësaj punimi ka për qëllim po ashtu të hulumtojë më shumë rreth sfidave dhe përparësive që ka Kosova në procesin e integrimeve në Bashkimin Evropian. Për realizimin e këtij punimi ndër të tjera janë shfrytëzuar metodat sasiore (kuantitative). Pjesëmarrës të këtij hulumtimi janë 100 studentë nga Kolegji Universum, të programeve të ndryshme dhe moshave të ndryshme të përzgjedhur me anë të mostrës së rastësishme. Si instrumente për mbledhjen e të dhënave janë shfrytëzuar pyetësorët të përpiluar në bazë të shkallës së Likertit. Të dhënat sasiore janë analizuar me programin SPSS 26 dhe rezultatet janë paraqitur në formë tabelore. Po ashtu është përdorur edhe metodologjia deskriptive si dhe shfletimi i literaturës relevante.

## 1. Hyrje

Pas Luftës së Dytë Botërore (më tej LDB), shtetet e Evropës Perëndimore, të cilat nuk ishin futur nën ombrellën sovjetike e panë të nevojshme krijimin e një mekanizmi përmes së cilit do të rritej bashkëpunimi ekonomik dhe në planin afatgjatë do të zbuteshin politikisht tensionet franko-gjermane e po ashtu përmes zhvillimit ekonomik do të ndalej depërtimi i komunizmit dhe rrjedhimisht ndikimi i BRSS-së. Fillimisht ky mekanizëm ishte Komuniteti Evropian për Thëngjill dhe Çelik (më tej KETHÇ), i cili u zgjerua dhe përplotësua nga mekanizma të tjerë për t'u bërë i njohur si Komuniteti Evropian (tani Bashkimi Evropian). Themelues ishin Franca, Gjermania, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu. Ndër vite pjesë e Komunitetit Evropian u bënë edhe shumë vende të tjera, të cilat i plotësonin kushtet për të qenë pjesë e tij. Ky projekt ekonomik prej vitit 1992 mori edhe karakter të qartë politik duke u shndërruar në Bashkimin Evropian (më tej BE).

Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor synojnë të bëhen pjesë e BE-së, mirëpo për të qenë pjesë e tij, duhet t'i plotësojnë kriteret e Kopenhagës, të përcaktuara nga BE-ja. Republika e Kosovës aktualisht është kandidat potencial për anëtarësim në BE (por me shumë probleme në ndërtimin e raporteve zyrtare për shkak të mosnjohjes së saj nga pesë shtete anëtare). Integrimi në BE është një synim konsensual i qytetarëve të Kosovës dhe shumicës së partive politike sepse për ta kjo nënkupton siguri, zhvillimin ekonomik, demokraci, paqe dhe stabilitet politik.

Integrimi i Kosovës në BE mbetet një ndër synimet kyçe të shtetit tonë, sepse integrimi në BE nuk do të thotë thjesht një ulëse, mirëpo do të thotë rritje e mirëqenies dhe evropianizim i jetës sonë. Duke qenë një synim i rëndësishëm i qytetarëve dhe politikës në Kosovë përmes kësaj teme do të hulumtohet më shumë rreth kësaj teme. Me anë të këtij studimi do të trajtohen më në detaje këto elemente dhe të hulumtohet më shumë rreth perceptimeve të studentëve si një kategori dinamike në vendin tonë.

## 2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është analizimi i perceptimeve të studentëve të Kolegjit Universum në lidhje me integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Synohet po ashtu të analizohen edhe perceptimet e studentëve të Kolegjit Universum për marrëdhëniet e Kosovës me shtetin e Serbisë, rolin e këtyre marrëdhënieve në integrimet evropiane si dhe sfidat e përparësitë e Kosovës në rrugën e integritit evropian.

Pyetja themelore e hulumtimit \

- Cilat janë perceptimet e studentëve të Kolegjit Universum në lidhje me integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian?

Nën pyetjet e hulumtimit

- Cilat janë perceptimet e studentëve të Kolegjit Universum në lidhje me raportin Kosovë-Serbi?
- Cilat janë perceptimet e studentëve të Kolegjit Universum në lidhje me sfidat dhe përparësitë e Kosovës për integrimin në Bashkimin Evropian?

### 3. Hipotezat e hulumtimit

Hipoteza kryesore e këtij punimi të cilin do të përpiqemi ta vërtetojmë përmes hulumtimit me studentët e Kolegjit Universum është se procesi i integrimit evropian është shumë i rëndësishëm për Kosovën, por përcillet me sfida jo vetëm të brendshme por edhe ato që kanë të bëjnë me raportet me vetë BE-në për shkak të mosnjohjes nga ana e pesë shteteve të saj si dhe të dialogut me Serbinë dhe rezultatit të tij.

### 4. Rishikimi i literaturës

#### 4.1 Sfidat dhe përparësitë për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian (BE)

Duke u bazuar në raportet e ndryshme ndër vite dhe në studime të shumta, mund të themi se sfidat për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian janë më të mëdha se sa përparësitë. Ashtu siç del edhe nga hulumtimi që është bërë me studentët, sfidat që ka Kosova në këtë rrugëtim kanë një peshë të madhe në procesin e integrimi të Kosovës në BE. Në vazhdim do të paraqiten disa nga përparësitë dhe sfidat me të cilat Kosova ballafaqohet, sipas studimeve të ndryshëm. Përfitimet e integrimit në BE për Kosovën: • Siguria, stabiliteti politik dhe bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor; • Prosperiteti dhe zhvillimi ekonomik; • Standardet më të larta të jetesës dhe modernizimi; dhe • Shtet më i fuqishëm, sistem efikas i drejtësisë, mundësi më të mëdha për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Sfidat e integrimit në BE për Kosovën: • Përshtatja e ekonomisë për t'u ballafaquar me sfidat e tregut të përbashkët evropian; • Shfrytëzimi efikas i asistencës teknike dhe financiare të BE-së për reformat kritike, afatgjata; • Forcimi i funksionimit të institucioneve të Kosovës; dhe • Ruajtja e qëndrimit pozitiv të shoqërisë sa i përket integrimit në BE (Kuvendi i Kosovës, p.d.). Sfidat kryesore për Kosovën në rrugën drejt anëtarësimit në BE kanë të bëjnë me kuptimin e procesit dhe pasojave të tij. Në këtë drejtim është i rëndësishëm angazhimi dhe përkushtimi i qeverisë e cila duhet të trajtojë integrimin evropian si prioritet të rendit të parë. Po ashtu sfida janë edhe konsolidimi i institucioneve të qëndrueshme dhe të fuqishme, si dhe fuqizimi i kapaciteteve administrativ për të përgatitur dhe implementuar strategji dhe plane konsistente, koherente dhe 38 mirë të bashkërenduara, që sigurojnë zhvillim ekonomik dhe ecje të shpejtë drejtë Bashkimit Evropian (Ahmeti, 2022).

Mosnjohja e Republikës së Kosovës nga pesë vendet anëtare të BE-së është një pengesë serioze në rrugën e integrimit të Kosovës në BE. Edhe nëse Komisioni, Këshilli Evropian dhe Parlamenti Evropian (më tej PE) po tentojnë të gjejnë rrugë e mundësi për të lënë anash pengesat ligjore dhe politike në rrugën e integrimit, ky mbetet edhe më tutje një nga problemet më të mëdha. Një hap përpara nga institucionet tjera të BE-së në lidhje me politikën e BE-së ndaj Kosovës qëndron PEja jo vetëm përmes mbështetjes së vazhdueshme të perspektivës së BE-së për Kosovën dhe liberalizimit të vizave, por edhe përmes thirrjeve (korrik 2010) të pesë vendeve, për ta njohur Republikën e Kosovës (Kuçmari, 2011).

Në korrik të vitit 2022 PE-ja miratoi një rezolutë për Kosovën ku për herë të parë normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë e ndërlidh me njohjen e dy anshme (Parliament, 2022).

Deputetja gjermane Viola von Cramon (2022) pas miratimit të kësaj rezolute për Kosovën theksoi se “raportet me Serbinë duhet të normalizohen përmes marrëveshjes e cila duhet të bazohet në njohjen e ndërsjellë”. Në përgjithësi, sfidat e Kosovës nga aspekti i perspektivës së saj evropiane mund të kategorizohen në tri fusha kryesore: të brendshme, e cila përfshin sfida në lidhje me krijimin e një ekonomie të qëndrueshme që siguron vende pune për të rinjtë dhe që është në gjendje të konkurrojë në tregun e BE-së; të jashtme, më saktë marrëdhëniet me Serbinë dhe mosnjohja nga 5 vendet anëtare të BE-së (Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja); dhe së treti, zhvillimet e brendshme politike të BE-së që çojnë në pamundësinë e saj për të zbatuar një politikë të qëndrueshme dhe kohezive ndaj Kosovës, siç u dëshmuua me rastin e liberalizimit të vizave. Kosova aktualisht është i vetmi vend në rajon, i cili akoma nuk ka parashtruar kërkesë për anëtarësim dhe konsiderohet vetëm si një vend i mundshëm kandidat për anëtarësim në BE.

## 4.2 SRruga e Kosovës për pranimin në Bashkimin Evropian (BE)

Ka kaluar pothuajse një dekadë ndërmjet përfundimit të luftës në vitin 1999 dhe shpalljes së pavarësisë së Kosovës e miratimit të kushtetutës së saj në vitin 2008. Ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, situata e Kosovës është më e ndryshme, andaj edhe trajtohet më me kujdes nga BE-ja. Kosova u bë një ndër temat më të diskutuara në këto dy dekadat e fundit nga ana e institucioneve evropiane në rrafshin e politikave të sigurisë, atyre zhvillimore, ekonomike e diplomatike që nga fundi i viteve 90-të, e vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite temë e rëndësishme sidomos për shkak të problemeve të pazgjidhura me Serbinë. Kështu BE-ja ka qenë në vazhdimësi prezente qoftë në gjetjen e modaliteteve të ndihmës për Kosovën, qoftë në procesin e definimit të statusit të saj politik, qoftë në përafrimin e vendit me BE-në, e mbi të gjitha në dekadën e fundin në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë (Bajraktari, 2014). Sipas ish diplomatit shqiptar Lisjen Bashkurtit (2006) Kosova vijon të mbetet sfida me serioze në Ballkan, çështja më e vështirë e Bashkimit Evropian dhe një ndër rastet më të komplikuar për zgjidhje definitive në sistemin e sotëm ndërkombëtarë.

Për të qenë pjesë e BE-së Kosova duhet të ketë marrëdhënie të mira me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në rastin e integritit të Kosovës dhe të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, BE-ja ka shtuar si kriter thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Në këtë mënyrë, paralelisht me rrugën integruese në BE, Kosova dhe vendet e rajonit kanë për obligim të rrisin bashkëpunimin ekonomik dhe politik në mes tyre (Bajrami & Krasniqi, 2017).

## 5. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi përfshin popullacionin i cili është i përbërë nga studentët e Kolegjit Universum dhe mostra e hulumtimit janë studentët të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme.

Meqë pyetësi është shpërndarë në mënyrë online, studentët e këtij institucioni kanë pasur mundësinë të jenë pjesë e këtij hulumtimi duke zgjedhur vetë nëse duan të jenë pjesëmarrës në hulumtim apo jo. Në vazhdim do të paraqiten të dhënat demografike për të dhënat sasiore.

Në hulumtim kanë marrë pjesë 100 studentë nga drejtimet e ndryshme të Kolegjit Universum. Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve pjesa dominuese 65% ishin studentë të gjinisë femërore, ndërsa 35% studentë të gjinisë mashkullore. Moshja e pjesëmarrësve në hulumtim fillon nga 18-20 vjet ku 62% janë deklaruar se i takojnë këtij grupi të moshës, 26% i takojnë moshës 21-23vjet, 8% moshës 24-30 vjet dhe vetëm 4% u deklaruan mbi 30 vjeç. Duke u bazuar në të dhënat e tabelës e shohim se më së shumti studentë i takojnë grupit 18-20 vjeçar me 62%, ndërsa më pak grupit të moshës mbi 30 vjeç, me vetëm 4%. Sipas vitit të studimeve më së shumti pjesëmarrës në hulumtim janë studentët e vitit të parë me 56%, pastaj të vitit të tretë me 26%, më pas të vitit të dytë me 10%. Po ashtu, pjesë e hulumtimit ishin edhe studentët nga viti i dytë në nivelin master me 5% dhe studentët nga viti i parë në nivelin master me 2%. Studentët pjesëmarrës në hulumtim i përkasin nivelit bachelor me 92% dhe nivelit master me 8%. Sa i përket programit apo drejtimit të studentëve, meqë popullacioni i studimit janë të gjithë studentë të Kolegjit Universum, mostër janë studentë të programeve e drejtimeve të ndryshme të këtij kolegji nga kampus i Lipjanit.

Meqë pyetësi është shpërndarë në mënyrë online, studentët e këtij institucioni kanë pasur mundësinë të jenë pjesë e këtij hulumtimi duke zgjedhur vetë nëse duan të jenë pjesëmarrës në hulumtim apo jo. Në vazhdim do të paraqiten të dhënat-demografike për të dhënat sasiore.

### Të dhënat demografike për të dhënat sasiore

		Femër	Mashkull					
<b>Gjinia</b>	N	65	35	100				
	%	65%	35%	100				
		<b>18-20</b>	<b>21-23</b>	<b>24-30</b>	<b>Mbi 30</b>			
<b>Mosha</b>	N	62	26	8	4	100		
	%	62%	26%	8%	4%	100		
		<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>I II (Master)</b>		
<b>Viti i studimeve</b>	N	56	10	26	1	2	5	100
	%	56%	10%	26%	1%	2%	5%	100
		<b>Bachelor</b>	<b>Master</b>					
<b>Niveli i studimeve</b>	N	92	8	100				
	%	92%	8%	100				

**Tabela 1.** Shpërndarja e mostrës sipas të dhënave demografike

Në hulumtim kanë marrë pjesë 100 studentë nga drejtimet e ndryshme të Kolegjit Universum. Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve pjesa dominuese 65% ishin studentë të gjinisë femërore, ndërsa 35% studentë të gjinisë mashkullore.

Mosha e pjesëmarrësve në hulumtim fillon nga 18-20 vjet ku 62% janë deklaruar se i takojnë këtij grupi të moshës, 26% i takojnë moshës 21-23vjet, 8% moshës 24-30 vjet dhe

vetëm 4% u deklaruan mbi 30 vjeç. Duke u bazuar në të dhënat e tabelës e shohim se më së shumti studentë i takojnë grupit 18-20 vjeçar me 62%, ndërsa më pak grupit të moshës mbi 30 vjeç, me vetëm 4%.

Sipas vitit të studimeve më së shumti pjesëmarrës në hulumtim janë studentët e vitit të parë me 56%, pastaj të vitit të tretë me 26%, më pas të vitit të dytë me 10%. Po ashtu, pjesë e hulumtimit ishin edhe studentët nga viti i dytë në nivelin master me 5% dhe studentët nga viti i parë në nivelin master me 2%. Studentët pjesëmarrës në hulumtim i përkasin nivelit bachelor me 92% dhe nivelit master me 8%.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë pas analizimi të mesatares aritmetike, devijimit standard, frekuencës dhe variancës mund të shohim se studentët e Kolegjit Universum kanë mendime të ndryshme rreth integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Në përgjithësi studentët kanë dhënë shumëllojshmëri të përgjigjeve duke zgjedhur opsionet e ndryshme të vendosura në pyetësor, mirëpo për disa çështje ekzistojnë mendim të njëjtë nga shumica e studentëve. Sidoqoftë me që pyetjet kanë qenë në lidhje me integrimin në përgjithësi, Bashkimin Evropian, raportin Kosovë- Serbi, sfidat dhe përparësitë e integritit të Kosovës në BE, rezultatet kanë qenë të ndryshme dhe jo gjithëherë ka mbizotëruar shumica.

	Nuk pajtohem	Pjesërisht pajtohem	Neutral	Pajtohem	Plotësisht pajtohem	Frekuenca	Mesatarja aritmetike	Devijimi standard
1. Integrimi në BE është shumë i rëndësishëm për shtetin e Kosovës.	2%	5%	10%	21%	62%	100	4.37%	.99143
2. Negociatat me Serbinë e përshpejtojnë procesin e anëtarësimit në BE.	12%	12%	32%	28%	16%	100	3.26%	1.19443
3. Kosova duhet të bëjë një kompromis me Serbinë për anëtarësim në BE.	27%	9%	33%	26%	5%	100	2.75%	1.27426
4. Integrimi i Kosovës në BE do të sjellë paqe dhe stabilitet më Ballkanin Perëndimor.	3%	10%	12%	43%	32%	100	3.91%	1.05500
5. Sfidat e shtetit të Kosovës për integrim në BE janë më të mëdha se përparësitë.	8%	4%	31%	34%	23%	100	3.60%	1.12815
6. Sfidat më të mëdha për integrimin e Kosovës në BE është luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar.	9%	8%	16%	44%	23%	100	3.64%	1.18509
7. Kosova i ka plotësuar kriteret për liberalizimin e vizave në Bashkimin Evropian	8%	10%	15%	33%	34%	100	3.75%	1.25025
8. Mos liberalizimi i vizave konsiderohet si çështje politike.	5%	5%	16%	41%	33%	100	3.92%	1.077007

9. Bashkimi Evropian i përkrah politikat shtetërore të Kosovës.	14%	7%	42%	31%	6%	100	3.08%	1.08879
10. Pas 5 viteve Kosova do të jetë pjesë e Bashkimit Evropian.	14%	11%	24%	39%	12%	100	3.24%	1.22367
11. Lufta në Ukrainë mund të ndikojë në anëtarësimin e Kosovës në BE.	20%	7%	29%	33%	11%	100	3.08%	1.28456
12. Dialogu i Kosovës me Serbinë duhet të vazhdojë deri në arritjen e marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve	9%	11%	27%	34%	19%	100	3.43%	1.18283
13. Problemi në mes të Kosovës dhe Serbisë është pikë kyçe e mos liberalizimit të vizave për Kosovën.	16%	12%	26%	29%	17%	100	3.19%	1.30806
14. Mosnjohja e Kosovës nga pesë shtetet e Bashkimit Evropian është pengesa kryesore për integrimin e Kosovës në BE	4%	10%	17%	43%	26%	100	3.77%	1.07172
15. Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të ndikojë pozitivisht në liberalizimin e vizave	25%	7%	27%	26%	15%	100	2.99%	1.39621

**Tabela 2.** Analiza përshkruese (frekuenca, mesatarja, varianca dhe devijimi standard) e pyetësorit për studentët

Deklarata e parë në pyetësorin për studentët ishte *‘Integrimi në BE është shumë i rëndësishëm për shtetin e Kosovës’*. Për këtë deklaratë 2% të studentëve janë përgjigjur se nuk pajtohen, 5% kanë thënë se pjesërisht pajtohen dhe 10% ishin neutral. Për opsionin pajtohem ishin 21% të studentëve, ndërsa 62% prej tyre ishin për opsionin plotësisht pajtohem. Duke u bazuar në këto rezultate të marra në pyetjen apo deklaratën e parë mund të shohim se studentët e Kolegjit Universum e shohin si të rëndësishëm integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian duke qenë se shumica dërrmuese apo 83% e tyre kanë qëndrim pozitiv.

Në deklaratën e dytë *‘Negociatat me Serbinë e përshpejtojnë procesin e anëtarësimit në BE’*, studentët mbajnë qëndrime të ndryshme. Në këtë deklaratë 12% të studentëve janë përgjigjur se nuk pajtohen, po ashtu 12% janë përgjigjur se pajtohen pjesërisht, pra në total janë 24% të studentëve që mbajnë qëndrim negativ ndaj ndërlidhjes së negociatave me Serbinë me procesin e anëtarësimit në BE ose janë hezitues. Për opsionin pajtohem janë 28% të studentëve, ndërsa plotësisht pajtohen 16% e studentëve, rrjedhimisht me qëndrim pozitiv janë 44% e studentëve. E madhe është edhe përqindja e studentëve që kanë qëndrim neutral ndaj këtij pohimi, me 32% të studentëve të anketuar. Kjo përgjigje dëshmon edhe për skepticizmin e një numri të madh të rinjve dhe popullatës në përgjithësi të Kosovës rreth rezultateve të dialogut Kosovë - Serbi dhe ndërlidhjes së tij me procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE.

*‘Kosova duhet të bëjë një kompromis me Serbinë për anëtarësim në BE’* është deklaratë e tretë e pyetësorit të realizuar me studentët e Kolegjit Universum. Në këtë deklaratë 27% e studentëve nuk pajtohen, ndërsa 9% pjesërisht pajtohen. Rrjedhimisht 36% e studentëve

mund të themi se ose kanë qëndrime krejtësisht negative ose shumë hezituese rreth këtij pohimi. Për opsionin pajtohem janë përgjigjur 26% të studentëve, ndërsa plotësisht pajtohem janë përgjigjur 5% të studentëve. Kështu, 31% e studentëve mbajnë qëndrim pozitiv ndaj këtij pohimi. Një përqindje e lartë e studentëve në këtë deklaratë mbajnë qëndrim neutral, përkatësisht 33% prej tyre. Kjo deklaratë realisht dëshmon për ndarjet e thella që ka shoqëria kosovare sa i përket dialogut me Serbinë dhe mundësive të kompromiseve me të. Me një përqindje përafërsisht të barabartë janë si ata që janë kundër, si ata që pajtohen, si ata që janë neutral. Sipas mendimit tonë këto përgjigje janë një reflektim i saktë i dilemave që ka shoqëria shqiptare në Kosovë ndaj këtij procesi në përgjithësi.

Në deklaratën *'Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të ndikojë pozitivisht në liberalizimin e vizave'* 32% e studentë nuk e përkrahin këtë pohim. Në anën tjetër 41% e tyre besojnë se implementimi i marrëveshjes për asociacionin e komunave do të afrojë liberalizimin e vizave. 27% e studentëve mbajnë qëndrim neutral, duke pohuar edhe njëherë një trend të përgjithshëm të këtij hulumtimi se në çështjet që kanë të bëjnë me Serbinë hezitimet e shoqërisë shpërfaqen edhe në bindjet e studentëve.

## 6. Përfundimet

Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian është një ndër çështjet më të rëndësishme për vendin tonë që nga pavarësia e shtetit të Kosovës. Bazuar në rezultatet e hulumtimi me studentë mund të shohim se edhe ata mbajnë një qëndrim pozitiv për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe e trajtojnë si çështje me rëndësi për shtetin tonë. Kosova për të përshpejtuar integrimin BE ka filluar dialogun dhe negociatat me Serbinë. Kjo çështje ka polarizuar shoqërinë shqiptare të Kosovës. Debatet dhe mospajtimet në mes të partive politike janë bartur edhe në shoqëri. Ky tension dhe çarje e shoqërisë del edhe nga hulumtimi me studentët e Kolegjit Universum. Studentët e Kolegjit Universum ndajnë mendime të ndryshme për negociatat me Serbinë, andaj kjo çështje do të duhej të trajtohej me kujdes të veçantë edhe në nivelet e larta të politik-bërjes në Kosovë. Ballkani Perëndimor dhe shtetet e tij kanë qenë dhe mbeten problem për Bashkimin Evropian. Shtetet e Ballkanit Perëndimor synojnë të anëtarësohen në BE dhe të gjitha këto shtete janë duke punuar rreth plotësimin të kriterëve për integrim në BE. Studentët e Kolegjit Universum mendojnë që integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian do të sjellë paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor. Sfidat e Kosovës për integrim në BE konsiderohen si të mëdha, ndërsa përparësitë si më të vogla. Këto sfida janë paraqitur edhe në raportet e viteve të ndryshme, të cilat tregojnë për rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian. Studentët e Kolegjit Universum mendojnë që sfidat e shtetit të Kosovës janë më të mëdha se sa përparësitë. Ndërsa e konsiderojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar si sfida më e madhe për integrimin e Kosovës në BE. Kosova është një ndër pak vendet, e cila nuk ka liberalizim të vizave. Për qytetarët e vendit tonë mos liberalizimi i vizave është një padrejtësi e madhe, sepse të rinjtë nuk kanë mundësi të dalin të studiojnë, punojnë apo vizitojnë vende të ndryshme, pa pasur një vizë Shengen. Studentët e Kolegjit Universum mendojnë që Kosova i ka plotësuar kriteret dhe kushtet për liberalizimin e vizave. Po ashtu, studentët mendojnë që mos liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës



konsiderohet si çështje politike. Andaj, liberalizimi i vizave duhet të ndodhë sa më shpejtë dhe 41 qytetarët e vendit tonë dhe sidomos të rinjtë të kenë mundësi të lëvizin lirshëm në shtetet e Evropës Perëndimore. Politikat shtetërore të Kosovës luajnë rol të rëndësishëm në plotësimin e kushteve dhe kriterëve për integrim evropian. Studentët kryesisht mbajnë qëndrim neutral sa i përket faktit se a i përkrah BE-ja politikat shtetërore të Kosovës. Në anën tjetër janë mjaft optimist sa i përket mundësisë që pas pesë viteve Kosova të jetë pjesë e BE-së

## 7. Rekomandimet

Bazuar në këto rezultate të marra nga hulumtimi i realizuar mund të rekomandojmë: - Të shfrytëzohen të gjitha mundësitë të cilat ia lehtësojnë Kosovës rrugën drejt integritimit në BE. - Sistemi i drejtësisë t'i nënshtrohet një reforme të thellë përmes vettingut. Përmes reformave të ofrohet mundësimi i ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga organet e drejtësisë. - Të punohet në politikën e jashtme në atë drejtim që shtetet skeptike sa i përket liberalizimit të vizave të ndryshojnë qëndrimet e kamotshme. Rendi i ri botëror mund të ofrojë situata të favorshme për Kosovën të cilat mund t'i hapin rrugën vendit për lirinë e lëvizjes. - Të punohet në funksionalizimin dhe efikasitetin e cila vazhdon të cilësohet si sfidë në vend. - Të ofrohen mundësi studimi e punësimi për gratë duke luftuar pabarazinë në tregun e punës, duke ndikuar që papunësia të ulet. - Të vazhdohen negociatat dhe dialogu me Serbinë duke u përkujdesur që këto negociata të ndikojnë pozitivisht në integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. - Të punohet që si rezultat i dialogut Kosovë-Serbi të zgjidhet çështja e të pagjeturve. - Qeveria jonë të kërkojë zbatimin e parimit të reciprocitetit në marrëveshjen finale me Serbinë ashtu që çdo model që ofrohet për serbët në veriun e Kosovës të vlejë edhe për shqiptarët në Kosovën Lindore. - Të analizohen dhe diskutohen raportet vjetore nga Bashkimi Evropian, në mënyrë që të evidentohen sfidat të cilat e përcjellin shtetin e Kosovës dhe e pamundësojnë integrimin e Kosovës në BE. - Të mbahen trajnime informuese për integrimin e Kosovës në BE në mënyrë që qytetarët e vendit tonë të jenë më të informuar rreth kësaj çështje.

## Referencat:

### Libra, artikuj, punime

- Abazi, E. [2008]. Kosovo Independence: An Albanian Perspective. SETA Policy Brief, No. 11, 2-5.
- Ahmeti, H. [2022, Maj 12]. Gjendja aktuale dhe sfidat e Kosovës drejt BE. Ekonomia. Gjetur në <http://www.ekonomia-ks.com/sq/opinion/gjendja-aktuale-dhe-sfidat-e-kosoves-drejt-be>
- Ahmeti, K. [2016]. Kriteret e Kopenages.

- Arnorsson, A. & Zoega, G. [2016]. On the causes of Brexit. Londer: BIROn - Birkbeck Institutional Research Online.
- Bajraktari, H. [2014]. ROLI DHE PERSPEKTIVA EUROPIANE E KOSOVËS. Tiranë: Instituti i Studimeve Evropiane. Gjetur në <https://unitir.edu.al/doktoratura-halim-bajraktari-instituti-studimeve-europiane/>
- Bajrami, H. & Krasniqi, L. [2017]. Kosova dhe Marrëveshja për Stabilizim Asociim me BE-në: Rruga e Kosovës drejt Integritimit Ekonomik Evropian [Tryezë shkencore]. Prishtine: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.
- Bashkurti, L. [2006]. Europa Ballkani dhe Sfida e Kosovës. Tiranë: Geer.
- Beqiraj, A. [2012]. Kushtet që Kosova duhet të plotësojë për t'u pranuar në BE. Prishtina: Ballkani.
- Berisha, B. [2021, Shkurt 5]. As këtu as atje: Marrëdhëniet e ndërlikuara të Kosovës me Bashkimin Evropian. sbunker. Gjetur në <https://sbunker.net/histori-nga-rajoni-3-blllogje-tematike/90813/as-ketu-as-atje-marredheniet-e-nderlikuara-te-kosoves-me-bashkimin-evropian/>
- Bodo Weber & Agron Bajrami. [2018]. Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në BE dhe OKB. Berlin-Prishtine: Këshilli për Politika të Demokratizimit [DPC, Berlin], Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur [KFOS, Prishtinë] dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike [GLPS, Prishtinë].
- Bytyqi, J. [2017]. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE TË BE-SË: SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT. Gjetur në <http://www.ajls.org/doc/JBytyqi-AJLS-VOL-I.pdf>
- Çollaku, B. [2006]. Kosova dhe kapacitetet e saja për integrim në BE; Mos lejo që bari të rritet nën këmbë! . Prishtinë: KIPRED [Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave]. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
- Dinan, D. [2010]. Historia e integritimit European. Tirane, Albania: Instituti i Studimeve Nderkombetare.
- Fonten, P. [2010]. Evropa në 12 leksione. Luksemburg: Zyra e botimeve të Bashkimit Evropian.
- Galyan, A. [2014]. Learn as We Go: The European Union's Involvement in Constitution Building in the Post-conflict Western Balkans. STOCKHOLM, SWEDEN: International Institute for Democracy and Electoral Assistance . Dardan, Galyan ose heqe krejt nga bibliografia ose citoje diku në tekst sepse nuk është i cituar.
- Hajrullahu.V, Curri.F. [2017]. Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore të Kosovës në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin European. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile-Prishtine.
- Halili. F. & Halili, V. [2013]. KOSOVA - SFIDAT E INTEGRIMIT. Revista Diskutime, Prishtina. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
- Hoogenboom, J. [2011]. The EU as a Peacebuilder in Kosovo. Bucharest: Civil Society Dialogue Network [CSDN]. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
- Ker-Lindsay.J, Economides.S. [2012]. Standards before Status before Accession: Kosovo's EU Perspective. Journal of Balkan and Near Eastern Studies, 14:1, 77-92. doi:doi.org/10.1080/19448953.2012.656939. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje

ose heqe nga bibliografia.

- Kiçmari, S. [2011]. Rruga e integritit të Republikës së Kosovës në BE. Prishtinë: Republika e Kosovës,
- Ambasada e Republikës së Kosovës në Vjenë.
- Kumar, R. [2014]. Methodology: A Step-by-Step Guide for Beginners . Indiana: SAGE Publications Ltd. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
- Leitão, F.M.A & Valente, I.M.F. [2020]. Kosovo's long road to EU Membership. Periódico do CIEDA e do CEIS20, em parceria com GPE e a RCE.
- Matthews, B. & Ross, L. [2010]. Metodatat e hulumtimit- Udhezues praktik per shkencat sociale dhe humane. Harlow: Pearson Education Limited.
- Mustafa, M & Zogaj, A. [2009]. Sfidat e Kosovës për qëndrueshmëri ekonomike. Prishtine: AAB. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
- Mustafa.I, Havolli.S. [2017]. Rruga e Kosovës drejt integritit ekonomik evropian [Tryezë shkencore]. Prishtine: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës , Seksioni i Shkencave Shoqërore. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
- Nezaj, N. X. [2015]. The development of Kosovo and its relationship with the EU, Discussion Paper, No. 4/15. Hamburg: Europa-Kolleg Hamburg, Institute for European Integration. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
- Sadriu, J. L. [2017]. Bashkimi Evropian: një përmbledhje e shkurtër. Prishtina: Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës.
- Sopi, A. [2022, Korrik 9]. Synimi i Kosovës për statusin e vendit kandidat në BE, një rrugë pa fund. Kallxo. Gjetur në <https://kallxo.com/lajm/synimi-i-kosoves-per-statusin-vendin-kandidat-ne-be-nje-rruge-pa-fund/>
- Keukeleire, S. & Delreux, T. [2014]. The Foreign Policy of the European Union (second edition). Hampshire: Palgrave Macmillan.
- Sydow, B. v. [2010]. The situation in Kosovo and the role of Council of Europe. Strasbourg : Parliamentary Assembly .
- Trabelsi, M. A. [2011]. The impact of the financial crisis on the global economy: can the Islamic financial system help? The Journal of Risk Finance , 12 [1] , 1-11.
- Vuksani, R. [2021]. Çfarë mësojmë nga reagimi i Bashkimit Evropian gjatë procesit të Brexit? Tirana: EuroSpeak.

### Dokumente zyrtare

- Commission, E. [2005]. Regional cooperation in the Western Balkans:A policy priority for the European Union. Brussels: European Commission.
- European Commission. [2003]. Eu-Western Balkans Summit Thessaloniki, 21 June 2003. Selanik : European Commission.
- European Commission. [2020]. Raporti për Kosovën\* 2020. Bruksel: EN.
- European Commission. [2021]. Kosovo\* 2021 Report. Strasbourg: EN.
- Kuvendi i Kosovës [a.d.]. Procesi i integritit në BE: Roli i Kuvendit të Kosovës dhe i Komisionit të tij për Integritim Evropian. Prishtine: Projekt i financuar nga BE, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, PROJEKTI I BINJAKËZIMIT:Përkrahja

- e mëtejme për Kuvendin e Kosovës.
- Qeveria e Kosovës. [2022]. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2022-2026. Prishtina: Republika e Kosovës.
  - Ministria e Punëve të Jashtme. [2020]. Këshilli i Evropës. Prishtina: Republika e Maqedonisë së Veriut. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.
  - Ministria për Dialog. [2016]. Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
  - Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian. [2020]. Strategjia Kombëtare për Integrimin Europian "KOSOVA 2020". Prishtine: GIZ.
  - European Parliament. [2022]. European Parliament resolution of 6 July 2022 on the 2021 Commission Report on Kosovo. Strasbourg: European Parliament.
  - Qeveria e Kosovës. [2012]. Plani i Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Prishtinë: Republika e Kosovës. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.

### Fjalime dhe raporte

- "QELIZA", R. i.-v. [Tetor 2011]. Integrimi në Bashkimin Europian i Nivelit Lokal. Prishtinë: Friedrich Ebert Stiftung.
- Bashkimi Evropian. [2013]. Bashkimi Evropian sqaron: Si funksionon Bashkimi Evropian. Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian.
- Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane. [2020]. Kosova – BE 2.0: Hapat e ardhshëm në procesin integruar të Kosovës. Prishtine: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, KFOS.
- KCSF. [2018]. Rëndësia e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Sektorin Privat. Prishtine: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile [KCSF].
- Osmani, V. [2020, Nentor 3]. Integrimi i Kosovës në BE, kërkohet të tejkalohen dallimet politike. IndeksOnline. Gjetur në <https://indeksonline.net/%E2%80%8Bintegrimi-i-kosoves-ne-be-kerkohet-te-tejkalohen-dallimet-politike/>
- Rauing. [2015]. Fjala e Ambasadorit Raunig, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Konferencën "Integrimi Evropian dhe Bashkëpunimi Rajonal në Ballkanin Perëndimor. "Mes konsensusit dhe kompromisit – Kornizimi i Integritit të Vendeve të Evropës Juglindore". Tiranë: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë- Prezenca në Shqipëri. Ky burim mungon në tekst. Ose citoje ose heqe nga bibliografia.

# Ndikimi i machine learning ne intelegjencen Artificiale

---

Albion Burrniku

Belinda Rexha

---

## ABSTRACT

Inteligjenca artificiale ka përparuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të aplikimit të teknikave të mësimimit të makinave. Sistemet e inteligjencës artificiale tani mund të mësojnë dhe të përmirësohen duke u bazuar në hyrjet e të dhënave, duke ndihmuar në zhvillimin e sistemeve inteligjente që janë të afta për të trajtuar sfida të ndryshme. Ky studim hulumton se si mësimi i makinave ndikon në inteligjencën artificiale, duke u përqëndruar në atë se si ndihmon sistemet e inteligjencës artificiale të funksionojnë në mënyrë më efektive. Puna jonë shkencore fokusohet në mënyrën se si mësimi i makinave ka rritur saktësinë, shpejtësinë dhe interpretimin e sistemeve të inteligjencës artificiale, si dhe implikimet e tij për të ardhmen e inteligjencës artificiale. Vizioni kompjuterik, përpunimi natyror i gjuhës, robotika dhe shumë fusha të tjera kanë parë përdorim të gjerë të mësimimit të makinave në vitet e fundit.

## Fjalët Kyçe:

Machine Learning, Inteligjenca Artificiale, Saktësia, Sistemet, Algoritmet

## 1. Hyrje


Për dekadat e fundit, inteligjenca artificiale ka qenë një fjalë e zhurmshme në botën e teknologjisë. Nga Siri tek makinat e vetë-voztës, bota po mbështetet gjithnjë e më shumë në makinat për të kryer detyra që dikur kryeheshin vetëm nga njeriu. Me futjen e mësimimit të makinës, IA është bërë më e sofistikuar dhe ndikimi i saj në shoqëri është rritur. Mësimi i makinerive ka qenë kritik në evolucionin e inteligjencës artificiale, duke e bërë atë më të efektshme dhe më të saktë. Qëllimi i këtij punimi është të hetojë ndikimin e mësimimit të mak-

inës në inteligjencën artificiale, duke theksuar avantazhet dhe dizavantazhet e saj.

Një nëngrup i inteligjencës artificiale i njohur si “mësimi me makina” i mundëson makinerive të mësojnë nga të dhënat dhe të zhvillohen pa programim eksplicit. Qëllimi i mësimi me makina është të krijojë algoritme që mund të njohin modelet dhe korrelacionet në të dhënat dhe pastaj të përdorin këtë kuptim për të parashikuar ose vendosur mbi të dhënat e freskëta, të paeksploruara. Metodatat e mësimi të makinerive vijnë në forma të ndryshme, të tilla si të mësuarit me përforsim, të mësuarit pa mbikëqyrje dhe të mësuarit e mbikëqyrrur [1].

Në kundërshtim me mësimin pa mbikëqyrje, që kërkon modele në të dhënat pa etiketë, mësimi i mbikëqyrrur përfshin trajnimin e një modeli me të dhëna të etiketuara. Trajnimi i një modeli duke përdorur një sistem stimulues dhe dënues njihet si të mësuarit përforsim. Kujdesi shëndetësor, bankimi dhe transporti janë vetëm disa nga fushat e shumta ku përdoret mësimi i makinerive.

Të mësuarit e makinave qëndron në kryqëzimin e shkencave kompjuterike, inxhinierisë dhe statistikave dhe shpesh shfaqet në disiplina të tjera. Siç do ta shihni më vonë, ai mund të aplikohet në shumë fusha nga politika tek gjeoshkencat. Është një mjet që mund të aplikohet në shumë probleme. Çdo fushë që duhet të interpretojë dhe të veprojë mbi të dhënat mund të përfitojë nga teknikat e mësimi të makinës [2].



## 2. Saktësi e përmirësuar e sistemeve IA

Aftësia e mësimi të makinerisë për të përmirësuar saktësinë e sistemit të inteligjencës artificiale është një nga përfitimet më të rëndësishme të saj. Algoritmet e mësimi të makinerisë mund të shqyrtojnë grupet e mëdha të të dhënave dhe të identifikojnë modelet që mund të mungojnë nga njerëzit. Sistemet e inteligjencës artificiale kanë bërë progres në një numër fushash, falë aftësisë së tyre për të përpunuar sasi të mëdha të dhënash dhe për të zbuluar modele.

Algoritmet e mësimi të makinerive janë shfrytëzuar në shumë fusha të jetës, përfshirë mjekësinë, për të zbuluar saktësisht sëmundjet dhe për të ndihmuar në përmirësimin e shën-

detit të pacientëve. Në sektorin e transportit, algoritmet e mësimit të makinerive janë përdorur për të përmirësuar modelin e trafikut, duke sjellë kohë më të shpejtë udhëtimi dhe efikasitet më të madh. Përmes kësaj teknologjie, bizneset kanë mundësi të kuptojnë më mirë sjelljen dhe preferencat e klientëve të tyre, duke ndryshuar mënyrën e operimit dhe duke bërë një revolucion në sektorin e biznesit..

Shpërthimi i fundit i aplikacioneve që përdorin teknologjinë e inteligjencës artificiale ndodh kryesisht për të përmirësuar cilësinë e mësimit të makinerisë dhe për të përdorur modele të ndryshme dhe më të gjerë të të dhënave. Megjithatë, llogaritjet e mësimit të makinerisë janë një detyrë e vështirë që kërkon një sasi të madhe të kompjuterëve të lidhur në rrjet për të kryer algoritmin e mësimit në mënyrë paralell.

## 2.1 Random forest

Breiman zhvilloi modelin e random forest (RF) si një teknikë transformuese të imitimit. Disa pemë vendimi (decision tree) janë ndërtuar nga random forest duke përdorur bootstrap sampling, por çdo ndarje në pemë merret parasysh vetëm për nën-pjesë të rastit të faktorëve.

Në kontrast me algoritmet e drejtpërdrejta dhe përforcuese, kjo përzgjedhje rastësore e variablave shton diversitetin në model dhe shpesh sjell parashikime më të sakta. Numri i shembujve dhe variablave të përdorura për të ndërtuar modelin RF janë faktorë që mund të ndryshojnë, dhe urtësia konvencionale këshillon vendosjen e numrit të variablave të zgjedhura për të përfshirë si kandidatë në çdo pikë ndarëse, për të qenë rrënja katrore e numrit të përgjithshëm të inpueteve të kandidatit [3].

Model Type	Confusion Matrix		Accuracy (%)	Sensitivity (%)	Specificity (%)	AUC		
	G	T						
Individual Models	ANN	G	6,831	1,072	86.63	86.76	86.49	0.909
		T	1,042	6,861				
	SVM	G	6,911	992	88.67	89.63	87.75	0.917
		T	799	7,104				
	LR	G	6,321	1,582	85.13	86.16	81.85	0.859
		T	768	7,135				
Ensembles	RF	G	6,998	905	91.16	93.44	89.12	0.927
		T	491	7,412				
	HE	G	6,885	1,018	90.61	93.66	87.96	0.916
		T	466	7,437				

**Figura 1. Performanca e modeleve parashikuese duke përdorur 10-Fold Cross-Validation në setin e të dhënave të balancuara**

Kërkimi ynë ka gjetur se shifrat tregojnë se cilat algoritme për mësim e makinerisë e kanë ndihmuar më shumë në rritjen e saktësisë. Megjithatë, ne kemi eksploruar edhe ndjeshmërinë dhe faktorë të tjerë në këtë fushë.


### 3. Rritja e shpejtësisë së sistemeve AI

Një efekt tjetër i rëndësishëm i mëimit të makinës në inteligjencën artificiale është aftësia e saj për të përshpejtuar sistemet e inteligjencës artificiale. Sistemet e inteligjencës artificiale konvencionale kanë nevojë për programim eksplicit, i cili mund të jetë i gjatë dhe i paefektshëm. Mësimi i makinës, nga ana tjetër, lejon sistemet e inteligjencës artificiale të vetë-mësojnë dhe të zhvillohen, duke sjellë si rezultat sisteme më të efektshme dhe më të shpejta.

Në industrinë bankare, për shembull, algoritmet e mëimit të makinës janë përdorur për të identifikuar mashtrimin në kohë reale, duke sjellë si rezultat zbulimin më të shpejtë dhe më të saktë. Algoritmet e mëimit të makinës janë përdorur gjithashtu për të optimizuar proceset e prodhimit të produkteve, duke sjellë si rezultat më shumë prodhim dhe kosto më të ulët. Korporatat tani mund të studiojnë volume të mëdha të dhënash në kohë reale, duke i ndihmuar ato të bëjnë zgjedhje më të sakta dhe më të shpejta [4].

Mund të kuptojmë mjedisin gjithnjë e më të ndërlikuar me ndihmën e mëimit të makinës. Tashmë, sasia e të dhënave me të cilën ne jemi të ekspozuar ka tejkaluar atë që mendjet dhe sensorët tanë mund të përballojnë. Arkivat e sotme të informacionit në internet janë aq të mëdha dhe të mbushura me përmbajtje dixhitale sa që përpunimi manual nuk është më i mundur. Leximi i makinës është procesi i leximit duke përdorur mësimin e makinës.

Ne kërkojmë motorë kërkimi që janë më inteligjentë se ata që mbështeten vetëm në fjalë kyçe. Meqë informacioni tani shpërndahet në një shumëllojshmëri burimesh dhe platformash, duhet të kërkojmë në mënyrë inteligjente secilën dhe të kombinojmë rezultatet [2].




**Figura 2. Aftësitë e njohjes së gjuhës dhe imazhit të sistemeve AI tani janë të krahasueshme me ato të njerëzve**



## 4. Sfidat dhe kufizimet e machine learning në inteligjencën artificiale

Shqetësimet në lidhje me pasojat e mundshme etike të shfrytëzimit të algoritmeve të mësimin të makinës në disa fusha janë ngritur gjithashtu për shkak të mungesës së transparencës së këtyre algoritmeve. Për shembull, mund të jetë e vështirë të mbrohen përfundimet e nxjerra nga një algoritëm i mësimin të makinës në sistemin e drejtësisë penale, veçanërisht nëse rezultate të tilla janë të paragjykuara ose të padrejta. Si rezultat, ekziston një nevojë në rritje për të krijuar sisteme të mësimin të makinës që janë transparente, të përgjegjshme dhe të kuptueshme për njerëzit. Zhvillimi i metodave për t'i bërë algoritmet e mësimin të makinës më të lehtë për t'u kuptuar dhe shpjeguar është një temë e debatuar në fushën e inteligjencës artificiale.



*Fig. 3 DCPS përmbledhje konceptuale (Computing O. Inc. n.d)*

Aplikimet e inteligjencës artificiale tani mbështeten shumë në mësimin e makinës, e cila u mundëson kompjuterëve të mësojnë nga të dhënat dhe të bëjnë parashikime ose gjykime pa programim eksplisit. Mësimi i makinës përballet me një numër vështirësish dhe kufizimesh që kanë një ndikim në ecurinë dhe besueshmërinë e saj, pavarësisht nga suksesi i saj i madh në disa fusha [2]. Nevoja për shumë të dhëna për të trajnuar algoritmet është një nga problemet kryesore me mësimin e makinës në inteligjencën artificiale. Kjo vështirësi është veçanërisht e rëndësishme për mësimin e thellë, një zonë e mësimin e makinës që përdor rrjetet nervore me disa shtresa për të mësuar përfaqësimet e të dhënave me shkallë të ndryshme të abstraksionit.

Mbledhja dhe etiketimi masiv i të dhënave mund të jetë kohë-konsumues dhe i shtrenjtë,

veçanërisht në fushat ku të dhënat janë të rralla ose të ndjeshme. Paragjykimi në algoritmet e mësimit të makinës është një çështje e mundshme që është një pengesë e madhe. Paragjykimi mund të vijë nga një numër vendesh, të tilla si të dhëna të paragjykuara, algoritme të paragjykuara ose interpretime të paragjykuara të rezultateve. Veçanërisht në industri të tilla si kujdesi shëndetësor, bankat dhe drejtësia penale, algoritmet tendencioze mund të sjellin rezultate të pasakta ose zgjedhje diskriminuese, duke ngritur pyetje etike dhe ligjore. Një tjetër pengesë që pengon algoritmet të inteligjencës artificiale të interpretohen dhe të jenë transparente është karakteri i tyre i kutisë së zezë. Mund të jetë e vështirë të dalloni të metat ose paragjykimet pasi është e vështirë të kuptohet se si një model i caktuar i inteligjencës artificiale arriti në përfundimin ose parashikimin e tij. Mungesa e transparencës mund të jetë një pengesë e madhe për adoptimin në industritë ku përgjegjësia dhe besimi janë thelbësore, siç është kujdesi shëndetësor. Vështirësia e menaxhimit të të dhënave me dimension të lartë dhe identifikimi i karakteristikave të dobishme është një tjetër pengesë e inteligjencës artificiale.


Problemi i dimensionalitetit mund të sjellë herë pas here në overfitting, kur modeli merr mbi zhurmën në të dhënat në vend të modeleve themelore. Ky kufizim është veçanërisht i rëndësishëm në fusha si njohja e zërit dhe fotografisë, ku të dhënat janë të ndërlikuara dhe shumëdimensionale.

## 5. E ardhmja e machine learning dhe inteligjencës artificiale

Inteligjenca artificiale dhe mësimi i makinave kanë një të ardhme premtuese. Ndërtimi i sistemeve inteligjente që mund të ndihmojnë shoqërinë në një shumëllojshmëri mënyrash, me siguri do të rezultojë nga përparimi i vazhdueshëm i algoritmeve të mësimit të makinës. Për shembull, algoritmet e mësimit të makinave mund të përdoren në sektorin e arsimit për të përshtatur mësimin, duke përmirësuar rezultatet e studentëve. Për më tepër, optimizimi i rendimentit të korrave dhe reduktimi i mbeturinave duke përdorur algoritme të mësimit të makinave mund të rrisë produktivitetin dhe të ulë kostot në sektorin bujqësor.

Megjithatë, çështjet etike duhet të merren parasysh nëse mësimi i makinave dhe inteligjenca artificiale do të arrijnë potencialin e tyre të plotë. E ardhmja e inteligjencës artificiale dhe mësimi i makinave po duket gjithnjë e më e ndritshme, ndërsa teknologjia vazhdon të rritet shpejt. Këto teknologji kanë potencialin të transformojnë mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe lidhemi me njëri-tjetrin duke analizuar sasi të mëdha të dhënash dhe duke mësuar prej tyre [4].

Krijimi i algoritmeve dhe modeleve gjithnjë e më komplekse është një komponent intrigues i së ardhmes së mësimit të makinave dhe inteligjencës artificiale. Këto algoritme do të jenë në gjendje të trajtojnë të dhëna më të mëdha dhe më të komplikuar si ata përparojnë, duke lejuar parashikime më të sakta dhe më të arsyeshme.



*Figura 4. 5 Trendet kryesore të machine learning për të ardhmen*

## 6. Përfundimi

Si përfundim, mësimi i makinerive ka pasur një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e inteligjencës artificiale, duke rezultuar në sisteme më të avancuara, efikase, dhe të sakta të inteligjencës artificiale. Algoritmet e mësimi të makinerive mundësojnë sistemet e inteligjencës artificiale të analizojnë dhe përpunojnë sasi të mëdha të dhënash, të identifikojnë modellet dhe korrelacionet dhe të bëjnë parashikime ose vendime. Kjo ka çuar në përmirësimin e saktësisë dhe rritjen e shpejtësisë së sistemeve të inteligjencës artificiale, duke i bërë ato më efektive në fusha të ndryshme, të tilla si kujdesi shëndetësor, transporti, prodhimi, dhe bankat. Mësimi i makinerive gjithashtu ka revolucionarizuar mënyrën e operimit të bizneseve, duke u mundësuar atyre të kuptojnë më mirë sjelljen dhe preferencat e klientit të tyre. Megjithatë, mbështetja në rritje në mësimin e makinerive ka ngritur shqetësime edhe në lidhje me privatësinë e të dhënave, paragjykimin dhe çështjet etike. Pavarësisht nga këto sfida, e ardhmja e mësimi të makinerive dhe inteligjencës artificiale duket premtuese, me përparime të vazhdueshme në teknologji dhe aplikime në industritë e ndryshme. Ndërsa ecim përpara, është thelbësore të arrihet një ekuilibër midis përparimit teknologjik dhe konsideratave etike për të siguruar që mësimi i makinerive dhe inteligjenca artificiale vazhdojnë të përfitojnë nga shoqëria duke minimizuar dëmin e mundshëm. Njerëzit po kuptojnë potencialin e mësimi të makinerive për të përmirësuar inteligjencën artificiale. Me aftësinë e saj për të përpunuar sasi masive të të dhënave dhe për të identifikuar modelet që njerëzit mund të mungojnë, mësimi i makinerive po rrit saktësinë dhe shpejtësinë e sistemeve të inteligjencës artificiale. Në fusha të ndryshme si kujdesi shëndetësor, bankat, transporti dhe prodhimi, algoritmet e mësimi të makinerive janë aplikuar për të përmirësuar vendim-marrjen, optimizuar proceset e prodhimit, dhe për të identifikuar mashtrimin në kohë reale. Për më tepër, teknologjia e mësimi nga makina po bëhet një mjet jetik për bizneset në kuptimin e preferencave të klientëve të tyre dhe për të ndryshuar mënyrën e tyre të veprimit në mënyrë revolucionare. Ndërsa te-

knologjia e mësimit nga makina vazhdon të përparojë dhe të zhvillohet, pritet që ajo të luajë një rol të rëndësishëm në formën e së ardhmes së inteligjencës artificiale.

**Mirënjohjet:** Si studentë, ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë Prof. Dr. Hyrmet Mydyti për ndihmën e saj të paçmuar gjatë projektit të letrës kërkimore. mbështetja e saj kanë qenë të rëndësishme për të na ndihmuar të arrijmë qëllimet tona dhe ne e vlerësojmë përkushtimin e saj.

## Referencat:

1. Ethem Alpaydin, [2010], Introduction to Machine Learning, Massachusetts Institute of Technology.
2. Ramesh Sharda, Dursun Delen, And Efraim Turban, [2021], Authorized Adaptation from The United States Edition, Entitled Analytics, Data Science, & Artificial Intelligence: Systems for Decision Support, Pearson Education, Isbn 978-0-13-519201-6.
3. Peter Harrington, [2012], Machine Learning In Action, Manning Publications Co.
4. Ethem Alpaydin, [2016], Machine Learning the New Ai, Massachusetts Institute of Technology.

Burime të tjera:

1. Marco Canini, Amedeo Sapio, [2021], <https://www.innovationnewsnetwork.com/artificial-intelligence-speeds-increased-by-new-technology/10636/>.

Xuli Tang, Xin Li, Ying Ding, Min Song, Yi Bu, [2020],

The Pace of Artificial Intelligence Innovations: Speed, Talent, And Trial-A

# Përdorimi i metodave agile në zhvillimin e softuerit

Faton Xhema

## ABSTRAKT

Zhvillimi i softuerit ka luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në botën industriale. Në fillimet e tij, ai u zhvillua përmes disa metodave tradicionale, por tani ka ndryshuar në metodat agile. Metodot agile, ose mënyra e shkathët e zhvillimit të softuerit, janë një metodë që shumë kompani e përdorin. Kjo metodë përfshin zhvillimin e softuerit nga gjithë ekipi në të njëjtën kohë dhe është shumë funksionale. Pakënaqësia me shpenzimet e përgjithshme të përfshira në metodat e dizajnit të softuerëve dhe kostot e larta që ofroheshin nga metodologjitë e mëparshme gjatë viteve 1980-1990, të njohura si Waterfall, çuan në krijimin e metodave agile. Metodologjia agile ka për qëllim kodimin në vend të dizajnit dhe ka qasje të veçantë ndaj metodologjive të tjera, pasi ato janë të bazuara në përsëritjen e zhvillimit të softuerit. Softueri funksional mund të jetë i gatshëm për kohë më të shkurt dhe mund të bëhen ndryshime të cilat mund të kërkohen nga klienti.

## Key words:

Agjile, Manifesti i Agjile, Principet e agjile

## 1. Hyrje

Zhvillimi i softuerëve ka qenë gjithmonë një sfidë në vetvete, sidomos kur kërkesat e klientëve nuk janë kuptuar mirë dhe metodat tradicionale të zhvillimit nuk kanë funksionuar. Metodot agile dhe zhvillimi i softuerit me to kanë bërë që sfidat të zvogëlohen shumë, duke e bërë të mundur që softueri të dalë në treg sa më efikas dhe në kohë më të shkurtër, dhe me

kosto më të ulët.

Krijimi i programeve kompjuterike duke zbatuar metodat agile arrin të bëhet përmes bashkëpunimit të cilat janë vetë-organizuara si dhe janë ekipet funksionale ku zhvilluesit punojnë në mënyrë përsëritëse dhe graduale. Zhvillimi agil në vete promovon planifikimin adaptiv, ofron një periudhë kohore për qasje përsëritëse, dhe ofron zhvillim evolutiv dhe është i hapur për përgjigje të shpejtë dhe fleksibile për ndryshimet e mundshme në softuer. Zhvillimi i softuerit duke përdorur metodat agile promovon ndërveprime të parapara gjatë gjithë ciklit të zhvillimit të softuerit. Metodatat agile ofrojnë zhvillimin e shpejtë dhe të duhur të softuerit.

Softuerët duhet të zhvillohen më shpejt për të pasqyruar ndryshimin e nevojave të biznesit. Softueri zhvillohet në atë mënyrë që të ketë versione të shumta në mënyrë që të vlerësohet nga palët e interesit se a po përmbushen kërkesat e tyre.

Sipas Mark C. Layton, metodatat agile ofrojnë një menaxhim të projektit ku fokusi kryesor është në përmirësimin dhe ofrimin e hershëm dhe të vazhdueshëm të produktit rreth të cilit janë të vendosura këto metodatat. Kontributi i ekipit në konstruktimin e produktit të testuar krijon një pasqyrim të kërkesave të klientit (Mark C. Layton, 2017).

Andrew Stellman ka një mendim se metodatat agile krijojnë një emocion tjetër dhe se bota e zhvillimit të softuerit ka një mënyrë të qëndrueshme dhe reale në zgjidhjen e problemit ku gjeneratat e mëparshme janë përballur për një kohë të gjatë. Praktikatat e thjeshta dhe të drejtpërdrejta mundësojnë zhvillimin e saktë të softuerit (Andrew Stellman, 2016).

Sipas themeluesve të metodave agile, ka katër vlera të lidhura me metodatat agile që ndihmojnë ekipet në zhvillimin e softuerit, dhe ato janë si vijon:

- Individët dhe ndërveprimet
- Softueri i punës
- Bashkëpunimi me klientët
- Përgjigjja ndaj ndryshimeve
- 

Këto vlerësime ndryshojnë nga metodologjitë e tjera ku vlerat e tyre kanë qenë:

- Proceset dhe mjetet
- Dokumentacioni i plotë
- Negocimi i kontratës
- Ndjekja e një plani

## 2. Metodatat agile

Në zhvillimin e ueb faqeve dhe ndryshimet që u bënë në to, filluan të vështirësohen dhe të komplikohen punët në zhvillimin e softuerit. Në mesin e viteve të 90-ta filloi të ndjehet kjo vështirësi, duke bërë që ekipet të punojnë pa ndalje ditë e natë. Metodologjitë e mëparshme si Waterfall nuk ishin më një zgjidhje e mirë tani. Prandaj, në vitin 2001, një grup prej 17 personash u mblodhën bashkë dhe sugjeruan forma të reja për zhvillimin e softuerit.

Për disa muaj ata arritën të zhvillojnë:

- Manifestin e Agjilit
- Principet e Agjilit
- Aleanca Agile


Ndërsa qasjet e mëhershme ishin të fokusuar në gjërat e ngurta si shmangja e ndryshimeve, dokumentimi i çdo elementi dhe kontrolli në bazë të hierarkisë, manifesti i Agjilit ishte një deklaratë e fuqishme që përbëhej prej jo më shumë se 75 fjalëve. Manifesti fokusohet kryesisht në ecurinë e punës, si konceptin e kryerjes dhe menaxhimin e projektit. Nëse lexojmë vetëm pikat në të majtë, mund të kuptojmë paradigmen e re që kanë parashikuar.

Manifesti ka katër parime kryesore, ku individët dhe ndërveprimet, softueri funksional, bashkëpunimi me klientin dhe reagimi ndaj ndryshimit janë më të vlerësuar se sa proceset dhe mjetet, dokumentimi i hollësishëm, negociimi i kontratës dhe përcjellja e planit.

### 3. Rolet ne metodat agile

Ekipet e agilëve janë ekipet që janë të organizuara në mënyrë që të ofrojnë produktet që mund të ndryshojnë shpejt dhe janë të gatshme për treg në kohë më të shpejtë se me metodat tradicionale. Ekipet agile janë ekipet që janë të ndara në disa role që bëjnë ekipin më efektiv. Metodatat agile funksionojnë duke ndarë përgjegjësitë në disa role të ndryshme. Edhe pse të ndarë në disa role në ekipet agile, askush nuk është shefi i askujt. Roli janë:

- Pronari i produktit (Product Owner)
- Udhëheqësi i ekipit (Team leader) ose Scrum Master
- Anëtarët e ekipit të zhvillimit (Anëtarë të ekipit të zhvillimit)
- Palët e interesit (Stakeholders)



*Figura 1-Rolet ne metodat agile*

## 4. Pronari i produktit

Roli i pronarit të produktit është një rol që ka për qëllim të kuptojë kërkesat e klientit dhe palëve të interesuara. Pronari i produktit është pjesë e ekipit që shpjegon kërkesat e klientit dhe palëve të interesuara zhvilluesve të produktit.

Pronari i produktit gjatë zhvillimit të projektit, duke përdorur metodat agile, duhet të:

- Krijojë planin për projektin duke shqyrtuar strategjitë, drejtimin dhe vendosjen e synimeve.
- Të ketë eksperiencë në fushën e produktit që është duke u zhvilluar.
- Të kuptojë dhe të shfaqë në mënyrën më të mirë kërkesat që vijnë nga klienti tek ekipi që po zhvillon projektin.
- Të ndajë kërkesat e zhvillimit të produktit sipas prioritetit dhe të mbledhë dhe menaxhojë kërkesa të reja.
- Të jetë përgjegjës për buxhetin dhe përfitimin e produktit.
- Të caktojë një datë për përfundimin e funksionaliteteve të produktit.
- Të ndërmarrë veprime dhe të përgjigjet në pyetje gjatë bashkëpunimit ditor me zhvilluesit e produktit.
- Të vendosë në fund të sprintit nëse kërkesat janë përmbushur dhe të vendosë rreth punës nëse është përfunduar në rregull.
- Të tregojë para zhvilluesve arritjet që janë bërë në përfundim të sprintit.

## 5. Udhëheqësi i ekipit

Udhëheqësi i ekipit është personi i cili mbështet ekipin e zhvillimit, heq pengesat organizative dhe kujdeset që projekti të realizohet në bazë të principeve agjile.

Udhëheqësi i ekipit gjatë zhvillimit të produktit përmes metodave agjile duhet të:

- Edukojë pjesëtarët e ekipit rreth vlerave dhe praktikave mbi të cilat është ndërtuar Scrum-i dhe të ndihmojë që së bashku t'i ndjekin këto vlera dhe praktika.
- Largojë pengesat që mund të adresohen nga jashtë ose brenda në drejtim të ekipit të zhvillimit, qoftë drejtpërdrejt ose anasjelltas.
- Rrisë mundësitë e ndërlidhjes midis ekipit dhe palëve të interesuara në produktin që po zhvillohet.
- T'i rrisë nivelet e mirëkuptimit brenda ekipit për palët e ndryshme.
- Largojë shpërqendrimet e ekipit që mund të ndodhin brenda organizatës.

## 6. Anëtarët e ekipit të zhvillimit

Ekipi zhvillues i produktit përbehet nga lloje të ndryshme të njerëzve me përgjegjësi të ndryshme, si zhvillues softuerësh, dizajnues, testues, dhe të tjerë. Roli i tyre është të zhvillo-



jnë produktin sipas mënyrave që i ka paraparë pronari i produktit.

Gjatë zhvillimit softuerik, përmes metodave agile, ekipi zhvillues është:

- Faktori kryesor në krijimin e projektit dhe rezultatet në të.
- Vetë-organizuar dhe vetë-menaxhuar dhe detyrat dhe përgjegjësit përcaktohen sipas dëshirës së ekipit për t'i përfunduar ato.
- Ndër-funksionale, ku ekipi i zhvillimit zotëron të gjitha aftësitë e nevojshme për të përpunuar, dizajnuar, zhvilluar, testuar, integruar dhe dokumentuar kërkesat në funksionalitetin e punës.
- Shumë të aftë dhe ofrojnë mundësi të ndërrimit pa pasur ndonjë problem në produktivitet.
- Të formuar në atë mënyrë që pjesëtarët të mbeten të njëjta nga fillimi deri në fund.
- Vendosur në mënyrë ideale në një hapësirë të përbashkët, për të qenë të bashkuar.

## 7. Palët e interesit (stakeholders)

Palët e interesit ose Stakeholders janë personat të cilët kanë interes në atë projekt. Personat nga fusha të ndryshme shoqërore ose kompani bëjnë pjesë të palëve të interesit.

Palët e interesit në projektet ku përdoren metodat agile përfshijnë:

- Klienti, i cili ka qëllimin kryesor të projektit.
- Njerëz teknikë, si arkitektë të infrastrukturës ose administratorë të sistemit, mund të jenë pjesë e palëve të interesit.
- Si përfaqësues të klientit, mund të jenë pjesë opsionale shitësit, shërbyesit e klientëve, njerëz nga marketingu dhe nga legjislativi.
- Mund të përfshijë ekspertë të produktit ose çështjes përveç pronarit të produktit.
- Palët e interesuara mund të ndihmojnë në sigurimin e njohurive kryesore rreth produktit dhe përdorimit të tij.
- Në fund të sprintit, ata mund të vlerësojnë punën e ekipës së zhvillimit dhe të japin këshilla dhe kritika të pronarit të produktit.
- Palët e interesuara dhe roli që ata luajnë ndryshojnë ndërmjet projekteve dhe organizatave.

## 8. Përfundime

Gjatë shikimit të të dhënave të mbledhura, mund të shohim se metodat agile janë ndër metodat me më së shumti planifikim dhe përllogaritje të atij planifikimi, që e bëjnë të mundur zhvillimin e softuerit në mënyrë shumë më të shpejtë dhe të saktë, bazuar në kërkesat e klientit.

Përdorimi i metodave agile rritet çdo vit me një përqindje shumë të lartë. Në vitin 2020 kishte një rritje prej 37%, ndërsa në vitin 2021, kjo rritje ishte 86%. Metodave agile kanë një sukses prej 42% dhe një dështim shumë të vogël prej 9%, dhe 49% e tyre janë suksesshme,

mirëpo të sfiduara deri në përbushjen e plotë.

Në këtë hulumtim, roli i metodave agile është shumë i veçantë në zhvillimin e softuerit, duke ndikuar në rritjen e produktivitetit të ekipit, si dhe në përbushjen e plotë të kërkesave të klientit në një periudhë më të shkurtër kohore.

Gjatë zhvillimit softuerik, duhet të mundohemi sa më shumë të përbushim manifestin dhe principet e metodave agile, që të arrijmë suksesin e projektit.

## Referencat:

Librat:

1. Andrew Stellman, J. G. [2016]. Head First Agile. O'Reilly Media, Inc.
2. Cohn, M. [2006]. Agile Estimation and Planning. Pearson Education, Inc.
3. Kent Beck, M. B. [2001]. Manifesto for Agile Software Development. Gjetur në <https://agilemanifesto.org/>
4. Mark C. Layton, S. J. [2017]. Agile Project Management [bot. i 2nd]. New Jersey: John Wiley & Sons, Inc.
5. Pekka Abrahamsson, O. S. [2002]. Agile Software Development Methods. Espoo, Finland, Finland: VTT publication.
6. Shala, A. [2014-2015]. Zhvillimi i shpejtë [agjil] i softuerit. nd-Error, Volume 14, Issue 4, 101094.

# Llogaritja kuantike në sigurinë kibernetike

Mehreme Gashi, \_  
Elita Rexha

## ABSTRAKTI

Në këtë punim do flasim për ndikimin e llogarisë kuantike në sigurinë kibernetike. Do të eksplorojmë ndikimin e informatikës kuantike në sigurinë kibernetike dhe do të shqyrtojmë sfidat dhe mundësitë që ajo paraqet. Llogaritja kuantike është një fushë brenda shkencës së informacionit kuantik, që përfshin rrjetet, ndjeshmërinë kuantike dhe simulimin kuantik. Ajo përfiton nga vetitë e kubitëve, ose biteve kuantike, për të kryer operacione në të njëjtën kohë dhe për të zgjidhur probleme të caktuara më shpejt se kompjuterët klasikë. Informatika kuantike është një teknologji me zhvillim të shpejtë që ka potencialin të revolucionarizojë shumë fusha, duke përfshirë sigurinë kibernetike.

Ndërsa kjo teknologji premtan llogaritje më të shpejta dhe komunikime më të sigurta, ajo gjithashtu paraqet rreziqe të reja në siguri, duke kërkuar krijimin e zgjidhjeve të reja të sigurisë. Informatika kuantike është shfaqur si një fushë që përparon me shpejtësi me potencialin për të transformuar fusha të ndryshme të informatikës, duke përfshirë sigurinë kibernetike. Ky dokumentim synon të shqyrtojë implikimet e mundshme të llogaritjes kuantike në sigurinë kibernetike, duke përfshirë dobësitë e protokolleve ekzistuese kriptografike, nevojën për zhvillimin e teknikave të reja të enkriptimit që janë rezistente ndaj kuantike dhe ndikimin në strategjitë e mbrojtjes kibernetike.

Për më tepër, ky dokumentacion trajton sfidat dhe mundësitë që informatika kuantike ofron për sigurinë kibernetike, si dhe pasojat e mundshme të llogaritjes kuantike në industri dhe aplikacione të ndryshme. Ky dokumentim bazohet në burime të ndryshme, si kërkimet akademike, raportet e industrisë dhe njohuritë e ekspertëve.

## Fjalët kyçe:

llogaritja kuantike, siguria kibernetike, teknikat e kriptomit

## 1. Llogaritja kuantike

Llogaritja kuantike është një paradigmë e re informatike që funksionon bazuar në parimet e mekanikës kuantike. Ndryshe me llogaritjen klasike, e cila mbështetet në bit me dy vlera të mundshme (0 ose 1), llogaritja kuantike përdor kubit ose bit kuantikë, të cilët mund të mbajnë disa gjendje në të njëjtën kohë përmes mbivendosjes. Kjo veçori unike lejon kompjuterët kuantikë të kryejnë llogaritjet specifike më shpejt dhe eksponencialisht më efikasë se kompjuterët klasikë. Kjo i bën ata të përshtatshëm për të trajtuar probleme komplekse si faktorizimi i numrave të mëdhenj, që është themeli i shumë protokolleve kriptografike.

Llogaritja kuantike është një nënfushë e shkencës së informacionit kuantik që përfshin rrjetet, sensorin kuantik dhe simulimin kuantik. Ai shfrytëzon vetitë e kubitëve për të kryer operacione paralelisht dhe zgjidhjen e problemeve specifike në mënyrë më efektive se kompjuterët klasikë. Superpozicioni dhe ngatërimi janë dy tipare kritike të kubitëve që i japin kompjuterit kuantik fuqinë e tij. Sidoqoftë, kubitët janë të ndjeshëm ndaj dekoherencës, e cila ndodh kur ndërveprimi i tyre me mjedisin rezulton në humbjen e informacionit. Korrigjimi kuantik i gabimeve (QEC) mund ta trajtojë këtë çështje, por kërkon burime të konsiderueshme.

Kompjuterët kuantikë nuk mund të zëvendësojnë plotësisht kompjuterët klasikë, por ata kanë një potencial të jashtëzakonshëm për zgjidhjen e problemeve në fusha si shkenca e materialeve, biofizika, kimia dhe inteligjenca artificiale. Ruajtja e të dhënave në kompjuterët kuantikë kryhet duke përdorur kubit, të cilët mund të ekzistojnë në një kombinim të gjendjeve të ndryshme derisa të vëzhgohen. Për më tepër, ngatërimi mund të ndodhë midis dy grimcave, duke rezultuar në rezultate të ndërlydhura të matjes, edhe në distanca të gjata.

## 2. Kompjuteri kuantik dhe kriptografia

Informatika kuantike ka potencialin për të ndikuar ndjeshëm në sigurinë kibernetike duke thyer shumë nga algoritmet e enkriptimit që përdoren aktualisht. Kriptografia e çelësit publik, e cila përdoret për të siguruar transaksione në internet, mbështetet në vështirësinë e faktorizimit të numrave të mëdha.

Megjithatë, kompjuterët kuantikë mund të faktorizojnë lehtësisht numra të mëdhenj duke përdorur algoritmin e Shor, i cili e bën kriptografinë e çelësit publik të prekshme ndaj sulmeve. Për më tepër, kriptografia simetrike e çelësit, e cila mbështetet në gjetjen e çelësit sekret të përdorur për të kriptuar dhe deshifruar të dhënat, është gjithashtu në rrezik nga sulmet e llogaritjes kuantike. Ndërsa kompjuterët kuantikë mund të përdoren ende për enkriptimin e të dhënave, sfida e shpërndarjes së çelësve mbetet një problem. Protokollet e reja kriptografike, si shpërndarja e çelësve kuantikë, po zhvillohen për të adresuar këtë problem duke përdorur parimet e mekanikës kuantike për të siguruar transmetimin e sigurt të çelësve sekretë.

Algoritmet e zakonshme të kriptimit, si RSA, AES, ECC, Diffie-Hellman dhe Blowfish, përdorin operacione komplekse matematikore për të krijuar çelësa kriptografikë që janë të

vështirë për t'u thyer. Megjithatë, rritja e llogaritjes kuantike përbën një kërcënim të rëndësishëm për këto metoda tradicionale të kriptimit. Kompjuterët kuantikë përdorin kubit për të kryer llogaritjet paralelisht, gjë që mundëson shpejtësi shumë më të shpejta llogaritëse ndërsa numri i kubitëve rritet. Në vitin 1998, Isaac Chuang dhe Neil Gershenfeld zhvilluan një kompjuter kuantik me dy kubit që ishte në gjendje të zgjidhte një pyetje me katër zgjedhje në të njëjtën kohë, duke demonstruar potencialin e llogaritjes kuantike për të thyer metodat tradicionale të kriptimit.

Kriptografia është procesi i kodimit të një mesazhi, i njohur si tekst shifror, në mënyrë që vetëm marrësi i synuar mund ta kuptojë atë. Dëshifrimi është procesi i kundërt i deshifrimit të tekstit të shifruar përsëri në tekst të thjeshtë. Kriptografia përdoret për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe vërtetimin e informacionit.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të kriptimit: kriptimi simetrik dhe ai asimetrik (ose me çelës publik). Kriptografia simetrike është më e shpejtë dhe përdoret për të kriptuar komunikimet dhe të dhënat e ruajtura, ndërkriptografia me çelës publik përdoret për shkëmbimin e sigurt të çelësve, vërtetimin dhe nënshkrimin dixhital të mesazheve. Të dyja format e kriptimit duhet të jenë të sigurta në aplikacionet në web që i përdorin ato.

### 3. Kriptografia post-kuantike

Për të adresuar sfidat e paraqitura nga llogaritja kuantike, studiuesit po punojnë në zhvillimin e protokolleve të reja kriptografike që janë rezistente ndaj sulmeve kuantike, të njohura si kriptografia post-kuantike. Kriptografia post-kuantike përdor probleme matematikore që besohet se janë rezistente ndaj sulmeve nga kompjuterët klasikë dhe kuantikë. Për shembull, kriptografia e bazuar në rrjetë është një protokoll kriptografik post-kuantik që mbështetet në vështirësinë e problemeve specifike matematikore për të ofruar siguri. Zhvillimi i kriptografisë post-kuantike është thelbësor për sigurimin e sigurisë së infrastrukturës kritike, të tilla si transaksionet financiare, komunikimet qeveritare dhe operacionet ushtarake, të cilat janë të prekshme ndaj sulmeve nga kompjuterët kuantikë. Qeveritë dhe organizatat duhet të marrin masa për të zbatuar protokollin kriptografik post-kuantik për të siguruar që sistemet e tyre të jenë të sigurta ndaj kërcënimeve të paraqitura nga kompjuterët kuantikë.

### 4. Kompjuterët kuantikë dhe siguria kibernetike

Llogaritja kuantike pritet të ketë një ndikim të madh në sigurinë kibernetike, veçanërisht në fushën e kriptimit. Megjithatë, ka ende pasiguri në lidhje me realizueshmërinë, kohën dhe stabilitetin e saj. Potenciali strategjik i teknologjisë kuantike është i rëndësishëm për shkak të integritetit të saj të mundshëm me teknologji të tjera në zhvillim, siç janë analitika e të dhënave të mëdha, blockchain dhe mësimi i makinave. Për shembull, Amazon ka zhvilluar një bazë të dhënash Quantum Ledger që mund të shkallëzojë dhe ekzekutojë transaksionet automatikisht. Zhvillimi i kompjuterëve kuantikë mund të sigurojë një avantazh të rëndë-

sishëm strategjik dhe të nxisë shqetësime për sigurinë kombëtare.

Efekti i llogaritjes kuantike në enkriptimin e të dhënave të ruajtura dhe të komunikuar është një shqetësim kritik. Informatika kuantike ka potencialin për të thyer shumë nga algoritmet e enkriptimit në përdorim aktualisht, duke bërë të dhënat e ndjeshme ndaj sulmeve kibernetike. Sidoqoftë, kompjuteri kuantik ofron gjithashtu mundësi të reja për rritjen e sigurisë kibernetike. Studiuesit po eksplorojnë mënyra të reja për të përdorur llogaritjen kuantike, siç është shpërndarja e çelësit kuantik, për të zhvilluar sisteme enkriptimi të paprekshëm. Llogaritja kuantike po rrit gjithashtu efikasitetin dhe saktësinë e algoritmeve të mësimit të makinave, të cilat mund të përdoren për të zbuluar dhe për t'iu përgjigjur kërcënimeve kibernetike.

## 5. Konkluzioni

Shkeljet e të dhënave dhe sulmet kibernetike po bëhen gjithnjë e më të shpeshta, duke theksuar nevojën për përmirësimin e sigurisë së të dhënave. Një nga kërcënimet që shfaqet për metodat tradicionale të kriptimit është llogaritja kuantike, e cila ka potencialin të thyen shumë protokolle kriptografike që mbrojnë informacionin e ndjeshëm në kohën aktuale. Për të adresuar këtë sfidë, studiuesit po eksplorojnë zhvillimin e kriptografisë kuantike, e cila synon të krijojë një ekosistem të ri kriptografik që është rezistent ndaj llogaritjes kuantike. Megjithatë, mbetet ende e paqartë nëse llogaritja kuantike do të bëhet realitet së shpejti apo do të mbetet një koncept. Megjithatë, është e qartë se sistemet tona kompjuterike duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve të rëndësishme për t'u përgatitur për ndërprerje të tilla, pasi kjo mund të vërë në rrezik informacionin e të gjithë popullsisë.

Informatika kuantike ka potencialin të jetë një teknologji transformuese për sigurinë kibernetike, por gjithashtu paraqet rreziqe të reja sigurie që duhen adresuar. Zhvillimi i protokolleve kriptografike post-kuantike është thelbësor për garantimin e sigurisë së infrastrukturës kritike, ndërsa kërkimet e reja në aplikimet e llogaritjes kuantike mund të ofrojnë zgjidhje inovative për rritjen e sigurisë kibernetike. Ndërsa kompjuteri kuantik vazhdon të evoluojë, është jetik që qeveritë dhe organizatat të mbeten vigjilente dhe proaktive në adresimin e sfidave dhe mundësive që paraqet.

## Referencat:

1. "Quantum Computing for Computer Scientists" by Noson S. Yanofsky and Mirco A. Mannucci
2. "Quantum-Safe Cryptography" by Vadim Lyubashevsky, Chris Peikert, and Thomas Prest, J., & Winterfeld, S. [2014].
3. Cyber Warfare: Techniques, Tactics and Tools for Security Practitioners
4. Malloy, I. [2013]. Quantum cryptography goes mainstream

# Përdorimi i entropisë së informacionit në gjenerimin e fjalëve në lojën Wordle

Shkodran Hasani

## ABSTRAKT

Loja Wordle është një lojë që ka fituar një popullaritet të madh gjatë vitit 2022, në të cilën shumë lojtarë kanë ndarë rezultatet e tyre në rrjetet sociale. Një fjalë pesë-shkronjëshe përzgjedhet çdo ditë, të cilën lojtarët kanë gjashtë mundësi për ta gjetur. Pas çdo tentative, lojtarëve u ofrohen të dhëna se cila shkronjë gjendet në përgjigjen përfundimtare ose në pozitën e duhur. Cila është fjala optimale që do të na çonte në përgjigjen përfundimtare dhe cili është numri i mundësive për të arritur këtë përgjigje në sa më pak prova? Një mënyrë efektive është përdorimi i entropisë së informacionit.

Në këtë punë do të flasim për lojën Wordle dhe teorinë e informacionit duke përdorur një projekt që kam ndërtuar në gjuhën programuese JavaScript [[link](#)], ku do të shohim avantazhet dhe mangësitë që na jep përdorimi i entropisë në matjen e informacionit që përmban çdo fjalë dhe përzgjedhjen e atyre optimale.

## Fjalët kyçe:

Entropia e Informacionit, Probabiliteti, Analiza e frekuencës, Wordle, Wordle Solver, Javascript.

## 1. Hyrje

Wordle është një lojë e bazuar në ueb e krijuar dhe zhvilluar nga inxhinieri i softuerit Josh Wardle, e publikuar nga kompania The New York Times që në fillim të vitit 2022. Konceptualisht, Wordle është e ngjashme me lojën Mastermind të vitit 1970 (Machkovech, 2022), por që përdor shkronjat (Wordle) në vend të ngjyrave (Mastermind).

Wordle ka një zgjidhje të vetme ditore, ku të gjithë lojtarët kanë gjashtë mundësi për të gjetur një fjalë pesë-shkronjëshe të përzgjedhur si përgjigje. Pas çdo supozimi të lojtarit, ofrohen të dhëna që tregojnë kur shkronjat përputhen ose zënë pozicionin e duhur.

Edhe pse rregullat janë të lehta për t'u kuptuar dhe nuk kërkohet njohuri paraprake, sfida kryesore qëndron tek arritja e përgjigjes së fundit me sa më pak provë. Kjo ka shtyrë shumë njerëz në të gjithë botën të tentojnë të ndërtojnë algoritme dhe teknika të ndryshme me qëllim që të gjejnë përgjigjen përfundimtare në sa më pak provë.

Duke marrë parasysh faktet e cekura më lartë në këtë punim do të flasim kryesisht për entropinë e informacionit dhe përdorimi i saj në algoritmin për zgjidhjen e Wordle-s nga perspektiva e programimit (projektit të punuara në JavaScript), ku do të kuptojmë funksionin që kryen pjesë të ndryshme të kodit si dhe rezultatet që na ofron.

## 2. Rregullat e lojës

Me fillimin e lojës, lojtari gjendet para një table 5×6 me celula të zbrazëta, në të cilat do të vendosë fjalët që i sheh si të sakta. Pas çdo përpjekjeje, secila shkronjë shënohet me ngjyrë të gjelbër, të verdhë ose gri. Celula e gjelbër nënkupton se shkronja e vendosur në të është e duhur dhe në pozicionin e duhur, ndërsa celula e verdhë nënkupton se shkronja përkatëse gjendet në përgjigjen përfundimtare, por në një pozicion tjetër. Celula gri nënkupton se shkronjat e tilla nuk janë pjesë e përgjigjes përfundimtare.

## 3. Teoria e informacionit

Komunikimi është procesi i transmetimit të informacionit nga dërguesi tek marrësi, duke përdorur tingujt, shenjat ose veprimet. Për të matur sasinë e informacionit, mund të përdoret entropia dhe përfaqësimi kuantitativ i saj me bit (shkurtesë e “binary digit”). Një bit paraqet informacionin që kërkohet për një pyetje që mund të pranojë vetëm dy përgjigje të mundshme: po ose jo (Shannon & Weaver, 1963).

Hedhja e një monedhe metalike është një rast konkret që ilustron se si mund të matet sasia e informacionit. Supozojmë se personi A hedh një monedhë metalike dhe personi B mund të gjejë rezultatin duke e pyetur vetëm një pyetje: “A është rezultati ‘numër’?” Nëse përgjigja e personit A është “po”, atëherë personi B kupton se rezultati ishte “numër”, ndërsa nëse përgjigja është “jo”, atëherë rezultati ishte “stemë”. Nga ky shembull mund të konkludojmë se hedhja e një monedhe metalike përmban një bit informacioni.

Nga observimi i eventeve të ndryshme vijmë në përfundim se për:

$$k = 2,4,8,16\dots \Rightarrow I = 1,2,3,4\dots$$

Nga ku nxjerrim formulën:  $I = \log_2 k$  (1)


I - informacioni (numri i pyetjeve)

k - numri i rezultateve të mundshme (hapësira e rezultateve)



## 4. Entropia e informacionit

Por, a prodhon të njëjtin informacion një ngjarje nëse probabiliteti i ndodhjes së ngjarjes nuk është i barabartë? Supozojmë që kemi dy aplikacione, secila prej tyre gjeneron një varg të karaktereve të përbërë prej 4 shkronjave (A, B, C, dhe D) (Khan Academy, 2014). Aplikacioni 1 gjeneron shkronjat në mënyrë plotësisht të rastësishme (25% A, 25% B, 25% C, 25% D), ndërsa aplikacioni 2 gjeneron shkronjat sipas një probabiliteti të caktuar (50% A, 12.5% B, 12.5% C, 25% D). Për të kuptuar se sa informacion përmban secila shkronjë, përdorim metoden e lartëcekur.



**Figura 1. Paraqitja në formë vizuale të matjes së informacionit**

Në rastin e aplikacionit 1, mund të thuhet se për identifikimin e çdo shkronje nevojiten të paktën dy pyetje, pasi që çdo shkronjë përmban dy bitë informacioni. Ndërkaq, në aplikacionin 2, shkronja A përmban një bitë informacioni, shkronja D përmban dy bitë informacioni, ndërsa shkronjat B dhe C përmbajnë nga tre bitë informacioni.

Nëse kalkulojmë mesataren:

$$I = p_a \cdot I_a + p_b \cdot I_b + p_c \cdot I_c + p_d \cdot I_d$$

$$I = 0.5 \cdot 1 + 0.125 \cdot 3 + 0.125 \cdot 3 + 0.25 \cdot 2 = 1.75 \text{ bit}$$

p - probabiliteti

Në këtë shembull kuptojmë se sa më pak simbole të rastësishëm gjenerohen, aq më pak informacion përmban një event i caktuar. Nga ky konkludim, Shannon dha formulën e tij për llogaritjen e entropisë së informacionit, e quajtur nga ai “liria e zgjedhjes” (ang. The freedom of choice) (Shannon & Weaver, 1963).

$$H = p_1 \cdot I_1 + p_2 \cdot I_2 + \dots + p_n \cdot I_n = \sum_i p_i \cdot I_i$$

$$H = \sum_i p_i \cdot \log_2(1/p_i) \tag{2}$$

H – entropia e informacionit (bit).

## 5. Matja e informacionit të fjalëve

Më parë, kemi përmendur se njësia për matjen e informacionit është bit-i. Formulën ekuaioni (1) e kemi përmendur për të ilustruar se nëse një ngjarje përgjysmon numrin total të rasteve të mundshme, atëherë themi se ka një bit informacion. Në rastin tonë, numri total i rasteve përmban një listë prej 12972 fjalësh dhe rezulton se rreth gjysma e këtyre fjalëve përmbajnë shkronjën “S”. Kjo ngjarje ofron rreth një bit informacion. Në të njëjtën mënyrë, rreth çerek i fjalëve përmbajnë shkronjën “T”, duke treguar se ky lloj ngjarjeje përmban dy bit informacion (Sanderson, 2022). Për të llogaritur informacionin që përmban një fjalë, duhet të iterohet tek çdo shkronjë në fjalën përkatëse, duke gjetur numrin e bit-ve të informacionit që përfaqëson secila prej tyre, dhe në fund të llogarisë shuma totale e bit-ve të informacionit.

## 6. Ndërtimi i algoritmit të Wordle-s

Në këtë pjesë do të shqyrtojmë ndërtimin e kodit të algoritmit që fillon me kalkulimin e entropisë së çdo fjale për secilin pattern të mundshëm dhe gjen shumën e tyre. Pastaj, fjala me vlerën më të lartë zgjidhet si përgjigje.

```
1 import { possibleWords } from './../data/words.js';
2 import { matchedWords } from './filter.js';
3 let wordsLength = 5;
4 let bestWord;
5
6 let patterns = [];
7 const numberOfPatterns = Math.pow(3, wordsLength);
```

Si fillim kemi importuar listat `possibleWords` e cila përmban të gjitha fjalët e mundshme dhe listën `matchedWords` e cila do të ruaj fjalët të cilat e plotësojnë kushtin e pattern-ave të zbuluar paraprakisht, kemi deklaruar variablën `wordsLength` e cila mbanë vlerën e numrit të shkronjave që ka një fjalë (pesë) dhe variablën `bestWord` në të cilën do të ruhet fjala optimale për përgjigjen e lojës. Gjithashtu kemi deklaruar listën `patterns` e cila do të mbart vlerën e të gjithë pattern-ave të mundshëm të një fjale (për shënimin potencial të shkronjave me ngjyrë të gjelbër, të verdhë apo gri do të përdoren numrat 2, 1 apo 0). Kemi krijuar dhe variablën `numberOfPatterns` e cila tregon numrin e mundshëm të pattern-ave: .

```

8   for(let i = 0; i < numberOfPatterns; i++) {
9       patterns[i] = [];
10      let temp = i.toString(3).padStart(wordsLength, 0);
11      for(let j = 0; j < wordsLength; j++) {
12          patterns[i][j] = parseInt(temp[j]);
13      }
14  }

15
16  function informationEntropy() {
17      ... // algorithm code
79  }

```

Gjenerimi i këtyre pattern-ave realizohet në mënyrë automatike duke përdorur metodën `toString()`, e cila bënë konvertimin e një numri decimal (me bazë 10) në numër me bazë 3 (pasiqë si parametër ka numrin 3). Paralelisht me gjenerimin e numrave është përdorur metoda `padStart()`, e cila ka për detyrë që çdo gjenerim të pattern-it ta shndërroj në vlerë pesëshifrore duke shtuar zero në fillim të numrit sipas nevojës.

```

17  let matches = matchedWords.length;
18  let entropyValue = 0;
19  let entropyArray = [];
20  for(let h = 0; h < possibleWords.length; h++) {
21      for(let i = 0; i < numberOfPatterns; i++) {
22          for(let j = 0; j < matchedWords.length; j++) {
23              for(let k = 0; k < wordsLength; k++) {
24                  ... // if statements
41              }
42          }... // reset matches
          }... // reset entropyValue
25      }

```

Brenda metodës `informationEntropy()` kemi deklaruar variablën `matches` e cila do të përmbajë numrin e fjalëve që përshtaten një pattern-i të caktuar, variablën `entropyValue` e cila do të përmbajë vlerën mesatare të entropisë së një fjale të caktuar dhe listën `entropyArray` në të cilën do të ruhen vlerat e entropisë së të gjitha fjalëve. Kjo arrihet përmes iterimit në katër unaza të ndërthurura.

```

24  if(patterns[i][k] === 2) {
25    if(possibleWords[h][k] !== matchedWords[j][k]) {
26      matches--;
27      break;
28    }
29  }else if(patterns[i][k] === 1) {
30    if(!matchedWords[j].includes(possibleWords[h][k]) ||
31    possibleWords[h][k] === matchedWords[j][k]) {
32      matches--;
33      break;
34    }
35  }else {
36    if(matchedWords[j].includes(possibleWords[h][k])) {
37      matches--;
38      break;
39    }
40  }

```

Nëse pattern-i i caktuar ka vlerën dy atëherë eliminohet çdo fjalë nga lista `matchedWords` e cila nuk e përmban shkronjën e caktuar në këtë pozitë. Nëse pattern-i ka vlerën një atëherë eliminohet çdo fjalë që nuk e përmban shkronjën e caktuar apo edhe fjalët që e përmbajnë shkronjën në po atë pozitë (sepse fjala `possibleWords[h]` e përmban këtë shkronjë por në pozitë tjetër). Ndërsa nëse patterni ka vlerë zero, atëherë largojë të gjitha fjalët që e përmbajnë këtë shkronjë.

```

43  if(matches > 0) {
44    let probability = matches / matchedWords.length;
45    let information = Math.log2(matchedWords.length / matches);
46    entropyValue += probability * information;
47  }
48  matches = matchedWords.length;

```

Pas përfundimit të eliminimit të fjalëve që nuk përputhen, fillojmë me kalkulimin e entropisë për çdo pattern të mundshëm, që ka së paku një fjalë (`matches > 0`). Entropia e fjalës përfitohet përmes kalkulimit të shumës totale të prodhimit mes probabiliteti të një pattern-i dhe informacionit që jep ky pattern (shih *ekuacioni (2)*). Më pas bëhet resetimi i variablës `matches`, për kalkulimin e entropisë për fjalën e radhës.

```

50  entropyValue = parseFloat(entropyValue.toFixed(2));
51  entropyArray[h] = entropyValue;
52  entropyValue = 0;

```

Duke përdorur metodën `toFixed()` vlerat e fituara të entropisë rrumbullakohen në dy numra pas presjes dhjetore dhe ruhen në listën `entropyArray`, gjithashtu edhe vlera e `entropyValue` resetohet për tu përdorur për ruajtje e vlerës së entropisë së fjalës së ardhshme.

```

56  indexArray = [];
57  for(let i = 0; i < possibleWords.length; i++) {
58    if(matchedWords.includes(possibleWords[i])) {
59      indexArray.push(i);
60    }
61  }
62  let maxValue = entropyArray[0];
63  bestWord = possibleWords[0];
64  let tempIndex = 0;

```

Pasi kemi kalkular entropinë e informacionit për të gjitha fjalët, duhet gjetur vlerën maksimale. Paraprakisht për të gjitha fjalët që mund të jenë përgjigje potenciale të lojës (`matchedWords`) indekset e tyre i ruajmë në një listë të quajtur `indexArray`.

```

65  for(let i = 0; i < entropyArray.length; i++) {
66    if(entropyArray[i] > maxValue) {
67      maxValue = entropyArray[i];
68      bestWord = possibleWords[i];
69      tempIndex = i;
70    }
71    else if(entropyArray[i] === maxValue) {
72      if(indexArr.includes(i) && !indexArr.includes(tempIndex)) {
73        maxValue = entropyArray[i];
74        bestWord = possibleWords[i];
75        tempIndex = i;
76      }
77    }
78  }

```

Duke iteruar në të tërë listën e gjejmë vlerën maksimale dhe e ruajmë në variablën `maxValue` dhe fjalën përkatëse në variablën `bestWord`. Një hap shtesë që duhet ndërmarr, njëherazi arsyeja e përdorimit të listës `indexArray` është detektimi i vlerave të barabarta. Në rast se dy apo më shumë fjalë kanë vlera të njëjta të entropisë, atëherë përzgjedhja e vlerës maksimale bëhet duke marr për bazë se cila fjalë gjendet në listën e përgjigjeve të mundshme.

## 7. Përfundime

Gjatë testimit të algoritmeve të ndryshme, arritëm në përfundimin se përdorimi i entropisë së informacionit ofron performancën më të mirë në aspektin e saktësisë dhe efikasitetit. Në fakt, kjo metodë arrin zgjidhjen e lojës në 100% të rasteve. Përveç kësaj, entropia e informacionit gjen përdorim edhe në analizën e strukturës së fjalëve dhe fjalive, si dhe në kompresimin e informacionit, ndër të tjera.

## Referencat:

1. Khan Academy. [2014, April 28]. Information entropy. Retrieved from <https://www.khanacademy.org/computing/computer-science/informationtheory/moderninfotheory/v/information-entropy>
2. Machkovech, S. [2022, March 25]. Wordle creator describes game's rise, says NYT sale was "a way to walk away". Retrieved from arsTechnica: <https://arstechnica.com/gaming/2022/03/wordle-creator-describes-games-rise-says-nyt-sale-was-a-way-to-walk-away/>
3. Sanderson, G. [2022, February 6]. Solving Wordle using information theory. Retrieved from 3blue1brown: <https://www.3blue1brown.com/lessons/wordle>
4. Shannon, C., & Weaver, W. [1963]. The Mathematical Theory of Communication. Urbana, United States of America: The Univeristy of Illinois Press. Retrieved from [https://monoskop.org/images/b/be/Shannon\\_Claude\\_E\\_Weaver\\_Warren\\_The\\_Mathematical\\_Theory\\_of\\_Communication\\_1963.pdf](https://monoskop.org/images/b/be/Shannon_Claude_E_Weaver_Warren_The_Mathematical_Theory_of_Communication_1963.pdf)

# The Impact of Social Media on Mental Health

---

Eda Lakna

---

## ABSTRACT

Siç po e shohum edhe në grafikun 48% e respondentëve e përdorin telefonin 2-5 orë në ditë, 26% e respondentëve e përdorin telefonin 6-10 orë në ditë, 19% e respondentëve e përdorin telefonin më pak se 2 orë dhe 7% e respondentëve janë shprehur se e përdorin telefonin mbi 10 orë në ditë.

#### 4.18. Cilin aplikacion e përdor më së shumti në telefon?




Ky është grafikoni ku respondentët tregojnë për aplikacionet të cilat i përdorin më së shumti, ku shihet se 43% e respondentëve përdorin aplikacionin “snapchat”, 37% e respondentëve përdorin aplikacionin “instagram”, 8% e respondentëve përdorin aplikacionin “viber”, 7% e respondentëve përdorin aplikacionin “what’s app” dhe 5% e respondentëve e përdorin aplikacionin “facebook”.

#### 4.19. A përdorni lëndë narkotike?



Siç shihet në këtë grafikë 99% e nxënësve janë përgjigjur se nuk përdorin lëndë narkotike. Një person(1%) shprehet se përdor lëndë narkotike dhe i përket gjinisë mashkullore.

#### 4.20. Në çfarë moshe keni filluar të përdorni lëndë narkotike?



Në këtë pyetje është vetëm përgjigjja e një respodenti.

Dhe kjo përgjigje është se kur ka filluar respodenti që të përdor lëndë narkotike,ku respodenti shprehet se në moshën 15 vjeqare ka filluar të përdor lëndë narkotike.

#### 4.21. Sa orë në ditë kaloni bashkë me prindërit?


16. Sa i përket kësaj pyetje se “Sa orë në ditë kaloni bashkë me prindërit?” përgjigjja ka qenë e hapur, ku janë përgjigjur me përgjigje të ndryshme.

Ku përgjigjet e tyre ishin:

30 min – 1person	5-6 orë – 5 persona	10-15 orë – 1 person
1 orë – 1 person	5-8 orë – 2 persona	12 orë – 6 persona
2 orë – 4 persona	6 orë – 9 persona	14 orë – 1 person
2-3 orë – 3 persona	7 orë – 7 persona	17 orë – 1 person
3 orë – 4 persona	7-8 orë – 1 person	18 orë – 4 persona
3-4 orë – 5 persona	8 orë – 5 persona	20 orë – 1 person
4 orë – 3 persona	8-9 orë – 1 person	22 orë – 1 person
4-5 orë – 2 person	9 orë – 1 person	24 orë – 1 person
5 orë – 7 persona	10 orë – 10 persona	


Refuzon të përgjigjet - 9 persona  
 Jetim – 1 person  
 Rrallë najherë rri – 1 person  
 Shumë – 1 person  
 Gjysmën e ditës – 1 person  
 Shumicën e kohës – 1 person  
 Gjatë gjithë kohës jam me prindërit – 1 person

#### 4.22. A jeni të lirshëm të flisni tema të ndryshme me prindërit?




Në këtë pyetje 94% e respondentëve janë përgjigjur se flasin lirshëm me prindërit dhe 6% e respondentëve janë përgjigjur se nuk flasin lirshëm sepse kanë frikë.

#### 4.23. Sa para shpenzon në ditë?




Në këtë pyetje 57% e respondentëve janë përgjigjur se shpenzojnë deri në 3 euro, 35% e respondentëve janë përgjigjur se shpenzojnë 3-7 euro në ditë dhe 8% e respondentëve janë përgjigjur se shpenzojnë më shumë se 7 euro në ditë.

#### 4.24. A keni menduar ndonjëherë të lëndoni vetveten?



Siç shihet edhe në grafikon 88% e respondentëve janë përgjigjur se nuk kanë menduar ta lëndojnë vetveten kurse 12% e respondentëve kanë menduar ta lëndojnë vetveten.

#### 4.25. Si keni reaguar kur keni pare një zënkë në shkollë?



Sa i përket kësaj pyetje 81% e respondentëve janë përgjigjur se kur kanë parë zënkë në shkollë janë larguar nga aty kurse 19% e respondentëve janë përgjigjur se kur kanë parë zënkë në shkollë janë përfshirë në zënkë.

## 5. Analizimi i të dhënave dhe diskutimet

### 5.1. Njohuritë për shprehjet negative të adoleshentëve

Respondentët pohojnë se kanë njohuri shumica nga ta për shprehjet negative të adoleshentëve. Disa respondent treguan se nuk kanë njohuri dhe disa pohojnë që nuk kanë aspak njohuri. Kjo do të thotë se edhe pse jemi popullsi me një teknologji të përparuar prapëseprapë kemi ngecje në vetëdijësimin e adoleshentëve.

### 5.2. Informimi për shprehjet negative të adoleshentëve

Shumica e respondentëve u shprehën se informimin më të madhe e kishin nga interneti, rrethi shoqëror dhe mësimdhënësit dhe një pjesë e vogël janë shprehur se informimi ishte nga drejtorja e shkollës ose nuk kishin fare njohuri për shprehjet negative të adoleshentëve.

### 5.3. Mendimet e adoleshentëve për shprehjet negative

Për adoleshentët shprehjet më të mëdha negative janë droga, alkooli, dhuna dhe duhani kurse për telefon vetëm një % e vogël e konsidrojnë shprehjet negative. Kjo vërejtje si pasojë që në ditët e sotme edhe fëmija më i vogël i familjes bartë telefon apo ka telefon të personalizuar dhe për këtë shkak telefonin sipas adoleshentëve nuk është shprehje negative.

### 5.4. Fillimi i konsumimit të duhanit, shpeshësia dhe përdorimi i tij

Në qoftë se bazohemi se kur adoleshentët fillojnë ta konsumojnë duhanin atëherë vërehet qartë se pas moshës 15 vjeçare pra në kohën e adoleshencës fillohet më së shumti përdorimi



i pirjes së duhanit. Kjo ndodh për shkak se adoleshentët në këtë moshë kanë një vetëbesim tek vetja dhe çdo here janë të gatshëm të provojnë gjëra të reja.

Sa i përket pirjes së duhanit mund të themi se 88% e adoleshentëve të Komunës së Obiliq-it nuk e konsumojnë duhanin, kjo vërejtje gjatë shoqërore dhe si pasojë e vetëdijës familjare. Kurse 12% e adoleshentëve e konsumojnë duhanin ku shumica nga ta kanë dhe familjarët që e konsumojnë duhanin.

Kurse sa i përket se sa shpesh e konsumojnë duhanin atëherë e vërejmë se është konsumim i pakët i duhanit. Pra ne si kolektive studentore më së miri e dime se shumica e duhanpirësëve, duhanpirjen e fillojnë gjatë shkollimit të mesëm andaj me këtë lëmë të kuptojmë se në qoftë se në të ardhmën do kemi ndonjë trajnim për këtë fenomenë që është duke ndodhur gjatë kësaj kohe mund të them se do këtë sukses sepse adoleshenca ka ndikim tepër të madhe nga rrethi shoqëror.

### **5.5. Fillimi i konsumimit të alkoolit, shpeshësia dhe përdorimi i tij**

Sa i përket fillimit të konsumimit të alkoolit themi se fillojnë pas moshës 15 vjeqare një numër i vogël konsumimin e alkoolit e fillojnë para moshës 15 vjeqare. Përdorimi i alkoolit tek adoleshentët nën moshën 15 vjeqare mund të ndodh vetëm pa dijen e prindërve sepse asnjë prindër nuk e lejon fëmijun e tij të konsumojë alkool në këtë moshë të re. Kurse sa i përket konsumimit të alkoolit pas moshës 15 vjeqare kam vërejtur se shumica nga ta kanë konsumuar alkool vetëm gjatë festave dhe gjatë observimit kam vërejtur se konsumimi i alkoolit ka ndodhur në prani të prindërve dhe sasia është caktuar nga prindërit.

Sa i përket shpeshësisë, duke u bazuar në hulumtim themi se kemi adoleshentë që konsumojnë alkool në ditë, javë dhe muaj. Por % më e madhe ka qenë konsumimi vetë gjatë festave.

Gjatë observimit kam vërejtur se shumica e adoleshentëve nuk e konsideronin përdorim të alkoolit, konsumimin e alkoolit gjatë festave sepse thoshin “na veç natën e Vitit të Ri pijna”.

### **5.6. Përdorimi dhe kohëzgjatja e qëndrimit në telefon**

Sa i përket përdorimit të telefonit nga hulumtimi kuptojmë se të gjithë adoleshentët përdorin telefon mobil të personalizuar kurse sa i përket kohëzgjatjes së qëndrimit në telefon mund të themi se adoleshentët qëndrojnë një periudhë të madhe në telefon por 19% e adoleshentëve rrin më pak se 2 orë në telefon.

Mund të them se si pasojë e përdorimit të madhe të telefonit është dhe një sukses i dobët i adoleshentëve në shkollat e mesme.

### **5.7. Aplikacioni më i përdorur i telefonit**

Sa iu përket aplikacioneve më të përdorura me hulumtim vërejmë se “snapchat” dhe “Instagram” janë aplikacionet më të përdorura tek adoleshentët kurse “viber”, “what’s app” dhe “facebook” janë më pak të përdorura.

Kjo ndodh si pasojë se adoleshentët përdorin aplikacionet më të reja kurse nuk i përdorin aplikacionet pak më të vjetra.

## 5.8. Përdorimi dhe fillimi i lëndëve narkotike

Sa i përket se “*A përdorin lëndë narkotike?*” me hulumtimin e bërë dalim në konkludim se adoleshentët nuk përdorin lëndë narkotike përveç një adoleshenti i cili ka shprehur se përdor lëndë narkotike dhe se kur ka filluar që të përdor lëndë narkotike ka qenë në moshën 15 vjeçare.

Gjatë observimit ende pa e shpërndarë anketën tek ai person kam vërejtur ndryshim si “për nga mënyra e të folurit”, si “për nga sjellja arrogante e tij që kishe jo vetëm me mua por edhe me profesorin dhe drejtoreshën”.

## 5.9. Koha e përbashkët dhe çiltërsia me prindërit

Sa i përket se sa kohë adoleshentët kalojnë me prindërit e tyre kemi përgjigje të shumta e të ndryshme sepse në hulumtim ka qenë pyetje me përgjigje të hapur.

Ku sipas përgjigjeve të respondentëve themi se shumica e adoleshentëve qëndrojnë bukur shumë kohë me prindërit e tyre.

Kurse,sa i përket se “*A janë të lirshëm të flasin tema të ndryshme me prindërit?*”, shumica e adoleshentëve janë të lirshëm të flasin dhe shprehen lirshëm me prindërit e tyre.Por, ka edhe nga ata që nuk mund të flasin lirshëm me prindërit sepse kanë frikë.Kjo frikë që kanë nga prindërit pastaj mund t’i shtien adoleshentët të bëjnë gjëra të ndryshme,të provojnë gjëra të ndryshme siç janë:duhani, alkooli, dhuna, lëndët narkotike sepse me një fjalë prindërit asnjëherë nuk janë në dijeni se çka bëjnë fëmijët e tyre në atë rast.

## 5.10. Shpenzimet ditore dhe lëndimi i vetëvetës

Sa i përket shpenzimeve ditore që adoleshentët kanë gjatë ditës hulumtimi vërteton se shpenzimet janë të larta dhe duke u bazuar se secila familje ka 2-3 fëmijë janë edhe më të larta.Pastaj duke u bazuar që pagat janë të vogla në Kosovë vërejmë se prioritet për familjet kosovare janë fëmijët e tyre.

Kurse sa i përket se “*A kanë mendur ndonjëherë ta lëndojnë vetëveten?*” pjesa më e madhe janë shprehur se jo por një pjesë jo e vogël janë shprehur se po kam menduar ta lëndojnë vetëvetën ku prej tyre të gjitha kanë qenë nga gjinia femërore.Kjo do të thotë se gjinia femërore janë ende të shtypur dhe fjala e tyre nuk vlen sa e një mashkulli adoleshent.

## 5.11. Përfshirja në zënka shkollore

Sa i përket përfshirjes në zënka shkollore me hulumtim dalim në konkludime se 81% e adoleshentëve janë larguar nga zënkat dhe një pjesë prej 19% e adoleshentëve janë përfshirë në zënkë ku kryesisht janë gjinia mashkullore.Kjo vie si pasojë se gjinia mashkullore në adoleshencë kanë vetëbesim të madhe tek vetëvetja dhe mendojnë se janë rritur tashme dhe se janë të gjithëdijshëm.

## 6. Perfundimi dhe rekomandimet

Mund të nisemi me shprehjen se “sa më shpejt që adoleshentët të jenë të vetëdijshëm për shprehjet negative/të këqija dhe të ndërmarrin hapa për t’i trajtuar ato, aq më pak ka gjasa që ata të luftojnë me këto shprehje në moshën e rritur.

Vetëdija e vogël për shprehjet negative tek adoleshentëve është në nivel të mirë edhe pse në masë të vogël mund të themi se kemi shpjegime në shkollë të ndryshme për shprehjet negative të adoleshentëve nga ana e mësimit. Prandaj rekomandohet mbajtja e trajnimeve të shumta për vetëdijësimin e shprehjeve negative që mund të hasin adoleshentët për arsye se shkollë e mesme e lartë është shkollimi ku adoleshentët më së shumti mësojnë shprehje negative.

Duke e analizuar hulumtimin në përgjithësi mund të themi se telefoni dhe duhani janë shprehjet më të mëdha tek adoleshentët e Komunes së Obiliqit dhe mund të themi se kjo vërejtje si pasojë e mos çiltërsisë prindër-fëmijë dhe e mosrespektimit të madhe të prindërve që kishin prindërit tanë për prindërit e tyre.

Po ashtu mund të themi se gjatë pandemisë i gjithë globi thujase ishim në një krizë ekonomike por pavarësisht kësaj adoleshentët kanë një kosto të madhe ditore ku e kanë të siguar duhanin dhe shpenzimet shkollore.

Probleme të mëdha adoleshentëve po ju shkakton edhe rrethi shoqëror sepse në hulumtim e pamë se shumica e ndikimit ndodh nga rrethi shoqëror si ai ndikim negativ dhe ai pozitiv.

## 7. Pyetësori

Përsëritje i/e nderuar!

Unë Fiona Tovërlani studente e Departamentit të Infermierisë në “Kolegjin Universum” jam duke bërë hulumtimin me temë “SHPREHJET NEGATIVE TE ADOLESHENTEVE NE KOMUNEN E OBILIQIT”. Hulumtimi bëhet në kuadër të lëndës “Metoda hulumtuese” dhe ka për qëllim të mbledhë të dhëna rreth kësaj teme.

Ju lusim të na ndihmoni të realizojmë së bashku hulumtimin duke u përgjigjur në pyetjet e këtij pyetësori.

Ju sigurojmë se përgjigjet do të mbesin konfidenciale dhe anonimiteti juaj do të garanto-  
het gjithnjë.

Shënime demografike

- |                                              |            |             |             |
|----------------------------------------------|------------|-------------|-------------|
| <input type="checkbox"/> Gjinia:             | a) Femër   | b) Mashkull |             |
| <input type="checkbox"/> Moshë:              | a) 16      | b) 17       | c) 18 d) 19 |
| <input type="checkbox"/> Drejtimi:           | a) natyror | b) shoqëror |             |
| <input type="checkbox"/> Tipi i vendbanimit: | a) urban   | b) rural    |             |

Përkatësia etnike:.....

1. A keni njohuri për shprehjet negative të adoleshentëve?

- a) mjaftueshëm njohuri      b) pak njohuri      c) aspak njohuri

2. Nga kush jeni informuar për shprehjet negative të adoleshentëve?

- a) drejtorja e shkollës      b) mësimdhënësit      c) interneti  
d) rrethi shoqëror      e) nuk jam i/e informuar

3. Cilat shprehje mendoni se janë negative sipas jush?

- a) duhani      b) droga      c) telefoni (rrjetet sociale)  
d) alkooli      e) dhuna

4. A e përdorni duhanin?

- a) po      b) jo

5. Sa cigare në ditë pini?

- a) 0-9 cigare      b) 10-20 cigare      c) 21 e më shumë cigare

6. Në çfarë moshe keni filluar të konsumoni duhanin?

- a) nën moshën 15 vjeqare      b) mbi moshën 15 vjeqare

7. A mendoni se duhani të ka bërë person më agresiv?

- a) po      b) jo

8. A përdorni alkool?

- a) po      b) jo

9. Sa shpesh përdorni alkool?

- a) 1-3 herë në ditë      b) 1.3 herë në javë      c) 1-3 herë në muaj  
d) vetëm gjatë festave

10. Në çfarë moshe keni filluar të konsumoni alkoolin?

- a) nën moshën 15 vjeqare      b) mbi moshën 15 vjeqare

11. A përdorni telefon?

- a) po      b) jo

12. Sa kohë në ditë qëndroni në telefon?

- a) më pak se 2 orë      b) 2-5 orë në ditë      c) 6-10 orë në ditë  
d) mbi 10 orë në ditë

13. Cilin aplikacion e përdor më së shumti në telefon?

- a) facebook      b) Instagram      c) snapchat  
d) what's app      e) viber

14. A përdorni lëndë narkotike?

- a) po      b) jo

15. Në çfarë moshe keni filluar të përdorni lëndë narkotike?

a)15

b)16

c)17

d)18

e)19

16.Sa orë në ditë kaloni bashkë me prinderit?

\_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_

17.A jeni të lirshëm të flisni tema të ndryshme me prindërit?

a) po flas lirshëm

b) jo,kam frikë

18.Sa para shpenzon në ditë?

a)deri në 3€

b)3-7€

c)më shumë se 7€

19.A keni menduar ndonjëherë të lëndoni vetvetën?

a)po

b)jo

20.Si keni reaguar kur keni parë një zënkë në shkollë?

a) jam larguar nga aty

b) jam përfshirë në zënkë

## Referencat:

1. <https://ifightdepression.com/sq//cfare-eshte-adoleshenca>
2. <https://sq.nsp-ie.org/etapas-de-la-adolescencia-y-sus-caracteristicas-40d62a-2a462a>
3. <https://www.drugabuse.gov/publications/drugfacts/cigarettes-other-tobacco-products>
4. <https://www.cdc.gov/alcohol/faqs.htm>
5. <https://www.health.gov.au/health-topics/drugs/about-drugs/what-are-drugs>
6. <https://www.saferspaces.org.za/understand/entry/what-is-violence>
7. <https://www.techopedia.com/definition/2955/mobile-phone>
8. Shkolla "17 SHKURTI" - Obiliq



# Tumoret Intracerebrale tek Femijët

---

## Fjolla Ymeri

---

### Abstrakt

Ky punim është bërë për qëllimin e të kuptuarit së zhvillimit të tumoreve të trurit tek femijet, identifikimin e simptomave, njohjen e shkaktarëve, metodat e diagnostikimit, llojet e trajtimit gjithashtu dhe tipet e tumoreve më të shpeshta tek femijet. Tumoret e trurit të fëmijërisë nuk janë vetëm të njëjtat tumore që lindin në moshën madhore. Tumoret e trurit tek fëmijët dhe të rriturit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në incidencën e tyre, tumor llojin dhe trajtimin. Në përgjithësi, mbijetesat për ata me tumore të trurit janë më mirë në fëmijëri sesa në moshën e rritur. Megjithatë, papjekuria e fëmijës truri i bën të vështira vendimet e trajtimit, sidomos tek foshnjat.

## 1. Hyrje

Tumoret janë masa ose rritja e qelizave abnormale që ndodhin në një organ ose në indet apo strukturat të cilat gjenden në afërsi të tij. Egzistojnë tumoret malinje dhe tumoret beninje të cilët dallojnë përmes disa karakteristikave ku bëjnë pjesë :

- Diferencimi & Anaplazia
- Shkalla e rritjes
- Invazioni lokal
- Metastaza

Diferencimi iu referohet tumoreve beninje qelizat e të cilëve ngjajnë me qelizat normale si morfoligjikisht ashtu dhe funksionalisht. Ndërsa qelizat e tumoreve malinje variojnë nga tipe të diferencuara mirë, mesatarisht deri në lloje të dobëta. Tumoret malinje e përbera nga qelizat e pa diferencuara janë anaplastike.

Tumoret beninje kanë rritje të ngadalët, ndërsa tumoret malinje janë më agresive dhe rriten me shpejtësi të madhe.

Sa i përket invazionit apo pushtimit të indeve për rreth tumorit kjo ndodh tek tumoret malinje dhe krahas metastazave invaziviteti është tipari më i besueshëm i cili dallon tumoret malinje dhe beninje.

Metastaza ndodh kur qelizat malinje transferohen nga një vend në tjetrin jo në mënyrë të drejtpërdrejt por me anë të invazivitetit i cili lejon që qelizat malinje të depertojnë në enët e gjakut apo limfatike duke depërtuar në indin ose organin i cili gjendet në largësi.

Tumoret të trurit tek femijët janë tumoret më të zakonshme dhe nuk janë të njejta me tumoret e trurit tek të rriturit. Në përgjithësi tumoret e trurit janë metastaza nga vende tjera ndërsa tek fëmijët janë tumore primare (fillojnë në tru dhe nuk perhapen jashtë indit të trurit).

Krahasuar me të rriturit, femijët kanë më shumë gjasa të zhvillojnë tumore në pjesët e poshtme të trurit, gjithashtu dallojnë si nga incidenca, lloji dhe trajtimi (ndikon papjekuria e trurit të femijës ku bëhet e vështirë dhe vendimet e trajtimit sidomos tek foshnjat).

## 2. Anatomia & Fiziologjia e Trurit

Truri është një organ i madh me peshë rreth 1.4kg i cili shtrihet mbrenda zones cavitas cranii ku mbrohet nga kockat e neurokraniumit:

- Os frontalis
- Os parietalis
- Os temporalis
- Os occipitalis

Pjesët e tij janë :

**Cerebrumi** - paraqet pjesën më të madhe të trurit dhe zë fossat kraniale anteriore dhe mediale. Ndahet në dy hemisfera, të majtë dhe të djathtë ku secila përmban një nga ventrikujt lateral. Në pjesën superficiale të trurit hemisferat janë të lidhura me një masë të bardhë (white matter) fibra nervore të quajtur corpus callosum.

Sipërfaqja e korteksit cerebral tregon shumë palosje ose brazda me thellësi të ndryshme. Zonat e ekspozuara të palosjeve janë gyruse (përthyerje) dhe këto janë të ndara me sulcuse (çarje). Këto konvolucione rrisin shumë sipërfaqen e trurit.

Secila hemisferë e trurit ndahet në lobe, të cilat marrin emrat e kockave të kraniumit mbi to:

- Lobi frontal
- Lobi parietal
- Lobi temporal
- Lobi occipital



**Diencefaloni** - është pjesa e cila lidh cerebrumin me trurin e mesëm dhe siguron lidhjen funksionale në mes të hemisferave cerebrale dhe pjesës tjetër të SNQ ( Sistemi Nervor Qendror).

Perbehet nga : Talamusi,hipotalamusi dhe epitalamusi

- Talamusi luan rolin e një stacioni për impulset të cilat shkojnë në korteksin cerebral dhe impulse motore që vijnë dhe dalin nga hemisferat cerebrale.
- Hipotalamusi është i lidhur ngushtë me hipofizën, prodhon hormonin antidiuretik dhe oksitocinen.Gjithashtu vepron si qendra koordinuese e kontrollit inteligjent të trupit.
- Funkzioni i tij kryesor është të mbajë trupin në një gjendje të qëndrueshme të quajtur homeostazë.
- Epitalamusi është struktura e lidhur me epifizën e cila sekreton hormonin melatonin që është përgjegjës për ciklin e gjumit.

Pjesë tjetër e trurit është **Trungu Trunor** i cili përmban rrugët që percjellin informatat mes trurit dhe të gjithë trupit.Gjithashtu është vendi ku gjenden berthamat e nervave kranial të 3-të dhe 12-të ( n.okulomotor & n.hypogloss) dhe përmban formacionin retikular i cili është përgjegjës për kontrollin e nivelit të vetedijes,perceptimin e dhimbjes dhe rregullimin e sistemit kardiovaskular.

Sistemi i aktivizimit retikular (RAS) përbëhet nga zona brenda formacionit retikular që, kur aktivizohet, sjellin stimulim të shtuar të korteksit cerebral, shoqëruar me zgjim dhe rritje të vigjilencës, megjithëse mekanizmat e përfshirë nuk kuptohen mirë. RAS gjithashtu ndërmjetëson ndërgjegjësimin selektiv, që do të thotë se në mënyrë selektive bllokun ose lejon transmetimin e informacionit ndijor në korteksin cerebral; për shembull, zhurma më e vogël e bërë nga një fëmijë i sëmurë që lëviz në shtrat mund të zgjojë një nënë që fle, por zhurma e trenave që kalojnë rregullisht nuk e shqetëson atë.

Trungu trunor përbehet nga :

- Truri i mesem i cili kontrollon lëvizjet e pavullnetshme të syve dhe reflekset që lidhen me informacione vizuale dhe auditive.
- Ponsi i cili percjell informatat në mes të korteksit trunor,kontrollon disa nga funksionet respiratore.
- Medulla oblongata ku përmban qendrat që rregullojnë funksionet e zemrës dhe mushkërive,të gellititurit,kollën dhe të vjellurat.


Pjesa e fundit e trurit është **Cerebellumi** ( truri i vogël) i cili gjendet në pjesën inferiore të pjesës occipitale dhe pjesës posteriore të ponsit dhe medulla oblongata.

Paraqet zonën e cila kontrollon :

- Lëvizjet e muskujve
- Balancin
- Tonusin muskular
- Lëvizjet e syrit
- Mësimet motore ( ngasja e bicikletës).

### 3. Simptomat e Tumoreve Intacerebrale tek femijët

Presioni Intrakranial	Në kafkë nuk ka vend më shumë përvec trurit andaj zhvillimi dhe zgjerimi i tumoreve shkaktojnë këtë presion.
Dhimbje koke	Shumë fëmijë me një tumor të trurit përjetojnë dhimbje koke përpara diagnozës së tyre. Por shumë fëmijë kanë dhimbje koke dhe shumica e tyre nuk kanë tumor në tru. Një flamur i kuq për t'u kujdesur: një dhimbje koke që është më e keqe në mëngjes. Kjo është pjesërisht sepse presioni në tru rritet kur jeni shtrirë dhe një tumor mund ta përkeqësojë atë.
Konvulzionet	Kur një tumor i trurit ulet në sipërfaqen e trurit, ai mund të shkaktojë konvulsione. Shumë veprime mund të shkaktojnë një krizë, duke përfshirë të qeshurën.
Letargji dhe përgjumje	Një fëmijë i përgjumur zakonisht nuk është shkak për alarm. Nëse fëmija juaj po vepron letargjik, ose është tepër i përgjumur, pa ndonjë arsye të dukshme mund të jetë një shenjë e një tumori.
Nauze dhe të vjella	Të përzierat dhe të vjellat janë dy shenja të zakonshme të gripit ose sëmundjeve të ngjashme me gripin. Megjithatë, në raste të rralla, këto simptoma mund të jenë për shkak të një tumori të trurit që shkakton rritje të presionit brenda trurit.
Koma dhe vdekja	Nëse nuk identifikohen simptomat me kohë dhe tumoret nuk trajtohen.



#### Makroencefalia ( koka e zmadhuar)

Ndodh tek foshnjat kockat e të cilëve ende nuk janë ostifikuar plotësisht.

## 4. Shkaktarët e tumoreve te trurit tek femijet

Shkaktari specifik ende nuk dihet por disa nga faktorët e rrezikut janë :

<b>Faktorët gjenetik</b>	Tumoret primare të trurit fillojnë kur qelizat normale kanë mutacione ne ADN-në e tyre.Këto mutacione lejojnë qelizat të rriten dhe të ndahen me ritme të crregullta apo të rritura,që vazhdojnë të jetojnë kur qelizat e shëndetshme vdesin.
<b>Neurofibromatoza</b>	Nuk është crregullim i vetëm por i referohet tre kushteve të ndryshme ku përfshihet zhvillimi i tumoreve që prekin trurin, palcën kurrizore dhe nervat qe dergojnë sinjale.Këto zhvillohen në momentin kur ka ulje të neurofibrominës (produkt proteinik)
<b>Faktoret Mjedisorë</b>	Ekspozimi ndaj rrezatimeve

## 5. Diagnoza e Tumoreve Intracerebrale tek Femijet

<b>Egzaminimi Neurologjik</b>	Kontrolli i shikimit,dëgjimit,reflekseve,kordinimit ,ekuilibrit etj.
<b>Testet Imazherike</b>	MRI apo rezonanca magnetike ofron informacione të detajuar në lidhje me tumorin e trurit.
<b>Biopsia</b>	Marrja e një sasive të vogël indi nga zona e trupit ku mund të jetë i pranishëm tumori. Indi dërgohet në një laborator dhe ekzaminohet nën një mikroskop për qelizat e kancerit nga një specialist i quajtur patolog.

Pas diagnozes bëhen edhe analizat gjenomike gjithëpërfshirëse të cilat mund të ofrojnë informacione mbi terapitë e mundshme,gjasat e rezistencës ndaj terapive,provave klinike,përparimi i sëmundjes etj.

Qelizat e tumorit nën mikroskop duken identike por kanë anomali të ndryshme gjenetike.

## 6. Trajtimi & Prognoza

Trajtimi i tumoreve të trurit tek femijet varet nga tipi i tumorit për arsye se disa tipe kërkojnë një lloj të trajtimit ndërsa disa tipe tjera kërkojnë kombinim të trajtimeve.

Prognoza varet nga :

- Lloji i tumorit
- Madhësia
- Vendndodhja
- Prania ose mungesa e metastazave
- Përgjigja e tumorit ndaj terapisë
- Mosha dhe shëndeti i përgjithshëm i femijes
- Toleranca e femijes ndaj medikamenteve,procedurave ose terapive specifike etj.

<b>Radioterapia</b>	Kjo terapi fokuson rrezet e rrezatimit me energji të lartë në indin e tumorit dhe një sasi të vogël të indeve për rreth. Përdoret me shumë kujdes tek foshnjat dhe femijët e vegjël për shkak të trurit të tyre në rritje dhe zhvillim.
<b>Kimioterapia</b>	Kjo terapi përdoret për shumë lloje të tumoreve të trurit, duke përfshirë tumoret agresive të shkallës së lartë. Mund të administrohet - Per oral në formë pulillave, intravenoz ose me injektim direkt në lëngun cerebrospinal LCS etj,
<b>Imunoterapia</b>	Është klasa e trajtimeve që përfiton nga sistemi imunitar i një personi që ndihmon në vrasjen e qelizave kanceroze. Ndonëse efektive kundër tumoreve solide ( ngurta ) ka treguar më pak përfitim kundër tumoreve të trurit pediatrik.
<b>Ndërhyrjet kirurgjikale</b>	Shumica e tumoreve të trurit tek foshnjat dhe femijet kërkojnë largimin kirurgjikal të tumorit ose të paktën një biopsi si pjesë e trajtimit. Neurokirurgu mund të rekomandojë kirurgji për largimin e sa më shumë pjesëve nga tumori për të lehtësuar presionin intrakranial.
<b>Terapia target</b>	Kjo terapi fokusohet në anomalitë specifike të pranishme brenda qelizave kanceroze, duke bllokuar po këto anomali mund të shkaktojë vdekjen e qelizave kanceroze.

## 7. Llojet e tumoreve më të zakonshme të trurit tek femijet


- Gliomat
- Medulloblastoma
- Choroid plexus carcinoma

Neuronet e SNQ mbështeten nga qeliza gliale jo të ngacmueshme .Ndryshe nga qelizat nervore, të cilat nuk mund të ndahen, qelizat gliale vazhdojnë të shumohen gjatë gjithë jetës. Ka katër lloje: astroцитet, oligodendrocitet, qelizat endimale dhe mikroglija.

**Gliomat** janë tumore të cilët fillojnë nga qelizat gliale dhe zhvillohen në trurin e femijës dhe palcën kurrizore gjithashtu paraqesin tumoret më të shpeshta tek femijet.

- Astrocitomat janë lloji më i zakonshëm i gliomave, ndodhin tek femijët 5 dhe 8 vjec dhe zhvillohen nga qelizat gliale të quajtura astrocite. Grada e nje astrocitome është shumë e rëndësishme ku kemi :
  1. Astrocitoma policistike- ka rritje të ngadalët dhe mund të jetë cistike ( e mbushur me lëng)
  2. Astrocitoma difuze- infitron indin normal të trurit per rreth duke e bërë më të vështirë largimin e plotë kirurgjikal.
  3. Astrocitoma anaplastike- është malinj, simptomat varen nga vendndodhja dhe kërkon kombinim të trajtimeve.
  4. Glioblastoma multiforme- është tumor malinj i astrocitomes, rritet me shpejtësi, shkakton presion intrakranial dhe kërkon kombinim të trajtimeve.

- Ependimomat janë lloji tjetër i gliomave që formohen nga qelizat të cilat krijojnë, mbështesin, ushqejnë dhe rreshtojnë ventrikujt.
- Gliomat e trunqut trunor mund të jenë shumë sfidues për tu trajtuar, shumica e këtyre tumoreve janë të vendosur në mes të trunqut trunor dhe nuk mund të largohen me kirurgji.
- Gliomat e nervit optik- nervi optik është nervi i shikimit dhe nervi i dytë kranial, fjet kanë origjinën në retinen e syrit. Shkojnë prapa përmes pjesës posteriore të zgavrës orbitale dhe më pas kalojnë përmes vrimës optike të os sphenoidalis në cavitas cranii. Këto tumore gjenden në ose rreth nervave optik dhe shihen shpesh tek femijët me neurofibromatozë. Shkaktojnë humbje të shikimit dhe jo vetëm. Për shkak se sistemi optik gjendet pranë qendrës së hormoneve të trurit ndikon në funksionet endokrine të trupit si prodhimi i hormoneve.




*Të paraqitura janë disa fotografi klinike me leziona neurogjene.*

- Fotografi klinike e 12-vjecarës me proptozë aksiale të djathtë.
- MRI aksiale T2 që tregon një masë orbitale fusiforme retrobullare që përfshin nervin optik të majtë.
- Fotografi intraoperative e gliomes së nervit optik të hequr.
- Neurofibroma pleksiforme e kapakut të sipërm të djathtë me një deformim karakteristik në formë "S"

- E. Njolla karakteristike
- F. CT orbitale me trashje të pjesës së përkohshme të kapakut të sipërm të djathtë.
- G. Fotografi klinike e një femije 6-vjecar që tregon proptozë aksiale të majtë.
- H. Po i njejtë femije me njolla dhe neurofibroma
- I. MRI aksiale që tregon një masë orbitale fulciforme retrobullare që përfshin nervin optik të majtë.
- J. Fotografi klinike e foshnjës 1-vjecare gjatë egzaminimit nën anestezion të përgjithshëm që tregon globin e djathtë të zmadhuar me errësirë të kornesë.
- K. E njejtë foshnjë me njolla dhe neurofibroma.
- L. Skanimi CT orbital aksial që tregon globin dhe orbiten e djathtë të zmadhuar.

**Medulloblastoma** është tumori më i shpeshtë malinj i trurit dhe përbën 15% të tumoreve të trurit tek femijet.

Formohen në cerebellum dhe ndodhin kryesisht tek moshat 4 dhe 9 vjecare, prek djemtë më shumë se vajzat. Këto lloje të tumoreve fillojnë me simptoma të hidrocefalus-it për shkak se tumori i formuar në pjesën e pasme të trurit mbyll rrugët e lëngut cerebrospinal dhe gjeneron presion duke shkaktuar dhimbje koke e shoqëruar me nauze dhe të vjella. Megjithatë nuk përjashtohen edhe simptomat e disfunktionit cerebellar.



*MRI sagjitale e cila tregon tumorin e tipit Medulloblastoma në cerebellum (trurin e vogël).*

### **Choroid plexus carcinoma**


Truri i njeriut ka katër ventrikuj :

- Dy ventriku lateral
- Ventrikuli i tretë
- Ventrikuli i katërt.

Plexusi choroid është i lokalizuar në ventrikuj dhe prodhon lëngun cerebrospinal i cili mbush ventrikujt dhe hapsirën subarachnoidale duke ndjekur një cikël konstant mes prodhimit dhe absorbimit dhe duke e mbrojtur turin nga goditjet.

Carcinoma i referohet tumoreve të cilat formohen në epitelin e indeve që do të thotë se këto janë tumoret të cilat formohen në epitelin e pleksusit koroid.

Këto tumore shkaktajnë grumbullim të LCS duke rezultuar ne hidrocefalus, mund të jenë malinj dhe beninj dhe pa marrë parasysh qasjeve multidisiplinare apo llojeve të ndryshme të trajtimeve rezultati në pefundim është jo i mirë ku shumë të mbijetuar shfaqin pasoja neurologjike si nga tumori ashtu edhe nga trajtimi



*MRI e cila demonstroi një masë të madhe të lobuar mbrenda ventrikulit lateral e cila shoqërohet me zgjerim të ventrikulit.*

## 8. Diskutime & Rekomandime

### Transnasal Endoscopic Surgery | Sofia's Story

Kirurgjia endoskopike transnazale është një teknikë minimalisht invazive e cila lejon një kirurg të depërtojë në bazë të kafkës dhe në pjesën e sipërme të palcës kurrizore.

Sofia një adoleshente fillimisht kishte simptoma me probleme të shikimit ku u sugjerua që ka nevojë për syze, simptomat të cilat vazhduan edhe pas vendosjes së syzeve. Pas shumë diagnozave të ndryshme arriti të diagnostikohet me llojin e tumorit kondrosarkoma ( tumor malinj i kockave) dhe përmes kirurgjisë endoskopike transnazale tumori në bazë të kafkës iu hoq dhe shikimi iu rikthye në normalitet.

Arsyeja konkrete e paraqitjes së rastit të mësipërm është të kuptuarit e rëndësisë të identifikimit të simptomave të cilat vijnë nga zhvillimi i një tumori në trurin e një fëmije situat e cila nëse nuk merret parasysh mund të përfundoj me fatalitet.

## Referencat:

1. Ross and wilson Anatomy and Physiology in health and illness 13th edition book
2. mayo clinic
3. John Hopkins Medicine
4. Researchgate
5. oncohematol key
6. PubMed
7. BioDigital
8. Transnasal Endoscopic Surgery | Sofia's Story



# Qendrimi ndaj personave me aftësi të kufizuara

---

Donjeta Halimi,  
Rolantina Muji,  
Laurena Hyseni

---

## 1. Hyrje

### 1.1 Historiku i aftësisë së kufizuar

Trajtimi dhe perceptimet e aftësisë së kufizuar kanë pësuar transformim që nga vitet 1900. Kjo ka ndodhur kryesisht sepse personat me aftësi të kufizuara kanë kërkuar dhe krijuar ato ndryshime. Ashtu si lëvizjet e tjera për të drejtat civile, lëvizja për të drejtat e aftësisë së kufizuar ka një histori të gjatë. Shembuj të aktivizimit mund të gjenden midis grupeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar që datojnë që nga vitet 1800. Shumë ngjarje, ligje dhe njerëz kanë formësuar këtë zhvillim. Deri më sot, Akti i Amerikanëve me Aftësi të Kufizuara (ADA) i vitit 1990 dhe Ligji pasues i Ndryshimeve të ADA (2008) janë arritjet më të mëdha ligjore të lëvizjes. ADA është një ligj kryesor për të drejtat civile që ndalon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në shumë aspekte të jetës publike. Lëvizja për të drejtat e aftësisë së kufizuar vazhdon të punojë fort për të drejta të barabarta.

Lennard Davis (2010) sqaron dallimin midis dëmtimit dhe paaftësi. Ai deklaron se, “Dëmtimi është fakti fizik i mungesës së krahut ose këmbës. Aftësia e kufizuar është procesi shoqëror që e shndërron një dëmtim në negativ duke krijuar pengesa për qasjen.” Duke pasur parasysh këtë, në këtë blog, unë do të përpiqem të hetoj se çfarë do të thotë “paaftësi” në periudha të ndryshme. Në vijim, unë do të ndaj disa shembuj se si kultura popullore përfaqëson njerëzit me aftësi të kufizuara.

#### 1.1.1 Grekët dhe Romakët e Lashtë

Grekët e lashtë nuk kishte shumë tolerancë për njerëzit me aftësi të kufizuara. Për shembull, Spartanë, do të braktiste foshnjat me aftësi të kufizuara në vende të shkreta. Në Politikë, Aristoteli shkroi se duhet të miratohet një ligj që ndalon çdo fëmijë me aftësi të kufizuara të

jetojë: “Le të ketë një ligj që asnjë fëmijë i deformuar nuk do të jetojë.” Zgjidhja e tij për ta ishte eutanazia.

Sa për romakët, ata i konsideronin njerëzit me aftësi të kufizuara si burim turpi. Kishte praktika të ndryshme që ata zbatuan ndaj tyre. Ata i braktisnin fëmijët e deformuar për të vdekur, ndonjëherë i shisnin si skllever ose i punësonin si argëtues të oborrit.

### 1.1.2 Mesjeta

Meqenëse Mesjeta zgjati mbi 1000 vjet, ne mund të flasim për një qasje homogjene ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara. Përkundrazi, kishte perspektiva të ndryshme pozitive dhe negative. Për të filluar, aftësia e kufizuar nuk ekzistonte si fjalë. Përkundrazi, njerëzit ishin të verbër, memecë, memecë, të çmendur, budallenj ose të çalë. Këto ishin termat e përdorur për t’iu drejtuar njerëzve me aftësi të kufizuara.

Së dyti, ata në përgjithësi ndanin të njëjtën kategori me të varfërit. Për më tepër, kishte lypës që pretendonin se ishin të verbër. Kështu, njerëzit nuk ishin kurrë të sigurt nëse të verbërit ishin vërtet të verbër apo thjesht pretendonin se do të fitonin para duke lypur. Kishte edhe një fakt tjetër, i cili problematizoi gjendjen e verbërisë. Gjatë periudhës mesjetare, kriminelët u verbuan si ndëshkim. Në një farë mënyre, ky akt kriminalizoi edhe verbërinë.

Qëndrimet ndaj aftësisë së kufizuar ishin të përziera. Njerëzit mendonin se ishte një ndëshkim për mëkat, ose rezultat i lindjes nën ndikimin armiqësor të planetit Saturn. Të tjerë besonin se njerëzit me aftësi të kufizuara ishin më afër Perëndisë - ata po vuanin purgatorin në tokë dhe jo pas vdekjes dhe do të arrinin në parajsë më shpejt.



*Lazar House, Sprowston Road, Norwich, 1951. © Historic England*

Nuk kishte asnjë dispozitë shtetërore për personat me aftësi të kufizuara. Shumica jetuan dhe punuan në komunitetet e tyre, të mbështetur nga familja dhe miqtë. Nëse nuk mund të punonin, qyteti ose fshati i tyre mund t'i mbështeste, por ndonjëherë njerëzit iu drejtuan lypjes. Për to kryesisht kujdeseshin murgjit dhe murgeshat që strehonin pelegrinët dhe të huajt si detyrë e tyre e krishterë.

### 1.1.3 Periudha e hershme modern

Ndërsa aftësitë e kufizuara ishin më shumë përvoja shpirtërore për periudha mesjetare, Modernët e Hershëm iu afruan atyre me një perspektivë më materialiste. Para së gjithash, pati një rifokusim në humoret e Galenit: biliare të zezë, biliare të verdhë, gjak dhe gëlbasë. Sëmundjet do të ndodhnin me tepri të ndonjë prej këtyre humoreve. melankolik, për shembull, do të ndodhte në tepriçën e biliare të zezë.

Së dyti, u shfaq koncepti i vetes dhe dinjitetit të vetes. Marrëdhënia midis botëve mikrokozme (qenieve njerëzore) dhe makrokozme (rendi i madh ose kozmosi) ishte shumë e përhapur. Kjo analogji do të zbulonte të vërtetën për natyrën njerëzore. Me fjalë të tjera, vetja ishte gjithashtu pjesë e mjedisit.

Gjithashtu, Mbretëresha Elizabeth urdhëroi miratimin e ligjeve të varfra. Tani ishte qeveria dhe jo kisha ajo që mori përgjegjësinë për njerëzit me aftësi të kufizuara. Sidoqoftë, kushtet në të cilat ata duhej të jetonin ishin shumë sfiduese.

### 1.1.4 Paaftësia në vitet 19th dhe në fillim të shekullit të 20 –të

Pas Revolucionit Industrial, po zhvillohej një proces masiv institucionalizimi së bashku me rritjen e institucioneve për personat me aftësi të kufizuara, të tilla si azilumet dhe shtëpitë e punës. Kjo ishte një përpjekje për të hequr njerëzit me probleme mendore dhe fizike nga sytë e publikut. Për më tepër, janë krijuar “shkolla speciale” për njerëzit me aftësi të kufizuara në të nxënë ose me dëmtim të dëgjimit dhe shikimit. Gjithçka për ta ishte e ndarë, dhe ata u detyruan të jetojnë një jetë të ndarë nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Për më tepër, aftësia e kufizuar kishte filluar të bëhej një interes më i madh i reformatoreve socialë si Dorothea Dix dhe mjekëve të tillë si Eduard Seguin (1812-1880) dhe Jean-Etienne Dominique Esquirol (1782-1840). Seguin dhe Esquirol iu përkushtuan studimit të dëmtimeve njohëse. Seguin hapi “shkollën speciale” të parë në 1839 dhe në 1866 ai botoi veprën e tij në anglisht, të titulluar “Idiocia dhe trajtimi i saj me metodën fiziologjike”.

Sa i përket psikiatrit francez Esquirol, kontributi i tij kryesor ishte të përdorte vëzhgimet klinike për të arritur një analizë sistematike të shqetësimeve mendore. Gjithashtu, ai dallooi marrëzinë nga prapambetja mendore. Në shoqërimin e gjithë këtij përparimi, eugenika dhe ligjet e shëmtuara shërbyen si mjete alternative të cilat synonin sterilizimin e njerëzve me aftësi të kufizuara nga raca njerëzore dhe opinioni publik.



*The Hospital of Bethlem [Bedlam] at Moorfields, London: seen from the north, with ladies and gentlemen walking in the foreground, one giving money to a cripple. Engraving by W. H. Toms. © Wellcome Library, London*

### 1.1.5 Fundi i Shekullit 20

Pas viteve 1950 dhe veçanërisht 1970, organizatat miratuan qasje të reja drejt aftësisë së kufizuar. Domosdoshmëria e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara fitoi njohje në mbarë botën dhe u bë një shqetësim ndërkombëtar. Së pari, në 1971, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Deklaratën për të Drejtat e Personave me Vonesë Mendore. Së dyti, në 1975, [Deklarata e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar](#) u miratua. Këto deklarata thonë se personat me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta njerëzore si të tjerët dhe duhet të kenë akses të plotë në të gjitha llojet e shërbimeve publike. Derisa [Viti Ndërkombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar është 1981](#) për shkak të thirrjes së OKB -së për një program veprimi, 3 Dhjetori është festuar si Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar që nga viti 1992. Shkurtimisht, të gjitha këto ndryshime filluan një epokë të re.

### 1.1.6 Ligje të shëmtuara

Një proces tjetër i sterilizimit janë ligjet e shëmtuara, të cilat i referohen ordinancave që synojnë “lypës të shëmtuar” në shumë qytete në SHBA. Në Ligjet e shëmtuara: Aftësia e kufizuar në publik, Susan M. Schweik thellohet në këtë temë dhe ndan këto ordinanca. Për shembull, Seksioni 3 i Ligjeve të Shëmtuara të San Franciskos (1867), thotë “çdo person i sëmurë, i gjymtuar, i gjymtuar ose i deformuar në çfarëdo mënyre në mënyrë që të jetë një objekt i shëmtuar ose i neveritshëm, ose një person i papërshtatshëm që të lejohet në ose në rrugë, autostrada, rrugëkalime ose vende publike në Qytetin ose Vendin e San Franciskos nuk do të ekspozohet aty ose aty në publik”(491). New Orleans, Portland, Chicago, Denver, Columbus dhe State of Pensilvania janë disa nga qytetet ose shtetet e tjera që zyrtarizuan ligjet e shëmtuara.

### 1.1.7 Akti i Amerikanëve me Aftësi të Kufizuara (ADA)

Më 26 korrik 1990, Presidenti George HW Bush nënshkroi ADA. Ky ligj ndalon çdo diskriminim ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara dhe detyron institucionet të bëjnë gjykimet e nevojshme në mënyrë që njerëzit me aftësi të kufizuara të jenë anëtarë aktivë të jetës amerikane. Neni 504 i Aktit të Rehabilitimit të vitit 1973 vjen si një shtesë e Aktit të Drejtave Civile të vitit 1964 i cili ndalon çdo diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, fesë, seksit ose origjinës kombëtare. [ADA përcakton aftësinë e kufizuar në tre aspekte:](#)

1. “Një dëmtim fizik ose mendor që kufizon ndjeshëm një ose më shumë aktivitete kryesore të jetës”,
2. “Një person që ka një histori ose rekord të një dëmtimi të tillë”
3. “Një person që perceptohet nga të tjerët si një dëmtim i tillë”

## 1.2 Termi person me aftësi të kufizuara

Termi person me aftësi të kufizuar nënkupton çdo person që nuk është në gjendje të sigurojë vetë, tërësisht ose pjesërisht, nevojat e një jete normale individuale ose shoqërore, si rezultat i një mangësie, të lindur ose jo, në fizike të saj aftësitë mendore.

Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Deklaratë. Këto të drejta do të jepen të gjithë personave me aftësi të kufizuara pa asnjë përjashtim dhe pa dallim ose diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionëve politike ose të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, gjendjes së pasurisë, lindjes ose ndonjë tjetër. situatë që zbatohet ose për vetë personin me aftësi të kufizuara ose për familjen e tij ose të saj.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e natyrshme për respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor. Personat me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga origjina, natyra dhe serioziteti i të metave dhe paaftësisë së tyre, kanë të njëjtat të drejta themelore si bashkëqytetarët e tyre të së njëjtës moshë, gjë që nënkupton para së gjithash të drejtën për të gëzuar një jetë të denjë, sa më normale dhe të plotë.

### 1.2.1 Terminologjia e duhur për aftësitë e kufizuara

Mos përdorni termat “i hendikepuar”, “me aftësi të ndryshme”, “i gjymtuar”, “i gjymtuar”, “viktimitë”, “i vonuar”, “i goditur”, “i varfër”, “fatkeq” ose “nevoja të veçanta”.

Vetëm për shkak se dikush ka një paaftësi, nuk do të thotë se ai/ajo është “guximtar”, “trim”, “i veçantë” ose “mbinjerëzor”. Personat me aftësi të kufizuara janë të njëjtë si cdo kush tjetër. Nuk është e pazakontë që dikush me aftësi të kufizuara të ketë talent, aftësitë dhe aftësitë.

Kur flasim për persona pa aftësi të kufizuara, është në rregull të thuash “njerëz pa aftësi aftësi të kufizuara.” Por mos iu referoni atyre si “normale” ose “të shëndetshme”. Këto terma mund të bëjnë njerëzit me aftësi të kufizuara të ndihen sikur ka diçka që nuk shkon me ta dhe se ato janë “anormale”. Kur dyshoni, thirrni një person me aftësi të kufizuara me emrin e tij/saj.

Aftësia e kufizuar	Gjuhë e vjetëruar	Gjuhë e respektueshme
Të verbër ose dëmtim të shikimit	Memece, e pavlefshme	I verbër/me shikim të dëmtuar, person i cili është i verbër/me shikim të dëmtuar
Dëmtim i shurdhër ose i dëgjimit	E pavlefshme, shurdh-memece, shurdhme-mece	I shurdhër ose me vështirësi dëgjimi, Personi i shurdhër ose me vështirësi në dëgjim
Paaftësi në të folur/komunikim	Memec, “Ai që flet keq”	Personi me aftësi të kufizuara në të folur / komunikim
Paaftësi në të nxënë	I vonuar, i ngadalshëm, i dëmtuar nga truri, “Special ed”	Paaftësi në të nxënë, Paaftësi njohëse, Personi me paaftësi të të nxënit ose njohës
Paaftësi e shëndetit mendor	Hipersensitiv, Psiko,içmendur	Personi me paaftësi psikiatrike, Personi me paaftësi të shëndetit mendor
Lëvizshmëri/Paaftësi fizike	Me aftësi të kufizuara, me sfida fizike, “Special”, i deformuar, i gjymtuar, i lidhur me rrota, i çalë	Përdorues i karriges me rrota, me aftësi të kufizuara fizike, person me aftësi lëvizëse ose fizike
Paaftësi emocionale	E shqetësuar emocionalisht	Me aftësi të kufizuara emocionale, person me paaftësi emocionale
Paaftësi kognitive	I vonuar, I vonuar mendërisht,	Me aftësi të kufizuara njohëse/zhvillimore, person me aftësi të kufizuara njohëse/zhvillimore
Shtat i shkurtër, njeri i vogël	Xhuxh	Dikush me shtat të shkurtër, Personi i Vogël
Kushtet shëndetësore	Viktimë, dikush “i goditur” me një paaftësi (d.m.th. “dikush i prekur me kancer” ose “viktimë e SIDA-s”)	I mbijetuari, dikush që “jeton me” një paaftësi specifike (d.m.th. “dikush që jeton me kancer ose SIDA”)

### 1.3 Llojet e aftësive të kufizuar

#### (1) Vizuale -

Paaftësitë e shikimit mund të variojnë nga humbja e lehtë ose e moderuar e shikimit në njërin ose të dy sytë deri në humbje të konsiderueshme ose të plotë të shikimit në të dy sytë. Disa njerëz përjetojnë ulje ose mungesë ndjeshmërie ndaj ngjyrave të caktuara ose verbëri të ngjyrave, si dhe ndjeshmëri ndaj shkëlqimit.

Kjo perfshin:

**Verbëria e ngjyrave** - vështirësi për të dalluar ngjyrat në përgjithësi të kuqe dhe jeshile, ose të verdhë dhe blu, dhe ndonjëherë pamundësia për të perceptuar ndonjë ngjyrë.

**Shikimi i ulët** - përfshin shikimin e paqartë, shikimin vetëm të mesit të fushës vizuale, shikimin vetëm të skajeve të fushës vizuale dhe shikimin e turbullt.

**Verbëri** - humbje e konsiderueshme e shikimit në të dy sytë.

## (2) Kognitive, mësimore dhe neurologjike

Aftësitë e kufizuara njohëse, të të mësuarit dhe neurologjike përfshijnë çrregullime neurologjike, si dhe çrregullime të sjelljes dhe shëndetit mendor.

Kjo përfshin:

**Paragjykimi #7:** Personat me aftësi të kufizuara shoqërohen vetëm me njëri tjetrin. Shpesh në shoqëri është një përshtypje se personat me aftësi të kufizuara dëshirojnë të shoqërohen vetëm me persona tjerë me aftësi të kufizuara. Në fakt, si gjithë tjerët, edhe personat me aftësi

të kufizuara zgjedhin shoqëritë e tyre në bazë të vlerave dhe interesave të përbashkëta.

**Paragjykimi #8:** Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të bëjnë jetë produktive. Personat me aftësi të kufizuara janë më se të aftë të marrin pjesë në jetën në komunitet. Ata/ato shkollohen, punojnë, kanë hobi, krijojnë familje, si të gjithë tjerët. Sfidat është të vihet fokusi në shkathtësitë e një individi e jo e kundërta.

### 1.9.1 Paragjykimet mbi personat me aftësi të kufizuara në shoqërinë kosovare

Në shoqërinë kosovare ekziston një trend mjaft negativ ndaj qasjes drejt personave me aftësi të kufizuara. Për shkak të mungesës së informatave dhe perceptimeve të gabuara në Kosovë ka shumë paragjykime diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Këto paragjykime në mungesë të trajtimit krijojnë bindje të gabuara, stimulojnë jo barazi dhe stigmatizojnë personat me aftësi të kufizuara. Në vijim janë të shënuara disa paragjykime që dalin shpesh në shoqërinë kosovare, dhe të cilat duhet të shmangen. Këto paragjykime janë identifi kua r nga organizata të personave me aftësi të kufizuar.

**Paragjykimi #1:** Personat me aftësi të kufizuara kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe kërkojnë lëmshë Gjendja ekonomike e personave me aftësi të kufizuara nuk lidhet domosdoshmërisht me aftësinë e kufizuar. Personat me aftësi të kufizuara punojnë sipas mundësive dhe kontribuojnë pozitivisht në shoqëri. Është shumë fyese t'i ofrohet lëmshë një personi me aftësi të kufizuar i/e cili/cila nuk kërkon lëmshë

**Paragjykimi #2:** Personat me aftësi të kufizuara mund ta bartin aftësinë e kufizuar tek të tjerët. Në Kosovë ende ekzistojnë disa ide fyese dhe të papranueshme për personat me aftësi të kufizuara. Në jetën e përditshme në Kosovë, shpesh personat me aftësi të kufizuara shmangen për shkak të frikës së pabazë se aftësia e tyre e kufizuar mund të bartet. Aftësia e kufizuar nuk mund të bartet, për dallim nga paragjykimet e gabuara.

**Paragjykimi #3:** Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të aftë të komunikojnë vet, prandaj komunikimi duhet të bëhet me asistentin/asistenten e tyre Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë integrale e shoqërisë dhe janë të aftë të komunikojnë. Aftësia e kufizuar nuk e kufizon aftësinë e komunikimit në shumicën e rasteve. Mos flisni me asistentin/asistenten e personit me aftësi të kufizuar por drejtoheni vetë individit. Nëse personi me aftësi të kufizuar ka problem me komunikim, këtë do ta kumtojë vetë ai/ajo apo personi që e ndihmon.

## 1.10 Kujdesi i përgjithshëm shëndetësor

Një gjendje shoqëruese është një gjendje shtesë e pavarur dhe e palidhur me gjendjen parësore.

Zbulimi dhe trajtimi i kushteve shoqëruese shpesh nuk menaxhohen mirë për personat me aftësi të kufizuara.

Dhe më vonë mund të ketë një ndikim negativ në shëndetin e tyre: për shembull, njerëzit me dëmtime intelektuale dhe probleme të shëndetit mendor zakonisht përjetojnë “hije diagnostikuese”.

Aftësia e kufizuar shoqërohet me një sërë kushtesh shëndetësore parësore:

disa mund të rezultojnë në shëndet të dobët dhe nevoja të larta për kujdesin shëndetësor; të tjerët nuk i pengojnë njerëzit me aftësi të kufizuara të arrijnë një shëndet të mirë. Për shembull:



- Një fëmijë i lindur i verbër mund të mos kërkojë në mënyrë specifike kujdes shëndetësor të vazhdueshëm për gjendje shëndetësore parësore dhe dëmtime të lidhura me to.
- Një adoleshent me një dëmtim traumatik të shtyllës kurrizore mund të ketë nevoja të konsiderueshme për kujdesin shëndetësor gjatë fazës akute të gjendjes parësore, por më pas mund të kërkojë vetëm shërbime për të ruajtur shëndetin - për shembull, për të parandaluar gjendjet dytësore.
- Të rriturit me gjendje kronike si p.sh skleroza e shumëfishtë, fibroza cistike, artriti ose skizofrenia mund të kenë nevoja komplekse dhe të vazhdueshme të kujdesit shëndetësor lidhur me gjendjen e tyre parësore shëndetësore ose dëmtime të lidhura me to.

### **1.10.1 Nevojat e përgjithshme të kujdesit shëndetësor**

Personat me aftësi të kufizuara kërkojnë shërbime shëndetësore për nevoja të përgjithshme të kujdesit shëndetësor si pjesa tjetër e popullsisë. Nevojat e përgjithshme shëndetësore përfshijnë promovimin e shëndetit, kujdesin parandalues (imunizimi, ekzaminimi i përgjithshëm i shëndetit), trajtimi i sëmundjeve akute dhe kronike dhe referimi i duhur për nevoja më të specializuara aty ku kërkohet. Të gjitha këto nevoja duhet të plotësohen përmes kujdesit shëndetësor parësor, përveç atij sekondar dhe terciar, sipas rastit. Qasja në kujdesin parësor shëndetësor është veçanërisht e rëndësishme për ata që përjetojnë një kufi më të hollë ose më të ngushtë të shëndetit për të arritur standardin e tyre më të lartë të arritshëm të shëndetit dhe funksionimit.

### **1.10.1 Rreziku i zhvillimit të kushteve shoqëruese**

Personat me aftësi të kufizuara kanë të njëjtin shëndet problemet që prekin popullatën e përgjithshme, si gripi dhe pneumonia. Disa mund të jenë më të ndjeshëm ndaj zhvillimit të kushteve kronike për shkak të ndikimit të faktorëve të rrezikut të sjelljes si rritja e pasivitetit fizik. Ata gjithashtu mund të përjetojnë fillimin më të hershëm

nga këto kushte. Një studim tregoi se të rriturit me aftësi të kufizuara zhvillimore kishin një shkallë të ngjashme ose më të madhe të kushteve shëndetësore kronike si presioni i lartë i gjakut, sëmundjet kardiovaskulare dhe diabeti sesa njerëzit pa aftësi të kufizuara.

Prevalenca e diabetit të njerëzit me skizofreni është rreth 15%, krahasuar me popullatën e përgjithshme norma prej 2–3%.

Disa njerëz me aftësi të kufizuara zhvillimore tregojnë shenja të plakjes së parakohshme në të 40-at dhe 50-at e tyre dhe ata mund të përjetojnë më shpesh kushte shëndetësore të lidhura me moshën. Për shembull, njerëzit me sindromën Down kanë një incidencë më të lartë të sëmundjes Alzheimer sesa popullata e përgjithshme, ndërsa njerëzit me dëmtime intelektuale (të palidhura me sindromën Down) kanë shkallë më të lartë të demencës.

Në Australi, njerëzit me aftësi të kufizuara të moshës 15-64 vjeç kishin më shumë gjasa të ishin mbipeshë ose obezë sesa njerëzit e tjerë (48% krahasuar me 39%) dhe të pinin duhan çdo ditë (3). Të dhënat e cituara nga Vëzhgimi i Faktorëve të Riskut të Sjelljes 2001 dhe 2003.

Sistemi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës raportoi gjetje të ngjashme. Personat me aftësi të kufizuara kanë përqindje më të lartë të pirjes së duhanit (30.5% krahasuar me 21.7%), kanë më shumë gjasa të jenë fizikisht joaktivë (22.4% krahasuar me 11.9%) dhe kanë më shumë gjasa të jenë obezë (31.2% krahasuar me 19.6%).

Një studim kanadez duke përdorur një kampion kombëtar tregoi se njerëzit me dëmtime dëgjimi kishin më shumë gjasa se popullata e përgjithshme të raportonin nivele të ulëta të aktivitetit fizik. Një studim në Ruandë raportoi se të rriturit me amputime të gjymtyrëve të poshtme të përfshira në sjellje të dobëta të lidhura me shëndetin si duhanpirja, konsumimi i alkoolit, përdorimi rekreativ i drogës dhe mungesa e ushtrimeve.

### 1.10.3 Promovimi dhe parandalimi i shëndetit

Keqkuptimet për shëndetin e personave me aftësi të kufizuara kanë çuar në supozimet se personat me aftësi të kufizuara nuk kanë nevojë për akses në promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve.

Provat tregojnë se ndërhyrjet në promovimin e shëndetit, si aktivitetet fizike, janë të dobishme për personat me aftësi të kufizuara. Por aktivitetet e promovimit të shëndetit rrallë synojnë njerëzit me aftësi të kufizuara dhe shumë prej tyre përjetojnë pengesa të shumta për pjesëmarrje. Për shembull, aksesit i kufizuar në promovimin e shëndetit është dokumentuar për njerëzit me sklerozë të shumëfishtë, goditje në tru, poliomielit, dëmtim intelektual, dhe probleme të shëndetit mendor.

Ndërsa disa kërkime tregojnë dallime minimale në normat e imunizimit, njerëzit me aftësi të kufizuara në përgjithësi kanë më pak gjasa të marrin shërbime depistuese dhe parandaluese. Disa studime zbuluan se gratë me aftësi të kufizuara marrin më pak ekzaminim për kancerin e gjirit dhe qafës së mitrës krahasuar me gratë pa aftësi të kufizuara, dhe burrat me aftësi të kufizuara kanë më pak gjasa të marrin.

### 1.10.4 Pabarazitë shëndetësore të përjetuara nga personat me aftësi të kufizuara

Mbretërinë e Bashkuar hetoi zyrtarisht vdekjet e parakohshme midis njerëzve me aftësi të kufizuara në të mësuar ose probleme të shëndetit mendor dhe raporte lokale për akses të pabarabartë në kujdesin shëndetësor midis 2004 dhe 2006.

Njerëzit me probleme afatgjata të shëndetit mendor - të tilla si depresioni i rëndë, çrregullimi bipolar ose skizofrenia dhe paaftësitë në të mësuar, si autizmi:

- Kishte më shumë gjendje shëndetësore kronike sesa popullata e përgjithshme. Ata kishin më shumë gjasa të ishin obezë dhe të kishin sëmundje të zemrës, presion të lartë të gjakut, sëmundje të frymëmarrjes, diabet, goditje në tru ose kancer gjiri. Njerëzit me skizofreni kishin gati dy herë më shumë gjasa të kishin kancer të zorrëve. Megjithatë regjistrimi i njerëzve me aftësi të kufizuara në të mësuar në mjediset e kujdesit parësor ishte i dobët, norma më të larta të sëmundjeve të frymëmarrjes dhe obezitetit në këtë populatë u treguan.
- Zhvillimi i sëmundjeve kronike në moshë më të re se njerëzit e tjerë. Për shembull, 31% e njerëzve me skizofreni u diagnostikuan me sëmundje të zemrës nën moshën 55 vjeç, krahasuar me 18% të të tjerëve me sëmundje të zemrës.
- Vdiq më shpejt pas diagnozës. Pesë vjet pas një diagnoze të sëmundjes së zemrës (përshtatur për moshën), 22% e njerëzve me skizofreni dhe 15% e njerëzve me çrregullim bipolar kishin vdekur, krahasuar me 8% të njerëzve pa probleme serioze të shëndetit mendor. Modeli ishte i ngjashëm për goditjen në tru dhe çrregullimin kronik obstruktiv pulmonar. Individitë kërkon kujdes shëndetësor dhe nuk merr kujdesin e nevojshëm.

Përqindjet						
	Vendet me të ardhura të ulëta		Vendet me të ardhura të larta		Të gjitha vendet	
	Me aftësi të kufizuara	Pa aftësi të kufizuara	Me aftësi të kufizuara	Pa aftësi të kufizuara	Me të kufizuara	Pa aftësi të kufizuara
Mashkull						
Nuk mund ta përballoja vizitën	40.2	58.8*	11.6	29.8*	33.5	53.0*
Nuk ka transport	18.4	16.6	6.9	28.3*	15.2	18.1
Nuk mund të përballoja transportin	20.1	30.6	2.1	16.9*	15.5	27.8*
Pajisjet e ofruesit të kujdesit shëndetësor joadekuate	8,5	18,7*	5,0	27,8*	7,7	22,4*
Aftësitë e ofruesit të kujdesit shëndetësor të pamjaftueshme	5.8	14.6*	9.9	13.5	6.7	15.7*
Ishin trajtuar keq më parë	4.6	17.6*	7.2	39.6*	5.1	23.7*
Nuk mund të merrja pushim	9.5	11.9	6.2	7.9	8.8	11.8
Nuk dija ku të shkoja	5.1	12.4	1.5	23.1	4.3	15.1
Personi nuk mendoi se ai/ajo fëmija ishte mjaft i sëmurë	42.6	32.2	44.1	18.0	43.7	28.4
Provova por iu mohua kujdesi	5.2	14.3	18.7	44.3	8.5	23.4
Femër						
Nuk mund ta përballoja vizitën	35.6	61.3*	25.8	25.0	32.2	51.5*
Nuk ka transport	14.0	18.1	7.9	20.4*	13.8	17.4
Nuk mund të përballoja transportin	15.3	29.4	4.4	15.2	13.3	24.6
Pajisjet e ofruesit të kujdesit shëndetësor joadekuate	10,2	17,0	8,4	25,7*	9,8	17,0
Aftësitë e ofruesit të kujdesit shëndetësor të pamjaftueshme	5.3	13.6	8.9 *	20.6*	6.3	15.7
Ishin trajtuar keq më parë	3.7*	8.5*	9.3	20.1*	5.3	10.2
Nuk mund të merrja pushim	6.1	8.3	8.3	17.8	6.6	10.6
Nuk dija ku të shkoja	7.7	13.2	9.3	16.2	9.0	12.2
Personi nuk mendoi se ai/ajo fëmija ishte mjaft i sëmurë	30,7	28,2	21,3	22,6	29,3	29,3
Provova, por iu mohua kujdesi	3.8	9.0	19.6	54.6	7.3	21,7*

**Fig. Adresimi i barrierave për kujdesin shëndetësor**

-Analiza e të dhënave të Anketës Botërore të Shëndetit tregoi një ndryshim domethënës midis burrave dhe grave me aftësi të kufizuara dhe njerëzve pa aftësi të kufizuara për sa i

përket barrierave të qëndrimit, fizik dhe nivelit të sistemit me të cilat përballen aksesit ndaj kujdesit (shih Tabelën) identifikoi koston, distancën dhe mungesën e transportit si arsye për të mos përdorur shërbimet, së bashku me shërbimet që nuk janë më të dobishme ose individit nuk është i kënaqur nga shërbimet.

### 1.11 Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, më shumë se një bilion njerëz në të gjithë botën jetojnë me aftësi të kufizuar. Këta persona, përgjithësisht, kanë më shumë probleme shëndetësore, mundësi më të pakta ekonomike, edukim dhe arritje akademike më të ulëta. Kjo ndodh më së shumti për shkak të barrierave me të cilat ata përballen në jetën e tyre të përditshme, se sa si rrjedhje ekskluzive e aftësisë së kufizuar.

Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar (3 dhjetor), u vendos me Rezolutën 47/3 në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i kësaj dite është promovimi i të drejtave, mirëqenies, si dhe rritja e ndërgjegjësimit lidhur me situatën e personave me aftësi të kufizuar në të gjitha sferat e shoqërisë dhe aspektet e zhvillimit – jetës politike, sociale, ekonomike dhe kulturore.

Aftësia e kufizuar nuk është thjesht një çështje e shëndetit publik, por gjithashtu e të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të shoqërisë. Përpjekjet e OBSH-së për të mbështetur shtetet në aspekte të ndryshme, reflektohen në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2014-2021, në Raportin Botëror për Aftësinë e Kufizuar, si dhe në Konventën e të Drejtave për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, e ndërtuar përgjatë disa dekadave të punës së Kombeve të Bashkuara dhe përshtatur në vitin 2008, ka përparuar edhe më shumë me implementimin e Agjendës për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, dhe dokumenteve të tjera të ngjashme.



## 2 Metodologjia

Metoda hulumtuese e cila është përdorur në këtë punim për arritjen e informatave të dëshiruara është rishikimi i literaturës. Burimet të cilat janë shfrytëzuar për marrjen e këtyre informatave përfshijnë: literaturën nga librat elektronik si dhe artikujt e tjerë mjekësor shkencor nga interneti.

Për këtë punim është përzgjedhur organizata “HandiKos” të cilët kemi marr informata rreth organizatës për qëndrimet rreth personave me aftësi të kufizuara.

## 3 Rezultatet

Përqindja e personave me aftësi të kufizuara është më e larta në Jug të Shteteve të Bashkuara.

61 milionë të rritur në Shtetet e Bashkuara jetojnë me aftësi të kufizuara.

Organizata Botërore e Shëndetësisë vlerëson se rreth 15% e popullsisë së botës ka aftësi të kufizuara.

Në Kosovë jetojnë mbi 200 mijë persona me aftësi të kufizuara apo rreth 10 për qind e popullsisë së përgjithshme.

Rreth 1.3 miliardë njerëz - rreth 16% e popullsisë globale - aktualisht përjetojnë paaftësi të konsiderueshme. Aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet individëve me një gjendje shëndetësore, si paraliza cerebrale, sindroma Down dhe depresioni, me faktorët personalë dhe mjedisorë duke përfshirë qëndrimet negative, transportin e paarritshëm dhe ndërtesat publike dhe mbështetjen e kufizuar sociale.

Sipas rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011, numri i fëmijëve të moshës 0 deri në 14 vjeç të raportuara me një ose më shumë vështirësi të afatgjata është 3,298. Ndërsa, 1,555 fëmijë të moshave 15-19 vjeç janë raportuar me një ose më shumë vështirësi dhe 1,639 të rinj të moshave 20-24 vjeç me një ose më shumë vështirësi të raportuara. Numri rritet ndjeshëm në mes të moshave 55 dhe 69 dhe pastaj pëson rënie përsëri. Në të gjitha kategoritë, numri i meshkujve të raportuar është më i lartë se femrat.

Mosha	“Shurdhimi ose dëmtimi i rëndë i dëgjimit”	“Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit”	“Një gjendje që kufizon në mënyrë thelbësore një ose më shumë aktivitete fizike bazë të tilla si ecja, ngjitja e shkallëve, ngritja ose mbajtja e gjërave.”	“Një paaftësi në të mësuar ose intelektual”	“Një vështirësi e gjatë psikologjike ose emocionale”	“Të tjera, duke përfshirë çdo sëmundje të gjatë”
0-14	355	431	1,050	684	616	865
15-19	123	155	513	348	351	418
20-24	200	127	562	315	385	398
25-29	191	135	608	318	456	522
30-34	212	146	926	334	536	708
35-39	245	220	1,312	366	738	1,178
40-44	321	299	1,644	351	780	1,497
45-49	401	488	2,181	294	725	2,068
50-54	564	732	2,587	312	693	2,915
55-59	687	946	3,211	284	667	3,430
60-64	928	1,073	3,515	340	595	3,817
65-69	1,197	1,170	3,745	368	464	3,764
70-74	1,434	1,189	3,757	451	456	3,172
75-79	1,365	1,091	3,054	403	313	2,177
80+	1,712	1,233	2,902	439	358	1,682
<b>Totali</b>	<b>9,935</b>	<b>9,435</b>	<b>31,567</b>	<b>8,133</b>	<b>8,133</b>	<b>28,611</b>

**Fig.1 Sipas Censurit 2011, numri i fëmijëve të moshës 0 deri në 14 vjeç sipas numrit të vështirësive afatgjata, me vetëm një vështirësi të raportuar është 2,811.**

Janë 1308 fëmijë të moshës 15-19 vjeç me një vështirësi të raportuar dhe 1397 të rinj të moshës 20-24 vjeç gjithashtu me një vështirësi të raportuar.

Numrat rriten midis moshës 55 dhe 69 vjeç dhe më pas bien përsëri. Në të gjitha kategoritë, numri i meshkujve të raportuar është më i lartë se i femrave

**Fig.2 Përqindja e të rriturve me lloje të paaftësisë funksionale në Shtetet e Bashkuara**




Fig.3 Të rriturit që jetojnë me aftësi të kufizuara kanë më shumë gjasa të:






Fig.4 Lloji i aftësisë së kufizuar në Shqipëri (%)



Prevalenca (%) e çdo abuzimi në moshën madhore, që nga mosha 15 vjeç, mesatarja rajonale dhe sipas vendit, midis të gjitha grave (N=13,826) dhe të gjitha grave me aftësi të kufizuara (N=1,002)



Në organizaten Handikos janë të anëtarësuar 1325 anëtarë në komunën e Gjilanit, 40 prej tyre janë fëmijë. Mbi 16.000 persona të antarësuar në gjithë Kosovën , Rreth 4000 fëmijë përfitues të shërbimeve.

Gjinden nga një staf shëndetësor prej tyre janë: një Infermiere, një psikologe, një logopede, edukatore dhe një punonjëse sociale.

Brenda muajit sillen rreth 19 fëmijë. 10 prej tyre janë femra dhe 9 meshkuj, mirëpo Brenda vitit lëviz numri.

Në këtë organizatë gjinden të gjitha llojet e përsoneve me aftësi të kufizuar. **Ndërmarrin shumë lloje aktivitësh sikurse Fizioterapi për parandalimin e aftësisë së kufizuar me paralizë cerberale. Lopgopedi, psikosociale, ekskurzione etj..**

Përsoneat me aftësi të kufizuar disa janë të punësuar në Eko higjiena, komunë, ashtu si-kurse punë private dhe shtetërore.

504 fëmijë janë ne shkolla fillore nga mosha 7 deri 15 vjeq, 153 prej tyre kanë nga një asistent, dhe 4 vajza janë në fakulltet që kanë problem me aftësi fizike.

Në disa objekte janë bërë lehtësime për përsoneat me aftësi të kufizuar fizike siq janë: dy kopshte, dy shkolla fillore, një gjimnaz, një shkollë e mesme teknike për ekonomi dhe shkolla e muzikës.



*Fig 1. Pjerrina e modernizuar nga projekti i realizuar në shkollën fillore “Thimi Mitko” në Gjilan*

Gjilan	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
Pjerrina	3	/	2
Tualete	/	/	5
Sportele	5	/	/
Qasja nga trotuari	3	/	5

*Fig 2. Qasshmëria në pjerrina (rampa), tualete, sportele nëpër QMF dhe Ambulanca*



-Ne kemi vërejtur se objektet shëndetësore duke filluar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat tjera dhe Ambulancat në përgjithësi nuk ofrojnë qasje fizike për PAKF. Tre nga to ofrojnë qasje apo hyrje të kënaqshme. 12 përmes pjerrinave apo rampave në objekt për PAKF. Dy të tjera të cilat edhe pse kanë pjerrina, janë jofunksionale dhe të paqasshme nga PAKF.

	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
Pjerrina	4	2	1
Tualete	5	/	2
Qasja nga trotuari	5	/	2

**Fig 3. Qasshmëria në trotuare, pjerrina (rampa), tualete nëpër objektet shkollore**



**Fig. 4 Foto të hapsirave plotësisht, pjesërisht dhe aspak të qasshme**



**Fig. 5 Teatri i qytetit të Gjilanit ofron pjerrina plotësisht të qasshme për PAK.**



***Fig.6 Shërbimet komunale ofrojnë  
pjerrina pjesërisht të qasshme për PAK***



***Fig.7 Një pjesë e qytetit aspak e qasshme për PAK***

## Pytësori

### 1. Qfarë shërbimesh ofrojnë organizata juaj?

- Ofrojnë trajtimin për personat me aftësi të kufizuar, për të rritur dhe fëmijë. Rehabilitim primar fizikal, rehabilitim psiko-motorik, parapërgaditje të fëmijëve për shkollim, shërbime të ofruara në shtëpi, mbështetje këshilla dhe asistenc ligjore në përmbushjen e të drejtave sipas legjistacionit në fuqi. Shërbime me mjete ortopedike karrocat, lëvizje statike, karroc tualeti, shërbime logopedike dhe psikologjike.

### 2. Cfare keni punë primare?

- Punë primare kemi fëmijët të moshes 1-15 vjec, parapërgaditjen për shkollë, socializimin me fëmijët tjerë, vetëkujdesin për fëmijë.

### 3.Sa anëtarë bëjnë pjesë në këtë organizatë?

- Mbi 16.000 persona të antarësuar në gjithë Kosovën , Rreth 4000 fëmijë përfitues të shërbimeve. Gjithsej janë 1325 anëtarë në komunën e Gjilani, prej tyre fëmijë 40. Brenda muajit lëvizin rreth 19 fëmijë që 10 janë femra dhe 9 meshkuj, mirëpo numri i tyre brenda vitit lëvizë.

### 4.Cilat janë llojet e aftësisë të kufizuar që ofroni shërbime?

- Në organizatën tonë gjenden të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar psikomotorik, paraliz cerebrale, sindroma down etj...

### 5.A keni staf të mjaftueshëm shëndetësorë?

- Nuk kemi staf të mjaftueshëm janë vetëm një Infermiere,Logopede,Fizioterapeute,edukatore, punonjëse sociale.

### 6. A ju ofrojnë ndihmë instrucionet e Kosovës ndaj PAK?

- Kemi shumë pak përkrahje nga komuna që iu ofrojnë Subvencione me një shumë minimale, kemi përkrahje me projekte të ndryshme, mirëpo dy vitet e fundit kanë filluar të vetëdijësohen që sivjet kemi ndërmarrë ndihmë nga “Ministria e financave të punës dhe transfereve.

### 7. A ju mohohet e drejta e punësimit të PAK?

- Jo aspak, kemi person me aftësi të kufizuar të punësuar në Eko Hixhienë, Komunë, në disa punë private dhe shtetërore. Ligji e lejon gjdo 50 persona nga një person me aftësi të kufizuar.

### 8.A ju mohohet e drejta e shkollimi të PAK?

- 504 fëmijë gjithësej janë në shkolla fillore nga mosha 7 deri 15 vjeq. 153 fëmijë kan nga një asistent dhe 5 persona me aftësi të kufizuar fizike femra në fakulltet.

### 9.A hasni problem në mbajtjen e tyre?

- Jo aspak për ne nuk është problem, është pak problem për disa në socializimin e njerzve apo fëmijëve tjerë kurse san a përket neve jo.

### 10.A ankohen ndonjëherë familjaret apo personat për cënim të drejtave?

- Sa i përket Handikos-it jo.

## 4. Perfundimi

Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara. Këto të drejta do tu jepen të gjithë personave me aftësi të kufizuara pa asnjë përjashtim dhe pa dallim ose diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, moshës, gjuhës, fesë, opinioneve politike ose të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, gjendjes së pasurisë, lindjes ose ndonjë tjetër, situatë që zbatohet ose për vetë personin me aftësi të kufizuara ose për familjen e tij ose të saj.

- Në Kosovë jetojnë mbi 200 mijë persona me aftësi të kufizuara apo rreth 10 për qind e popullsisë së përgjithshme.
- Rreth 1.3 miliardë njerëz - rreth 16% e popullsisë globale - aktualisht përjetojnë paaftësi të konsiderueshme.
- Në organizatën Handikos janë të anëtarësuar 1325 anëtarë në komunën e Gjilanit, 40 prej tyre janë fëmijë. Mbi 16.000 persona të antarësuar në gjithë Kosovën , Rreth 4000 fëmijë përfitues të shërbimeve.
- Nuk gjinden kushte të mjaftueshme, por veqse kanë filluar të vetëdijësohen.
- Në komunën e Gjilanit kanë ofruar disa kushte për lehtësimin e personave me aftësi të kufizuar nëpër disa shkolla fillore dhe institucione tjera.
- Kanë të drejta punësimi si dhe ashtu shkollimi.

## Referencat:

1. Disability History: The Disability Rights Movement - National Park Service--<https://www.nps.gov/articles/disabilityhistoryrightsmovement.htm>
2. Disability in the medieval period 1050-1485-<https://historicengland.org.uk/research/inclusive-heritage/disability-history/1050-1485/>
3. Historia e Aftësisë së Kufizuar dhe Përfaqësimi i saj në Kulturën Popullore, Şengün-<https://www.yoair.com/sq/blog/the-history-of-disability-and-its-representation-in-popular-culture/>
4. Convention on the Rights of Persons with Disabilities | OHCHR, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-rights-disabled-persons>
5. N Y L N National Youth Leadership Network, 2006 NYLN and KASA [https://www.aucd.org/docs/add/sa\\_summits/Language%20Doc.pdf](https://www.aucd.org/docs/add/sa_summits/Language%20Doc.pdf)
6. Types of Disabilities, © 2023 Yale University <https://usability.yale.edu/web-accessibility/articles/types-disabilities>
7. "Raporti i Botës për Aftësinë e Kufizuar", Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2011, fq.9
8. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2006. [http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd\\_albanian.pdf](http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf)
9. Emergency Handbook, UNCHR, [CRPD, 2006, A/RES/61/106- <https://emergency.unhcr.org/entry/67443/persons-with-disabilities>
10. The biggest barrier for people with disability is how society disables them, Thursday, 22 July 2021-<https://epicassist.org/the-biggest-barrier-for-people-with-disability/>
11. "Rregullat e Mirësjelljes për Personat me Aftësi të Kufizuara", Shoqata e Bashkuar për Korriz [United Spinal Association], 2009 <https://www.unitedspinal.org/pdf/DisabilityEtiquette.pdf>

12. Working Together: Ensuring People with Disabilities Feel Welcome and Included in the Workplace-<https://askearn.org/page/disability-etiquette>
13. DORACAK PËR QASJEN DHE TERMINOLOGJINË E DREJTË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, Grupi për Qasje në Zgjedhje 2016, [http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/DORACAKU\\_GQZ\\_ALB\\_966740.pdf](http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/DORACAKU_GQZ_ALB_966740.pdf)
14. Bragge - Conflict and Resource Development: In The Southern Highlands of Papua New Guinea - 2007.fq.58
15. Bragge - Conflict and Resource Development: In The Southern Highlands of Papua New Guinea - 2007.fq.60
16. SITUATION ANALYSIS – UNICEF-European Union and UNICEF.” Katalogimi në botim – [CIP] Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani, by Paula Frederica Hunt dhe Vjollca Belegu-Caka. – Prishtinë : Unicef, 2018. – 150



# Kujdesi infermieror ndaj Pacientit pas Ndërhyrjes Kirurgjikale

---

Anjeza Morina,  
Zana Gashi

---

## 1. Hyrje

Infermieri/infermierja e kirurgjisë është ai/ajo, që specializohet në kujdesin operativ, duke bashkëpunuar me kirurgun dhe pacientin: para, gjate dhe pas ndërhyrjes kirurgjike. Infermiera kirurgjikale ka detyra të ndryshme në varsi të trajtimit dhe ndihmës që i jepet pacientit, përgaditjet e tij nga ana fizike dhe emocionale. Duke filluar me shpjegimin e procedurave operative dhe kontrollin e shenjave vitale, administrim e terapis përkatëse deri të sterilizimi i materialeve dhe asistimi që i jepet kirurgut në teatrin operator.

Infermieri është pjestar aktiv gjatë trajtimit kirurgjikal në të gjithë fazat e tij, nga ajo fillestare deri te procesi i kurimit përfundimtar. Kujdesi post-operator është pjesa e rëndësishme e infermierisë në pavionet tona, kjo përfshin; ndërrimin e plagave, monitorizimin constant të parametrave fizik, observimin për shenjat fillestare të komplikacioneve dhe administrimin e terapis përkatëse.

Puna e infermierit përmbledh në vetvete shumë sakrefica dhe orë jo-sociale, nga ana tjetër krijojnë një satisfaksion të veçantë duke qenë pjesë e stafit që sjell ndryshime substanciale në lehtësimin e dhimbjes apo/dhe shpëtuar jetën e pacientëve.

Si pjestar aktiv i një grupi primar të ndërhyrjeve finale mjeksore, infermieri i kirurgjisë ka përgjegjësi të veçanta në njohurit dhe aftësit e tij praktike.

## 2. QËLLIMI I HULUMTIMIT:

Ky hulumtim ka për qëllim të tregojë se si kryhet kujdesi infermieror ndaj pacientave pas ndërhyrjes kirurgjike, gjatë kryerjes së detyrave të tyre në repartin e Kirurgjisë përmes intervistave të cilën e kam zhvilluar me dy infermiere në Spitalin Rajonal të Prizrenit, veçanërisht tregohet për procedure, trajtimet, sfidat, deri tek dalja e pacientit nga spitali.

### 2.1 Pyetjet hulumtuese

Unë kam përdorur dy pyetje hulumtuese për ta arritur këtë hulumtim:

1. Cilat janë sfidat me të cilat përballen infermierët në repartin e Kirurgjisë?
2. Sa i japin rëndësi kujdesit ndajë vetës infermiert në orarin e punës ?

### 2.2 Hipoteza

- I. Puna e infermierëve në kirurgji vështirsohet nga sfidat me të cilat përballen ata.
- II. Në kirurgji infermierët e marrin në konsideratë shëndetin e tyre.

### 2.3 Konceptët Bazë

**Infermierët**- janë përgjegjës për kujdesin e të gjithë individëve nga çdo përkatësi etnike dhe fetare, duke përfshirë individë të shëndetshëm dhe të sëmurë. Kjo është zakonisht një qasje e kujdesit holistik që përbëhet nga kërkesat fizike, emocionale, psikologjike, intelektuale, sociale dhe shpirtërore të pacientëve.

**Shëndeti** - është "gjendja e mirëqenies së plotë fizike, shpirtërore dhe sociale e jo vetëm mungesa e sëmundjes dhe rraskapitja

**Departamenti i Kirurgjisë**- është pjesë e një spitali që ofron kujdes për pacientët që kanë nevojë për kujdesin kirurgjik.

## 3. METODOLOGJIA

### 3.1 Dizajni i hulumtimit

Ky është një hulumtim kualitativ ku për grumbullimin e të dhënave përdora metodën me intervistë të strukturuar me 10 pyetje tek infermierët, dhe me pikat që u fokusua arriem të nxjerrim informacionet për punimin time. Analiza e të dhënave është bërë duke përdorur analizën përmbajtësore.



### 3.2 Pjesëmarrësit

Për realizimin e këtij hulumtimi morrën pjesë vetëm 2 infermierë që punojnë në repartin e kirurgjis në Spitalin Rajonal të Prizrenit, të cilët ishin në dijeni paraprakisht për hulumtimin dhe pranuan të ishin pjesë e tij. Sa i përket gjinisë morrën pjesë vetëm dy femra ku sa i përket përvojë pune kishin 12 vite përvojë pune.

### 3.3 Procedura

Intervista u bë me pëlqimin e tyre edhe pse me një numër të vogël sepse të tjerët nuk shprehën dëshirë për të qenë pjesë e këtij hulumtimi kurse pala tjetër në pamundësi e tyre për shkak të punës së ngarkuar. Infermierët që morrën pjesë u informuan lidhur me hulumtimin dhe se çfarë kishte për qëllim ky hulumtim. E gjithë intervista është bërë me konfidencialiteti të madh, edhe për këtë ata u njoftuan paraprakisht në mënyrë që mendimet, pikëpamjet e tyre të mund ti shprehin lirshëm dhe pa u ndjerë në presion.

## 4. REZULTATET

Rezultatet janë arritur nga intervistat e bëra përmes përgjigjeve të marrura nga infermierët e repartit të kirurgjisë në lidhje me pikat që përmban ky hulumtim.

### 4.1 Gjinia e infermierëve

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim ishin 2 femra infermierë të cilët ishin të gatshëm për të bërë intervistën.

### 4.2 Përvoja e punës

Sa i përket kësaj pjese, infermieret të dyja kishin nga 12 vite përvoj pune gjë që tregon që kan përvoj të mire në pune.

### 4.3 Përgjigjet e intervistave të infermierëve:

#### **P.1: Sa i kushtoni rëndësi shëndetit tuaj në vendin e punës?**

**Intervista 1.** –Rëndësia që i kushtoj vetës time sigurishtë është në maksimum, sepse shëndeti për mua është I rëndësishem duhet të mbrohem.

**Intervista 2.** –Sigurishtë që duhet ti kushtoj vetës rëndësi, sepse nëse ne nuk kujdesemi për vetën tonë, atëher nuk do të mund të kujdesëm për pacientët, shëndeti mbi të gjitha.

**P.2: Sa jeni e kënaqur me profesionin tuaj?**

**Intervista 1-** Unë si një vajze e re e kam pasur ëndërr të bëhem infermiere dhe ja i'a arrita qëllimit, jam e kënaqur me punën time dhe jam e punsuar rreth 12 vite.

**Intervista 2-** Unë jam krenare me punën time, infermiera cilesohet si pune humane, e vlersoj këtë pjesë shumë, në shërbim të popullit gjithmon.

**P.3: Si e menaxhoni një pacient të vështirë?**

**Intervista 1-**Nëse po flasim për gjatë dhënjes së shërbimeve, nëse pacienti është dhe vazhdon të jetë i vështirë sigurisht kërkojm ndihmë, asistent të mjaftueshëm deri në përfundim të shërbimeve.

**Intervista 2-** Zakonisht të këtij lloji pacienti nuk është që kemi por normal mundohemi të flasim but, qet në mënyre që të bindim që gjithqka është për të mirën e tij/saj dhe nëse metoda për qetësim nga ana jonë nuk funksionon atëherë duhet ta lemë pacientin të pushojë dhe të qetësohet vetë nga problemet që e shqetësojnë.

**P.4: Si bëhet organizimi i asistences infermierore?**

**Intervista 1**

Elementet predominuese	Ndarja e punës
	Kontrolli i kohës së kryerje së aktivitetit
Struktura e sistemit organizativ	Veprimet më komplekse i kryejnë infermierët më me provojë.
	Veprimet më të thjeshta I kryejn infermieret më të reja.

**P.5 Pacientët pas operacionit ku dërgohet?**

Pacienti i operuar mund të pritet:

- a- Në repartet e Terapis Intensive kur kërkohet support për ruajtjen e funksioneve vitale.
- b- Në repartet e Terapis Semi- Intensive, kur nevojitet observacion dhe monitorim intensive.
- c- Direkt ne pavion kur nuk ka nevoj për observim dhe monitorim intensive

Pacienti kur mbrrin në repartin përkatës kalohet në shtratin e pargaditur më pare, në pozicion të shtrir mbi shpin deri në zgjimin e plote. Infermieri duhet të verifikojë akseset venoze dhe rruget infuzionale, pozicionimin e tyre dhe fiksimin. Duhet pozicionuar në mënyre korekte drenat, sonda nazo-gastrike, kateteri urinar dhe duke kontrolluar bandazhi i plages kirurgjikale.

Gjithashtu duhet kontrolluar terapia infuzionale dhe rregulluar shpejtesia e infuzioneve. Nëse është e nevojshme vazhdon oksigjenimi. Pacienti duhet të qëndroj në një ambient të qetë, pa zhurm, dhe me temperature ambienti të përshtatshme dhe duhet shmangur ndriçimi direkt.

**P.6: Cilat janë hapat që ndërmirren menjëher në orët e para post-operative?**

Frekuenca respiratore, thellsia e respiracionit, ngjyra e lëkurës, karakteristika e respiracionit (pjesëmarrja në respiracionin e muskujve, zhurma respiratore).
Frekuenca kardaike, TA, PVC, kur pacienti ka akses venoz central.
Gjendja e ndërgjegjës dhe orientimi kohë-hapsire.
Diureza (sasia, cilësia, frekuenca, orare e fluksit).
Temperatura e trupit Dhimbja, intensiteti, vendi dhe shtrirja.
Sasia dhe lloji i likidit të drenuar nga drenat dhe sonda nazogastrike.
Bandazhi i plagës (nëse është lagur apo jo).

**P.7: Cilat mund të jenë efektet e dhimbës post-operative në organet e tjera të trupit?**

Aparati respirator	Frymarrja shpesht dhe sipërfaqësore Grumbullim sekrecionesh
Aparati kardiovaskular	Rritja e frekuencës kardiake Rritja e rezistencës periferike Trombemboli venoz
Aparati gastrostinal	Nauze Të vjella Ileus paralitk
Aparati urinar	Retension hidrik Retension urinar
Metabolizmi	Status hiperkatabolik
Sfera psikologjike	Ankth, inat, depresion, pagjumësi.

**P.8 Si rrjedh procedura e mjeksimit dhe parandalimit të infeksionit të plagëve?**

Parandalimi i infeksionit të vendit kirurgjikal fillon që para intervenimit me përgaditjen e përshtatshme të lëkurës, vazhdon në fazën intra-operative me marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve që reduktojnë rrishtin dhe përfundon në fazën post-operative me një përkujdes të veçantë për mjeksimin e plagës dhe ndjekjen e drenave. Plagët duhet të mbrohen përmes dezinfektimit dhe mbulimit me gaza sterile. Para mjekimit duhet të lare me solucion dezinfektues, procedurë që duhet përsëritur edhe pas mjekimit. Heqja e bandazhit duhet të kryhet me procedurë sterile, por jo më parë se 24-48 ore pas intervenimit, me përjashtim të rasteve ku plaga paraqet infeksion ose hemoragji.

**P.9 Sa është sfiduese mungesa e mjeteve në nivelin e punës?**

**Intervista 1-** Sigurisht është sfidë e madhe, sepse sigurisht do të ndikoj në mënyrën e punës për kujdesin ndaj pacientëve.

**Intervista 2-** Sigurisht është sfidë për ne si staf por edhe për pacientët, sepse shume herë pacientët detyrohen të blejnë vet disa gjëra që janë mangësi në spital.

**P.10 Cilat janë informacionet që duhet dhënë pacientit para largimit nga spitali?**

Kur infermieri merr në ngarkim në fazën pre-operative pacientët përkatës, fillojnë që heret

stategjite edukuese për një dalje nga spitali. Familjarët dhe pacienti duhet të njohin sa më pare çka është e nevojshme për një dalje të sigurve, cilat janë aktivitetet vetëkuruese të parashikuara për tu realizuar pas daljes (psh: mjekimi i plages, mënyra e administrimit të medikamenteve antitrombotike) dhe të cilet mund të mbeshteten në rast nevoje.

Informacionet që duhet garantuar në momentin e daljes:

Trajtimi i plages dhe mjekimi,

Dieta (cilësi dhe sasi)

Aktiviteti fizik

Shenjat dhe siptomat që kërkojnë vëmendje të veçante

Periudha, mënyrat dhe vendet e rikontrollit.

## 4.4 Analizimi i të dhënave

### 4.4.1 Kënaqësia e ushtrimit të profesionit të infermierisë

Sipas përgjigjjeve të marrura nga 2 infermieret që bashk-biseduam ato ishin të kënaqura me punën e tyre për kaq shumë vite pune, treguan që jemi të gatshme gjithmonë të jemi në shërbim të popullit në përmirësimin e shëndetit të tyre, gjë që kjo gjë i bënte edhe më të lumtura.

### 4.5.1 Rëndësia e shëndetit tuaj në vendin e punës

Infermieret treguan që edhe pse ato kujdesën shumë për shëndetin e pacientëve në të njëjtën kohë ata mundohen ti kushtojnë rëndësi edhe shëndetit të tyre duke u përkujdesur për vetën e tyre në një nivel të lartë për shkak që nëse ne nuk jemi mirë as pacientët nuk do të jenë në gjendje të mire.

### 4.5.2 Menaxhimi i një pacienti të vështirë

Infermieret thonë se problemi me pacient është i rrallë por në rast se ndodhë që të kenë problem me pacient të cilët për arsye të ndryshme mund të sillen me agresivitet që kjo mund të bëhet edhe sfidë për ne, atëherë si fillim ato thonë se mundohen të komunikojnë me të në mënyrë të butë, të ia shpjegojnë se çdo gjë do të shkojë në mënyrë të duhur për të, gjithashtu nëse do të jetë një situatë më e rënde sigurisht kërkohet ndihma e kolegeve.

### 4.5.3 Mungesa e mjetëve në vendin e punës

Sipas infermierëve mungesa e mjetëve të punës kjo bëhet sfiduese për ta sepse kjo gjë vështirëson punën. Në rast se ka mungesë të mjeteve duhet gjetur forma të tjera për të përmbytur kërkesat e pacientëve. Nganjëherë ka raste kur disa gjëra pacienët janë të detyruar të blejnë vetë për shkak të mungesës së mjeteve në repart.

## 5. Diskutimet

### 5.1 Vërtetimi i hipotezave

- I. Puna e infermierëve në kirurgji vështirsohet nga sfidat me të cilat përballen ata.
- II. Në kirurgji infermierët e marrin në konsideratë shëndetin e tyre gjatë gjithë përvojës së tyre të punës.
- I. Këto dy hipoteza janë vërtetuar nga rezultatet e arritura në këtë hulumtim sepse sfidat me të cilat mund të përballen infermierët të tilla si mungesa e mjeteve është dicka që e vështireson procesin e punës, gjithashtu në kuader të vështiresive hyne edhe stresi në punë, pagat jo të kënaqura etj.
- II: Infermierët e marrin në konsideratë shëndetin e tyre sipas rezultatëve ata kujdesen për shëndetin e tyre në një nivel të lartë sepse e dinë dhe kuptojnë rëndësinë e shëndetit të tyre si diçka mbi gjithçka tjetër dhe mundohen që përveç se të kujdesen për të tjerët të kujdesen edhe për veten e tyre, sepse po most ë ishin ata mire sigurishtë që kujdesi nuk do të ishte mire për pacientet.

### 5.2 Çështjet etike

Si fillim 2 infermieret që morren pjesë në intervist janë njoftuar në lidhje me hulumtimin dhe se çfare pyetje kishte të bënte intervista, është siguruar konfidencialiteti në mënyre që të ndihen të lirshme për të shprehur mendimet e tyre të lira.

### 5.3 Limitet

Ky hulumtim kishte edhe limitet e veta ku në rradhë të parë si limit ishte numri i vogël i të të intervistuarve.

Mos dëshira për të marrë pjesë në hulumtim nga disa infermierë.

## 6. Përfundimi dhe rekomandimet

Të jesh infermierë/re të bënë të ndihesh krenarë me veten që ke zgjedhur një profesion të tillë dhe që mund të iu dalësh në ndihmë pacientëve të cilët kanë nevojë për një dorë të zgjatur kur ata sëmurën keq apo gjenden në rrezikë për jetën e tyre në mënyra të ndryshme ku ti bëhesh shpëtimtar për ta duke iu ofruar kujdes, trajtim ndihmë për atë që ata kanë nevojë. Megjithatë të jesh infermierë në Kosovë mund të them që është më sfiduese se në vendet tjera përshkak të kushteve që mund ti kemi nëpër spitale tona që shpesh herë dinë të mos jenë të mira e madje shumë sfiduese për të arritur kryerjen e një pune pa asnjë vështërsi dhe si është më së miri.

Ky hulumtim ka pasur qëllim të tregoj trajtimi infermieror se si bëhet ndaj pacientëve, të tregohet se si ec procedura gjate shërbimeve gjatë qenderimit ne spital deri tek largimi i pacientit nga spitali dhe edukimi pacientit se bashku me familjart e tij/saj, gjithashtu fokusi qëndron edhe tek sfidat gjate punes qe kane, dhe se sa kujdesen për veten e tyre pa marr

parasysh sfidave me të cilat përballen.

“Vëmendja e vazhdueshme e një infermierje të mire është po aq e rëndësishme sa operacioni më i mire i një kirurgi”

“Krahasimi me profesionet e tjera, orët e infermieris janë më të gjata, puna më e vështirë dhe pagesa është e papërshtatshme për sasin e energjis që duhet investuar.

## 6.1 Rekomandimet

Edhe pse momentalisht mund të jetë e përealizueshme mirëpo mund të jetë si një rekomandim i imi mundësimi i mjeteve që nuk gjinden në repart për disa procedura kirurgjikale ku detyrohen të dërgohen pacientët për të bërë ndërhyrjet kirurgjike në QKUK dhe të kene një orar më fleksibil të punës, dmth reduktimi i orëve të gjata të punës.



